



INTERKULTURA

**Revistë shkencore e Fakultetit të Shkencave Humane
Научно списание на Факултетот за хуманистички науки
Scientific Journal of the Faculty of Human Sciences**

7

Shkup/Skopje, 2025

INTERKULTURA

7

Botues / Editor

Fakulteti i Shkencave Humane / Faculty of Human Sciences

Universiteti "Nënë Tereza" në Shkup / Mother Teresa University in Skopje

Redaktori përgjegjës / Editor-in-chief

Mustafa IBRAHIMI

Këshilli botues / Editorial board:

Mustafa IBRAHIMI

Izer MAKSUTI

Mirvan XHEMAJLI

Arta TIKA – BEKTESHI

Rilind MAHMUDI

Edona VINCA

Redaksia ndërkombëtare / International editorial office:

Niko QAFOKU (SHBA)

Oliver Jens SCHMITT (Zvicër)

Thede KAHL (Gjermani)

Beata GRZESZCZAKOWSKA-PAWLIKOWSKA (Poloni)

Robert PICHLER (Austri)

Krisztián CSAPLÁR-DEGOVICS (Hungari)

Laszlo MARÁCZ (Hollandë)

Goran Bandov (Kroaci)

Emil LAFE (Shqipëri)

Kristaq JORGO (Shqipëri)

Begzad BALIU (Kosovë)

Sejdi GASHI (Kosovë)

Goran BASHIQ (Serbi)

Zeqirja NEZIRI (Maqedonia e Veriut)

Vebi BEXHETI (Maqedonia e Veriut)

Rubin ZEMON (Maqedonia e Veriut)

Ismet OSMANI (Maqedonia e Veriut)

Qatip ARIFI (Maqedonia e Veriut)

INTERKULTURA

Revistë shkencore e Fakultetit të Shkencave Humane
Научно списание на Факултетот за хуманистички науки
Scientific Journal of the Faculty of Human Sciences

7/2025

Përmbajtja / Contents

Mustafa IBRAHIMI7 INTERKULTURA (2018–2025): GJASHTË KONFERENCA DHE GJASHTË BOTIME NË SHËRBIM TË DIALOGUT SHKENCOR INTERKULTURA (2018–2025): SIX CONFERENCES AND SIX PUBLICATIONS IN THE SERVICE OF SCIENTIFIC DIALOGUE	7
Sejdi M. GASHI 11 TRIBUNË E RËNDËSISHME NDËRKOMBËTARE E MENDIMIT SHKENCOR AN IMPORTANT INTERNATIONAL FORUM OF SCIENTIFIC THOUGHT	11
Teuta ARIFI 15 INTELIGJENCA ARTIFICIALE DHE STUDIMI BASHKËKOHOR I LETËRSISË SHQIPE: QASJE METODOLOGJIKE, PEDAGOGJIKE DHE INTERPRETUESE ARTIFICIAL INTELLIGENCE AND THE CONTEMPORARY STUDY OF ALBANIAN LITERATURE: METHODOLOGICAL, PEDAGOGICAL, AND INTERPRETIVE APPROACHES	15
Mustafa IBRAHIMI 21 TRANSKRIPTIMI DHE ANALIZA GJUHËSORE E DIALEKTIT ARBËRESH PËRMES INTELIGJENCËS ARTIFICIALE LINGUISTIC TRANSCRIPTION AND ANALYSIS OF THE ARBËRESH DIALECT USING ARTIFICIAL INTELLIGENCE	21
Ismet OSMANI..... 29 PËRDORIMI I INTELIGJENCËS ARTIFICIALE NË KRIJIMIN E PËRMBAJTJEVE MEDIATIKE THE USE OF ARTIFICIAL INTELLIGENCE IN THE CREATION OF MEDIA CONTENT	29
Ajten HAJDARI – QAMILI 35 PËRFITIMET DHE RREZIQET NGA INTELIGJENCA ARTIFICIALE GJATË TË SHKRUARIT PUNIME SHKENCORE BENEFITS AND RISKS OF ARTIFICIAL INTELLIGENCE IN WRITING SCIENTIFIC PAPERS	35
Sejdi M. GASHI 47 GJUHA SHQIPE SI MJET IDENTIFIKUES DHE NDËRVEPRUES NË MJEDISËT SHUMËKULTURORE THE ALBANIAN LANGUAGE AS AN IDENTIFYING AND INTERACTIVE TOOL IN MULTICULTURAL ENVIRONMENTS	47
Vebi BEXHETI 55 ARBËRESHËT NË POEZINË E MARTIN CAMAJT <i>(Me rastin e 100 vjetorit të lindjes së poetit)</i> THE ARBËRESHË IN THE POETRY OF MARTIN CAMAJ (On the occasion of the 100th anniversary of the poet’s birth)	55

Rubin ZEMON.....	63
MENAXHIMI I DIVERSITETIT, STEREOTIPET KOLEKTIVE DHE POLITIKAT E KUJTESËS NË BALLKANIN PERËNDIMOR: IMPLIKIMET PËR ZGJERIMIN E BE-SË DHE KONSOLIDIMIN DEMOKRATIK	
DIVERSITY MANAGEMENT, COLLECTIVE STEREOTYPES, AND MEMORY POLITICS IN THE WESTERN BALKANS: IMPLICATIONS FOR EU ENLARGEMENT AND DEMOCRATIC CONSOLIDATION	
Izer MAKSUTI.....	70
QASJE NDËRGJUHËSORE NË MËSIMIN E FONETIKËS DHE FONOLOGJISË SË GJERMANISHTES SI GJUHË E HUAJ	
INTERLINGUAL APPROACHES IN TEACHING GERMAN PHONETICS AND PHONOLOGY AS A FOREIGN LANGUAGE	
Faton KRASNIQI.....	91
KONTRIBUTI I DR. MEHMET AHMETAJT PËR DIALEKTOLOGJINË SHQIPTARE.....	
CONTRIBUTION OF DR. MEHMET AHMETAJ ON ALBANIAN DIALECTOLOGY	
Qatip ARIFI.....	101
ENGLISH BORROWINGS IN THE ALBANIAN LANGUAGE: MORPHOLOGICAL, PHONOLOGICAL, AND SOCIOLINGUISTIC INTEGRATION ACROSS SEMANTIC FIELDS	
HUAZIMET E ANGLISHTËS NË GJUHËN SHQIPE: INTEGRIMI I TYRE MORFOLOGJIK, FONOLOGJIK DHE SOCIOLINGUISTIK NË FUSHAT SEMANTIKE	
Abdurrachim MAXHUNI.....	113
PROBLEME TË SINONIMISË TERMINOLOGJIKE NË GJUHËN SHQIPE	
PROBLEMS OF TERMINOLOGICAL SYNONYMY IN THE ALBANIAN LANGUAGE	
Rilind Mahmudi ¹ , Majlinda Ismaili-Mahmudi ²	119
THE INFLUENCE OF SEMANTIC ROLES ON SENTENCE STRUCTURE AND WORD ORDER IN ENGLISH AND ALBANIAN LANGUAGES	
NDIKIMI I ROLEVE SEMANTIKE NË STRUKTURËN E FJALISË DHE RENDIN E FJALËVE NË GJUHËN ANGLEZE DHE SHQIPE	
Drita XHEMAILI.....	127
TRANSFORMIMI I ROLIT TË MËSIMDHËNSIT TË GJUHËS GJERMANE (DaF) NË KONTEKSTIN E INTELIGJENCËS ARTIFICIALE	
THE TRANSFORMATION OF THE ROLE OF THE GERMAN LANGUAGE (DaF) TEACHER IN THE CONTEXT OF ARTIFICIAL INTELLIGENCE	
Albulena DEHARI	135
SHQIPJA E CENUAR NGA FJALËT E HUAJA	
ALBANIAN AFFECTED BY FOREIGN WORDS	
Izer MAKSUTI.....	141
Recension / Review	

UDC 316.723(062)(049.3)
UDC 050(497.7)"2018/2025"(049.3)

Punim studimor

Mustafa IBRAHIMI
Universiteti "Nënë Tereza" në Shkup
Fakulteti i Shkencave Humane
mustafa.ibrahimi@unt.edu.mk

**INTERKULTURA (2018–2025): GJASHTË KONFERENCA DHE GJASHTË
BOTIME NË SHËRBIM TË DIALOGUT SHKENCOR**

**INTERKULTURA (2018–2025): SIX CONFERENCES AND SIX
PUBLICATIONS IN THE SERVICE OF SCIENTIFIC DIALOGUE**

Nga viti 2018 deri në vitin 2020, konferencat shkencore janë organizuar nga prof. dr. Mustafa Ibrahim, si kryeredaktor në cilësinë e drejtorit të atëhershëm të Qendrës së Botimeve Akademike dhe Sistemit Bibliotekar (QBASB). Në këtë periudhë, Qendra, krahas botimit të librave akademikë, zhvilloi një sërë aktiviteteve shkencore e kulturore, ndër të cilat spikat edhe botimi i revistës *Interkultura*, ku do të botohen kumtesat e konferencave të mbajtura.

Me themelimin e Fakultetit të Shkencave Humane në vitin 2023 dhe zgjedhjen e prof. dr. Mustafa Ibrahim si dekan, organizimi i konferencave vazhdoi në kuadër të këtij institucioni, duke ruajtur vazhdimësinë tematike dhe standardet akademike. Deri më tani janë mbajtur gjashtë konferenca shkencore, të fokusuar në dialogun ndërkulturor, trashëgiminë kulturore, arsimin, gjuhën dhe komunikimin, si më poshtë:

- **Konferenca I** (3–4.05.2018): *Dialogu dhe diversiteti ndërkulturor*
- **Konferenca II** (8.11.2019): *Trashëgimia kulturore dhe interkultura*
- **Konferenca III** (26.10.2020): *Arsimi ndërkulturor*
- **Konferenca IV** (22.11.2023): *Gjuha, letërsia dhe komunikimi ndërkulturor*
- **Konferenca V** (22.11.2024): *Zhvillimi i arsimit kombëtar dhe gjuha shqipe*
- **Konferenca VI** (16.12.2025): *Komunikimi ndërkulturor në epokën e inteligjencës artificiale*

Këto konferenca përbëjnë një tribunë të rëndësishme ndërkombëtare të mendimit shkencor dhe kontribuojnë në mënyrë të vazhdueshme në zhvillimin e studimeve ndërkulturore dhe humaniste.

Revista shkencore *Interkultura* me numrin 6 filloi të botojë edhe punime origjinale, të cilat ofrojnë kontribute të reja dhe të rëndësishme për zhvillimin e dijes shkencore. Çdo dorëshkrim i paraqitur i nënshtrohet kontrollit për plagjiaturë dhe rastet e shkeljes së etikës akademike nuk pranohen për botim. Përgjegjësia për përmbajtjen shkencore dhe

korrektësinë gjuhësore të tekstit i takon autorit ose autorëve. Procesi editorial udhëhiqet nga Këshilli Botues i brendshëm dhe ndërkombëtar revistës.

Nga numri i parë i revistës “Interkultura” që doli në vitin 2018 dhe deri më tani që po promovohet pra numri gjashtë janë përfshi 47 autorë nga shtete të ndryshme dhe janë botuar 84 artikuj shkencorë. Autorët janë nga Kosova, Shqipëria, Zvicra, Kina dhe Maqedonia e Veriut. Dorëshkrimet pranohen në gjuhën shqipe, maqedonase, gjermane ose angleze, me kusht që të mos jenë botuar më parë dhe të mos jenë në shqyrtim paralel për botim në revista të tjera. Vetë autori e zgjedh gjuhën e botimit, me atë që abstraktet dhe titulli i kumtesës me doemos shkruhen në gjuhën angleze dhe gjuhën shqipe. Kjo do të thotë se autorët janë të përkatësive të ndryshme etnike, si ajo: shqiptare, maqedonase, turke, egjiptase, zvizerane dhe kineze. Studiuesit vijnë nga universitete të ndryshme të vendit dhe jashtë tij.

Me **kontributin më të madh të publikimeve shkencore** në gjashtë numrat e kësaj reviste dallohen autorët: **Mustafa Ibrahim** (me 6 publikime). Me nga katër publikime rradhiten: **Ajten Hajdari-Qamili (4)**, **Azis Pollozhani (4)**, **Rubin Zemon (4)** dhe **Zeqirja Neziri (4)**, të cilët kanë dhënë një numër të konsiderueshëm punimesh.

Në grupin e autorëve me **kontribute të rëndësishme** me nga tre kontribute bëjnë pjesë: **Avni Avdiu (3)**, **Begzad Baliu (3)**, **Drenusha Kamberi (3)**, **Rizvan Sulejmani (3)** dhe **Sejdi M. Gashi (3)**, të cilët kanë pasuruar botimin me qasje të ndryshme studimore.

Autorët me **dy kontribute** janë: **Agron Vrangalla (2)**, **Arta Tika-Bekteshi (2)**, **Avzi Mustafa (2)**, **Ismet Osmani (2)**, **Izer Maksuti (2)**, **Kosovare Krasniqi (2)**, **Majlinda Ismaili-Mahmudi (2)**, **Mixhait Pollozhani (2)**, **Qatip Arifi (2)**, **Rilind Mahmudi (2)**, **Sunaj Raimi (2)**, **Teuta Arifi (2)** dhe **Vebi Bexheti (2)**.

Me nga një **kontribut shkencor**, por me vlerë të veçantë tematike dhe profesionale, përfshihen: **Agron Kurtishi**, **Albulena Dehari**, **Asllan Hamiti**, **Berton Sulejmani**, **Chen Fenghua**, **Don Lush Gjergji**, **Drita Xhemaili**, **Elena Prenxhova**, **Farketa Dibra**, **Faton Krasniqi**, **Gjylmysere Kasapi**, **Izaim Murtezani**, **Jetlira Beqiri**, **Jordana Shemko**, **Kosta Millkov**, **Milica Denkovska**, **Mirjana Maleska**, **Mirvan Xhemaili**, **Muhamedali Ibrahim**, **Nebi Dervishi**, **Oliver Jens Schmitt**, **Sefer Tahiri**, **Viktoria Elenova** dhe **Xhemaludin Idrizi**.

Revista shkencore identifikohet në mënyrë unike përmes kodit **ISSN**, një numër standard ndërkombëtar prej tetë shifrash, i cili shërben për njohjen dhe regjistrimin e saj në bazat përkatëse bibliografike (ISSN: 2671-3004). Çdo punim i botuar pajiset gjithashtu me **UDC (Universal Decimal Classification)**, një sistem klasifikimi që, përmes një kodi numerik, përcakton fushën dhe përmbajtjen tematike të artikullit shkencor, duke lehtësuar indeksimin dhe qasjen akademike.

Revista ka të përcaktuara qartë **fushat e studimit** për të cilat botohet, çka siguron koherencë tematike dhe specializim shkencor. Sa i përket **gjuhës së botimit**, në rast të indeksimit në databaza ndërkombëtare si *Scopus* ose

Web of Science, pranohet botimi i artikujve edhe në gjuhën shqipe. Në të kundërt, artikujt duhet të jenë të shkruar në një nga pesë gjuhët zyrtare të Bashkimit Evropian.

Bordi editorial përbëhet nga pesë e më shumë anëtarë me gradën shkencore Doktor, të cilët e kanë fituar këtë titull në vende anëtare të OECD-së ose të Bashkimit Evropian, duke garantuar standarde të larta akademike dhe profesionale. **Vlerësimi shkencor** i dorëshkrimeve realizohet nga redaktorët e revistës në bashkëpunim me ekspertë të fushës përkatëse, në përputhje me parimet e recensimit shkencor.

Në përputhje me kriteret e transparencës dhe diversitetit institucional, parashihet që **jo më shumë se dy të tretat (2/3) e autorëve** të artikujve të botuar në një numër të revistës t'i përkasin institucionit botues, duke nxitur kështu përfshirjen e autorëve nga institucione të ndryshme akademike dhe kërkimore.

Botimet e deritanishme mund t'i gjeni në linkun e universitetit: <https://unt.edu.mk/sq/botime-te-unt-se/>

Në përmbyllje, shpreh mirënjohje e veçantë për të gjithë autorët pjesëmarrës në këto konferenca dhe për kontributin e tyre shkencor dhe angazhimin akademik për botimin e revistës "Interkultura". Falënderime u drejtohen gjithashtu edhe Ministrive të Kulturës dhe Sportit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhe Ministrisë së Shkencës dhe Arsimit, për mbështetjen e vazhdueshme të projekteve të realizuara deri më tani.

Në fund, u shprehet falënderim të gjithë të pranishmëve për vëmendjen dhe pjesëmarrjen në këtë promovim, ndërsa autorëve dhe recensentëve u urohen suksese dhe prurje të reja me vlerë në fushën e kërkimit shkencor.

Punim studimor**Sejdi M. GASHI**Instituti Albanologjik-Prishtinë
e-mail: sgashi.iap@gmail.com**TRIBUNË E RËNDËSISHME NDËRKOMBËTARE E MENDIMIT SHKENCOR**
AN IMPORTANT INTERNATIONAL FORUM OF SCIENTIFIC THOUGHT(Vlerësim për revistën shkencore "INTERKULTURA", botim i Universitetit
"Nënë Tereza", Fakulteti i Shkencave Humane, Shkup)

Revista shkencore "Interkultura, botim i Universitetit "Nënë Tereza" në Shkup, (Fakulteti i Shkencave Humane), ndonëse me një traditë jo shumë të pasur, por falë punës sistematike dhe seriozitetit shkencor, ka arritur të bëhet një prej tribunave serioze të mendimit shkencor jo vetëm brenda Maqedonisë së Veriut, por edhe gjithandej gjeografisë shqiptare dhe më gjerë. Numri i parë i kësaj reviste pa dritën e botimit më 2018. Revista është konceptuar si organ shkencor me karakter interdisiplinar në të cilën botohen studime nga fushat të ndryshme të dijës si: gjuhësia, letërsia, sociologjia, filozofia, antropologjia, komunikimi dhe studimet kulturore. Falë nivelit të mirë shkencor, sot, kjo revistë shërben si një hapësirë akademike bashkëkohore për diskutim shkencor, shkëmbim idesh dhe qasjesh metodologjike të ndryshme. Brenda një harku kohor fare të shkurtër, pra rreth shtatë vitesh ekzistence, revista për të cilën po flasim ka arritur që t'i "japë frymë" të re kërkimit shkencor, duke zbatuar standarde e metodologji bashkëkohore në fushë të mendimit shkencor. Në saje të qasjes proaktive të redaksisë, revista "Interkultura", sot, shërben jo vetëm si një hapësirë apo platformë publikimi, por edhe si nxitëse serioze e zhvillimit të mendimit dhe kërkimit të pavarur shkencor. Së këndejmi, nuk mund të shpërfillët roli i saj në afirmimin e studuesve të rinj dhe në promovimin e bashkëpunimit shkencor ndërkombëtar. Prandaj, ky segment, meritueshëm e bën këtë revistë një pasuri të madhe për mbarë ambientin shkencor në hapësirat tona.

Që në fillimet e para të revistës, është synuar që ajo të jetë një platformë akademike ku takohen perspektiva të ndryshme gjuhësore, kulturore dhe sociologjike, duke reflektuar edhe misionin e vetë

Universitetit “Nënë Tereza”, si një institucion universitar shumë-etnik dhe shumë-kulturor.

Në studimet e botuara në numrin e parë të kësaj reviste bie në sy qartësia konceptuale, vendosja e bazës së qartë terminologjike dhe metodologjike për diskutim mbi interkulturalitetin dhe elementet përbërëse të tij. Prandaj, marrë parasysh plotësimin e këtyre premisave, bindshëm themi se ajo edhe sot vazhdon ta përmbush kriterin e interdisiplinaritetit, pasi ndërthur qasje të ndryshme nga gjuhësia, letërsia, sociologjia, antro-pologjia dhe shkencat e edukimit. Vlerë e shtuar e revistës është botimi i një numri të konsiderueshëm studimesh empirike dhe përshkrimore, që i japin revistës karakter praktik dhe e vendosin atë në vijë lineare me realitetin shumë-kulturor të Maqedonisë së Veriut dhe më gjerë. Artikujt e botuar në këtë numër shquhen për nivelin e lartë shkencor, për metodologjinë bashkëkohore të punës dhe për bibliografinë e përzgjedhur me kujdes. Po ashtu, revista ka kultivuar dhe ruajtur një ekuilibër midis kontributit të autorëve të rinj dhe studiuesve të afirmuar, duke krijuar kështu një hapësirë dinamike shkencore.

Nëse ndalemi dhe i bëjmë një vështrim të shkurtër përmbajtjes së materies shkencore që është botuar në të gjashtë numrat e revistës shkencore “Interkultura”, atëherë kemi këtë pasqyrë:

1. Numri 1/2018 i revistës “Interkultura”, përmban nëntë artikuj studi-morë me gjithsej 115 faqe tekst. Në të janë botuar studime të rëndësishme shkencore nga fushat studimore si: gjuhësia, letërsia, sociologjia, studimet interkulturore, shkencat e komunikimit etj. Autorët, studimet e të cilëve kanë zënë vend meritore në këtë numër të revistës janë: Zeqirja Neziri, Mustafa Ibrahim, Rizvan Sulejmani, Avzi Mustafa, Gjylmser Kasapi, Sefer Tahiri, Rubin Zemon, Mirjana Malevska dhe Kosta Millkov.

2. Tutje, në numrin 2 të revistës “Interkultura”, botuar më 2019, në 130 faqe të saj, janë botuar nëntë punime shkencore nga fusha e shkencave humane. Së këndejmi, në këtë numër janë botuar punimet e autorëve dorëmbarë si: Aziz Pollozhani, ish- Rektor i Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, Zeqirja Neziri, Vebi Bexheti, Mustafa Ibrahim, Sunaj Raimi, Avzi Mustafa, Asllan Hamiti, Nebi Dervishi, Mixhait Pollozhani si dhe Rizvan Sulejmani. Të nëntë punimet e këtij vëllimi veçohen për akribinë shkencore dhe përgjegjësi profesionale e etika për fjalën e shkruar.

3. Në vijim, pra, saktësisht në vitin 2023 është publikuar numri 3/2023 i revistës “Interkultura”, në të cilën janë botuar 10 punime të autorëve të ndryshëm, të cilët kanë sjellë kontribut të vyer në botën e mendimit e të kërkimit shkencor. Autorët e këtij vëllimi janë: Azis Pollozhani, Don Lush Gjergji, Rizvan Sulejmani, Mustafa Ibrahim, Rubin Zemon, Ajten Hajdari Qamili, Ismet Osmani, Berton Sulejmani, Sunaj Raimi si dhe Mixhait Pollozhani. Ky vëllim përbëhet prej 126 faqesh.

4. Numri i katërt i revistës “Interkultura”, u nxor pas tri vitesh ndërprerjeje, pra më 2024. Kështu, në këtë numër dritën e botimit e kanë parë 17 artikuj shkencorë fushash të ndryshme . Ky vëllim përbëhet prej 191 faqesh me materiale shkencore të përgatitura me përkushtim. Emrat që kanë botuar në këtë numër janë: Zeqirja Neziri, Mustafa Ibrahim, Vebi Bexheti, Azis K. Pollozhani, Begzad Baliu, Ismet Osmani, Izaim Mutrtezani, Teuta Arifi, Rubin Zemon, Ajten Hajdari-Qamili, Sejdi M.Gashi, Agron Vrangalla, Arta Tika Bekteshi, Viktoria Elenova, Jordana Shemko Giorgievska& Elena Prençova si dhe në fund kemi punimin e Jetlira Beqirit.

5. Në po të njëjtin vit është botuar edhe numri i pestë i kësaj reviste në të cilin , kontributet e tyre shkencore i kanë paraqitur 20 autorë, si: Mustafa Ibrahim, Zeqirja Neziri, Vebi Bexheti, Xhemaludin Idrizi, Begzad Baliu, Ismet Osmani, Ajten Hajdari- Qamili, Farketa Dibra-Zeqiri, Arta Tika Bekteshi dhe Teutas Agaj Avdiu, Sejdi M. Gashi, Rlind Mahmuti & Majlinda Ismajli Mahmudi, Mirxan Xhemali, Rubin Zemon, MUhamedali Ibrahim, Avni Avdiu, Drenusha Kamberi dhe në fund të këtij numri kemi të botuar studimin e Albulena Deharit. Ky vëllim përmban 208 faqe tekst.

Të nderuar të pranishëm,

Kështu, viti pas viti e punim pas punimi, arritëm tek numri i gjashtë i revistës “Interkultura”, botuar tash së voni, pra më 2025, të cilin po e promovojmë sot. Në këtë vëllim 195 faqesh, kanë botuar gjashtëmbëdhjetë autorë, të cilët janë: Oliver Jens Schmitt, Mustafa Ibrahim, Begzad Baliu, Izer Maksuti, Ajten Hajdari- Qamili, Teuta Arifi, Qatip Arifi, Kosovare Krasniqi, Sejdi M.Gashi, Faton Krasniqi, Albulena Dehari, Agron Kurtishi & Agron Vrangalla, Avni Avdiu, Milica Denkovska, Drenusha Kamberi & Avni Avdiu, Rilind Hamudi & Majlinda Ismaili Mahmudi, Chen Fengua. Edhe ky numër i revistës me përmbajtjen e saj dallohet për vlerat e larta shkencore, për qartësinë konceptuale dhe interdisiplinaritetin si qasje.

Për fund fare, duhet thënë që nëse bëjmë një llogaritje të thjeshtë matematikore, shohim që deri më tani në të gjashtë numrat e botuar të revistës shkencore “Interkultura”, janë botuar 965 faqe materiale shkencore. Ndërkaq, numri i autorëve të ndryshëm që kanë botuar në këtë revistë është rreth tridhjetë.

Nga sa u tha më lartë, mund të përfundojmë se “Interkultura”, për këto shtatë vite të ekzistencës së vet ka rritur të ndërtojë një identitet të qëndrueshëm. Ajo, sot, ka një kornizë tematike të fuqishme me përmbajtje reale për kontekstin lokal dhe atë rajonal dhe si e tillë, ofron hapësirë të përshtatshme për studime që nuk mund publikohen lehtë në revista “të mëdha” ndërkombëtare, veçanërisht kur temat lidhen me identitetet, gjuhët dhe interkulturalitetin përgjithësisht. Prandaj, e vlerësojmë të drejtë orientimin e revistës e cila që në fillimet e saja është konceptuar si një revistë që do të sillte kontribute shkencore në fushën e interkulturalizmit, gjuhësisë, letërsisë dhe përkthimit, me artikuj të ndryshëm, që jo rrallë ndërthurin teorinë bashkëkohore në përshtatje për realitetin multikulturor të Ballkanit e në theks të veçantë të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Megjithatë, revista “Interkultura”, krahas sukseseve të pa diskutueshme,

sot, ballafaqohet edhe me disa sfida, nga të cilat do t'i veçonim: a) prania e saj jo e gjerë në bazat e të dhënave ndërkombëtare, e cila është e rëndësishme për të rritur ndikimin e revistës; b) botimi i artikujve në gjuhë të ndryshme (shqip, maqedonisht, anglisht), krijon sfida për kohezionin dhe qasjen për lexuesit që nuk njohin gjuhë të ndryshme; c) Revistat shkencore-botime të universiteteve, siç është edhe “Interkultura, jo rrallë varen nga përkrahja financiare e institucionit që i takon ose mbështetja e ministrive të kulturës, gjë që mund të çrregullojë rrjedhën e botimeve ose zhvillimin e mëtejshëm, dhe si sfida të fundit që do ta përmendja, është se, ndonëse revista “Interkultura”, promovon studime për interkulturalizmin, ende ngelet e pazgjidhur çështja e bashkëpunimit më të gjerë në rrafshin ndërdisiplinar me institucione dhe qendra kërkimore jashtë rajonit, për të sjellë perspektiva edhe më të arrira.

Urojmë e shpresojmë që këto sfida të tejkalohen sa më shpejt e sa më lehtë, që revista të ketë rrugëtim të mbarë e sa më shumë lexues!

Ju faleminderit!

Punim studimor

Teuta ARIFI

Katedra për gjuhë dhe letërsi shqipe,

Fakulteti Filologjik, Shkup

teutarifi@gmail.com

**INTELIGJENCA ARTIFICIALE DHE STUDIMI BASHKËKOHOR I
LETËRSISË SHQIPE: QASJE METODOLOGJIKE, PEDAGOGJIKE DHE
INTERPRETUESE****ARTIFICIAL INTELLIGENCE AND THE CONTEMPORARY STUDY OF
ALBANIAN LITERATURE: METHODOLOGICAL, PEDAGOGICAL, AND
INTERPRETIVE APPROACHES****Përmbledhje**

Ky punim analizon ndërthurjen midis inteligjencës artificiale (IA) dhe studimit bashkëkohor të letërsisë shqipe, duke u fokusuar në ndikimin e teknologjive digjitale në qasjet kritike, interpretative dhe didaktike. Përdorimi i IA-së në analizën e korpuseve letrare krijon mundësi të reja për studime stilistike, semantike dhe strukturore, duke nxjerrë në pah modele narrative dhe leksikore që shpesh mbeten të padukshme në leximin tradicional hermeneutik (Moretti, 2013, pp. 1–4; Underwood, 2019, pp. 3–7). Punimi mbështetet në një studim empirik të realizuar përmes pyetësorit me studentë të Katedrës së Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe në Shkup, me qëllim shqyrtimin e rolit të IA-së në procesin e të mësuarit dhe të prodhimit të tekstit akademik. Rezultatet tregojnë se inteligjenca artificiale përdoret gjerësisht si mjet mbështetës në studim, por njëkohësisht ngre shqetësime lidhur me standardizimin e diskursit akademik dhe dobësimin e mendimit kritik (Selwyn, 2019, pp. 92–96). Punimi argumenton se IA duhet të integrohet në mënyrë kritike dhe reflektive, si instrument ndihmës dhe jo zëvendësues i interpretimit letrar (Hayles, 2012, pp. 11–14).

Fjalë kyçe: *Inteligjencë artificiale, humanitete digjitale, letërsi shqipe, interpretim letrar, arsim universitar.*

Abstract

This paper examines the intersection between artificial intelligence (AI) and contemporary studies of Albanian literature, focusing on the impact of digital technologies on critical, interpretative, and pedagogical approaches. The application of AI in the analysis of literary corpora enables new stylistic, semantic, and structural methodologies, revealing narrative and lexical patterns that often remain invisible within traditional hermeneutic reading practices (Moretti, 2013, pp. 1–4; Underwood, 2019, pp. 3–7). The study is based on empirical data collected through a questionnaire administered to students of the Department of Albanian Language and Literature in Skopje, aiming to examine the role of AI in learning processes and academic text production. The findings indicate that artificial intelligence is widely used as a supportive learning tool, while also raising concerns regarding the standardization of academic discourse and the potential weakening of critical thinking (Selwyn, 2019, pp. 92–96). The paper argues that AI should be integrated critically and reflectively as a supportive instrument rather than a substitute for literary interpretation (Hayles, 2012, pp. 11–14).

Keywords: *Artificial intelligence, digital humanities, Albanian literature, literary interpretation, higher education.*

1. Hyrje

Dekadat e fundit janë karakterizuar nga një transformim i thellë i mënyrës së prodhimit dhe qarkullimit të dijes, veçanërisht në fushat humanistike. Zhvillimi i teknologjive digjitale dhe, së fundmi, avancimi i inteligjencës artificiale kanë ndikuar drejtpërdrejt në mënyrën se si tekstet letrare analizohen, interpretohen dhe mësohen në kontekst akademik. Studimet letrare, të cilat tradicionalisht janë mbështetur në leximin hermeneutik, analizën historike dhe interpretimin estetik, po përballen me nevojën për të rishikuar mjetet dhe metodat e tyre përballë realiteteve të reja digjitale. Në këtë kontekst, humanitetet digjitale përfaqësojnë një fushë ndërdisiplinore që ndërthur metodat e shkencave kompjuterike me kërkimin humanistik, duke ofruar qasje të reja për analizën e teksteve letrare (McCarty, 2016, pp. 3–6). Inteligjenca artificiale, si komponent kyç i këtij zhvillimi, ka hapur debate të rëndësishme lidhur me rolin e algoritmeve në interpretimin e tekstit, autorësinë, kreativitetin dhe procesin e të mësuarit.

Letërsia shqipe, si një traditë letrare që ende përballlet me sfida në digjitalizim, arkivim dhe qasje akademike ndërkombëtare, ofron një terren të veçantë për analizimin e ndikimit të IA-së. Ky punim synon të kontribuojë në këtë debat duke shqyrtuar rolin e inteligjencës artificiale në studimin dhe mësimdhënien e letërsisë shqipe, duke kombinuar analizën teorike me të dhëna empirike nga konteksti universitar.

2. Korniza teorike: Humanitetet digjitale dhe studimet letrare

Koncepti i *distant reading*, i artikulluar nga Franco Moretti, përfaqëson një nga kthesat më të rëndësishme metodologjike në studimet letrare bashkëkohore. Në vend të analizës së tekstit individual, kjo qasje synon identifikimin e modeleve, tendencave dhe strukturave në korpuse të mëdha tekstuale (Moretti, 2013, pp. 1–10). Ky ndryshim metodologjik ka hapur debate të gjera lidhur me raportin midis analizës sasiore dhe interpretimit cilësor. Sipas Underwood (2019), përdorimi i metodave digjitale nuk e zëvendëson interpretimin, por e zhvendos atë në një nivel tjetër, ku analiza statistikore shërben si pikënisje për reflektim kritik (pp. 55–61). Megjithatë, kritikë të ndryshëm kanë vënë në dukje se rreziku i reduktimit të tekstit letrar në të dhëna numerike mbetet i pranishëm, veçanërisht kur analizat algoritmike përdoren pa një kornizë teorike të qartë (Hayles, 2012, pp. 17–21).

Në këtë kuadër, inteligjenca artificiale nuk duhet të konceptohet si zëvendësim i kritikës letrare, por si mjet që mund të plotësojë analizën hermeneutike duke ofruar perspektiva të reja. Kjo qasje është veçanërisht e rëndësishme për traditat letrare më pak të studiuara ndërkombëtarisht, siç është letërsia shqipe.

3. Metodologjia e studimit

Studimi empirik i këtij punimi bazohet në një metodë sasiore dhe cilësore, përmes përdorimit të pyetësorit si instrument kryesor kërkimor. Kampioni përfshin 30 studentë të viteve të ndryshme të Katedrës së Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe në Shkup. Përzgjedhja e kampionit është bërë mbi bazën e përdorimit aktiv të mjeteve të inteligjencës artificiale në procesin akademik.

Pyetësi ka përfshirë pyetje të mbyllura dhe të hapura që lidhen me:

- njohuritë mbi IA-në,
- frekuencën e përdorimit,
- mënyrat e përdorimit në lëndët e letërsisë,
- perceptimin e ndikimit të IA-së në të mësuarit dhe shkrimin

akademik.

Të dhënat janë analizuar në mënyrë deskriptive dhe interpretuese, duke u krahasuar me literaturën ekzistuese mbi përdorimin e IA-së në arsim (Selwyn, 2019, pp. 92–105).

4. Analiza e rezultateve

Rezultatet tregojnë se të gjithë studentët e anketuar kanë njohuri për të paktën një instrument të inteligjencës artificiale, me ChatGPT-në si mjetin më të përdorur. Përdorimi i tij është kryesisht ditor dhe lidhet me detyra

konkrete akademike, si shpjegimi i koncepteve teorike, kontrolli i gabimeve drejtshkrimore dhe ndërtimi i strukturës së eseve.

Një aspekt i rëndësishëm i rezultateve lidhet me mënyrën e përdorimit të IA-së në procesin e shkrimit akademik. Më shumë se tre të katërtat e studentëve deklarojnë se fillimisht i drejtohen ChatGPT-së për të krijuar një bazë informacioni, ndërsa një pjesë më e vogël thekson rëndësinë e hartimit paraprak të një koncepti personal. Kjo gjetje përputhet me studimet që theksojnë rolin ambivalent të IA-së në shkrimin akademik (Boddy & Boddy, 2022, pp. 148–152).

5. Diskutim

Raporti midis studentit dhe inteligjencës artificiale rezulton kompleks dhe shumëdimensional. Sa më e zhvilluar të jetë baza teorike dhe kritike e studentit, aq më reflektiv dhe kreativ është përdorimi i IA-së. Në të kundërt, përdorimi pasiv prodhon tekste të standardizuara dhe dobëson individualitetin autorësor, duke ngritur shqetësime serioze pedagogjike (Selwyn, 2019, pp. 101–105).

Kjo situatë kërkon rikonceptimin e rolit të pedagogut, jo si kontrollues i produkteve përfundimtare, por si udhëzues i procesit të të menduarit kritik. Siç thekson Boden (2016), teknologjia nuk është neutrale; ajo reflekton mënyrën se si përdoret dhe qëllimet që i atribuohen (pp. 135–139).

6. Argumentim

Ky studim argumenton se inteligjenca artificiale përfaqëson një realitet të pashmangshëm në studimet bashkëkohore të letërsisë shqipe. Ajo ofron mjete të fuqishme për analizë, organizim dhe akses në informacion, por njëkohësisht paraqet rreziqe lidhur me standardizimin e diskursit akademik dhe dobësimin e mendimit kritik. Prandaj, integrimi i IA-së në procesin akademik duhet të jetë i ndërgjegjshëm, kritik dhe pedagogjikisht i strukturuar. Inteligjenca artificiale duhet të funksionojë si instrument mbështetës që zgjeron horizontet e dijes, pa zëvendësuar dimensionin estetik, hermeneutik dhe historik të interpretimit letrar (Hayles, 2012, pp. 22–25; Underwood, 2019, pp. 211–214). Vetëm përmes një qasjeje të tillë, studimi i letërsisë shqipe mund të përfitojë nga potenciali i teknologjive digjitale, duke ruajtur njëkohësisht thelbin humanist të disiplinës.

7. Kufizimet e studimit

Megjithëse ky studim synon të ofrojë një pasqyrë të gjerë mbi rolin e inteligjencës artificiale në studimin bashkëkohor të letërsisë shqipe, ai paraqet disa kufizime që duhet të merren parasysh gjatë interpretimit të rezultateve. Së pari, madhësia e kampionit është relativisht e vogël dhe përfshin vetëm studentë të një institucioni universitar. Kjo nënkupton se gjetjet nuk mund të përgjithësohen automatikisht për të gjithë studentët e

letërsisë shqipe në kontekste të tjera akademike, qoftë brenda hapësirës shqiptare apo jashtë saj.

Së dyti, të dhënat empirike bazohen kryesisht në vetë-raportimin e studentëve për mënyrën dhe frekuencën e përdorimit të inteligjencës artificiale. Ky fakt mbart rrezikun e subjektivitetit dhe të vetëvlerësimit të pasaktë, veçanërisht në çështje që lidhen me etikën akademike dhe përdorimin real të IA-së në procesin e shkrimit akademik. Studime të ardhshme mund të përfitojnë nga kombinimi i pyetësorëve me analiza konkrete të produkteve tekstuale të studentëve.

Një kufizim tjetër lidhet me fokusin e studimit në aspektin pedagogjik dhe metodologjik të përdorimit të IA-së, duke lënë më pak të eksploruar dimensionin estetik dhe filozofik të marrëdhënies midis inteligjencës artificiale dhe krijimtarisë letrare. Megjithëse ky dimension përmendet në kuadër teorik, ai kërkon trajtim më të thelluar përmes analizave konkrete të veprave letrare dhe aplikimeve algoritmike mbi to.

8. Implikime pedagogjike dhe drejtime për kërkime të ardhshme

Rezultatet e këtij studimi kanë implikime të rëndësishme për praktikën pedagogjike në fushën e studimeve letrare. Së pari, ato sugjerojnë nevojën për rishikimin e mënyrës se si konceptohet shkrimi akademik në epokën e inteligjencës artificiale. Në vend që përdorimi i IA-së të ndalohej ose të stigmatizohet, ai duhet të integrohet në mënyrë të strukturuar në procesin mësimor, duke u shndërruar në objekt reflektimi kritik dhe jo vetëm në mjet prodhimi teksti.

Pedagogët e letërsisë kanë një rol kyç në orientimin e studentëve drejt përdorimit të ndërgjegjshëm të inteligjencës artificiale. Kjo nënkupton zhvillimin e detyrave që kërkojnë ndërthurjen e analizës personale me përdorimin kritik të mjeteve digjitale, si dhe vlerësimin e procesit të të menduarit, jo vetëm të produktit përfundimtar. Një qasje e tillë mund të kontribuojë në ruajtjen e individualitetit autorësor dhe në forcimin e mendimit kritik.

Në aspektin e kërkimeve të ardhshme, studime më të zgjeruara mund të fokusohen në analiza krahasuese ndërmjet institucioneve të ndryshme akademike, si dhe në përfshirjen e perspektivës së pedagogëve përballë përdorimit të IA-së. Po ashtu, kërkime të mëtejshme mund të eksplorojnë aplikimin konkret të metodave të *distant reading* në korpuset e letërsisë shqipe, duke krijuar baza të dhënash digjitale që do të shërbenin si burim i rëndësishëm për studimet letrare dhe gjuhësore.

9. Konkluzione

Duke marrë parasysh analizën teorike dhe gjetjet empirike, ky punim konfirmon se inteligjenca artificiale po shndërrohet në një element përbërës të pandashëm të studimit bashkëkohor të letërsisë shqipe. Ajo ndikon jo vetëm në mënyrën e analizës së teksteve, por edhe në procesin e të mësuarit,

shkrimit akademik dhe formimit intelektual të studentëve. Ndërsa inteligjenca artificiale ofron mjete të fuqishme për organizimin dhe analizën e informacionit, ajo nuk mund dhe nuk duhet të zëvendësojë interpretimin letrar si akt estetik, historik dhe kulturor. Rreziku i standardizimit të diskursit akademik dhe i humbjes së zërit individual mbetet real, veçanërisht në mungesë të një qasjeje pedagogjike të strukturuar.

Në këtë kuptim, sfida kryesore për studimet letrare nuk është rezistenca ndaj teknologjisë, por aftësia për ta përfshirë atë në mënyrë kritike dhe reflektive. Vetëm përmes një dialogu të vazhdueshëm midis humaniteteve dhe teknologjisë, studimi i letërsisë shqipe mund të ruajë thelbin e vet humanist, duke përfituar njëkohësisht nga mundësitë që ofron inteligjenca artificiale në shekullin XXI.

Bibliografia

Boden, M. A. (2016). *AI: Its nature and future*. Oxford University Press.

Boddy, J., & Boddy, C. (2022). Artificial intelligence and the future of academic writing. *Journal of Academic Ethics*, 20(2), 143–157. <https://doi.org/10.1007/s10805-021-09400-2>

Hayles, N. K. (2012). *How we think: Digital media and contemporary technogenesis*. University of Chicago Press.

Jockers, M. L. (2014). *Text analysis with R for students of literature*. Springer.

McCarty, W. (2016). Humanities computing. In S. Schreibman, R. Siemens, & J. Unsworth (Eds.), *A new companion to digital humanities* (pp. 3–24). Wiley-Blackwell.

Moretti, F. (2013). *Distant reading*. Verso.

Selwyn, N. (2019). *Should robots replace teachers? AI and the future of education*. Polity Press.

Underwood, T. (2019). *Distant horizons: Digital evidence and literary change*. University of Chicago Press.

Punim studimor

Mustafa IBRAHIMI

Universiteti "Nënë Tereza" në Shkup

Fakulteti i Shkencave Humane

mustafa.ibrahimi@unt.edu.mk

**TRANSKRIPTIMI DHE ANALIZA GJUHËSORE E DIALEKTIT ARBËRESH
PËRMES INTELIGJENCËS ARTIFICIALE****LINGUISTIC TRANSCRIPTION AND ANALYSIS OF THE ARBËRESH
DIALECT USING ARTIFICIAL INTELLIGENCE****Përmbledhje**

Studimi trajton përdorimin e mjeteve të inteligjencës artificiale për transkriptimin dhe analizën gjuhësore të të folmeve arbëreshe në tekstet që i kam mbledhur gjatë vizitave të mia në Kalabri dhe Sicili, gjatë periudhës 2006-2024. Përmes kombinimit të transkriptimit automatik (Whisper AI) dhe verifikimit manual gjuhësor, realizohet një pasqyrim i saktë i elementeve fonetike, morfologjike dhe leksikore të dialektit. Analiza eidenton ruajtjen e formave arkaike, ndikimin e italishtes dhe veçoritë sintaksore karakteristike të arbërishtes. Rezultatet tregojnë se tekstet arbëreshe paraqiten si mjet efektiv për rigjallërimin dhe dukshmërinë digjitale të gjuhës arbëreshe. Punimi propozon një qasje inovative në studimin e dialekteve dhe gjuhëve në rrezik zhdukjeje përmes Inteligjencës artificiale (IA).

Fjalë kyçe: *Dialekti arbëresh, inteligjenca artificiale, transkriptim, analizë gjuhësore, tekste arbëreshe.*

Abstract

The study addresses the use of artificial intelligence tools for the transcription and linguistic analysis of Arbëresh varieties in texts that I collected during my visits to Calabria and Sicily between 2006 and 2024. Through a combination of automatic transcription (Whisper AI) and manual linguistic verification, an accurate representation of the phonetic, morphological, and lexical elements of the dialect is achieved. The analysis

highlights the preservation of archaic forms, the influence of Italian, and syntactic features characteristic of Arbëresh. The results show that Arbëresh texts function as an effective tool for the revitalization and digital visibility of the Arbëresh language. The paper proposes an innovative approach to the study of dialects and endangered languages through artificial intelligence (AI).

Keywords: *Arbëresh dialect, artificial intelligence, transcription, linguistic analysis, Arbëresh texts*

Hyrje

Komuniteti arbëresh në Itali ka ruajtur ndër shekuj gjuhën, traditat dhe folklorin arbëresh, duke krijuar një korpus të veçantë kulturor brenda diasporës historike shqiptare. Këngët arbëreshe, si forma kryesore e shprehjes gojore, përmbajnë elemente thelbësore të identitetit kolektiv, të kujtesës historike dhe të strukturave arkaike të gjuhës shqipe. Si të tilla, ato përfaqësojnë një burim të rëndësishëm për studimet albanologjike, folkloristike dhe sociolinguistike, por njëkohësisht paraqesin vështirësi të theksuara në procesin e interpretimit dhe të përafrimit me shqipen standarde bashkëkohore.

Ndryshimet gjuhësore ndërkohore, proceset e standardizimit të shqipes dhe ruajtja e tipareve arkaike në arbërisht kanë krijuar një distancë strukturore, fonetike dhe semantike midis teksteve arbëreshe dhe shqipes standarde. Për pasojë, një pjesë e konsiderueshme e këtij materiali mbetet e vështirë për t'u qasur nga studiuesit, studentët dhe lexuesit e gjerë, pavarësisht faktit se tekstet dhe këngët janë inçizuar dhe botuar në forma të ndryshme.

Si bazë e këtij studimi janë marrë dy librat e autorit kushtuar Arbëresheve të Kalabrisë, të botuar në Shkup (2008; 2021), të cilët përmbajnë një korpus të pasur këngësh arbëreshe të mbledhura nga terreni. Megjithatë, deri më tani, këto tekste nuk kanë qenë të transkriptuara dhe të analizuara sistematikisht në raport me normën e shqipes standarde, gjë që e kufizon përdorimin e tyre në studime krahasuese dhe interpretuese.

Në këtë kontekst, përdorimi i inteligjencës artificiale (IA) paraqitet si një mundësi bashkëkohore për transliterimin, normalizimin dhe analizën e teksteve arbëreshe. IA krijon perspektiva të reja për përpunimin e materialeve gjuhësore tradicionale, duke mundësuar identifikimin e modeleve fonetike dhe leksikore, krahasimin ndërtekstual dhe rritjen e qëndrueshmërisë së transliterimit në nivel korpusi. Këto mjete teknologjike kontribuojnë në rritjen e qasshmërisë së teksteve për studime shkencore, përdorim arsimor dhe botime bashkëkohore, pa cenuar autenticitetin e tyre.

Qëllimi i këtij punimi është të analizojë potencialin e inteligjencës artificiale në transliterimin e këngëve arbëreshe, duke u përqendruar në ruajtjen e kuptimit leksikor, figuracionit poetik dhe funksionit kulturor të tekstit. Transliterimi trajtohet jo si proces thjesht teknik, por si ndërhyrje filologjike e ndjeshme ndaj kontekstit historik, gjuhësor dhe kulturor.

Procesi i transliterimit në këtë studim bazohet në parimin e besnikërisë ndaj tekstit burimor, duke respektuar njëkohësisht normën e shqipes standarde. Ai nuk synon zëvendësimin ose uniformizimin e varianteve dialektore arbëreshe, por paraqitjen e tyre në një formë të lexueshme dhe të analizueshme për publikun bashkëkohor. Kriteret kryesore të transliterimit përfshijnë ruajtjen e strukturave fonetike me vlerë semantike, për-shtatjen grafemike sipas sistemit të shqipes standarde, shënimin e formave arkaike dhe dialektore me funksion dallues, shmangien e interpretimit të lirë dhe ruajtjen e figuracionit poetik dhe funksionit performativ të këngës.

Në këtë kuadër, inteligjenca artificiale përdoret si mjet ndihmës analitik dhe teknologjik, dhe jo si zëvendësim i interpretimit shkencor. Roli i saj konsiston në normalizimin paraprak të teksteve, segmentimin e njësive leksikore, identifikimin e devijimeve nga norma standarde dhe ofrimin e sugjerimeve për transliterim të qëndrueshëm. Vendimet përfundimtare mbi transliterimin dhe interpretimin semantik mbeten objekt i verifikimit filologjik njerëzor, duke ndërtuar kështu një qasje hibride ndërmjet teknologjisë dhe analizës gjuhësore tradicionale.

2. Korniza teorike dhe metodologjia

2.1 Kënga arbëreshe si tekst folklorik

Kënga arbëreshe përbën një tekst polifunksional, i cili vepron njëkohësisht si formë estetike e shprehjes artistike, si mjet i komunikimit shoqëror dhe si bartëse e normave, vlerave dhe kujtesës kulturore të komunitetit. Nëpërmjet këngës transmetohen jo vetëm emocione dhe përvoja individuale, por edhe struktura kolektive të identitetit, modele sjelljeje dhe narracione historike, të cilat kontribuojnë në ruajtjen e vazhdimësisë kulturore arbëreshe.

Nga pikëpamja gjuhësore, këngët arbëreshe karakterizohen nga ruajtja e elementeve arkaike fonetike, morfologjike dhe leksikore, të cilat i japin arbërishtes një vlerë të veçantë dokumentuese. Siç thekson Demiraj (2008), arbërishtja ruan tipare të rëndësishme të shqipes së vjetër, çka e bën atë një burim të pazëvendësueshëm për studimet historike dhe krahasuese të gjuhës shqipe. Në këtë kuadër, kënga arbëreshe shfaqet jo vetëm si produkt estetik, por edhe si dokument gjuhësor dhe kulturor me rëndësi të veçantë shkencore.

2.2 Metodologjia

Studimi mbështetet në një qasje kualitative dhe krahasuese, e aplikuar në transliterimin dhe analizën e pesë këngëve arbëreshe të përzgjedhura nga korpusi i studimit. Metodologjia përfshin disa hapa të ndërlidhur:

- (1) transliterimin e teksteve arbëreshe në shqipen standarde, duke respektuar kriteret fonetike, morfologjike dhe semantike të përcaktuara;
- (2) ndërtimin e tabelave krahasuese, ku paraqiten paralelisht teksti original, forma e transliteruar dhe shpjegimi gjuhësor e kulturor i njësive përkatëse;
- (3) analizën semantike dhe kulturore të vargjeve, me fokus në figuracionin poetik, funksionin komunikativ dhe kontekstin etnokulturor të këngës.

Inteligjenca artificiale është përdorur si mjet ndihmës për analizë leksikore dhe sintaksore, veçanërisht për identifikimin e modeleve të përsëritura dhe të devijimeve nga norma standarde, ndërsa verifikimi përfundimtar, interpretimi semantik dhe vendimet transliteruese janë kryer nga studiuesi. Kjo qasje e kombinuar synon të sigurojë saktësi filologjike dhe koherencë metodologjike në trajtimin e materialit. Në studimin tonë kemi përdorur <https://gemini.google.com/app>

3. Analiza e shembujve

3.1. Gjatë qëndrimit tim në disa katunde arbëreshe, si në Maki, vendlindja e Jeronim de Radës, vizituam bustin dhe varrin e De Radës. Para kishës dëgjohet një kambanë. Është kambana e kishës së fshatit. "Qisha e famullisë është e kushtuar Shën Mërisë së mexasporisë, festa e së cilës mbahet më 21 Shën Martir. Para hyrjes në kishë gjendet një shesh i vogël me bustin e Jeronimit. Duke hyrë bren da, njeri prej miqve tanë arbëresh nga fshati na bëni me dije se varri i Jeronimit dhe të birit të tij gjenden brenda në kishë. Posa hymë brenda vërejtëm dy pllaka përkujtimore. Në pllakën e parë nga e majta, gjendej shkrimi që De Rada ia kishte kushtuar të birit Mikellanhullit, i cili kishte ndërruar jetë që në moshën 18 vjeçare, aty shkruante:" PREJU CHËTU MBË KISH MICHELANGELO BIRI IM SHCOVE I TETTËMBËDIET VIETTËSH SI ILL CË SHCREGHET NATTËN SYT E PAAN ENCHE DITIN CA DUALI NDO CU U LJËFAAR VETTËM SE BËRE MËË TË MADE ERRËSIRËN E ZËAVET TË PRINDET GIROLAMO I RADANJUVET XXX TË SHËN MITËRIT MDCCCLXXIII". Kurse mbi pllakën e Jeronim De Radës shkruante: "PËRGJYJU ARBRESH, KËTU PUSHON JERONIM DE RADA KËNGËTARI I SHQIPËRISË, UDHËHJËKËS I PARË I LIRISË KOMBËTARE".

Këtë tekst e përkthym nëpërmjet ChatGPT-së dhe fituam këtë tabelë::

Teksti Original	Shqipja standarde	Shpjegimi
PREJU CHËTU	Prehu këtu	Formulë epitafi; <i>chëtu</i> = këtu.
MBË KISH MICHELANGELO	në kishën e Shën Mëhillit	Vendvarrimi; <i>Michelangelo</i> = Shën Mëhilli (kryeengjëlli).
BIRI IM	birin im	Shprehje e drejtpërdrejtë atësore.
SHCOVE I	shkove	Eufemizëm poetik për vdekjen.
TETTËMBËDIET VIETTËSH	tetëmbëdhjetë vjeç	Tregon moshën e re të të ndjerit.
SI ILL CË SHCREGHET	si yll që shuhet	Metaforë për vdekjen e parakohshme.

Teksti Original	Shqipja standarde	Shpjegimi
NATTËN SYT E PAAN	natën sytë t'i mbylli	Shpreh momentin e vdekjes; <i>pa</i> = mbylli.
ENCHE DITIN CA DUALI	dhe ditën që doli	<i>enche</i> = edhe; dita e ndarjes nga jeta.
NDO CU U LJËFAAR	nuk u zbardh	Metaforë: dita nuk u ndriçua, mbeti e zymtë.
VETTËM SE BËRE MËË TË	vetëm se e bëre edhe më	Kalim drejt thellimit të errësirës shpirtërore.
MADE ERRËSIRËN E	të madhe errësirën e	Errësira si dhimbje dhe humbje.
ZËAVET TË PRINDET	zemrave të prindërve	<i>zëavet</i> = zemrave; dhimbja prindërore.
GIROLAM I RADANJVET	Jeronim De Rada	Autor i epitafit; emër në trajtë arbëreshe.
XXX TË SHËN MITËRIT	30 e Shën Mitrit	Data sipas kalendarit kishtar.
MDCCCLXXIII	1873	Viti i vdekjes (numra romakë).

Teksti 1. Epitaf për birin e De Radës, me gjuhë arbëreshe të përzier me elemente të italishtes kishtare (Ibrahimi 2021:42).

Ky epitaf është një nga tekstet më prekëse të De Radës, ku ylli që shuhet simbolizon rininë e këputur; dita që nuk zbardh shpreh dhimbjen absolute; errësira e zemrave të prindërve është kulmi emocional i tekstit.

3.1 Këngët e dasmës

Në katundin e afërm arbëresh Shën Sofi, në vitin 2007 e takuam një arbëreshe me emrin Vitorina Groça Bafa, e moshës 83 vjeçare, e cila na këndoi tri këngë nusnie që i kemi të inçizuara (Ibrahimi 2021:82). Nëpërmjet chat GPT-së ne kërkaum të njëjtat gjëra, ta përkthejë, ta transliterojë tekstin në gjuhën standarde dhe të jep shpjegim leksikor. Në tabelë është pasqyruar i tërë procesi i përkthimit dhe interpretimit:

(Kënga I - Nisu nuse plot legri)

Teksti Original	Shqipja standarde	Shpjegimi
Nisu nuse plot legri	Nisu nuse plot hare	<i>legri</i> = gëzim, hare; fillimi i përcjelljes së nuses.
Nisu nuse me gare	Nisu nuse me gëzim	<i>gare</i> = gëzim, dëshirë.
se je vete te shpija e re	se po shkon te shtëpia e re	Kalimi në jetën martesore.
U nis trimi plot legri	U nis dhëndri plot hare	<i>trimi</i> = dhëndri.
Me t'madhe n'humpanji	Me madhështi në shoqëri	Përcjellje solemne.
Moj ti bukura si vera	Moj ti e bukur si vera	Krahasim tradicional folklorik.
Se ta lvoj dhëndëri te dera	Se të pret dhëndri te dera	<i>lvoj</i> = pret, mirëpret.
Erdh me gjind e plot mall	Erdhi me njerëz dhe plot mall	Dhëndri vjen me krushq.
E t'ken me kishë tokirar	Dhe të çojnë në kishë së bashku	Rit kishtar i martesës.
Arangaso mori lule	O vajzë, mori lule	Thirrje poetike për nusen.
Sot nga vatra jote shkule	Sot u shkëpute nga vatra jote	Largimi nga familja prindërore.
Mori ti e bukura hënë	Mori ti, o e bukura hënë	Hëna si simbol i bukurisë femërore.
Mish uratën e sat ëmë	Merr bekimin e nënës sate	<i>uratë</i> = bekim.
Ec ti bil, ec me shëndet	Ec bija ime, ec me shëndet	Këshillë prindërore.
Mish uratën e tit et	Merr bekimin e babait tënd	Bekim familjar.
Ka do veni drit soni	Nga ky vend dritë dërgoni	Dritë = fat, mirësi.

Teksti Original	Shqipja standarde	Shpjegimi
Ju si dielli t'perëndoni	Si dielli të ndriçoni	Urtësi dhe begati.
Moj ti degza e gilshi	Moj ti degë e qershisë	Metaforë për rininë dhe freskinë.
Qon ti jetën dituni	Kaloje jetën me mençuri	<i>dituni</i> = dije, maturi.
E kur te sheshi mar von	Dhe kur të kaloni sheshin më vonë	Sheshi = jeta publike/shoqëria.
Gjith portierin dritëson	Gjithmonë pragun ndriçoni	Porta = shtëpia, familja.
Rrini mir për niqind vjet	Rroni mirë për njëqind vjet	Urim për jetë të gjatë.
të na vini me shëndet	Dhe të na vini gjithnjë me shëndet	Urim për kthim me gëzim e shëndet.

Teksti 2. Këngë nusnie kënduar nga Vitorina Groça Bafa, 83 vjeçare nga fshati Shën Sofi të Kalabrisë. Inçizuar në vitin 2007 (Ibrahimi 2021:82)

Kjo këngë përmban të gjitha elementet e ritualit të dasmës arbëreshe: përcjelljen e nuses, bekimin prindëror, simbolikën e dritës, diellit dhe luleve, si dhe urimin për jetë të gjatë e të begatë. Në vargun “*Nisu nuse plot legri*”, vihet re një leksik ritual dhe simbolik. Termi *legri* transliterohet si *hare*, duke ruajtur ngarkesën emocionale pozitive. IA-ja ndihmoi në identifikimin e ekuivalentëve semantikë, por interpretimi i simbolikës së *vatrës* dhe *bekimit prindëror* kërkon ndërhyrje njerëzore.

2. (Kënga II - Shkunden ni lulje)

Teksti Original	Shqipja standarde	Shpjegimi
Shkunden ni lulje	Shkundet një lule	<i>shkunden</i> = shkundet; fillim figurativ.
Shkunden vashezat kopilje	Shkunden vajzat e reja	<i>vashezat</i> = vajzat; <i>kopilje</i> = vajza të reja, të pamartuara.
Lulja bëhet ni triger	Lulja bëhet një thërrime	<i>triger</i> = copë e vogël, grimcë.
Ma vashat bien ka mënder	Por vajzat bien nga mendja	Metaforë e hutimit dashuror.

3. (Kënga III - Mori mal sa i bukur je)

Teksti Original	Shqipja standarde	Shpjegimi
Mori mal sa i bukur je	O mal, sa i bukur je	Thirrje lirike ndaj natyrës.
Kur spasjon dako t're	Kur shpërthen në pranverë të re	<i>spasjon</i> = shpërthen, çel; <i>dako t're</i> = pranverë e re.
Kur spasjon e kur fishkan	Kur çel dhe kur fishkëllen	Tinguj natyrorë që shoqërojnë bukurinë.
Zëmrën time me ka da	Zëmrën time ma ke ndarë	Bukuria e natyrës zgjon mall e dhimbje.

Teksti 3-4. Këngë nusnie kënduar nga Vitorina Groça Bafa, 83 vjeçare nga fshati Shën Sofi të Kalabrisë. Inçizuar në vitin 2007 (Ibrahimi 2021:82)

Në këngën e dytë dhe të tretë, këngëtari përdor lulen si metaforë të rinisë femërore dhe ndjenjës së paqëndrueshme. Ndërsa në këngën e tretë përmbajtja është lirike-natyrore, ku mali dhe pranvera personifikohen dhe ndikojnë emocionalisht te subjekti lirik. Në këngën e parë, nëpërmjet vargut “*Mori mal sa i bukur je*”) personifikohet vetë natyra. Ajo që të bije në sy gjatë transliterimit, jo vetëm që ruhet figuracioni poetik, por Inteligjenca artificiale ndihmon në strukturimin sintaksor të shqipes standarde.

3.2 Këngët e mërgimit dhe mallit

Po në këtë viti 2007, dhe po në katundin arbëresh të Shën Sofisë, inçizova edhe disa pleq. Në një skaj të verandës afër kishës një burrë të tetëdhjetave rrinte i vetmuar, i afrova dhe e pyeta “Si ju thonë”? “U jam Andoni Buljare jam pensionist- na thotë sapo afrohem. Këtu njerëzit merren me punë fushe e disa shkojnë jashtë dhe bëjnë shpi të bukura. Ku jemi ne me këtë faqe, disa flasin italian. Do t'u tregoj një storje arbërisht, na tha ai dhe filloi (Ibrahimi 2021:78):

1. (Teksti I - Kjo storja osht arbrisht)

Teksti Original	Shqipja standarde	Shpjegimi
Kjo storja osht arbrisht	Kjo histori është arbëreshe	<i>storja</i> = histori; vetëidentifikim gjuhësor e kulturor.
Ka arbrishtja e saj korteze	Arbërishtja ka hijeshinë e saj	<i>korteze</i> = finesë, hijeshi gjuhësore.
Ishit bravja dhorgojoze	Ishte vajzë e bukur dhe e hijshme	<i>bravja</i> = vajzë e bukur; <i>dhorgojoze</i> = elegante.
Për grat shumë xheloze	Por shumë xheloze ndaj grave	Tipar karakteror i subjektit femëror.
Kjo shum xhelozi	Kjo xhelozi e madhe	Theksim emocional.
Nga se ti mendjen dituri	Ngaqë ti mendjen e ke në dituri	<i>dituri</i> = zgjuarsi, dije.
Vat ka Amerika t'emigrarin	Shkove në Amerikë për mërgim	Temë e emigrimit arbëresh.
Varna tjet bydhunllore	Por atje jeta ishte e rëndë	<i>bydhunllore</i> = e vështirë, e rëndë.
Ktu-ktu kumbinati	Këtu-këtu kumbon kombi	Ironi sociale; jehonë e rreme kombëtare.
Ku varni demokradi	Ku varfëria quhet demokradi	Kritikë sociale dhe politike.
Më t'mejrët qu vendu	Më të mirët i quajnë vendi	Elita e shoqërisë.
E dërgojni servitu	Dhe i dërgojnë në shërbëri	<i>servitu</i> = robëri/shfrytëzim.

Në Kalabri me Arbëreshët Në Kalabri, te Arbëreshët Kontekst kulturor e gjeografik.

Teksti 5. Recitim nga *Andon Buljari, pensionist '80 vjeç*. Në fshatin Shën Sofi, Kalabri, viti 2007 (Ibrahimi 2021:78).

2. (Teksti II - Nga do që të shkoja)

Teksti Original	Shqipja standarde	Shpjegimi
Nga do që të shkoja	Kudo që të shkoja	Endje, mërgim.
ka ky shesh u varova	te ky shesh mbeta i lidhur	<i>u varova</i> = mbeta i ngulur shpirtërisht.
Moj ti lule – moj ti mall	Moj ti lule, moj ti mall	Figurë tradicionale e dashurisë.
Ti je s'erdhe për mu me gjallë	Ti nuk erdhe për mua sa isha gjallë	Dashuri e porealizuar.
Vajta Amerik e u prorë	Shkova në Amerikë dhe u mërgova	<i>u prorë</i> = u end, u largova.
U prorë semre pa i këne	U mërgova me zemër të thyer	Dhimbje shpirtërore.
Un ti kam malli shum	Unë për ty kam mall të madh	Malli si motiv qendror arbëresh.

Teksti 6. Recitim nga *Andon Buljari, pensionist '80 vjeç*. Në fshatin Shën Sofi, Kalabri, viti 2007 (Ibrahimi 2021:78).

Të dy tekstet përfaqësojnë poezinë/këngën arbëreshe të mërgimit, ku ndërthuren: identiteti gjuhësor, kritika sociale, dashuria dhe malli dhe përvoja e emigracionit. Vargje si “*Vajta Amerik e u prorë*” përfaqësojnë

përvojën historike të emigracionit arbëresh. IA-ja e interpreton saktë *u prorë* si “u mërgova”, duke e lidhur kuptimin me kontekstin sociohistorik.

4. Diskutim

Rezultatet nga transliterimi i 5 teksteve arbëreshe të mbledhura nga unë, por të transletiruara dhe interpretuara nëpërmjet Inteligjencës artificiale, tregojnë se inteligjenca artificiale është veçanërisht e dobishme në identifikimin e fjalëve dialektore, ofrimin e përkthimeve paraprake dhe ndërtimin e korpuseve krahasuese.

Megjithatë, duhet të jemi të kujdesshm në disa segmente etnokulturore, sepse ajo nuk mund të zëvendësojë analizën kulturore dhe etnologjike. Simbolet folklorike dhe funksioni ritual i këngëve kërkojnë interpretim njerëzor, duke e bërë bashkëpunimin me IA, studiuës thelbësor.

5. Përfundime

Ky studim dëshmon se përdorimi i inteligjencës artificiale në transliterimin e këngëve arbëreshe përfaqëson një qasje inovative dhe metodologjike të qëndrueshme në kuadër të studimeve albanologjike bashkëkohore. Rezultatet tregojnë se IA-ja mund të lehtësojë ndjeshëm qasjen në tekstet dialektore, duke mbështetur procesin e transliterimit dhe analizës leksikore e sintaksore, si dhe duke rritur koherencën e trajtimit në nivel korpusi.

Megjithatë, studimi vëren se efektiviteti i inteligjencës artificiale mbetet i kushtëzuar nga ndërthurja e saj me analizën filologjike dhe interpretimin njerëzor. Vendimet përfundimtare mbi kuptimin, figuracionin poetik dhe funksionin kulturor të teksteve kërkojnë domosdoshmërisht ndërhyrje shkencore, e cila siguron ruajtjen e autenticitetit gjuhësor dhe kulturor të këngëve arbëreshe.

Në këtë kuptim, metodologjia e propozuar ofron një model të aplikueshëm edhe për dokumentimin dhe analizën e dialekteve të tjera shqiptare, si dhe për ndërtimin e arkivave digjitale të folklorit, duke kontribuar në ruajtjen, studimin dhe transmetimin e trashëgimisë gjuhësore dhe kulturore shqiptare në kontekstin e teknologjive bashkëkohore.

Referencat:

- DE RADA, J. (2005). *Këngët e Milosaos* (botim kritik). Tiranë: Toena. (Vepra origjinale botuar më 1836)
- HAMP, E. P. (1994). Albanian and Arbëresh: Historical and linguistic perspectives. *International Journal of Albanian Studies*, 2(1), 45–62.
- IBRAHIMI, M. (2008). *Shënime udhëtimi mes arbëreshëve të Kalabrisë*. “Interlingua” Shkup 2008.
- IBRAHIMI, M. (2021). *Me Arbëreshët në Kalabri*. “Interlingua” Shkup 2021.
- ONG, W. J. (1982). *Orality and literacy: The technologizing of the word*. London: Routledge.
- VASQUEZ, J., & Martínez, L. (2021). Artificial intelligence and the preservation of minority languages. *Journal of Digital Humanities*, 8(2), 113–129.
- UEB-faqe: <https://gemini.google.com/app>
<https://chatgpt.com/>

UDC

UDC 316.774:17]:004.8

UDC 004.8:316.774

Punim studimor

Ismet OSMANI

Universiteti "Shën Kirili e Metodi" – Shkup,

Fakulteti i Filologjisë "Blazhe Koneski"

Katedra e Gjuhës dhe e Letërsisë Shqiptare

ismet_osmani@yahoo.com

**PËRDORIMI I INTELIGJENCËS ARTIFICIALE NË KRIJIMIN E
PËRMBAJTJEVE MEDIATIKE**

**THE USE OF ARTIFICIAL INTELLIGENCE IN THE CREATION OF MEDIA
CONTENT**

Abstrakti

Inteligjenca artificiale ka nxitur polemika të mëdha në botë dhe dyshime të shumta në lidhje me përdorimin e saj në sfera të ndryshme të shoqërisë. Në botën moderne të mediave digjitale, inteligjenca artificiale ka gjetur zbatim të gjerë në analizën e të dhënave, automatizimin e raportimit dhe krijimin e përmbajtjeve të ndryshme mediatike. Mediat përballen me nevojën e një efikasiteti më të madh në procesin e informacionit, gjë që reflektohet në krijimin më të shpejtë të përmbajtjes, duke respektuar standardet etike të gazetarisë. Ekziston nevoja për një analizë më të detajuar të përdorimit të inteligjencës artificiale në media dhe ndikimit të inovacioneve teknologjike në punën e gazetarëve dhe prodhimin e përmbajtjes mediatike, duke respektuar normat etike profesionale në gazetari. Qëllimi i këtij punimi është të analizojë rolin e inteligjencës artificiale, etikën mediatike, mënyrën se si publiku i qaset informacionit, si dhe të shqyrtojë mundësitë për integrimin e përgjegjshëm të këtyre teknologjive në praktikën mediatike, me qëllim ruajtjen e parimeve tradicionale gazetareske, siç janë saktësia, objektiviteti, transparenca dhe llogaridhënia.

Fjalë kyçe: *media, inteligjencë artificiale, standarde profesionale*

Abstract

Artificial intelligence has sparked major controversies worldwide and numerous doubts regarding its use across different spheres of society. In the modern world of digital media, artificial intelligence has found widespread application in data analysis, the automation of reporting, and the creation of various types of media content. Media organizations face the need for greater efficiency in information-processing workflows, which is reflected in faster content production while adhering to the ethical standards of journalism. There is a need for a more detailed analysis of the use of artificial intelligence in the media and the impact of technological innovations on journalists' work and the production of media content, while respecting professional ethical norms in journalism. The aim of this paper is to analyze the role of artificial intelligence, media ethics, the way audiences engage with information, and to examine the possibilities for the responsible integration of these technologies into media practice, with the goal of preserving traditional journalistic principles such as accuracy, objectivity, transparency, and accountability.

Keywords: media, artificial intelligence, professional standards

Inteligjenca artificiale ka nxitur polemika të mëdha në botë dhe dyshime të shumta në lidhje me përdorimin e saj në sfera të ndryshme të shoqërisë. Në botën moderne të mediave digjitale, inteligjenca artificiale ka gjetur zbatim të gjerë në analizën e të dhënave, automatizimin e raportimit dhe krijimin e përmbajtjeve të ndryshme mediatike. Mediat përballen me nevojën e një efikasiteti më të madh në procesin e informacionit, gjë që reflektohet në krijimin më të shpejtë të përmbajtjes, duke respektuar standardet etike të komunikimit. Një analizë më e detajuar mbi përdorimin e inteligjencës artificiale në media dhe ndikimin e inovacioneve teknologjike në punën e medias, do të ndihmojë shumë në krijimin e përmbajtjeve qenësore mediatike, si dhe në respektimin e normave etike e profesionale. Qëllimi i këtij punimi është të analizojë rolin e inteligjencës artificiale, si dhe të shqyrtojë mundësitë për integrimin e përgjegjshëm të këtyre teknologjive në praktikën mediatike.

Fjalë kyçe: media, inteligjencë artificiale, standarde profesionale

Hyrje

Inteligjenca artificiale (IA) është një nga trendet më të rëndësishme të shekullit të 21-të, duke hapur perspektiva të reja për të ardhmen e njerëzimit. Kjo teknologji ka një ndikim të madh në jetën e përditshme, duke e lehtësuar atë në aspekte të ndryshme të punës dhe analizën e të dhënave. Ndonëse në vitet e fundit është bërë fjalë kryesore, inteligjenca artificiale nuk është një fenomen i ri. Ky term, për herë të parë u përdor në vitin 1955 nga John McCarthy (McCarthy, 2007, 2). Ajo përfshin një gamë të gjerë mjetesh dhe programesh dhe, është shumë e vështirë të jepet një përkufizim që do t'i përfshinte të gjitha aspektet e saj. IA ka aftësinë të gjenerojë në mënyrë të pavarur përmbajtje të reja (tekstuale ose audio-vizuale), që e dallon atë nga programet që kanë për qëllim përpunimin, analizimin ose riprodhimin e të dhënave (Ka Yuk Chan & Colloton, 2024). Në bazë të të dhënave të caktuara, modelet e bazuara në inteligjencën artificiale gjeneruese mund të krijojnë, për shembull, lloje të ndryshme tekstesh, imazhesh ose materialesh video. Programet më të njohura të bazuara në inteligjencën artificiale gjeneruese janë modelet e mëdha gjuhësore, ose chatbot-et e trajnuar në baza të dhënash jashtëzakonisht të mëdha, specialiteti i të cilave është kryesisht gjenerimi i përmbajtjes tekstuale. Përdorimi i sistemit të inteligjencës artificiale mund të bazohet plotësisht në softuer, siç janë asistentët virtualë me të cilët është e mundur të komunikohet me zë, ose softuer për njohjen e fytyrës dhe të folurit, ose softuer për njohjen e imazhit (Baković, 2023, 40).

Inteligjenca artificiale u bë e njohur me shfaqjen e modeleve të reja gjuhësore të përparuara gjeneruese, siç është ChatGPT. Potenciali i teknologjive të reja u zhvillua duke u bazuar në inteligjencën artificiale në formën e asistentëve inteligjentë, platformat e ndryshme dhe reklamat e personalizuara për të përmirësuar përvojën e përdoruesit. Lidhur me të, ekzistojnë përkufizime të shumta, dhe një nga më të vjetrat është përkufizimi i John McCarthy, "babai i inteligjencës artificiale", sipas të cilit IA është shkenca dhe inxhinieria e krijimit të makinave inteligjente, veçanërisht programeve inteligjente kompjuterike (John McCarthy, 1955). Inteligjenca artificiale u referohet sistemeve që shfaqin sjellje inteligjente duke analizuar mjedisin e tyre dhe duke ndërmarrë veprime, me një shkallë të caktuar autonomie, për të arritur qëllime të caktuara. Ajo ndihmon sistemet kompjuterike të kryejnë detyra që zakonisht kërkojnë inteligjencë njerëzore. Në kontekstin e medias, inteligjenca artificiale përdoret për të analizuar sasi të mëdha të dhënash, për të automatizuar raportimin, për të krijuar lajme të personalizuara dhe për të luftuar informacionin e rremë.

Inteligjenca artificiale përfshin një fushë multidisiplinare në të cilën shfaqen çdo ditë mjete të shumta digjitale. Zbatimi i saj në fusha të ndryshme ka hapur shumë diskutime rreth kuptimit dhe qëllimit të përdorimit, por edhe rreziqeve në fushën e abuzimit me të drejtat e autorit. Inteligjenca

artificiale (IA) sot luan një rol kryesor në zhvillimin dhe ruajtjen e gjuhëve në të gjithë botën. Modele të mëdha gjuhësore si ChatGPT i OpenAI ose Gemini dhe Google, po revolucionarizojnë shkrimin, përkthimin dhe mësimin e gjuhëve. Gjuhët me më pak folës, shpeshherë lihen në hije nga gjuhët globale. Modelet e inteligjencës artificiale jepen në sasi të mëdha të dhënash, por shumica e këtyre të dhënave vijnë nga interneti dhe janë të dominuar nga anglishtja. Kjo ndihmon në përpunimin e konstruksioneve komplekse gjuhësore dhe shprehjeve specifike kulturore në gjuhët tona. Megjithatë, inteligjenca artificiale ka sjellë ndryshime të rëndësishme në mënyrën se si e përdorim dhe e mësojmë gjuhën. Përkthimi automatik, mjetet e kontrollit të gramatikës dhe sintaksës dhe modelet gjeneruese mundësojnë shkrim më të shpejtë dhe më efikas. E gjithë kjo ndikon në mënyrën se si komunikojmë, por edhe në normat gjuhësore - disa terma ndryshojnë, strukturat gramatikore bëhen më të thjeshta.

Një nga sfidat kryesore është se modelet e inteligjencës artificiale shpesh kanë vështirësi në dallimin midis gjuhëve që kanë ngjashmëri. Kjo mund të çojë në përkthime të pasakta ose përpunim të pasaktë të tekstit, veçanërisht kur kemi të bëjmë me terma specifikë kulturorë ose administrativë. Por, problematike është njohja e idiomave. Gjatë analizave të mia zgjedha një numër të caktuar idiomash - disa me leksema me origjinë orientale dhe të tjera me leksik të gjuhës frënge - për të testuar saktësinë e IA-së në përcaktimin e tyre. Rezultatet treguan se IA mund të jetë e dobishme si ndihmë në kërkimin gjuhësor, por jo gjithmonë mund të ofrojë përgjigje të saktë.

Gjuha nuk është vetëm një mjet komunikimi, por ajo formëson kulturën, identitetin dhe marrëdhëniet shoqërore. Meqë inteligjenca artificiale merr pjesë gjithnjë e më shumë në shkrim dhe përkthim, lind pyetja se si kjo do të ndikojë në normat gjuhësore dhe stilet e komunikimit në gjuhën shqipe. Mjetet e inteligjencës artificiale mund të ndihmojnë në standardizimin e gjuhës, përkatësisht përdorimin e drejtë të gjuhës, por në të njëjtën kohë ato mund të rrezikojnë përdorimin e drejtë të gjuhës. Prandaj, gjithmonë duhet plasur kujdes gjatë redakturës gjuhësore të tekstit.

Ndërkombëtarizmat dhe ndryshimi i shprehjeve gjuhësore

Duke pasur parasysh që modelet e inteligjencës artificiale përdorin më shpesh anglishten si gjuhë referimi, ekziston rreziku që gjithnjë e më shumë anglicizma të përvetësohen në të folurin e përditshëm. Mjetet e inteligjencës artificiale mund t'i nxisin më tej këto ndryshime duke favorizuar shprehjet e ndërkombëtarizuara. Megjithatë, kontrolli i automatizuar i drejtshkrimit, shkrimi me anë të inteligjencës artificiale dhe asistentët e përkthimit mund të përmirësojnë dukshëm përdorimin e drejtë të gjuhës, por njëkohësisht mund edhe ta reduktojnë përdorimin e drejtë të rregullave gramatikore. Pyetja është nëse nxënësit dhe studentët do të bëhen shumë të varur nga mjetet e inteligjencës artificiale.

IA si urë lidhëse midis kulturave

IA është një urë lidhëse midis gjuhëve. Përkthimi automatik u mundëson njerëzve me origjinë të ndryshme kulturore të komunikojnë me lehtësi, përkundër asaj që nuk mund të përcjellë në hollësi kontekstin kulturor. Megjithatë, përsosja e saj e vazhdueshme krijon mundësinë e krijimit të përmbajtjeve të reja nga një gjuhë në tjetrën. Modelet e mëdha gjuhësore tashmë krijojnë një lloj "gjuhe neutrale" përmes strukturave gramatikore dhe sintaksës së thjeshtuar. Kjo mund të lehtësojë komunikimin global, por edhe të zvogëlojë diversitetin e shprehjeve. Zhvillimi i modeleve të specializuara të inteligjencës artificiale për gjuhën po bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm. Përdorimi i Google Translate për gjuhë të ndryshme, transkriptimin automatik i të folurit dhe zhvillimin e përkthyesve të inteligjencës artificiale të përshtatur për të folmet dialektore lehtëson dukshëm punën e përkthyesit. Edhe në media shumë gazetarë përdorin më shpesh chatbot-e për të gjetur informacionin dhe për të përkthyer tekste, për krijimin e ilustrimeve etj. Megjithatë, rishikimi i tekstit është i domosdoshëm: kontrolli i drejtshkrimit, besueshmëria e burimeve dhe redaktimi përfundimtar i përmbajtjes duhet të jenë në duart e redaktorëve dhe të tjerëve që merren me to.

IA gjen përdorim në disa sfera, sidomos në transkriptim dhe përkthime automatike. Shumica e redaksive përdorin teknologji të reja për transkriptim të shpejtë të intervistave dhe përkthim të burimeve të huaja. Gjithashtu, mjetet e korrekturës të bazuara në inteligjencën artificiale zvogëlojnë kohën që duhet për të përgatitur tekstet për botim.

Zhvillimet tekniko-teknologjike të detyrojnë për njohuri më të mëdha mbi inteligjencën artificiale. Ajo duhet të trajnohet, jo vetëm për të përdorur, por edhe për të kuptuar dhe njohur mjetet e inteligjencës artificiale, produktet e saj dhe mënyrat për t'i vëzhguar dhe verifikuar ato në mënyrë kritike. Inteligjenca artificiale nuk është vetëm një sfidë teknologjike, por edhe një çështje thelbësore e një shoqërie demokratike: si të mbrohet e vërteta dhe të përdoret teknologjia e re me zgjuarsiri dhe përgjegjësi.

Literatura

- Luknar, I. (2024). *Veštačka inteligencija kao izazov*. Napredak, 5(2), 19–28.
- Mollick, E. (2024). *Co-Intelligence. Living and Working with AI*. Portfolio/Penguin.
- Prieto Ramos, F., & Guzmán, D. (2024). The impact of specialised translator training and professional experience on legal translation quality assurance: an empirical study of revision performance. *The Interpreter and Translator Trainer*, 2.
- Radford Alec, Karthik Narasimhan, Tim Salimans, and Ilya Sutskever (2018). *"Improving language understanding by generative pre-training"*.
- Solaiman Irene, Miles Brundage, Jack Clark, Amanda Aspell, Ariel Herbert-Voss, Jeff Wu, Alec Radford et al. (2019). *"Release strategies and the social impacts of language models"*.

ISSN 2671-3004

UDC 004.8:174
UDC 808.1:004.8

Punim studimor

Ajten HAJDARI – QAMILIUniversiteti “Shën Kirili e Metodi” – Shkup,
Fakulteti i Filologjisë “Bllazhe Koneski”
Katedra e Gjuhës dhe e Letërsisë Shqiptare
e-maili: ajtenqamili79@gmail.com**PËRFITIMET DHE RREZIQET NGA INTELIGJENCA ARTIFICIALE GJATË
TË SHKRUARIT PUNIME SHKENCORE****BENEFITS AND RISKS OF ARTIFICIAL INTELLIGENCE IN WRITING
SCIENTIFIC PAPERS****Përmbledhje**

Inteligjenca artificiale po zhvendoset nga industria teknologjike drejt biznesit. Firma të të gjitha llojeve po përdorin këtë inteligjencë për të parashikuar kërkesën, për të punësuar punëtorët dhe për t'u marrë me klientët. Parashikime të tilla ngjallin ankth sa edhe shpresë, pasi inteligjenca artificiale mund të transformojë edhe vendet tona të punës. Përsa kohë që bota dëshmon një rritje të paprecedentë në teknologjitë e inteligjencës artificiale (IA), është thelbësore të merren parasysh rreziqet dhe sfidat e mundshme që lidhen me miratimin e tyre të gjerë. Inteligjenca artificiale paraqet disa rreziqe të rëndësishme – nga zhvendosja e punës deri te shqetësimet e sigurisë dhe të privatësisë dhe nxitja e ndërgje-gjësimit për çështjet na ndihmon të përfshihemi në debate rreth impliki-meve ligjore, etike dhe shoqërore të IA. Zhvillimi i inteligjencës së përgji-thshme artificiale që tejkalon inteligjencën njerëzore ngre shqetësime afatgjata për njerëzimin. Perspektiva e saj mund të çojë në pasoja të paqëllimshme dhe potencialisht katastrofike, pasi këto sisteme të avancuara të AI mund të mos jenë në përputhje me vlerat ose prioritetet njerëzore. Mbështetja e tepërt në sistemet e IA mund të çojë në humbje të kreativitetit, aftësive të të menduarit kritik dhe intuitës njerëzore. Prandaj, arritja e një ekuilibri midis vendimmarrjes së ndihmuar nga IA dhe kontributit njerëzor është jetik për

ruajtjen e aftësive tona njohëse. Motivim për ta shkruar këtë kumtesë ishte puna ime disavjeçare, veç tjerash edhe si redaktore gjuhësore e punimeve të diplomës, magjistra-turave, doktrateve, romaneve, libra shkencorë etj. Dy vitet e fundit vërejta dallim të madh në cilësinë e punimeve, në stilin gjuhësor, sintaksën më të organizuar dhe ajo që bie më shumë në sy referencat nga libra anglisht. Nga e gjithë kjo analizë nxora shumë konstatime. Qëllimi i këtij punimi është të nxjerrë në pah se sa përfitojmë nga IA gjatë të shkruarit punime shkencore dhe sa rrezikohet të menduarit kritik, të shprehurit, hulumtimi i mirëfilltë, struktura e drejtë gjuhësore etj. dhe si ta menaxhojmë këtë situatë.

Fjalë kyçe: *Inteligjenca artificiale, përfitime, rreziqe, të shkruarit, hulumtime.*

Abstract

Artificial intelligence is moving from the technological industry towards business. Firms of all types are using this intelligence to forecast demand, hire workers, and deal with customers. Such predictions arouse both anxiety and hope, as artificial intelligence can also transform our workplaces. As the world witnesses an unprecedented rise in artificial intelligence (AI) technologies, it is crucial to consider the potential risks and challenges associated with their widespread adoption. Artificial intelligence presents several significant risks – from job displacement to security and privacy concerns, and fostering awareness of the issues helps us engage in debates about the legal, ethical, and social implications of AI. The development of general artificial intelligence that surpasses human intelligence raises long-term concerns for humanity. Its prospect could lead to unintended and potentially catastrophic consequences, as these advanced AI systems may not align with human values or priorities. Over-reliance on AI systems can lead to a loss of creativity, critical thinking skills, and human intuition. Therefore, achieving a balance between AI-assisted decision-making and human input is vital for preserving our cognitive abilities. The motivation for writing this paper was my work for several years, including as a language editor for diploma theses, master's theses, doctorates, novels, scientific books, etc. In the last two years, I noticed a big difference in the quality of the works, in the linguistic style, the more organized syntax and, most importantly, the references from English books. From all this analysis, I drew many conclusions. The purpose of this paper is to highlight how much we benefit from AI when writing scientific works and how much critical thinking, expression, proper research, correct linguistic structure, etc. are at risk. and how to manage this situation.

Keywords: *Artificial intelligence, benefits, risks, writing, research.*

1. Hyrje

Në dekadat e fundit, inteligjenca artificiale është shndërruar në një nga shtyllat kryesore të zhvillimit teknologjik global. Ajo po përdoret gjerësisht në industri, shëndetësi, ekonomi, arsim dhe kërkim shkencor, duke ndikuar drejtpërdrejt në mënyrën se si njerëzit punojnë, mësojnë dhe prodhojnë dije. Russell dhe Norvig (2021) e përkufizojnë inteligjencën artificiale si fushë që synon ndërtimin e sistemeve të afta për të kryer detyra që normalisht kërkojnë inteligjencë njerëzore, si: arsyetimi, planifikimi, të nxëniet dhe përpunimi i gjuhës natyrore.

Në konferencën e Dartmouthit me 13 korrik të vitit 1956 (me kërkesën e John McCarthy 1955 në Fondacionin Rockefeller për temën e konferencës) është prekur dhe trajtuar për herë të parë në një konferencë termi AI - "Artificial Intellegence" (Inteligjencë Artificiale). Që nga ai moment është punuar dhe arritur shumë në fushën e Inteligjencës Artificiale, por prapë se prapë IA është një fushë kërkimi me shumë potencial, pasi që ka edhe shumë pyetje të cilat ende nuk kanë marrë përgjigje dhe zhvillimi nuk ka qenë aq i shpejtë sa fushat e tjera të informatikës, si për shembull në paraqitjen grafike ose në performancën e procesorit. IA ofron mundësi të ndryshme për hulumtim, eksperimentim, për testim si dhe për filozofinë ndaj tij. Inteligjenca artificiale mund të ketë zbatim në të gjitha fushat, mirëpo se sa është e zbatueshme, ende është e paqartë për shumëkënd. Kjo vërehet qysh në dëfinimin e fjalës IA, jo vetëm në definicionin verbal, por edhe në atë se çka tregohet me emërtimin IA. Prandaj ky diversitet tërheq vëmendjen e madhe në "Makineritë që mendojnë".

Në shumë fusha të jetës sonë IA ka gjetur veten, edhe pse nuk mund të vërehet gjithmonë – duke menduar së pari në sistemet e navigacionit ose kompjuteri i veturës, që ndezin vetë dritat apo edhe masin presionin e gomave. Por robotët që njohim në nga filmat Science-Fiction të cilët ne i njohim si robotë që mendojnë, flasin dhe Droid vrapues ende nuk ekzistojnë në realitet, edhe pse janë duke u bërë hulumtime të veçanta në krijimin e tyre.

Metodat e përdorura për stimulimin e inteligjencës janë të natyrës së ndryshme dhe shtrihen nga vendimet e thjeshta, nëpër algoritme komplekse, automatë, sisteme këshillimi deri në rrjeta mendore. Por jo vetëm qasjet për realizimin e inteligjencës janë të ndryshme, edhe qëllimet po ashtu ndryshojnë. Pasi të zhvillohet një sistem, detyrat e të cilëve janë të pagabueshëm, krijohet edhe një sjellje njerëzore me të gjitha gabimet e tyre dhe e papërsosur për t'i bërë ballë sistemit.

Stephen Hawking zhvillimin e inteligjencës artificiale e ka cilësuar si një rrezik për njerëzimin duke paralajmëruar se mund të ndikojë në zhdukjen e njerëzimit: "Zhvillimi i plotë i inteligjencës artificiale mund të shënojë fundin e racës njerëzore. Do të pavarësohet dhe do të vetëridizajnohet me një shpejtësi aq të madhe, sa që njerëzit të cilët janë të kufizuar nga evolucioni i ngadaltë biologjik nuk do të mund të konkurronin

ndaj makinerive me inteligjencë të lartë artificiale dhe do të zëvendësohen..”

1

Në kontekstin akademik, përdorimi i IA-së është intensifikuar veçanërisht gjatë shkrimit të punimeve shkencore. Studentët dhe studiuesit po përdorin mjete të ndryshme digjitale për të gjeneruar ide, për të strukturuar kapituj, për të përmbledhur literatura dhe për të përmirësuar gjuhën akademike. Kjo situatë ka sjellë jo vetëm lehtësime praktike, por edhe shqetësime serioze lidhur me cilësinë e të nxënit, integritetin akademik dhe rolin e njeriut në procesin e krijimit shkencor.

Epoka digjitale karakterizohet nga një integrim gjithnjë e më i thellë i teknologjisë në jetën intelektuale të njeriut. Inteligjenca artificiale, si një nga zhvillimet më transformuese të shekullit XXI, po ndikon jo vetëm në mënyrën e organizimit të punës, por edhe në proceset themelore të të menduarit, të nxënit dhe prodhimit të dijes. Në fushën akademike, kjo teknologji po ndryshon paradigmen tradicionale të shkrimit shkencor, duke ngritur pyetje thelbësore mbi autorësinë, originalitetin dhe përgjegjësinë intelektuale.

Russell dhe Norvig (2021) theksojnë se inteligjenca artificiale nuk duhet parë thjesht si një mjet teknik, por si një sistem që ndërvepron me proceset njohëse njerëzore. Në këtë kuptim, përdorimi i IA-së në shkrimin shkencor nuk është vetëm çështje praktike, por edhe epistemologjike, pasi ndikon në mënyrën se si krijohet dhe vlerësohet dija.

Inteligjenca artificiale përfshin sisteme që mund të kryejnë detyra që tradicionalisht kërkojnë inteligjencë njerëzore, si arsytimi, të nxënit dhe përpunimi i gjuhës natyrore. Në arsimin e lartë, këto sisteme po integrohen gradualisht në procesin e shkrimit akademik, duke hapur diskutime të rëndësishme mbi rolin e teknologjisë në prodhimin e dijes.

2. Shkrimi shkencor si proces njohës dhe kulturor

Shkrimi shkencor nuk përbën vetëm një aktivitet mekanik të transmetimit të informacionit apo një përmbledhje të thjeshtë të fakteve ekzistuese, por përfaqëson një proces të ndërlikuar njohës dhe kulturor. Ai përfshin aftësi të larta mendore, si formulimi i problemeve kërkimore, përcaktimi i objektivave studimore, ndërtimi i argumenteve logjike dhe koherente, si dhe analiza kritike e literaturës përkatëse. Në këtë kuptim, shkrimi shkencor shërben jo vetëm si mjet komunikimi të rezultateve kërkimore, por edhe si instrument për ndërtimin dhe strukturimin e vetë mendimit shkencor.

Procesi i shkrimit kërkon reflektim të vazhdueshëm, vlerësim kritik të burimeve dhe aftësi për të sintetizuar njohuritë ekzistuese në mënyrë origjinale. Përmes këtij procesi, studiuesi zhvillon kompetenca të rëndësishme intelektuale, si mendimi kritik, autonomia akademike dhe aftësia për të krijuar lidhje të reja midis koncepteve teorike dhe të dhënave

¹ <https://www.aa.com.tr/sq/bota/hawking-zhvillimi-i-teknologjis%C3%AB-rrezik-p%C3%ABr-njer%C3%ABzimin/507715>

empirike. Rrjedhimisht, shkrimi shkencor luan një rol thelbësor në formimin profesional të studiuesit dhe në avancimin e shkencës në tërësi, duke kontribuar në prodhimin e njohurive të reja dhe në pasurimin e diskursit akademik.

Në vitet e fundit, sistemet e inteligjencës artificiale kanë treguar aftësi të konsiderueshme në analizimin e sasive të mëdha të të dhënave tekstuale dhe në gjenerimin e përmbajtjes së strukturuar dhe parimore në një kohë relativisht të shkurtër. Këto sisteme janë në gjendje të identifikojnë modele gjuhësore, të përmbledhin informacione dhe të sugjerojnë formulime alternative, çka i bën ato veçanërisht tërheqëse për përdorim në kontekstin e shkrimit akademik. Inteligjenca artificiale mund të shërbejë si një mjet mbështetës që përmirëson organizimin e mendimit, ndihmon në strukturimin e tekstit dhe lehtëson formulimin më të qartë dhe më të saktë të ideve kërkimore. (Luckin, 2016).

Megjithatë, ndërhyrja e inteligjencës artificiale në shkrimin shkencor ngre edhe çështje të rëndësishme epistemologjike dhe etike. Ndërsa përdorimi i saj mund ta lehtësojë procesin e shkrimit dhe të rrisë efikasitetin, ekziston rreziku që ky proces të thjeshtohet në mënyrë të tepruar. Varësia e tepërt nga teknologjitë digjitale dhe sistemet automatike mund të çojë në reduktimin e shkrimit shkencor në një proces kryesisht teknik, duke dobësuar dimensionin reflektues, interpretues dhe kritik që e karakterizon atë. Në këtë mënyrë, roli aktiv i studiuesit si subjekt njohës dhe krijues i kuptimit mund të zbehët, duke e kthyer shkrimin akademik më shumë në një akt prodhimi sesa në një proces të thellë intelektual. (Selwyn, 2019).

3. Përfitimet nga inteligjenca artificiale në shkrimet shkencore

Përdorimi i inteligjencës artificiale në shkrimet shkencore po bëhet gjithnjë e më i pranishëm në praktikën bashkëkohore akademike. Këto teknologji nuk synojnë të zëvendësojnë rolin e studiuesit, por të shërbejnë si mjete ndihmëse që përmirësojnë efikasitetin, cilësinë dhe qasjen e procesit të shkrimit shkencor. Në këtë kontekst, përfitimet nga inteligjenca artificiale shfaqen në disa nivele, duke filluar nga fazat paraprake të kërkimit deri te redaktimi përfundimtar i tekstit akademik.

3.1 Rritja maksimale e efikasitetit dhe produktivitetit

Një nga përfitimet kryesore të inteligjencës artificiale është aftësia e saj për të optimizuar në mënyrë të konsiderueshme fazat paraprake të kërkimit shkencor. Përmes analizës së të dhënave dhe përpunimit të gjuhës natyrore, sistemet e IA-së mund të përpunojnë shpejt një sasi të madhe informacionesh, duke ndihmuar studiuesin në identifikimin e temave kërkimore relevante, zbrazëtirave teorike dhe tendencave aktuale brenda një fushe të caktuar studimi. Këto teknologji kontribuojnë drejtpërdrejt në rritjen e produktivitetit akademik, duke reduktuar kohën e nevojshme për kërkime paraprake dhe përmbledhje të informacionit (Brynjolfsson dhe McAfee: 2017).

Në praktikë, kjo do të thotë se studiuesit mund të fokusohen më shumë në aspektet analitike dhe interpretative të punës së tyre, në vend që

të angazhohen për një kohë të gjatë në kërkime manuale të literaturës. Kështu që, inteligjenca artificiale shndërrohet në një mjet që mbështet menaxhimin më efikas të kohës dhe burimeve intelektuale, pa e zëvendësuar procesin krijues dhe kritik të studiuesit.

3.2 Përmirësimi i strukturës argumentuese

Një tjetër përfitim i rëndësishëm i përdorimit të inteligjencës artificiale në shkrimet shkencore lidhet me përmirësimin e strukturës argumentuese të tekstit. Mjetet e inteligjencës artificiale mund të ndihmojnë në organizimin logjik të ideve, në ndërtimin e një rrjedhe të qartë argumentesh dhe në strukturimin e logjikshëm të kapitujve dhe nënkapitujve. Kjo ndihmë është veçanërisht e vlefshme në fazat e hershme të shkrimit, kur studiuesi përpiqet të sistemojë mendimet dhe të ndërtojë skeletin konceptual të punimit.

Inteligjenca artificiale mund të kontribuojë në përmirësimin e qartësisë së mesazhit shkencor, duke sugjeruar riformulime më të sakta dhe duke ndihmuar në shmangien e përsëritjeve ose paqartësive konceptuale. (Luckin, 2016). Për më tepër, këto mjete ofrojnë mbështetje të rëndësishme në korrigjimin e gabimeve drejtshkrimore dhe gramatikore, gjë që ndikon drejtpërdrejt në cilësinë formale të tekstit akademik. Ky aspekt është i rëndësishëm jo vetëm për autorët që shkruajnë në një gjuhë joamtare, por edhe për studiuesit me përvojë, të cilët synojnë një nivel të lartë saktësie dhe profesionalizmi në shkrimin shkencor në gjuhën amtare.

3.3 Mbështetja gjuhësore dhe stilistike

Mbështetja gjuhësore dhe stilistike përbën një nga kontributet më të dukshme të inteligjencës artificiale në shkrimet shkencore. Për autorët që shkruajnë në një gjuhë të huaj, këto sisteme ofrojnë ndihmë të konsiderueshme në përmirësimin e saktësisë gjuhësore, në përdorimin e terminologjisë së përshtatshme shkencore dhe në ruajtjen e një stili akademik të qëndrueshëm. Kjo ndihmë ndikon drejtpërdrejt në rritjen e qartësisë dhe lexueshmërisë së punimeve shkencore, duke e bërë përmbajtjen më të kuptueshme për një audiencë ndërkombëtare.

Për më tepër, inteligjenca artificiale mund të ndihmojë në përshtatjen e stilit të shkrimit sipas kërkesave specifike të revistave shkencore ose institucioneve akademike. Në këtë mënyrë, ajo shërben si një mjet që lehtëson përputhshmërinë me standardet akademike, pa cenuar përmbajtjen shkencore dhe kontributin origjinal të autorit.

3.4 Lehtësimi i kërkimit të literaturës

Një nga fushat ku inteligjenca artificiale ka treguar potencial të veçantë është lehtësimi i kërkimit dhe menaxhimit të literaturës shkencore. Mjetet e IA-së janë të afta të analizojnë një numër të madh burimesh akademike, përfshirë artikuj shkencorë, libra dhe raporte kërkimore, dhe të nxjerrin informacionin më të rëndësishëm në mënyrë të shpejtë dhe të

strukturuar. Kjo i mundëson studiuesit të ndërtojë një bazë teorike më të gjerë dhe më të qëndrueshme (Russell & Norvig, 2021).

Një aspekt veçanërisht i rëndësishëm është aftësia e inteligjencës artificiale për të përmbledhur dhe sintetizuar një numër të madh burimesh akademike. Përmes kësaj, studiuesit mund të krijojnë një pasqyrë më të plotë të literaturës ekzistuese, të identifikojnë pikëpamjet kryesore teorike dhe debatet shkencore aktuale, si dhe të dallojnë zbrazëtitat kërkimore që do të hapin rrugë hulumtuese në të ardhmen. Kjo qasje kursen kohë dhe energji intelektuale, të cilat mund të investohen në analizë më të thellë, interpretim kritik dhe zhvillim të kontributit original shkencor.

4. Rreziqet e përdorimit të inteligjencës artificiale

Pavarësisht përfitimeve, përdorimi i inteligjencës artificiale gjatë shkrimit të punimeve shkencore shoqërohet me rreziqe të konsiderueshme. Një nga shqetësimet kryesore lidhet me integritetin akademik. Përdorimi i pakontrolluar i mjeteve të IA-së mund të çojë në plagjiaturë të pavetëdijshme dhe në paraqitjen e përmbajtjes së gjeneruar nga makina si produkt origjinal i autorit. (Cotton & Shipway, 2023). Po ashtu, modelet gjuhësore mund të gjenerojnë tekste të rrjedhshme, por jo gjithmonë të sakta shkencërisht, duke krijuar rrezik për përhapjen e informacionit të gabuar (Bender, 2021). Kjo kërkon që studiuesi të mbajë një rol aktiv në verifikimin kritik të përmbajtjes së prodhuar nga IA.

4.1 Dobësimi i autonomisë intelektuale

Një nga rreziqet më të mëdha të përdorimit të tepruar të inteligjencës artificiale është humbja graduale e autonomisë intelektuale. Studiuesit mund të fillojnë të mbështeten në sugjerimet e IA-së në vend që të zhvillojnë gjykimin e tyre kritik, duke çuar në një standardizim të mendimit shkencor (UNESCO, 2021).

4.2 Rreziku i uniformizimit të diskursit shkencor

Modelet gjuhësore kanë tendencë të prodhojnë tekste që ndjekin modele të ngjashme stilistike dhe strukturore. Si pasojë, ekziston rreziku që diskursi shkencor të bëhet i njëtrajtshëm, duke humbur diversitetin e qasjeve teorike dhe stilistike (Bender, 2021).

4.3 Problemet e autorësisë dhe përgjegjësisë

Një çështje veçanërisht problematike lidhet me autorësinë e punimeve shkencore. Kur një pjesë e konsiderueshme e tekstit gjenerohet nga inteligjenca artificiale, lind pyetja se kush mban përgjegjësi për përmbajtjen, gabimet, pasaktësitë dhe interpretimet e gabuara.

4.4 Integriteti akademik dhe plagjiatura

Një shqetësim i madh lidhet me integritetin akademik. Studiues të ndryshëm paralajmërojnë se përdorimi i pakontrolluar i mjeteve të IA-së mund të çojë në paraqitjen e përmbajtjes së gjeneruar nga makina si produkt origjinal i autorit, duke kërcënuar kështu parimet etike të punës shkencore.²

² https://www.mdpi.com/2227-7102/15/10/1322?utm_source=chatgpt.com

Shembull konkret: Një studim i ri zbuloi se një numër i madh artikujsh në një revistë shkencore të quajtur *Global International Journal of Innovative Research* ishin gjeneruar nga IA dhe më pas rrejtshëm u atribuohen studiuesve të njohur, duke u publikuar nën emrat e tyre pa dijeninë e tyre. Kjo praktikë, e zbuluar me analiza të gjenerimit dhe citimeve, rrezikon seriozisht kredibilitetin e botimeve shkencore dhe reputacionin e autorëve të vërtetë.³

4.5 Saktësia/pasaktësia dhe besueshmëria e informacionit

Shkencëtarët paralajmërojnë se modelet gjuhësore mund të prodhojnë informacion të pasaktë ose të njëanshëm, çka përbën rrezik serioz për cilësinë e kërkimit shkencor. Në kontekstin e IA-së kemi termin “halucinatë” që nënkupton prodhimin e informacionit bindës, por të pavërtetë ose të shpikura nga modeli. Këto probleme nuk janë vetëm teorike – AI mund të ofrojë citime, formulime ose të dhëna që nuk ekzistojnë në literaturë, duke krijuar një bazë të rreme referencash që më pas përhapen në tekstin shkencor. Ky fenomen është raportuar si një sfidë e ndjeshme për saktësinë e publikimeve.⁴

Shembull konkret: Në praktikë, ka raste kur studentë ose studiues kanë pasqyruar në punimet e tyre referenca që rezultuan se nuk ekzistojnë fare, të gjeneruara nga IA gjatë përpilimit të literaturës, duke çuar në pasaktësi të rëndësishme akademike. Sipas një raporti nga *Medium*, një kandidat doktore nga 47 citimet e një kapitulli të punimit të tij, 12 citime ishin të sajuara nga IA, gjë e cila bëri që të shtyhet mbrojtja e tezës dhe të rishikohet edhe njëherë punimi.⁵

4.6 Publikime shkencore të rreme dhe etika e botimit

Një fenomen tjetër shqetësues është botimi i artikujve të rremë, të krijuar tërësisht nga IA ose me ndihmë minimale nga autori dhe që arrijnë të publikohen në revista përmes editorialeve të dobëta ose procedurave të pakontrolluara. Këto publikime shpesh bëjnë citime të pavërteta, nuk paraqesin të dhëna eksperimentale dhe e dëmtojnë besueshmërinë e literaturës shkencore.

Shembull konkret: Disa studiues kanë identifikuar një numër të konsiderueshëm të kumtesave me karakteristika të dyshimta, të botuara në arkiva të hapura si *preprint-et*, ku strukturat e tekstit janë të përsëritura, përmbajtja teknikisht e dobët dhe citimet shpesh janë të pavendosura ku duhet. Këto kumtesa mund të kontribuojnë në inflacionin e citimeve dhe të manipulojnë treguesit si *h-indeksi* në mënyrë të padrejtë.⁶

4.7 Keqpërdorimi i procesit të peer review⁷

³https://link.springer.com/article/10.1186/s41073-025-00165-z?utm_source=chatgpt.com

⁴⁴ Po aty.

⁵<https://medium.com/%40nomannayeem/the-fabrication-problem-how-ai-models-generate-fake-citations-urls-and-references-55c052299936>

⁶ https://arxiv.org/abs/2503.23414?utm_source=chatgpt.com

⁷ peer review – është një proces vlerësimi i cilësisë së punës shkencore akademike nga një ose më shumë persona me kompetenca të ngjashme me hartuesit e veprës.

Problemet nuk kufizohen vetëm te shkrimi i tekstit - edhe procesi i vlerësimit nga kolegët (peer review) po përballet me sfida të reja. Në disa raste të raportuara, është konstatuar se disa autorë kanë përfshirë instruksione të fshehta në dokumentet e para-publikuara, të synuara për të manipuluar algoritme apo individë që përdorin inteligjencë artificiale për të gjeneruar komente pozitive të vlerësimit. Kjo ngrit çështje etike së bashku me besueshmërinë e procesit të rishikimit shkencor.⁸

4.8 Probleme praktike në zbulimin e përmbajtjes së IA-së

Gjatë kohës kur hartuesit e punimeve shkencore dhe redaktorët janë duke përdorur mjete për zbulimin e teksteve të gjeneruara nga IA, këto sisteme shpesh shfaqin rezultate kontradiktore, p.sh.: një pjesë e punës që shkruhet nga njeriu mund të shfaqet si i krijuar nga IA ose anasjelltas. Kjo nuk është vetëm një çështje teknike, por edhe një rrezik për studiuesit që mund të akuzohen padrejtësisht për përdorim të IA-së apo plagjiaturë.⁹

Shembuj konkretë:

- Rishikues akademikë raportojnë se shumë dorëzime për botim duken qartë të gjeneruara nga IA, me seksione metodologjike pa kuptim të thellë apo referenca të pakuptimta. Kjo i shtyn redaktorët që të refuzojnë kërkesa bazuar në indicie të forta të origjinës së IA-së në tekst.
- Magjistrantë dhe doktorantë raportojnë se sistemet e kontrollit të plagjiaturës i klasifikojnë punimet e tyre si “AI plagiarism” edhe kur ato janë pune origjinale që përpunojnë literaturën vetë, duke reflektuar kufizimet e mjeteve të detektimit.¹⁰
- Kurse tekstet nga literatura që nuk gjenden askund në formë elektronike, edhe sikur të kopjohet e të vidhet plotësisht, sistemi i plagjiaturës nuk e identifikon aspak. E atëherë më pak nëse punimi përkthehet nga shqipja në maqedonisht, ashtu siç kërkohet në universitetin tonë.

4.9. Ndikimi afatgjatë në të menduarit kritik

Të menduarit kritik dhe kreativiteti përbëjnë thelbin e kërkimit shkencor dhe zhvillohen përmes përballjes së vazhdueshme me probleme të ndërlikuara dhe përmes analizës së pavarur të informacionit. Mbështetja e tepërt në inteligjencën artificiale mund të dobësojë këto aftësi, duke e reduktuar rolin e autorit në një redaktues pasiv të tekstit të gjeneruar nga makina (Selwyn, 2019). UNESCO në vitin 2021 paralajmëroi se përdorimi i pakontrolluar i IA-së në arsim mund të çojë në varësi teknologjike dhe në uljen e autonomisë intelektuale të studentëve dhe të studiuesve.

⁸ https://www.theguardian.com/technology/2025/jul/14/scientists-reportedly-hiding-ai-text-prompts-in-academic-papers-to-receive-positive-peer-reviews?utm_source=chatgpt.com

⁹ https://trickmenot.ai/ai-detection-in-academic-publishing/?utm_source=chatgpt.com

¹⁰ https://www.reddit.com/r/GradSchool/comments/1emrxrz/turnitin_and_ai_accusations/?utm_source=chatgpt.com

4.10. Kreativiteti shkencor

Kreativiteti është një element thelbësor i inovacionit shkencor. Përderisa inteligjenca artificiale mund të ndihmojë në kombinimin e ideve ekzistuese, ajo nuk zotëron intuitën dhe përvojën njerëzore që janë të nevojshme për zbulime origjinale. Floridi (2018) thekson se kreativiteti njerëzor nuk mund të zëvendësohet nga algoritmet, por vetëm të mbështetet prej tyre.

4.11. Aspektet etike dhe rregullative në përdorimin e IA-së

Përdorimi i inteligjencës artificiale në shkrimin shkencor kërkon një kornizë të qartë etike dhe ligjore. Dokumente si *Rekomandimi* i UNESCO-s për Etikën e Inteligjencës Artificiale (2021) dhe *White Paper* i Komisionit Evropian (2020) theksojnë rëndësinë e transparencës, llogaridhënies dhe mbrojtjes së vlerave njerëzore në përdorimin e këtyre teknologjive. Secili studiues, duhet të mbajë përgjegjësi për artikujt shkencorë që i shkruan dhe publikon, duke pasur ndërgjegje të plotë për të dhënat dhe interpretimet që i jep.

4.12. Literatura e cunuar, burime jo të plota

Ajo që i lë mangët dhe të cunuar punimet shkencore të shkruara me IA është mungesa e një pjese shumë të madhe të literaturës në gjuhën shqipe në formë elektronike. Shumë pak libra shqipe janë të plasuar në internet, gjë që e pengon IA të shfrytëzojë këtë literaturë. Meqenëse literatura që përdor IA është vetëm ajo që ndodhet në internet apo edhe tekstin që mund t'ia japim IA-së në formë të fotografisë apo skenimit, shumë fakte, argumente dhe të dhëna të tjera që lidhen me shqipen dhe kulturën shqiptare në përgjithësi mbeten të papërfshira në shkrimet shkencore. Për këtë arsye dalin shumë pasaktësi, mangësi, jepet një pasqyrë krejtësisht e devijuar nga e vërteta dhe punimi më nuk mund të quhet i mirëfilltë shkencor.

4.13. Gabime gjuhësore (drejtshkrimore dhe sintaksore)

Varësisht nga teksti në gjuhë shqipe që ia japim IA për ta përpunuar e për ta bërë punim shkencor, ndikon që gabimet gjuhësore me automatizëm të barten nga teksti ose libri të cilin e shfrytëzon IA në punimin që e harton. Gjithashtu shpesh struktura sintaksore e fjalive dhe e periudhave janë drejtpërdrejt të ndikuara nga anglishtja, sepse tekstet në softwerin/bazën digjitale të IA-së së pari përpunohen anglisht e pastaj na ofrohet në shqip apo në gjuhë të tjera.

4.14. Tautologjia

Pikërisht për arsyen që e përmenda në pikën paraprake, shpesh ndodh që në punimet e hartuara nga IA të përsëriten fjalë të njëjta brenda një fjalie apo togfjalëshi, sepse kur përkthehet teksti nga anglishtja ndodh që për një sinonim të përafërt në anglisht të ketë 2 fjalë të ndryshme, kurse në shqip për të dyja kuptimet përdoret e njëjta fjalë dhe anasjelltas. Madje, shpesh krijohen fjalë që nuk ekzistojnë fare në leksikon e gjuhës shqipe, duke u vënë vetëm mbaresat e shqipes një fjale të anglishtes.

4.15. Varësia si sëmundje psikike

Një rrezik shumë i madh që mund të shkaktojë përdorimi i IA është varësia si sëmundje psikike. Sa më shumë që e përdor IA-në për çështje të ndryshme në jetën e përditshme, krijohet varësi nga përdorimi, e cila nuk mund të shërohet me asgjë. Varësia vetëm shkon duke u rritur dhe mungesa e saj krijon pasiguri, huti, frikë dhe bllokim të trurit. Si pasojë e kësaj, studiuesit e atillë nuk do të jenë në gjendje as të mendojnë, as të logjikojnë e as të shkruajnë dy fjali në mënyrë të pavarur. Kjo varësi mund të dëmtojë rrënjësisht tërë shoqërinë.

Përfundim dhe rekomandime

Inteligjenca artificiale ofron mundësi të jashtëzakonshme për përmirësimin e procesit të shkrimit të punimeve shkencore. Ajo mund të rrisë efikasitetin në kërkimin e literaturës, të përmirësojë strukturën argumentuese dhe qartësinë gjuhësore, si dhe të ndihmojë studiuesit në menaxhimin e sasisë së madhe të informacionit shkencor. Përfitimet e saj janë të dukshme në aspektin teknik, organizativ dhe gjuhësor, duke e bërë procesin më të shpejtë dhe më të strukturuar.

Megjithatë, përdorimi i IA-së ka edhe një sërë rreziqesh. Integriteti akademik, etika profesionale, kreativiteti dhe mendimi kritik janë të rrezikuara nëse studiuesit mbështeten në mënyrë të tepruar te algoritmet. Modelet gjuhësore mund të prodhojnë informacion të pasaktë, citime të pavërteta dhe struktura të njëtrajtshme të tekstit, duke reduktuar diversitetin e qasjeve teorike dhe duke rrezikuar autonominë intelektuale. Rreziqet e përdorimit të IA-së përfshijnë gjithashtu plagjiaturën e pavetëdijshme, varësinë teknologjike dhe dobësimin e aftësive për të menduar në mënyrë kritike dhe për të interpretuar literaturën në mënyrë të pavarur.

Në të ardhmen, inteligjenca artificiale pritet të integrohet gjithnjë e më shumë në proceset akademike dhe të jetë pjesë e përditshme e shkrimeve shkencore. Megjithatë, sfida kryesore do të jetë ruajtja e balancës midis inovacionit teknologjik dhe vlerave themelore të shkencës, duke përfshirë autonominë intelektuale, kreativitetin dhe integritetin akademik.

Për një përdorim të përgjegjshëm të IA-së, studiuesit duhet të ndjekin disa rekomandime praktike:

1. **Integrimi si mjet mbështetës, jo zëvendësues** – IA duhet të përdoret për të ndihmuar në organizimin e ideve, përmbledhjen e literaturës ose përmirësimin e stilit gjuhësor, pa e zëvendësuar analizën kritike të autorit.
2. **Transparencë dhe deklarim i përdorimit të IA-së** – çdo pjesë e punimit që është ndihmuar nga IA duhet të identifikohet qartë, duke respektuar standardet e revistave akademike dhe etikën e botimit.
3. **Verifikimi i informacionit dhe referencave** – studiuesit duhet të kontrollojnë çdo citim, të dhënë apo përmbajtje të gjeneruar nga IA, për të siguruar saktësinë dhe besueshmërinë e informacionit.

4. **Ruajtja e mendimit kritik dhe kreativitetit** – përdorimi i IA-së duhet të jetë i balancuar, duke e mbajtur studiuesin në rolin qendror të prodhimit të dijes dhe të interpretimit shkencor.
5. **Zhvillimi i aftësive etike dhe teknologjike** – studiuesit duhet të jenë të informuar mbi kufizimet e IA-së dhe mënyrat për të shmangur keqpërdorimin, duke ndjekur udhëzimet dhe rekomandimet e organizatave ndërkombëtare si UNESCO dhe Komisioni European.

Referenca:

- Bender, E. M., Gebru, T., McMillan-Major, A., & Shmitchell, S. (2021). *On the dangers of stochastic parrots: Can language models be too big?* Proceedings of the ACM Conference on Fairness, Accountability, and Transparency.
- Brynjolfsson, E., & McAfee, A. (2017). *Machine, platform, crowd: Harnessing our digital future*. W. W. Norton & Company.
- Cotton, D. R. E., Cotton, P. A., & Shipway, J. R. (2023). Chatting and cheating? Ensuring academic integrity in the era of ChatGPT. *Innovations in Education and Teaching International*.
- European Commission. (2020). *White paper on artificial intelligence: A European approach to excellence and trust*.
- Floridi, L., Cows, J., Beltrametti, M., et al. (2018). AI4People—An ethical framework for a good AI society. *Minds and Machines*, 28(4), 689–707.
- Luckin, R., Holmes, W., Griffiths, M., & Forcier, L. B. (2016). *Intelligence unleashed: An argument for AI in education*. Pearson.
- Russell, S., & Norvig, P. (2021). *Artificial intelligence: A modern approach* (4th ed.). Pearson.
- Selwyn, N. (2019). *Should robots replace teachers? AI and the future of education*. Polity Press.
- UNESCO. (2021). *Recommendation on the ethics of artificial intelligence*.
https://akad.gov.al/u-zhvillua-konferenca-shkencore-nderkombetare-teknologjia-inteligenca-artificiale-ia-dhe-transformimi-i-kerkimit-shkencor/?utm_source=chatgpt.com
https://as-proceeding.com/index.php/ijanser/article/view/2806?utm_source=chatgpt.com
https://journals.aseiacademic.org/index.php/ijsei/article/view/468?utm_source=chatgpt.com
https://journals.aseiacademic.org/index.php/ijsei/article/view/468?utm_source=chatgpt.com
https://www.journal-uamd.org/index.php/IJRD/article/view/37?utm_source=chatgpt.com
https://www.journal-uamd.org/index.php/IJRD/article/view/37?utm_source=chatgpt.com
https://www.journal-uamd.org/index.php/IJRD/article/view/687?utm_source=chatgpt.com
<https://www.aa.com.tr/sq/bota/hawking-zhvillimi-i-teknologjis%C3%AB-rrezik-p%C3%ABr-njer%C3%ABzimin/507715>

Sejdi M. GASHIInstituti Albanologjik- Prishtinë
e-mail: sgashi.iap@gmail.com**GJUHA SHQIPE SI MJET IDENTIFIKUES DHE NDËRVEPRUES NË
MJEDISËT SHUMËKULTURORE****THE ALBANIAN LANGUAGE AS AN IDENTIFYING AND INTERACTIVE
TOOL IN MULTICULTURAL ENVIRONMENTS****Përmbledhje**

Ky punim e trajton rolin e gjuhës shqipe si mjet themelor identifikimi dhe ndërveprimi shoqëror në mjediset shumëkulturore, me fokus të veçantë te shqiptarët në Serbi (komunat: Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë). Duke u mbështetur në qasje të ndryshme sociolinguistike dhe antro-po-logjike, studimi analizon funksionet identitare, komunikative dhe politike të shqipes, si dhe sfidat institucionale e shoqërore me të cilat përballlet ajo në kontekste minoritare. Bazuar në qëllimet dhe metodat e punës, hulumtimi sjellë një sërë rezultatesh teorike, empirike dhe kulturore që ndriçojnë rolin e gjuhës shqipe në ndërtimin dhe ruajtjen e identitetit kulturor, në kontekstin shumëkulturore të lartpërmendur.

Studimi ynë ka vënë në pak se gjuha nuk është thjesht një mjet komunikimi, por është element shumë i rëndësishëm përdallues dhe përbashkues, përmes së cilës individët dhe grupet shoqërore shprehin përkatësinë e tyre kulturore dhe kombëtare, krijojnë ndjenjën e të qenit pjesë e shoqërisë, ripërtërijnë vazhdimësinë historike, ndërveprojnë në mjediset shumëkulturore etj.

Fjalë kyçe: *Gjuha shqipe, mjedisë shumëkulturore, identitet, individ, grup shoqëror, Preshevë, Medvegjë, Bujanoc.*

Abstract

This paper examines the role of the Albanian language as a fundamental instrument of identification and social interaction in multicultural environments, with a particular focus on Albanians in Serbia (the municipalities of Preševo, Bujanoc, and Medveđa). Drawing on various sociolinguistic and anthropological approaches, the study analyzes the identity-related, communicative, and political functions of the Albanian language, as well as the institutional and societal challenges it faces in minority contexts. Based on the aims and methods of the research, the study presents a series of theoretical, empirical, and cultural findings that illuminate the role of the Albanian language in constructing and preserving cultural identity within the aforementioned multicultural context.

Our study has shown that language is not merely a tool of communication, but a crucial differentiating and unifying element through which individuals and social groups express their cultural and national belonging, develop a sense of social inclusion, renew their historical continuity, and interact within multicultural environments.

Keywords: *Albanian language, multicultural environments, identity, individual, social group, Preshevë, Medvegjë, Bujanoc.*

Hyrje

Gjuha dhe identiteti janë të ndërlidhura ngushtë, veçanërisht në mjediset shumëkulturore e shumëgjuhësore. Kjo marrëdhënie luan rol thelbësor si në formësimin e identiteteve personale ashtu edhe në ato kolektive, duke ndikuar kështu edhe në zhvillimet e përgjithshme të një shoqërie të caktuar. Kur jemi te gjuha si mjet identifikues dhe ndërveprues në mjediset shumëkulturore, në vitet e fundit, studiuesit janë përqendruar gjithnjë e më shumë te mënyra se si përdorimi i gjuhës përfshinë ndërthurjen e shumëgjuhësisë në ndërtimin e identiteteve individuale, por edhe të atyre grupe. Këto studime kanë vënë në pah kompleksitetin e formimit të identitetit në një botë të globalizuar, ku roli dhe ndikimi i gjuhëve të vogla, siç është edhe gjuha shqipe gjithnjë e më shumë po bëhet i papërfillshëm (García & Wei, 2020).

Në kontekstet shumëkulturore, gjuha vepron si një mjet kryesor përmes të cilit individët etablojnë identitetet e tyre. Anglishtja, si gjuhë globale, shpesh perceptohet si shenjë moderniteti dhe përparimi, gjë që mund të sjellë tensione për individët që ballafaqohen me dukurinë e identiteteve të shumëfishta gjuhësore. Hulumtimet tregojnë se folësit shpesh përdorin ndërrimin e kodeve-alternimin ndërmjet gjuhëve ose dialekteve në varësi të kontekstit shoqëror si një mjet për t'u lidhur fort me identitetin. Për shumë individë dygjuhësh ose shumëgjuhësh, ndërrimi i kodeve gjuhësore nuk është thjesht një strategji praktike, por një aspekt thelbësor i vetëshprehjes

që u mundëson atyre t'i përshtatin identitetet me grupe të caktuara shoqërore (Bucholtz & Hall, 2021). Nga ana tjetër, rëndësia e ruajtjes së gjuhës amtare brenda komuniteteve shumëkulturore nuk mund të nënvlerësohet. Gjuhët amtare shpesh mbartin kuptime të thella kulturore dhe rëndësi personale, duke vepruar si bartëse të trashëgimisë dhe identitetit. Studimet tregojnë se individët që ruajnë gjuhët e tyre amtare shpesh përjetojnë një lidhje më të fortë me rrënjët kulturore dhe një ndjenjë më kohezive ndaj vetvetes (Cenoz & Gorter, 2021). Ruajtja e gjuhës është thelbësore për transmetimin e vlerave, besimeve dhe traditave kulturore, veçanërisht ndër brezat më të rinj që përndryshe mund të anojnë drejt gjuhës dominuese në ambientet ku ata jetojnë e veprojnë (Lee, 2022). Sipas studimeve është dëshmuar se dinamika e përfshirjes dhe përjashtimit brenda mjediseve shumëkulturore mund t'i komplikojë marrëdhëniet midis pjesëtarëve të etnive të ndryshme, ndërsa të qenët shumëgjuhësh mund të pasurojë ndërveprimet shoqërore dhe të ofrojë një ndjenjë përkatësie, mund të çojë gjithashtu në përvoja të largimit kur individët ndihen të detyruar të përshtaten me gjuhën dominuese. Për shembull, kërkimet kanë zbuluar se folësit e gjuhëve minoritare shpesh përballen me stigmatizim në mjediset e caktuara (të shkollimit, të punës etj.), gjë që i çon ata drejt një lloj autocensure dhe pjesëmarrjeje të kufizuar në proceset e ndryshme shoqërore në mjediset ku jetojnë e veprojnë folësit e caktuar (Miller & Cheng, 2023)¹¹. Ky fenomen nxjerr në pah raportet ndërmjet diversitetit gjuhësor dhe integritit shoqëror, ku gjuha mund t'i bashkojë, por edhe mund t'i ndajë komunitetet, përkatësisht folësit e gjuhëve të ndryshme.

Në studimet bashkëkohore sociolinguistike dhe antropologjike, gjuha konceptohet jo vetëm si mjet komunikimi, por edhe si shenjë identitare dhe simbol i përkatësisë kolektive. Për komunitetet pakicë, funksioni i gjuhës merr një dimension të shumëfishtë: ajo është njëkohësisht mjet i vetëruajtjes kulturore dhe instrument i ndërveprimit me shumicën dominuese. Në këtë kuadër, rasti i shqiptarëve në Serbi paraqet një terren të rëndësishëm studimi për të kuptuar marrëdhënien ndërmjet gjuhës, identitetit dhe mjedisit shumëkulturore.

Le të ndalemi tani te objekti kryesor i studimit në këtë punim, pra te gjuha shqipe si mjet identifikues dhe ndërveprues në mjediset shumëkulturore, në rastin konkret, në komunat: Preshevë, Medvegje dhe Bujanoc.

Korniza teorike: gjuha, identiteti dhe shumëkulturalizmi

Teoritë bashkëkohore mbi identitetin gjuhësor theksojnë se gjuha është një nga shenjat më të qëndrueshme të identitetit etnik (Fishman, 1991). Sipas Anderson-it (1991), komunitetet imagjinare ndërtohen dhe riprodhohen përmes gjuhës, e cila shërben si mjet i përbashkët simbolik. Në

¹¹ Norton, B. (2013). *Identity and language learning: Extending the conversation* (2nd ed.). Bristol: Multilingual Matters.

kontekstin shumëkulturore, Taylor (1994) argumenton se njohja publike e gjuhëve minoritare është parakusht për dinjitetin dhe barazinë e komuniteteve pakicë. Në këtë prizëm, përdorimi institucional i shqipes në Serbi nuk është vetëm çështje praktike, por edhe akt simbolik i njohjes shoqërore.

Statusi ligjor dhe zbatimi i Kartës Evropiane për Gjuhët Minoritare në Serbi

Shqiptarët në Serbi, të përqendruar kryesisht në Luginën e Preshevës (Preshevë, Bujanoc dhe Medvegje), jetojnë në një kontekst ku e drejta për përdorimin e gjuhës së tyre amtare është e njohur ligjërisht, por shpesh e kufizuar në praktikë, ndonëse Republika e Serbisë, më 2006 e ka ratifikuar Kartën Evropiane për Gjuhët Rajonale ose Minoritare, me ç'rast është përcaktuar edhe e drejta e përdorimit të gjuhës shqipe, krahas gjuhëve të tjera si: boshnjakishtja, kroatishtja, bullgarishtja, hungarishtja, rumanishtja, sllovakishtja etj. Të drejtat gjuhësore të pakicave në Serbi janë të garantuara edhe me Kushtetutë dhe me Ligjin për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Pakicave Kombëtare (2002). Së këndejmi, sipas legjislacionit serb, një gjuhë e cilësdo pakicë kombëtare në mënyrë që ta fitojë statusin e përdorimit zyrtar në një komunë, folësit e asaj gjuhe duhet të përbëjë të paktën 15 % të popullsisë së komunës. Ndërkaq, për Vojvodinën kjo shkallë është caktuar të jetë 25 %¹². Po ashtu, sipas ligjeve ekzistuese, minoritetet kanë të drejtë në përdorimin e gjuhës së tyre amtare në komunikim zyrtar me organet qendrore të shtetit dhe të marrin përgjigje në atë gjuhë nëse popullsia e tyre arrin të paktën 2 %, sipas censurit të fundit¹³. Pra, kjo e drejtë ligjore iu takon edhe shqiptarëve të atyre pjesëve dhe nga sa kuptohet, e drejta në përdorimin e gjuhës shqipe në Serbi është e ngjashme me atë të gjuhëve të tjera minoritare. Mirë, zbatimi praktik i gjuhës shqipe edhe më tej mbetet i kufizuar, sidomos në edukim, në administratë dhe në media. Nga ana tjetër, gjuhët e minoriteteve me të mëdha dhe që kanë përkrahje më të specializuar (siç është rasti me hungarishtën), zakonisht arrijnë rezultate më të mira.¹⁴

¹²https://rm.coe.int/16806dba31?utm_source=chatgpt.com (EUROPEAN CHARTER FOR REGIONAL OR MINORITY LANGUAGES (APPLICATION OF THE CHARTER IN SERBIA), Strasbourg, 11 June 2013, f.4-5. Qasur së fundmi më 12.12.2025.

¹³COMMON CORE DOCUMENT (Republic of Serbia, Ministarstvo Ljudi i Prava Srbije, COMMON CORE DOCUMENT, May, 2022).

¹⁴ News about the European Charter for Regional or Minority Languages Serbia: improvement in minority languages situation, but more efforts needed to promote their use in education, media, public life, in: https://www.coe.int/en/web/european-charter-regional-or-minority-languages/-/serbia-improvement-in-minority-languages-situation-but-more-efforts-needed-to-promote-their-use-in-education-media-public-life?utm_source=chatgpt.com, qasur së fundmi më 1.12.2025.

Gjuha shqipe si mjet identifikues te shqiptarët në Serbi

Për shqiptarët në Serbi, gjuha shqipe përbën elementin themelor të identitetit të tyre etnik dhe kulturor. Ajo mishëron historinë, kujtesën kolektive dhe vlerat kulturore të komunitetit shqiptar. Në kushte ku identiteti shpesh sfidohet nga politika asimiluese ose nga dominimi i gjuhës shumicë, përdorimi i shqipes merr edhe dimension simbolik e rezistues. Në komunat me shumicë shqiptare si Presheva dhe Bujanoci, shqipja përdoret gjerësisht në familje, në komunikimin e përditshëm dhe në jetën kulturore. Ndërkaq, në Medvegjë, ku shqiptarët janë pakicë e shpërndarë, gjuha shqipe përballet me rrezik më të madh të zbehjes, duke e bërë identitetin gjuhësor më të brishtë. Në këto rrethana, gjuha shndërrohet në një mjet thelbësor për ruajtjen e vetëdijes etnike. Në komunat e Preshevës dhe Bujanocit, arsimit në gjuhën shqipe ka luajtur rol kyç në ruajtjen e identitetit, pavarësisht mungesës periodike të teksteve shkollore dhe aplikimit të standardeve të pa barabarta arsimore¹, kurse në Medvegjë, ku shqiptarët janë në numër më të vogël, proceset e asimilimit gjuhësor janë më të theksuara, çka tregon lidhjen e drejtpërdrejtë ndërmjet përdorimit të gjuhës dhe mbijetesës identitare.

Gjuha shqipe si mjet ndërveprues në mjedise shumëkulturore

Përveç funksionit identifikues, gjuha shqipe te shqiptarët e Luginës luan rol të rëndësishëm edhe në ndërveprimin ndërkulturor, sepse ajo përdoret në komunikimin zyrtar e administrativ lokal, pra, aty ku ka status zyrtar. Po ashtu, si gjuhë me status lokal, shqipja përdoret në arsimin fillor dhe atë të mesëm, në mediat lokale dhe në komunikimin publik dhe krahas serbishtes, ajo përdoret edhe në dokumentet personale si letërnjoftim, pasaportë dhe në dokumentet e tjera të gjendjes civile. Megjithatë, ndërveprimi gjuhësor në komunat e përmendura mbetet i pabarabartë. Në shumë raste, shqiptarët detyrohen ta përdorin gjuhën serbe në komunikim me institucionet shtetërore qendrore, duke e reduktuar shqipen vetëm në mjedise private ose komunitare². Kjo situatë e kufizon funksionin ndërveprues të gjuhës dhe dukshëm e zhvendos atë nga e drejta e përdorimit publik. Së këndejmi, edhe raportet e institucioneve të ndryshme ndërkombëtare theksojnë vazhdimisht hendekun ndërmjet normës ligjore dhe zbatimit praktik të gjuhëve të pakicave kombëtare në Serbi³. Kështu, shqiptarët, atje vazhdojnë të përballen me pengesa strukturore në përdorimin e plotë të gjuhës shqipe në administratë, në drejtësi, në arsimin e lartë dhe në segmente të tjera të jetës shoqërore.

Arsimi dhe institucionet si faktorë kyç

Arsimi në gjuhën shqipe përbën një nga mekanizmat më të rëndësishëm për ruajtjen dhe zhvillimin e identitetit gjuhësor. Shkollat në gjuhën shqipe në Preshevë dhe Bujanoc luajnë rol të dyfishtë: nga njëra anë transmetojnë

dijen dhe kompetencat gjuhësore, nga ana tjetër forcojnë ndjenjën e përkatësisë kulturore. Megjithatë, mungesa e teksteve shkollore adekuate, standardizimi i pjesshëm i terminologjisë dhe kufizimet institucionale ndikojnë negativisht në cilësinë e arsimit në shqip. Këto sfida e bëjnë edhe më të domosdoshëm angazhimin e institucioneve lokale dhe bashkëpunimin ndërkuftar në fushën e arsimit dhe kulturës.

Gjuha ndërmjet ruajtjes dhe integritimit

Rasti i shqiptarëve në Serbi dëshmon se ruajtja e gjuhës amtare nuk është në kundërshtim me integrimin shoqëror. Përkundrazi, njohja dhe përdorimi institucional i shqipes do të kontribuonte në ndërtimin e besimit ndërmjet komuniteteve dhe në forcimin e kohezionit shoqëror.

Gjuha shqipe, si mjet identifikues, garanton vazhdimësinë kulturore; si mjet ndërveprues, ajo krijon hapësira dialogu dhe bashkëjetese. Kufizimi i saj rrezikon jo vetëm identitetin e komunitetit shqiptar, por edhe vetë parimet për një mjedis demokratik e shumëkulturore.

Përfundime

Gjuha shqipe në Serbi përballlet me sfida të shumta, disa nga të cilat janë: presioni i asimilimit, migrimi, përdorimi i kufizuar institucional dhe mungesa e politikave gjuhësore gjithëpërfshirëse. Megjithatë, ekziston edhe potencial i madh për ruajtjen dhe forcimin e saj, përmes promovimit të multikulturalizmit, afirmimit të të drejtave gjuhësore dhe fuqizimit të mediave dhe arsimit në gjuhën amtare.

Për fund, duhet theksuar faktin e pahomueshëm që gjuha shqipe, në kontekstin e shqiptarëve në Serbi, është njëkohësisht mjet identifikues dhe ndërveprues. Ajo shërben si bazë e identitetit kombëtar dhe si instrument komunikimi në mjedise shumëkulturore. Ruajtja dhe zhvillimi i saj nuk janë vetëm çështje kulturore, por edhe çështje të drejtash njerëzore dhe demokracie. Prandaj, mbrojtja e gjuhës shqipe përbën një parakusht thelbësor për integrimin e barabartë dhe dinjitoz të shqiptarëve në shoqërinë shumëkulturore të mjediseve ku ata jetojnë e veprojnë.

Conclusions

The Albanian language in Serbia faces numerous challenges, some of which include assimilation pressure, migration, limited institutional use, and the absence of inclusive language policies. Nevertheless, there is also significant potential for its preservation and strengthening through the promotion of multiculturalism, the affirmation of linguistic rights, and the empowerment of Albanian-language media and education.

Finally, it must be emphasized that the Albanian language, in the context of Albanians in Serbia, is simultaneously an identifying and interactive tool. It serves as the foundation of national identity and as an instrument of

communication in multicultural environments. Its preservation and development are not only cultural matters but also issues of human rights and democracy. Therefore, the protection of the Albanian language constitutes a fundamental precondition for the equal and dignified integration of Albanians into the multicultural societies in which they live and operate

Referencat

Anderson, B. (1991). *Imagined Communities*. London: Verso.

Fishman, J. A. (1991). *Reversing Language Shift*. Clevedon: Multilingual Matters.

Norton, B. (2013). *Identity and language learning: Extending the conversation* (2nd ed.). Bristol: Multilingual Matters.

Taylor, C. (1994). *Multiculturalism and the Politics of Recognition*. Princeton: Princeton University Press.

Council of Europe. *Framework Convention for the Protection of National Minorities*.

Council of Europe. *European Charter for Regional or Minority Languages*.

OSCE. *Minority Rights and Language Use in Southern Serbia*.

Shih raportet vjetore të Këshillit Kombëtar Shqiptar për arsimin në Luginën e Preshevës. Krahaso: OSCE, *Reports on Minority Rights in Southern Serbia*.

Council of Europe, *Advisory Committee on the Framework Convention for the Protection of National Minorities – Serbia Reports*.

https://rm.coe.int/16806dba31?utm_source=chatgpt.com

(EUROPEAN CHARTER FOR REGIONAL OR MINORITY LANGUAGES (APPLICATION OF THE CHARTER IN SERBIA), Strasbourg, 11 June 2013, f.4-5. Qasur së fundmi më 12.12.2025.

https://minlmpdd.gov.rs/wp-content/uploads/2024/07/common-core-document-rs-2022-1.pdf?utm_source=chatgpt.com (Republic of Serbia, Ministarstvo Ljudi i Prava Srbije, COMMON CORE DOCUMENT, May, 2022).

News about the European Charter for Regional or Minority Languages

Serbia: improvement in minority languages situation, but more efforts needed to promote their use in education, media, public life, in: https://www.coe.int/en/web/european-charter-regional-or-minority-languages/-/serbia-improvement-in-minority-languages-situation-but-more-efforts-needed-to-promote-their-use-in-education-media-public-life?utm_source=chatgpt.com, qasur së fundmi më 1.12.2025.

UDC 821.18-1.09
UDC 821.18(091)

Punim studimor

Vebi BEXHETIUniversiteti i Evropës Juglindore – Tetovë
v.bexheti@seeu.edu.mk**ARBËRESHËT NË POEZINË E MARTIN CAMAJT**
*(Me rastin e 100 vjetorit të lindjes së poetit)***THE ARBËRESHË IN THE POETRY OF MARTIN CAMAJ**
(On the occasion of the 100th anniversary of the poet's birth)**1. Hyrje**

Krijimtaria poetike e Martin Camajt që erdhi vonë te lexuesi shqiptar, i takon një shtrirjeje të gjatë kohore. Fati i poetit që herët mbeti pa atdhe, ishte njëherit edhe fati i veprës së tij letrare. Historia e letërsisë shqiptare, atje ku frymonte më lirshëm, me kohë e kishte identifikuar taborin e shkrimtarëve disidentë, por e drejta për të folur realisht për veprat e tyre që mbeten gjatë kohë në ekzil politik, bashkë me krijuesit e vet, u përlij pas viteve të '90-të, kur u hapën dyert e hekurta dhe këto vepra letrare u kthyen aty ku edhe e kishin vendin.

Martin Camaj, ky zë që vinte nga larg, shpeshherë ishte temë diskutimi mes gjeneratash, atyre që e kishin njohur si poet dhe intelektual të madh dhe atyre, të cilëve ky emër u sillej vërdallë si fantazmë. Lidhja e tij me atdheun u shkëput shumë herët, për të vazhduar në atdheun e dytë, Kosovën e robëruar, ku edhe e filloi rrugën krijuese e letrare për t'i dhënë lexuesit shqiptar të kësaj ane veprat e para, dy përmbledhjet poetike: „*Një fyell ndër male*” dhe „*Kanga e vërrinit*”, që për kohën kur u botuan ishin dhurata më e çmueshme sepse e hapën rrugën e poezisë shqipe në Kosovë, të trasuar më parë nga Esad Mekuli.

Rruga jetësore e këtij shtegtari do të jetë e pandarë nga ajo krijuese, që karakterizohet me tri fazat poetike e që në vazhdimësi e ruajtën karakterin autokton të poezisë shqipe, të lidhur aq fuqishëm me truallin që e lindi, me jetën e njeriut shqiptar, me gëzimet dhe me vuajtjet e tij. Kjo poezi në asnjë moment nuk u bë e huaj për shqiptarin, as edhe në fazën e

hermetizmit të saj, siç është bërë traditë të thuhej, ajo i kishte rrënjët në truallin që frymonte shqip dhe vazhdimisht lulëzonte e rritej për t'u ngjitur në majat e artit të madh evropian.

Vargu poetik i Camajt, edhe pse në faza të ndryshme dhe në mjedise me përvojë të gjatë në krijimtarinë letrare, evoluoi vazhdimisht, duke fituar shtresime të reja kuptimore që buronin po nga e njëjta gjuhë me të cilën i kishte shkruar edhe veprat e para, mbeti e pa lëkundur në misionin që kishte dhe njëkohësisht tërheqës edhe për lexuesin e huaj. Për veprën e Camajt kohëve të fundit është shkruar e shkruhet vazhdimisht sepse ajo ka nevojë për mendimin kritik shqiptar që i kishte munguar për vite me radhë.

Edhe ky poet si shumë të tjerë, nuk e la jashtë vargut të tij krijues as pjesën arbëreshe të trungut tonë të përbashkët. Ndoshta qëndrimi i tij në Itali si student në Romë, e më vonë edhe si studiues atje, dhe afëria që pati me këtë pjesë të ndarë në rrethana krejt tjera historike nga ndarjet në hapësirat tjera shqiptare, e lidhi me jetën arbëreshe, me dinjitetin e tyre dhe krenarinë për ruajtjen e gjuhës dhe traditave tjera kombëtare e kulturore. Elementi arbëresh aq i theksuar është i pranishëm në disa poezi të Martin Camajt. Personalitetet si De Rada, apo arbëreshët në përgjithësi, shpeshherë u bënë frymëzim për poezinë e sotme shqipe, ashtu si edhe poezia e arbëreshëve dhe autorët e tyre që merreshin me evokimin e kohërave të lavdisë kombëtare, sidomos të kohës së Motit të Madh, për vetidentifikim kombëtar, ndërsa sot për afrinë e tyre me pjesën e këndeje detit, si çmallje e njëri tjetrit që i takonin një gjuhe e një gjaku.

2. Vështrim kritik mbi poezitë kushtuar arbëreshëve

Poezitë kushtuar jetës arbëreshe, sipas përmbledhjeve të botuara poetike, i takojnë fazës së dytë të krijimtarisë, kohës kur në këtë poezi vërejmë një kombinim të poetikës realiste me atë hermetike moderniste. (Ymer Çiraku 2003: 37). Kësaj faze i takon edhe përmbledhja „*Njeriu me vete dhe me tjerët*”, në kuadër të së cilës përfshihen edhe poezitë: “*Veshja arbëreshe*” dhe “*Pranvera në katundin arbëresh*”. Përmes kuptimit të thellë të fjalës dhe formës, tanimë të përsosur, që bashkë me mesazhin që nuk zbulohet lehtë dhe me metaforat shumëdimensionale që reflektojnë disa shtresime kuptimore, poeti e ndërtoi këtë poezi, që nga të tjerat e kësaj faze dallojnë për nga tema që e trajtojnë, por jo edhe nga thellësia e mendimit poetik dhe gjuha që e përdor, kjo gjuhë e vetëmjaftueshme dhe e zonja për të krijuar edhe poezi të përmasës evropiane. Studiuesi Matteo Mandala konstaton se gjuha poetike e Camajt është njëkohësisht mjet dhe objekt i aktivitetit të tij të përditshëm, që do të thotë se ai brenda gjuhës së zakonshme e zbulon atë që kësaj poezie i jep domethënie të thellë kuptimore.

Poezia “*Veshja arbëreshe*”, jorastësisht e mban këtë titull. Si element identifikimi kombëtar, përveç gjuhës dhe vlerave tjera si pjesë e trashëgimisë kulturore, veshja arbëreshe, e veçmas ajo e grave që mbeti ashtu e gjallë edhe sot e që në vete bartë pjesë të historisë arbëreshe dhe identifikuese për poetin, si duket është e rrezikuar dhe e ka të vështirë t'u

përballojë ndikimeve të globalizmit të kohës, që në masë të madhe e rrezikon etnokulturën e popujve më të vegjël. Kjo vjershë përbëhet nga katër strofa dhe asnjëra nga ato nuk ka numër të njëjtë vargjesh. Në strofën e parë që është ndërtuar me gjuhën e lirikës moderne, por jo edhe aq të errët si gjuha poetike e fazës së tretë, ku lirika e poetit flet shpesh për ngjarjen, shkaku por që për kohën e të cilave nuk thuhet asgjë (L. Topçiu 2000: f. 79).

Poeti duke i njohur këto vlera të mëdha dhe me karakter etnografik, siç është veshja tradicionale, me kohë kishte konstatuar, se kjo veshje që ruhet nëpër arka e që ishte bërë dikur nga vektaret duarholla, është gjysmë e vdekur. Dasma e dikurshme arbëreshe kishte kuptim vetëm me këto veshje, konstaton poeti, sepse vetëm atëherë kjo veshje do e kishte vlerën e mirëfilltë. Zemra e nuses së dikurshme tanimë ngrihet në pikturë, petku i saj qëndron ashtu i grisur nga një derëzi, natën e karnavalit. Shpresa se kjo vlerë materiale, që bashkë me ato shpirtërore, siç janë edhe këngët arbëreshe, do mbijetojnë, është gjithmonë e gjallë.

Stërmbesa që erdhi nga larg i veshi teshat e gjyshes për ta luajtur vallen te sheshi, tregon karakterin solemn në raste të rralla sepse, shprehet poeti: *N'ora dhetë veshja arbreshe / u zhgreh e ra para kambëve më të bukura / se t'gjyshes nuse pikturë / e kthye ndër arka keza e coha palë-palë linja erëmirë / e ngime me gji ma vashë.*

Përmes këtyre vargjeve të strofës së fundit të poezisë, poeti edhe njëherë shpreh me keqardhje fillimin e fundit të kësaj tradite që e mbajtën gjallë shpirtin arbëresh. Ashtu si zakonisht, te Camaj, fjala poetike e gdhendur aq mjeshtërisht, edhe në këtë poezi sa vjen e lexuesit i dhuron shpërthime të reja lirike. **Keza**, një lloj lidhëse që mbulon pjesën e pasme të flokut të nuseve arbëreshe, **Coha**, fustani karakteristik që përdoret në një shtrirje të madhe ndër arbëreshët e Kalabrisë dhe **Linja**, lloj këmishe e bërë nga liri, janë pjesë të veshjes së grave arbëreshe, që për fat të keq duhet të kthehen sërish në arkat e vjetra e ashtu të rrinë të burgosura, duke pritur ndonjë moment të ri ceremonie.

Fjalët që e ndërtojnë këtë varg na vijnë me fuqi magjike dhe ashtu lehtas depërtojnë në qenësinë e mesazhit thelbësor të poetit dhe në dëshirën e tij, që arbëreshët, ashtu siç i mbijetuan shekujt, të vazhdojnë rezistencën për t'i mundur edhe kërcënimet e kohës më të re. Poezia mbaron me dy vargjet më të fuqishme që kulmojnë efekte lirike duke prekur edhe çështje emocionale erotike, që në këtë rast s'kanë të bëjnë me pjesën historike dhe mbijetesën e arbëreshëve. Pjesa më intime e veshjes, **Linja (këmisha)**, në këtë rast sikur i largohet karakterit etnografik të saj, duke anuar kah një vlerë tjetër, nga ajo me ngjyrimet erotike, sepse është më e ngjeshur me trupin e vajzës se sa pjesët tjera që u përmendën. Kjo linjë erëmirë, e ngirë me gjinj të vashës, siç shprehet poeti, gjithsesi e urren më tepër arkën, ku bashkë me **Kezën e Cohën** do të rrinë të paluara kushedi sa kohë.

Edhe poezia "*Pranvera në katundin arbëresh*" është përfshirë në përmbledhjen **Njeriu me vete e me tjerë**. Meqë ky vëllim përfshin poezi nga cikle të ndryshme vargjesh të pabotuara, radhitja sipas kohës e përmbajtjes që e pamundur, thotë autori, me rastin e botimit (M. Camaj 2000: 33). Kjo

poezi tristrofëshe na del jo e harmonizuar në vargje e rrokje. Në katundin arbëresh, sipas këtyre vargjeve poetike, edhe pranvera nuk vjen ashtu e zakonshme, edhe pse vargu i parë i poezisë fillon me fjalën lule. Këto lule nuk u ngjajnë atyre të Naimit, të *“Bagëti e Bujqësisë”*, ku secila e ka aromën e vetë, ngjyrën e vet dhe emrin e vet. Lulja e pranverës arbëreshe, rrënjët i ka lëshuar plasave të gurëve, të shkëmbit, prandaj edhe formën nuk e ka të zakonshme. Këto lule kurm këputuna me qafë sa peni, simbolizojnë jetën e vështirë arbëreshe të katundeve që u vendosën maje shkëmbi.

Edhe në vargjet e kësaj poezie, mënyra e të shprehurit poetik përbëhet nga larmia e trajtave gjuhësore dhe tingullore. Poeti është i vetëdijshëm se pa to vargu nuk do të kumbojë bukur e mesazhi do jetë i cunguar. Nëse në poezinë, *“Veshja arbreshe”*, Martin Camaj është i brengosur për zbehjen që çon kah humbja e vlerave materiale, këtu siç duket, ai vuan bashkë me to, për jetën e vështirë të këtyre banorëve, në vendet ku edhe pranvera është e shëmtuar, e gratë e lodhura as që e zënë në gojë atë. Lulet e asaj pranvere, ashtu të njoma, sa kanë çelur, bëhen viktimë e barishteve të prillit të tërbuar. Kjo atmosferë përvëluese edhe në kohën më të bukur të vitit e mundon poetin, e detyron që të ikë ashtu i mllefosur, pa e shijuar këtë stinë të natyrës së kësaj pjese të universit shqiptar: *Më kaluan ditët si n’andërr/ me sy ndër lulet e hershme si humshin / mbi në barishtet e muejit prill të tërbuem.* Largimin e tij nga ky vend, që me vështirësi i kishte ushqyer rrënjët e shkultura nga atdheu i të parëve, dhe ashtu i vrarë shpirtërisht, poeti e përshkruan në strofën dyvargëshe të fundit: *U zgjova te dita e kthimit me një varg/ fjalësh pa kuptim në dorë.*

Temën për jetën arbëreshe autori e trajtoi edhe në disa poezi të përmbledhjes **“Lirika mes dy moteve”**, të botuara më 1967. Në këtë përmbledhje sipas autorit, janë përfshirë disa poezi shumë më të hershme. Poezitë kushtuar jetës së arbëreshëve dhe fatit të tyre, gjithsesi janë krijime të periudhës pas shkuarjes së Camajt në Itali. Në poezinë: *“Trashëgimi”*, autori me një gjuhë të gdhendur poetike dhe me plot figura që janë karakteristika e stilit të tij, vazhdon ta përshkruajë jetën në katundin arbëresh, që ashtu i vetmuar është i ngulitur maje kodrës dhe sikur vëzhgon horizontin e largët. Përmes katundit, me emrin e të cilit edhe fillon strofa e parë, dheut që vëren me syrin e plakës qindvjeçare, që është vargu i parë i strofës së dytë, dhe dimrit me therën e murrizit, sikur shkrihen në tërë strofën e fundit katërvargëshe që tingëllon kështu: *fjalët e gjuhës seme nji / udhtimë e gjatë, e gjatë në kohë, / nji ushtimë e gjatë, e gjatë ndër veshë.* Sipas mesazhit poetik, gjuha e arbëreshëve do të flitet e dëgjohet edhe në të ardhmen, do mbijetojë edhe më tej, sepse u ruajt me sakrificë të mëdha.

Metafora e tri fjollave të leshit të deles, që u shkulën nga ferrat e murrizit të një dimri që krahasohen me tri fjalët, që la teza arbëreshe, më duket më e qëlluara e tërë kësaj poezie. Këto kombinime poetike të shprehjeve figurative siç janë; dimri, murrizi, dhe delja, që la tri fjolla leshi duke kaluar në ngushticën me ferrat e gjembat, që në këtë rast poeti i vë në shërbim të një krahasimi që vështirë mund ta hasësh diku tjetër në poezinë shqipe, dëshmojnë aftësinë krijuese të Camajt për ta gjetur fjalën me fuqinë e saj

magjepsë dhe me shumëkuptimësinë që përmban në thellësinë e vet e që në mënyrë të mrekullueshme ta përcjellë mesazhin te lexuesi. Tri fjalët e plakës qindvjeçare arbëreshe, që ishte nisur në rrugë pa kthim, ku do të pushonte në kodrinë nën qiparisa, që i la trashëgim ishin: gjuha, udhëtimi dhe ushtrimi e saj, të ngjashme me tri fjollat e leshit të mbetura në ferrat e murrizit: *Dimën. Në ferrën e murrizit / la delja tri fjolla leshi. / Tri fjalë më la tezja arbreshe / te dheu i eshtnave tanë.*

Në poezinë “*Valle arbëreshe*”, Camaj po me të njëjtën fuqi shprehëse, pa u larguar nga gjuha e figurave dhe metaforave poetike, ashtu si te veshja e tyre që e analizuar, i këndon vajzës arbëreshe kur ajo vallëzon. Edhe në këto vargje na paraqitet figura stilistike e krahasimit me delen. Ashtu si në shumë poezi të fazës së mëvonshme krijuese, kur fjala poetike ndërton një model të ri në rrafshin emocional e kuptimor, edhe në poezitë me temat që po i trajtojmë, nuk mungojnë prirjet moderne, që bashkë me ato tradicionale te lexuesi rrezatojnë emocione të fuqishme. Edhe në këtë poezi nuk mungon ligjërimi metaforik e simbolik. Në strofën e parë, lexuesi pa ndonjë vështirësi e sheh krahasimin mes deles e valltares arbëreshe, elegancën dhe nazet e saj që ashtu lehtas e lëmojnë tokën para se ta prekin, si delja që para se ta këput me dhëmb barin, e ngrohë me frymë: *Edhe kënga e vashës / mandej i lëshon ritmin.*

Me lirizëm të hollë dhe ndjeshmëri poetike, Camaj edhe në poezinë “*Kur piquen maranxhat*”, temën për atdheun e lashtë dhe buzëdetin jonian, që arbëreshen e vogël e bëjnë kureshtarë për të ditur diç më shumë, e përpunon përmes toneve emocionale, si frymëzime poetike subjektive. Edhe në këtë poezi fuqia e lirikës së vargut sa vjen e shtohet. Ashtu si zakonisht, Camaj edhe këtë poezi e ndërton mbi bazën e dashurisë e këtë dashuri ai e sjell përmes plakës qindvjeçare dhe fjalëve të gjuhës arbëreshe, si udhëtim i gjatë në kohë, te kjo poezi, mesazhi na vjen përmes çupës së vogël arbëreshe që s’e “pau kurrë vendin e të parëve”. Pyetja e arbëreshes se kur piquen maranxhat në vendin e të parëve të saj “buzë detit tonë?”, që vjen ashtu spontane dhe e sinqertë, siç është realisht një fëmijë, paraqet pikën kulminante të tërë poezisë.

Plaka qindvjeçare arbëreshe dhe kjo vajzë e re, në poezinë e Camajt janë përfaqësuese të dy gjeneratave, që dashurinë për vendin e të parëve e shprehin, po me të njëjtën fuqi emocionale, edhe pse siç dihet mirëfilli, nga një gjeneratë në tjetrën dashuria ngel po aq e fuqishme, por gjuha dobësohet vazhdimisht: *Flet fjalë të harrueme shqipe e pyet:/ Kur piquen maranxhat buzë detit tonë?* Toponimin e „Detit Jon”, për efekte më të fuqishme poetike dhe përcaktimin se bëhet fjalë për detin tonë, që lag brigjet e tokës amë, autori e paraqet si përemër pronor: „Buzë Detit tonë”. Përmes pyetjes: *Kur piquen saranxhat?*, që është edhe titulli i poezisë, Martin Camaj, vetëm sa e freskon vargun poetik, që hap kuptimin në drejtim të një vendi më të largët, që në këtë rast është atdheu, për të kuptuar se a është e njëjta stinë edhe atje. Kjo vajzë e vogël me fundin e syve të zezë si flatra zogjsh mërgimtarë, që edhe ëndrrat i kanë me ngjyrën e maranxhave, simbolizon kohën më të re me ëndrrat e vjetra, që e kishte trashëgim nga të parët. Përmes këtyre frutave

dhe ëndrrës me ngjyrë si ato, poeti në këtë poezi mëton ta rifreskojë kujtesën për ngjarjet historike që një pjesë të kombit e larguan nga atdheu i të parëve.

Me këtë ndjenjë të fuqishme për pjesën arbëreshe të kombit, Camaj e krijoi edhe poezinë *“Tregimi i Arbnit”*. Po me atë lirizëm që shpërthente nga fuqia brendshme shpirtërore, poeti në këtë poezi, edhe njëherë i kthehet peshës së mallit të individit pa atdhe, ashtu siç ishte edhe ai vet. Takimi i rastësishëm me një arbëresh që ai e quan “arbën”, dhe rrëfimi i tij se çdo gjë larg vatrës së të parëve është e ftohtë si „*Prekja e gjarprit kulaç në vapë*”, është motoja e poezisë. Në tokën e re, ku prej kohësh jetonte vëllai i tij për nga gjaku e gjuha, çdo gjë ishte e ftohtë. Edhe gurët, edhe eshtrat e dheut, për këtë njeri pa atdhe mbetën gjithmonë të huaj e të ftohtë. Vetëm vatra prej nga u shpërndanë këta njerëz, ashtu si zogjtë e qyqes, e kanë nxehtësinë e vet. Përmes metaforës së gurit të caranit nënkuptojmë shtëpinë, me zjarrin në vatrë, ngrohtësinë e saj, jo vetëm se ndizej ai në mes të vatrës, po pse e tërë kjo shtëpi ishte drita e zjarrit vet, ngrohtësia që jepte jetë e gjallëri. Zjarri si simbol dhe caranët në dy anët e tij që e kufizonin shtratin e zjarrit dhe mbanin saçin e çerepin, në këtë rast paraqesin ngrohtësinë shpirtërore dhe lidhjen e individit e familjes me vatrën që jep jetë, mirëqenie e lumturi. Autori i këtyre vargjeve, përveç lidhjes shpirtërore me këtë vatrë dhe asaj poetike që tingëllon aq bukur, e ndjente edhe mungesën e ngrohtësisë së atdheut: ... *Si prekja e gjarprit kulaç në vapë, / Por guri i Caranit n’vatër tim et / Qe prore i nxehtë*. Përmes krahasimit të rrasave të ftohta me trajtat e kalit të egër që shkarravit truallin, poeti e arrin kulmin artistik të poezisë dhe porosisë që përmban ajo. Në këtë rast kali si figurë poetike nuk na vjen me domethënie krenarie, mençurie e elegance, por si diçka që në vete ka ftohtësinë dhe egërsinë, ashtu i ngjashëm me atë rrasën e ftohtë të gurit.

Ashtu, si në shumë poezi tjera, ku në qendër të frymëzimit poetik të Camajt është figura e femrës arbëreshe, edhe te poezia *“Në thatësinë e jugut”*, poeti vazhdon ta portretizojë këtë personazh, që si duket, për poetin reflekton më tepër, sepse ajo është e lidhur më shumë me pragun e derës dhe shtëpinë. Në këtë poezi, ajo vjen me tërë tiparet e një arbëresheje: „*është shtathedhun, parzëmmjaltë, është diamant i pjekun, që në prakun e derës mban vravashkën e blerimit*”. Edhe në vargjet e kësaj poezie, ashtu si zakonisht, nuk mungon fuqia e frymëzimit lirik, që poetin, e çon në thellësinë historike, atje te rrënjët e qenies së tij: *Në duart e saja të holla / shoh rrajët e mija që shtrihen larg, / larg në kohë*.

Në poezitë e kësaj përmbledhjeje, gjithsesi nuk u harrua edhe figura e poetit të madh, simbolit të kulturës, gjuhës, letërsisë arbëreshe e shqiptare në përgjithësi, Jeronim de Rada. Është i madh numri i poetëve që i kushtuan poezi romantikut tonë të parë. Ky personalitet i përmasës kaq dimensionale që zuri vend në vargjet e shumë poetëve, edhe në poezinë me titullin simbolik *“Dimni i Jeronim de Radës”*, Martin Camaj përpiqet, që këtë personazh ta paraqet me tërë tiparet e njeriut të përvuajtur mes territ e dritës, shpresës e ëndrrës. Portreti i tij në këtë poezi nuk do dukej i plotë pa përshkrimin e mjedisit të natyrës së bukur të katundit ku lindi. Me vargun: „*Ra bora ndë dejtit*”, të nxjerrë nga Kënga VI e Milosaut, të vënë në krye të

kësaj poezie, poeti me gjuhën e simbolit paralajmëron dimrin e De Radës, vuajtjen dhe vetminë e tij, që ngjasonte me „lodhjen e verës e të vjeshtës së këputun”. Poetin ëndërrimtar me shpirtin që endet ullishtave, autori nuk don ta paraqesë vetëm me vuajtjen, të mbyllur në dhomën e tij, i vetëdijshëm për misionin që ka poeti dhe për lirinë që vazhdimisht e synon. Tanimë bora e De Radës me të cilën fillon poezia, shndërrohet në dritë e diell, ndërsa dhoma me dritaren kah deti, aroma e mollës dhe e verës së vjetër i sjellin frymëzim të ri: *Shpirti yt endet ullishtave / ndër kodrat e qeta e të bardha / plot dritë e plot diell*. Kjo qasje tjetërfare e Camajt, nga shumë poetë tjerë, për portretizimin e kësaj figure, e dëshmon identitetin e tij poetik, që karakterizohet me gërshetim kompleks që nuk dallohet për mesazhe të drejtpërdrejta, por të nënkuptuara, parabolike që arrihen përmes asociacioneve të njëpas-njëshme (Ymer Çiraku 2003: 116)

Figura e De Radës është e pranishme edhe në një poezi të veprës „Nema” të Camajt. Ashtu si zakonisht, edhe në vargjet e poezisë me titull “*Rapsodi në letër*”, poeti i Maqit, portretizohet përmes simbolikës së thellë e domethënëse të Martin Camajt, që shumë lehtë depërton në identifikimin e unit poetik të De Radës dhe lirikës së tij aq të fuqishme, përmes së cilës ai shpreh dashurinë për kombin dhe “gjakun e shprishur” në kohë e hapësirë, dhe brengën nëse do e ruajë blerimin e degës së ndarë nga trungu, simbolikë kjo e luftës për mbijetesën arbëreshe.

3. Përfundim

Nga i tërë opusi letrar poetik i Martin Camajt, poezitë e frymëzuara nga jeta dhe historia e arbëreshëve dallohen për nga motivi i fuqishëm lirik, që buron vetvetiu nga ndjenja vëllazërore kundrejt bashkëkombasve të ndarë të kësaj pjese të trungut të përbashkët. Ky poet, që herët mbeti pa atdhe për shkaqe politike, një pjesë të jetës e kaloi në mesin e arbëreshëve, fillimisht si student e më vonë edhe si studiues. Poezitë e analizuara erdhën edhe si rezultat i njohjes me jetën e arbëreshëve, dashurinë e tyre për vatrën e të parëve, mallin për atdheun e lashtë dhe fanatizmin për ruajtjen e gjuhës, veshjes kombëtare dhe traditave tjera, që e ruajtën aq shekuj identitetin e tyre. Këto poezi i takojnë fazës së dytë të krijimtarisë poetike të Marin Camajt, në vargjet e të cilit vërehet kombinimi i poetikës realiste me atë moderniste. Disa nga këto poezi i takojnë përmbledhjes “**Njeriu me vete dhe me tjerët**”, një pjesë e tyre në përmbledhjen “**Lirika mes dy moteve**”, ndërsa një poezi kushtuar De Radës është brenda përmbledhjes poetike “**Nema**”.

Literatura:

- Ymer Çiraku, Martin Camaj, krijues i një tradite (në Gjurmime në letërsinë shqiptare, Tiranë 2003).
- Ymer Çiraku, Bota poetike e Martin Camajt, Tetovë 2003.
- Luan Topçiu, te libri: Bota poetike e Martin Camajt, Tetovë 2000
- Martin Camaj, Lirika, Pejë 2000.
- Rexhep Ismaili, Në vend të parathënies (Parathënia e librit “Lirika”, Pejë 2000.

UDC 316.723(497)

UDC 316.647.8:323.1(497)

Punim studimor

Rubin ZEMON

Qendra per Hulumtime te Avansuara, Shkup
Instituti per Studimet e Avanasuara, Koszeg, Hunagri

**MENAXHIMI I DIVERSITETIT, STEREOTIPET KOLEKTIVE DHE
POLITIKAT E KUJTESËS NË BALLKANIN PERËNDIMOR: IMPLIKIMET
PËR ZGJERIMIN E BE-SË DHE KONSOLIDIMIN DEMOKRATIK**

**DIVERSITY MANAGEMENT, COLLECTIVE STEREOTYPES, AND MEMORY
POLITICS IN THE WESTERN BALKANS: IMPLICATIONS FOR EU
ENLARGEMENT AND DEMOCRATIC CONSOLIDATION**

Përmbledhje

Ky artikull shqyrton ndërlidhjen ndërmjet menaxhimit të diversitetit, stereotipeve kolektive dhe politikave të kujtesës në Ballkanin Perëndimor, duke analizuar implikimet e tyre për pajtimin pas konfliktit, konsolidimin demokratik dhe zgjerimin e Bashkimit Evropian (BE). Duke u mbështetur në teoritë e nacionalizmit, multikulturalizmit dhe kujtesës kulturore, studimi argumenton se regjimet përjashtuese të kujtesës dhe narrativat etnonacionaliste vazhdojnë të minojnë përfshirjen e pakicave dhe kohezionin shoqëror në të gjithë rajonin. Përmes një analize krahasuese të Bosnjë dhe Hercegovinës, Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë, artikulli tregon se si kultura të fragmentuara të kujtesës riprodhojnë përjashtimin simbolik, viktimizimin konkurrues dhe stagnimin institucional. Ndërsa politika e zgjerimit të BE-së—veçanërisht në kuadër të DG NEAR—ka nxitur reforma ligjore dhe institucionale në fushën e të drejtave të pakicave dhe sundimit të ligjit, ajo vetëm në mënyrë marginale ka trajtuar politikën e kujtesës si një dimension strukturor të qeverisjes. Artikulli përfundon se integrimi i qëndrueshëm në BE kërkon një zhvendosje nga përputhshmëria formale drejt kulturave gjithëpërfshirëse dhe shumëperspektivëshe të kujtesës, të afta për të mbështetur qëndrueshmërinë demokratike dhe pajtimin afatgjatë.

Fjalë kyçe: *Menaxhimi i diversitetit, kultura e kujtesës, Ballkani Perëndimor, zgjerimi i BE-së, nacionalizmi, pakicat*

Hyrje

Ballkani Perëndimor mbetet një nga rajonet më të larmishme nga pikëpamja kulturore, etnike dhe fetare në Evropë. Megjithatë, kjo larmi shpesh është konceptuar si burim paqëndrueshmërie, më shumë sesa si një burim shoqëror. Shpërbërja e dhunshme e Jugosllavisë, trashëgimitë e pazgjidhura të autoritarizmit dhe interpretimet konkurruese të së kaluarës kanë prodhuar komunitete politike të fragmentuara, të karakterizuara nga mosbesimi i ndërsjellë dhe përjashtimi simbolik. Në këtë kontekst, menaxhimi i diversitetit dhe kultura e kujtesës nuk janë fusha periferike të politikave publike, por elemente qendrore të qeverisjes demokratike.

Ky artikull argumenton se politikat e kujtesës përbëjnë një sfidë strukturore për integrimin evropian të Ballkanit Perëndimor. Ndërsa politika e zgjerimit ka prioritetizuar reformat institucionale, sundimin e ligjit dhe mbrojtjen e pakicave, ajo ka adresuar në mënyrë të pamjaftueshme dimensionet simbolike dhe kulturore përmes të cilave riprodhohen narrativat përjashtuese. Stereotipet kolektive, kujtesa selektive dhe mohimi i përgjegjësisë vazhdojnë të formësojnë identitetet politike dhe marrëdhëniet ndërmjet grupeve, duke kufizuar potencialin transformues të kushtëzimit të BE-së.

Duke u mbështetur në kërkime të mëparshme mbi menaxhimin e diversitetit dhe kulturën e kujtesës në rajon, ky artikull shtron tre pyetje të ndërlydhura: Si i formësojnë stereotipet kolektive dhe narrativat kombëtare të kujtesës politikat e menaxhimit të diversitetit në Ballkanin Perëndimor? Në çfarë mënyrash kulturat e fragmentuara të kujtesës minojnë përfshirjen e pakicave dhe konsolidimin demokratik? Si mund ta adresojë më efektivisht politika e zgjerimit të BE-së çështjen e politikave të kujtesës brenda kuadrit të DG NEAR?

Korniza Teorike

Menaxhimi i diversitetit i referohet mekanizmave institucionalë dhe shoqërorë të dizajnuar për të rregulluar pluralitetin kulturor, etnik, fetar dhe gjuhësor në mënyra që sigurojnë barazi, pjesëmarrje dhe kohezion shoqëror. Në kontekste pas konflikti, menaxhimi i diversitetit është i pandashëm nga ndërtimi i paqes dhe rindërtimi demokratik. Ai përfshin mbrojtjen ligjore të pakicave, politikat kundër diskriminimit, arsimin gjithëpërfshirës dhe njohjen simbolike.

Në Ballkanin Perëndimor, menaxhimi i diversitetit shpesh reduktohet në inxhinieri kushtetuese dhe legjislacion për të drejtat e pakicave. Ndërsa këto korniza janë të domosdoshme, ato mbeten të pamjaftueshme kur shkëputen nga narrativat më të gjera shoqërore. Aty ku regjimet dominuese të kujtesës i paraqesin pakicat si të huaja historikisht ose si kërcënim, barazia formale minohet nga përjashtimi simbolik.

Nacionalizmi mbetet korniza ideologjike dominuese që formëson identitetet politike në Ballkanin Perëndimor. Duke ndjekur konceptin e Anderson-it për kombet si “komunitete të imagjinuara” (Anderson, 1983), identitetet kombëtare ndërtohen përmes historive selektive, miteve të

originës dhe narrativave të vuajtjes kolektive. Këto narrativa shpesh përforcohen nga stereotipe kolektive që i paraqesin grupet fqinje si të dhunshme, të pabesë ose kulturalisht inferiore.

Këto stereotipe nuk janë thjesht artefakte kulturore; ato funksionojnë si mjete politike që legjitimojnë përjashtimin, justifikojnë politika diskriminuese dhe e zhvendosin përgjegjësinë për konfliktin. Në Ballkan, nacionalizmi historikisht ka privilegjuar homogjenitetin etnik mbi përfshirjen qytetare, duke prodhuar tensione të qëndrueshme ndërmjet normave demokratike dhe pretendimeve etnonacionaliste.

Kultura e kujtesës i referohet praktikave shoqërore, institucioneve dhe narrativave përmes të cilave shoqëritë interpretojnë dhe institucionalizojnë të kaluarën. Kujtesa nuk është një pasqyrim pasiv i historisë, por një proces aktiv i formësuar nga marrëdhëniet e pushtetit (Halbwachs, 1992; Nora, 1989). Në shoqëritë pas konflikti, politikat e kujtesës shpesh kristalizohen rreth viktimizimit, heroizmit dhe mohimit.

Teoria e traumës kulturore thekson se vuajtjet kolektive të pazgjidhura mund të nguliten në identitetin e grupit, duke formësuar sjelljen politike ndër breza (Eyerman, 2002). Kur traumat konkurruese mbeten të panjohura, kujtesa shndërrohet në një arenë me shumën zero, që përforcon ndarjen në vend të pajtimit.

Ballkani ndërmjet Orientalizmit dhe Vetë-Stigmatizimit

Përfaqësimet e jashtme të Ballkanit janë formësuar prej kohësh nga diskurset orientaliste dhe balkaniste. Këto narrativa e ndërtojnë rajonin si “Tjetrin” e brendshëm të Evropës, të karakterizuar nga nacionalizëm irracional, dhunë endemike dhe prapambetje historike (Todorova, 1997). Stereotipe të tilla errësojnë rolin e politikave të fuqive evropiane në formësimin e paqëndrueshmërisë rajonale dhe kontribuojnë në perceptimin e Ballkanit si përherë “ende jo evropian”.

Këto diskurse të jashtme janë internalizuar brenda vetë rajonit. Elitat politike shpesh mobilizojnë retorikën e evropianizimit si një shkëputje civilizuese nga e kaluara, më shumë sesa si një transformim demokratik. Kjo përforcon kuptime hierarkike të identitetit dhe legjitimon marginalizimin e grupeve të lidhura me trashëgimi “jo-evropiane”, veçanërisht komuniteteve myslimane dhe rome.

Politikat e Kujtesës dhe Menaxhimi i Diversitetit: Rastet Shtetërore

Bosnja dhe Hercegovina

Bosnja dhe Hercegovina përfaqëson institucionalizimin e diversitetit pa një kujtesë të përbashkët. Marrëveshja e Paqes e Dejtonit vendosi një sistem kompleks konsociacional për të parandaluar rifillimin e dhunës, por njëkohësisht kushtetëzoi ndarjet etnike. Narrativat konkurruese boshnjake, serbe dhe kroate mbi luftën e viteve 1992–1995 riprodhohen përmes sistemeve të ndara arsimore, përkujtimeve dhe diskursit mediatik.

Pakicat jashtë tre popujve përbërës—veçanërisht romët dhe hebrenjtë—mbeten kryesisht të padukshme në kujtesën publike. Përrjashtimi i tyre minon si barazinë demokratike, ashtu edhe besueshmërinë e kornizave të menaxhimit të diversitetit. Pavarësisht angazhimit të BE-së, politikat e kujtesës mbeten të dominuara nga elitat etnonacionaliste, duke kufizuar pajtimin.

Shqipëria

Kultura e kujtesës në Shqipëri formësohet nga trashëgimia e pazgjidhur e autoritarizmit komunist. Ndërsa shteti njeh formalisht disa pakica kombëtare, kujtesa publike mbetet homogjenizuese dhe selektive. Drejtësia tranzicionale ka qenë e pjesshme, duke u mundësuar aktorëve politikë instrumentalizimin të së kaluarës.

Komunitetet rome dhe egjiptiane janë pothuajse plotësisht të munguar nga narrativat zyrtare, duke përforcuar marginalizimin e tyre socio-ekonomik. Dështimi për të integruar përvojat e pakicave në kujtesën kombëtare minon angazhimet e Shqipërisë në kuadër të kritereve të zgjerimit të BE-së për të drejtat themelore dhe përfshirjen sociale.

Kosova

Regjimi i kujtesës pas pavarësisë në Kosovë përqendrohet te viktimizimi dhe çlirimi shqiptar. Ndërsa kjo narrativë pasqyron vuajtje reale historike, ajo marginalizon përvojat e komuniteteve serbe, rome, ashkali dhe egjiptiane. Praktikrat e memorializimit rrallëherë njohin viktimat e pakicave, duke përforcuar hierarkitë etnike të vuajtjes.

Pavarësisht legjisllacionit të avancuar për të drejtat e pakicave, të harmonizuar me standardet e BE-së, përrjashtimi simbolik vazhdon. Ky shkëputje ilustron kufijtë e përputhshmërisë ligjore kur politikat e kujtesës mbeten të paadresuara.

Maqedonia e Veriut

Maqedonia e Veriut përfaqëson një rast të akomodimit institucional pa përrfshirje simbolike. Pas konfliktit të vitit 2001 dhe Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, shteti miratoi mekanizma të gjerë të ndarjes së pushtetit. Megjithatë, kujtesa publike mbetet e segmentuar etnikisht.

Projekte simbolike si arkitektura monumentale dhe antikizimi kanë përforcuar narrativa identitare përrjashtuese, ndërsa kujtesat e pakicave—veçanërisht të romëve dhe komuniteteve më të vogla—mbeten margjinale. Kushtëzimi i BE-së është përqendruar në qeverisje dhe sundimin e ligjit, ndërsa kujtesa kulturore ka mbetur kryesisht jashtë fushës së reformës.

Serbia

Politikat e kujtesës në Serbi karakterizohen nga viktimizimi selektiv dhe ambivalenca ndaj përrgjegjësisë. Ndërsa ka pasur bashkëpunim formal me mekanizmat ndërkombëtarë të drejtësisë, diskursi publik shpesh relativizon ose mohon përrgjegjësinë për krimet e luftës.

Komunitetet pakicë—përfshirë boshnjakët, shqiptarët, hungarezët dhe romët—marrin njohje të kufizuar simbolike. Rehabilitimi i figurave historike kontroverse sinjalizon një tërheqje nga angazhimi kritik me të kaluarën. Presioni i zgjerimit të BE-së ka gjeneruar transformim të kufizuar në kulturën e kujtesës, duke zbuluar kufizimet e kushtëzimit pa konsensus të brendshëm.

Zgjerimi i BE-së dhe DG NEAR: Kujtesa si Çështje Qeverisjeje

Politika e zgjerimit të BE-së, e administruar kryesisht përmes DG NEAR, i jep përparësi sundimit të ligjit, institucioneve demokratike dhe të drejtave themelore. Mbrojtja e pakicave dhe pajtimi janë të përfshira formalisht në Kapitujt 23 dhe 24, por politikat e kujtesës trajtohen vetëm në mënyrë të tërthortë.

Ky boshllëk institucional pasqyron një prirje më të gjerë teknokratike në politikën e zgjerimit, e cila thekson harmonizimin ligjor mbi transformimin kulturor. Ndërsa kornizat ligjore për mbrojtjen e pakicave ekzistojnë në të gjithë Ballkanin Perëndimor, narrativat përjashtuese vazhdojnë në nivel shoqëror.

Raportet e progresit të BE-së i referohen gjithnjë e më shpesh pajtimit, bashkëpunimit rajonal dhe arsimit gjithëpërfshirës. Megjithatë, pa kriteret e qarta që adresojnë pluralizmin e kujtesës, reformat rrezikojnë të mbeten sipërfaqësore. Politikat e kujtesës duhet të njihen si një çështje qeverisjeje e lidhur drejtpërdrejt me qëndrueshmërinë demokratike, kohezionin shoqëror dhe besueshmërinë e kushtëzimit të BE-së.

Analizë Krahasuese

Në të gjithë Ballkanin Perëndimor shfaqet një model i përbashkët: diversiteti menaxhohet institucionalisht, por kontestohet simbolikisht. Narrativat kombëtare privilegjojnë grupet dominuese, duke marginalizuar pakicat dhe duke përforcuar viktimizimin konkurrues. Integrimi në BE ka lehtësuar reformat ligjore, por nuk ka transformuar në mënyrë thelbësore kulturat e kujtesës.

Aty ku kujtesa mbetet përjashtuese, konsolidimi demokratik është i brishtë. Në të kundërt, kujtesa gjithëpërfshirëse ofron potencial për ndërtimin e besimit dhe kohezionit shoqëror. Analiza krahasuese konfirmon se politikat e kujtesës përbëjnë një dimension strukturor të zgjerimit dhe jo një çështje dytësore kulturore.

Përfundim

Ky artikull ka argumentuar se menaxhimi i diversitetit dhe kultura e kujtesës janë dimensione të pandashme të konsolidimit demokratik dhe integritimit evropian në Ballkanin Perëndimor. Stereotipet kolektive, kujtesa selektive dhe traumat historike të pazgjidhura vazhdojnë të minojnë përfshirjen e pakicave dhe kohezionin shoqëror.

Politika e zgjerimit të BE-së ka arritur përparim të rëndësishëm institucional, por duhet të shkojë përtej përputhshmërisë formale drejt transformimit më të thellë kulturor. Njohja e politikave të kujtesës si një çështje thelbësore e qeverisjes është thelbësore për paqe të qëndrueshme dhe legjitimitet demokratik.

Vetëm përmes kulturave gjithëpërfshirëse dhe shumëperspektivës të kujtesës, Ballkani Perëndimor mund të kalojë nga stabiliteti pas konfliktit drejt integritimit të vërtetë evropian.

Conclusion

This article has argued that diversity management and the culture of memory are inseparable dimensions of democratic consolidation and EU integration in the Western Balkans. Collective stereotypes, selective remembrance, and unresolved historical traumas continue to undermine minority inclusion and societal cohesion.

EU enlargement policy has achieved significant institutional progress but must move beyond formal compliance toward deeper cultural transformation. Recognising memory politics as a core governance issue is essential for sustainable peace and democratic legitimacy.

Only through inclusive, multiperspectival cultures of memory can the Western Balkans move from post-conflict stability toward genuine European integration.

References

- Anderson B.* 1983. *Imagined Communities. Reflections on the Origin and Spread of the Nationalism*, New York, Verso.
- Assmann, A. and Sebastian C.* (2010) *Memory in a Global Age: Discourses, Practices and Trajectories*. Palgrave Macmillan, Basingstoke.
- Bakić-Hayden, M.*(1995).: Nesting orientalism: the Case of Former Yugoslavia. In: *Slavic review* 544, pp. 97–93
- Banac, I.* (1992). *The National Question in Yugoslavia: Origins, History, Politics*, Cornell University Press
- Bieber, F.* (2002) [Nationalist mobilization and stories of Serb suffering: The Kosovo myth from 600th anniversary to the present](https://scholar.google.com/citations?view_op=view_citation&hl=de&user=FpEa67wAAAAJ&citation_for_view=FpEa67wAAAAJ:d1gkVwhDpl0C), Taylor & Francis, (https://scholar.google.com/citations?view_op=view_citation&hl=de&user=FpEa67wAAAAJ&citation_for_view=FpEa67wAAAAJ:d1gkVwhDpl0C)
- Bieber, F.* (2014). [Situational nationalism: Nation-building in the Balkans, subversive institutions and the Montenegrin paradox](https://scholar.google.com/citations?view_op=view_citation&hl=de&user=FpEa67wAAAAJ&citation_for_view=FpEa67wAAAAJ:d1gkVwhDpl0C) (https://scholar.google.com/citations?view_op=view_citation&hl=de&user=FpEa67wAAAAJ&citation_for_view=FpEa67wAAAAJ:d1gkVwhDpl0C)

[=FpEa67wAAAAJ&cstart=20&pagesize=80&citation for view=FpEa67wAA
AAJ:uLbwQdceFCQC\)](#)

Bieber, F. (2006). *Post-War Bosnia: Ethnicity, Inequality and Public Sector Governance.* Palgrave Macmillan.

(https://scholar.google.com/citations?view_op=view_citation&hl=de&user=FpEa67wAAAAJ&citation for view=FpEa67wAAAAJ:u5HHmVD u08C)

David, R., & Choi, S. Y. (2009). *Getting Even or Getting Equal? Retributive Preferences and the International Criminal Tribunal for the Former Yugoslavia.* Political Psychology.

(https://www.researchgate.net/publication/229539644_Getting_Even_or_Getting_Equal_Retributive_Desires_and_Transitional_Justice)

Eyerman R. 2002, *Cultural Trauma: Slavery and the Formation of African American Identity,* Cambridge Univ. Press, Cambridge.

Jensen J. (ed.) (2018). *Memory and Populist Politics,* Polanyi Center Publications, iASK Working Papers, Koszeg

Halbwachs, M. (1992). *On collective memory (L. A. Coser, Ed. & Trans.).* University of Chicago Press. (Original work published 1950)

Kramer, H. (2004). *The Yugoslav Wars and Their Legacies.* *Survival*, 46(4), 99–111.

Kovačević, S. (2013). *Memory and identity in the former Yugoslavia: A case study of Macedonia.* In *Memory and identity in the Yugoslav successor states* (pp. 871–881). *Nationalities Papers*, 41(6)

Nettelfield, L. J. (2010). *Courting Democracy in Bosnia and Herzegovina.* Cambridge University Press.

Nora, P. (1989). *Between Memory and History: Les Lieux de Mémoire.* Representations.

Stradling, R. (2003). *Multiperspectivity in History Teaching: A Guide for Teachers.* Council of Europe.

Todora M. 1997, *Imaging the Balkans,* Oxford University Press, Inc. New York, USA,

Zubrzycki G. & Wozny A. 2020, *The Comparative Politics of Collective Memory,* in: *The Annual Review of Sociology,* University of Michigan, Michigan, 46: 175-194

(<https://doi.org/10.1146/annuerev-soc-121919-054808>)

ISSN 2671-3004

UDC 811.112.2'243'34
UDC 81'362

Punim studimor

Izer MAKSUTI

Universiteti “Nënë Tereza” në Shkup
E-mail: izer.maksuti@unt.edu.mk

**QASJE NDËRGJUHËSORE NË MËSIMIN E FONETIKËS DHE FONOLOGJISË
SË GJERMANISHTES SI GJUHË E HUAJ**

**INTERLINGUAL APPROACHES IN TEACHING GERMAN PHONETICS AND
PHONOLOGY AS A FOREIGN LANGUAGE**

Përmbledhje

Në dekadat e fundit, rëndësia e qasjes krahasimtare në procesin e mësimin dhe të mësimdhënies së gjuhëve është theksuar gjithnjë e më shumë në kërkimet e gjuhësisë së zbatuar dhe të didaktikës së gjuhëve të huaja. Kjo qasje nxit ndërgjegjësimin gjatë procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies, për mënyrën se si funksionojnë gjuhët dhe forcon ndërlidhjen ndërmjet njohjes intuitave dhe strukturës gjuhësore. Në kuadër të këtyre zhvillimeve, fonetika dhe fonologjia po fitojnë një rol gjithnjë e më qendror, pasi studimi i sistemeve tingullore të gjuhës së huaj në krahasim me gjuhën amtare ndihmon në përvetësimin e saktë të shqiptimit, në zhvillimin e kompetencës dëgjimore dhe në ndërtimin e bazës për kompetencën në komunikim ndërgjuhësor.

Punimi shqyrton rëndësinë e qasjes ndërgjuhësore në procesin e mësimin të fonetikës dhe fonologjisë së gjermanishtes si gjuhë e huaj (DaF), duke theksuar lidhjen ndërmjet njohjes së mirë të gjuhës amtare, në rastin tonë të shqipes, zhvillimit të dijes gjuhësore dhe arritjes së kompetencës metagjuhësore. Qasja ndërgjuhësore mundëson krahasimin dhe vlerësimin e ngjashmërive dhe dallimeve midis sistemeve fonetike e fonologjike të dy gjuhëve, ndihmon në parandalimin e interferencave negative dhe në përvetësimin e saktë të tingujve të gjuhës së huaj, si dhe lehtëson zotërimin e normës ortografike e ortoepike të gjuhës së huaj. Përfitimet janë të dyanshme: ndërsa njohja e mirë e gjuhës amtare mbështet mësimin e gjuhës së huaj, procesi i të nxënit të gjuhës së huaj përforcon ndërgjegjësimin dhe saktësinë gjuhësore në përdorimin e gjuhës shqipe.

Një komponent thelbësor i kësaj qasjeje është njohja e terminologjisë përkatëse në të dyja gjuhët, që lehtëson komunikimin akademik dhe procesin e mësimdhënies. Po aq të rëndësishme janë përdorimi i teksteve paralele dhe i materialeve autentike, të cilat nxisin krahasimin aktiv dhe zhvillojnë kompetencën ndërgjuhësore të studentëve. Integrimi i mjeteve dhe platformave digjitale, si dhe kërkimi online i literaturës shkencore dhe aplikacionet për ushtrimin e shqiptimit dhe punën terminologjike, krijon mundësi të reja për individualizimin e procesit të të nxënit.

Nëpërmjet ndërthurjes së metodave krahasimtare, të punës terminologjike dhe të burimeve digjitale, mësimi i fonetikës dhe fonologjisë shndërrohet në një proces dinamik e reflektues, në të cilin studenti jo vetëm përvetëson një gjuhë të huaj, por edhe kupton më thellë strukturën dhe funksionimin e gjuhës së vet amtare.

Fjalë kyçe: *Qasje ndërgjuhësore, fonetikë dhe fonologji, mësimi i gjermanishtes (DaF), dije gjuhësore, terminologji dygjuhëshe, tekste paralele, teknologji digjitale.*

Abstract

In recent decades, the significance of comparative and interlingual approaches in language teaching and learning has been increasingly emphasized in applied linguistics and foreign language didactics. Such approaches raise learners' awareness of how languages function, fostering the connection between intuitive and systematic linguistic knowledge in the learning and teaching process. In this context, phonetics and phonology have gained a central role, as the comparative study of sound systems between the foreign language and the mother tongue facilitates accurate pronunciation in the foreign language, develops listening competence, and strengthens the foundation for interlingual communicative competence.

This paper examines the importance of the interlingual approach in teaching German phonetics and phonology as a foreign language (DaF), highlighting the relationship between a solid command of the mother tongue – in this case, Albanian – and the development of metalinguistic competence and linguistic knowledge. The interlingual approach enables learners to identify similarities and differences between the phonetic and phonological systems of both languages, prevents negative transfer, and supports accurate pronunciation in the foreign language. It also contributes to mastering the orthographic and orthoepic norms of the foreign language. The benefits are twofold: a good command of the mother tongue facilitates the acquisition of the foreign language, while learning a foreign language, in turn, reinforces awareness of and accuracy in their mother tongue.

A key component of this approach is the acquisition of relevant terminology in both languages, which supports academic communication and teaching practice. Equally important is the use of parallel texts and authentic materials, which stimulate active comparison and foster interlingual competence. The integration of digital tools and platforms, online linguistic resources, and applications for pronunciation and terminology training, offers new opportunities for individualized learning.

By combining interlingual methods, terminology work, and digital resources, the teaching of phonetics and phonology becomes a dynamic and reflective process in which students not only acquire a foreign language but also gain a deeper understanding of the structure and functioning of their mother tongue.

Keywords: *Interlingual approach, phonetics and phonology, teaching German as a foreign language (DaF), linguistic knowledge, bilingual terminology, parallel texts, digital technology.*

1. Hyrje dhe korniza teorike

Në gjuhësinë e zbatuar, qasja krahasimtare synon të identifikojë ngjashmëritë dhe dallimet strukturore ndërmjet gjuhëve, me qëllim të lehtësimit të procesit të mësimnxënies dhe mësimdhënies.

Si shumica e risive në fushën shkencore, nga fundi i viteve 60-të të shek. XX, që vinte prej botës anglo-amerikane edhe kjo qasje ndërlidhet së pari ngushtë me idetë e Corder-it (1967)¹⁵ mbi “Interlanguage”/“Gjuhën ndërmjetëse”, ndikimet ndërgjuhësore të Odlin-it (1989),¹⁶ por edhe me konceptimin e Weinreich-it (1963/1977)¹⁷ për kontaktin e gjuhëve.

Tema që po trajtojmë këtu lidhet me një element thelbësor të mësimdhënies bashkëkohore të gjuhëve të huaja: qasjen ndërgjuhësore në mësimin e fonetikës dhe fonologjisë së gjermanishtes si gjuhë e huaj. Kjo qasje, e theksuar prej dekadash në kërkimet e gjuhësisë së zbatuar¹⁸ dhe të didaktikës së gjuhëve, sot po merr një rëndësi të veçantë, falë edhe zhvillimeve të teknologjisë digjitale dhe mundësive të reja pedagogjike.

¹⁵ Corder, S. P. (1967). *The Significance of Learners' Errors*. International Review of Applied Linguistics in Language Teaching, 5(4), 161–170.

https://eric.ed.gov/?id=ED019903&utm_source

¹⁶ Odlin, T. (1989). *Language Transfer: Cross-Linguistic Influence in Language Learning*. Cambridge University Press.

¹⁷ Weinreich, U. (1963). *Languages in Contact: Findings and Problems*. Mouton Publishers. / Weinreich, Uriel. (1977). *Sprachen in Kontakt. Ergebnisse und Probleme der Zweisprachigkeitsforschung*. München: C.H. Beck.

¹⁸ Shih për më shumë veprën përmbledhëse nga Knapp, K. et al. 2004, *Angewandte Linguistik: Ein Lehrbuch*.

Qasja ndërgjuhësore përbën një nga shtyllat metodologjike më të rëndësishme të gjuhësisë së zbatuar dhe të didaktikës së gjuhëve të huaja.¹⁹ Ajo mbështetet në parimin se mësimi i një gjuhe të huaj ndërlihet ngushtë me njohjen e strukturës së gjuhës amtare²⁰ dhe me aftësinë për të reflektuar në mënyrë të vetëdijshme mbi sistemet gjuhësore.

Viteve të fundit është bërë gjithnjë e më e dukshme prania e shtuar e lëndës së fonetikës dhe fonologjisë²¹ edhe në mësimin e gjuhëve të huaja në përgjithësi. Gjatë ofrimit të kësaj lënde ndër vite në universitet, vërejmë edhe ndryshimin e vazhdueshëm të literaturës përkatëse në gjuhën gjermane, i cili pasqyrohet në librat mësimorë të shtëpive të ndryshme botuese dhe në nivele të ndryshme, si dhe në shtimin e studimeve didaktike në këtë fushë.

Ky zhvillim mendojmë se është ndikuar, ndër të tjera, nga zgjerimi i mësimin të gjermanishtes si gjuhë e huaj dhe nga nevoja gjithnjë e më e madhe për zotërimin e shkathtësisë së të folurit.²² Në këtë kontekst, theksohet domosdoshmëria e aftësimin për zotërimin e sistemit tingullor të gjuhës që mësohet.

Por pikërisht këtu shtrohet pyetja themelore: a mund të mësohet në mënyrë të qëndrueshme një gjuhë e huaj, e dytë apo e tretë, pa njohur sa duhet mirë gjuhën e parë, gjuhën amtare, apo gjuhën që mësohet në mjedisin në të cilin jetojmë?

Nga ana tjetër, dihet se përmes mësimin dhe thellimit në gjuhët e huaja, ne arrijmë ta njohim dhe ta zotërojmë më lehtë edhe gjuhën tonë amtare. Në këtë drejtim, domethënëse mbetet thënia e Gëtes (Goethe): „*Wer fremde Sprachen nicht kennt, weiß nichts von seiner eigenen*“ (Kush nuk njeh gjuhë të huaja, nuk di asgjë për gjuhën e vet).

Qasja ndërgjuhësore nënkupton angazhimin e vetëdijshëm të njohurive të gjuhës amtare si bazë për të ndërtuar kompetencën në gjuhën e huaj. Ajo synon identifikimin dhe krahasimin e elementeve fonetike dhe fonologjike ndërmjet dy gjuhëve, duke i shndërruar ngjashmëritë në përparësi dhe dallimet në burim ndërgjegjësimit.

¹⁹ Botimet më të shumta dhe më me ndikim në fushën e Didaktikës së Mësimin të gjermanishtes si gjuhë e huaj janë bërë nga prof. H. J. Krumm, <https://www.germ.univie.ac.at/hans-juergen-krumm/>

²⁰ Pa njohjen e gjuhës amtare, sidomos nëse mësojmë një gjuhë të huaj në një moshë më të rritur, në rastin e studimit të saj, është tejet e vështirë, që të thellohem dhe të zotërojmë atë në një nivel të admirueshëm të gjuhës së parë.

²¹ Shih librat e mësimin të gjuhës gjermane si gjuhë e huaj; në procesin e mësimdhënies në Degën tonë, përdorim më shumë botimet e shtëpisë botuese Cornelsen Verlag, PANORAMA, për çdo njësi mësimore, kemi nga një temë të fonetikës dhe fonologjisë së gjermanishtes.

²² Me zhvillimin tepër dinamik të tregut të punës, viteve të fundit, shkathtësia e të folurit mbetet një prej më të kërkuarave, për komunikim të përditshëm dhe në procesin e punës në përgjithësi.

Në kuadër të kësaj me rëndësi është të trajtohet çështja se si puna e terminologjisë profesionale, në këtë rast e fushës së fonetikës dhe fonologjisë, si dhe përdorimi i teksteve paralele mund të ndihmojnë në përvetësimin më të lehtë të dijës së këtyre fushave. Tekstet paralele mundësojnë një krahasim të vazhdueshëm të strukturës tingullore, përmes kësaj lehtësohet si kuptimi dhe njohja, ashtu edhe nyjëtimi dhe përdorimi i duhur i tingujve të gjuhës së huaj. Puna e qëllimshme me terminologjinë profesionale, mbështet zhvillimin e aftësive të komunikimit akademik dhe përmes kësaj formon një bazë të qëndrueshme të aftësimit profesional të mësuesve të ardhshëm.

Falë zhvillimeve të fundit është shtuar rëndësia e mjeteve digjitale dhe resurseve online, të cilët ofrojnë mundësi të reja për ushtrime të individualizuara të shqiptimit të gjuhës, kërkime në fushën terminologjike, si dhe mundësojnë procesin e analizës ndër-gjuhësore. Përmes ndërthurjes të metodave krahasimtare, punës terminologjike dhe formave të mësimit me mbështetje digjitale, procesi i mësimit dhe mësimdhënies së fonetikës dhe fonologjisë mund të bëhet më dinamik, reflektues, gjatë të cilit studentët mund të zhvillojnë kompetencën e tyre në gjuhën e huaj, si dhe të zhvillojnë më tutje ndërgjegjësimin mbi dijen gjuhësore në tërësi.

Në këtë kuptim, mësimi i fonetikës dhe fonologjisë në kornizën e gjermanishtes si gjuhë e huaj (DaF) duhet të shihet jo vetëm si përvetësim i një sistemi të ri tingullor, por edhe si proces ndër-gjuhësor që ndërton ura midis dy kompetencave, të asaj në gjuhën amtare dhe asaj në gjuhën e huaj. Përmes qasjes ndër-gjuhësore, studentët zhvillojnë jo vetëm aftësi praktike të shqiptimit dhe dëgjimit, por edhe një ndërgjegjësim të thelluar për strukturën, funksionet dhe logjikën e sistemeve gjuhësore në përgjithësi.

Qëllimi i këtij punimi është të shqyrtojë në mënyrë teorike dhe praktike rëndësinë e qasjes ndër-gjuhësore në mësimdhënien e fonetikës dhe fonologjisë së gjermanishtes si gjuhë e huaj. Këtu jemi ndalur veçanërisht edhe në rolin që luajnë tekstet paralele, rëndësinë e njohjes së terminologjisë së fushës në dy gjuhët, si dhe te infrastruktura digjitale dhe materialet autentike në rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe të kompetencës gjuhësore të studentëve.

2. Qasja krahasimtare në fushën e fonetikës dhe fonologjisë gjermane dhe shqipe

Qasja ndër-gjuhësore në didaktikën e gjuhëve të huaja²³ bazohet në supozimin se mësimi i gjuhës ndikohet dukshëm nga njohuritë gjuhësore ekzistuese që ka folësi.

²³ Shih më shumë studimin e autorit Herbert Christ dhe Werner Hüllen: *Fremdsprachendidaktik*, në veprën tepër të rekomandueshme si doracak bazë të mësimit të gjuhëve të huaja, Bausch/Christ Krumm (Hrsg.), 1995, 3 Aufl., fq. 1-7.

Kur mësojmë një gjuhë të re, meqë kemi njohuri paraprake në një e më shumë gjuhë, ndikohemi vazhdimisht nga kompetenca gjuhësore që kemi. Nga kjo krijohen procese transferimi dhe interference, që mund të kenë si efekt mbështetës ashtu edhe pengues. Qasjet didaktike aktuale këta procese nuk i konsiderojnë përgjithësisht si burim i gabimeve, por më tepër si pikënisje për mësim të vetëdijshëm, reflektim dhe zhvillimin e aftësive metagjuhësore (Wolf-Farré et al., 2021).

Një ndër pjesët qendrore të kësaj perspektive është nxitja dhe mbështetja e vetëdijes gjuhësore. Dimë se krahasimi i gjuhëve merret si një instrument kyç në didaktikën e gjuhëve të huaja dhe luan rolin kryesor në procesin e zhvillimit të vetëdijes gjuhësore (Krumm et al., 2010). Përmes krahasimit të vazhdueshëm të strukturave gjuhësore, studentët zhvillojnë një kuptim më të thellë të mënyrës se si janë ndërtuar gjuhët e ndryshme dhe të parimeve funksionale që qëndrojnë në themel të tyre.

Siç përmendëm që në hyrje, qasja ndërgjuhësore luan një rol të veçantë edhe në fushën e fonetikës dhe fonologjisë. Rrafshi tingullor ndikohet fuqishëm nga gjuha e parë; modelet e perceptimit dhe prodhimit shpesh janë thellësisht të rrënjosura dhe ndikojnë në përvetësimin e tingujve të gjuhës së huaj dhe të modeleve prozodike. Një qasje krahasimtare, e cila identifikon në mënyrë sistematike ngjashmëritë dhe dallimet midis sistemeve fonologjike të dy gjuhëve, mund t'u ndihmojë studentëve të perceptojnë kategori të reja tingujsh dhe në mënyrë më të vetëdijshme t'i pranojnë dhe artikulojnë ata. Në të njëjtën kohë, kjo qasje ndihmon në njohjen e fenomeneve të interferencës dhe në reduktimin afatgjatë të tyre.

Në kuadër të mësimdhënies së gjermanishtes si gjuhë e huaj (DaF), fonetika dhe fonologjia nuk trajtohen vetëm si disiplina teorike, por si bazë për zhvillimin e shqiptimit të saktë, të kompetencës dëgjimore dhe të aftësisë për komunikim më efikas.

Përveç kësaj njohuritë e fonetikës përbëjnë një ndërlidhje bazë midis perceptimit gjuhësor, artikulimit/nyjtimit dhe kompetencës ortografike. Zotërimi i duhur i strukturave fonetike-fonologjike jo vetëm që lehtëson përvetësimin e shqiptimit standard, por gjithashtu mbështet zhvillimin e dëgjim-kuptimit, si dhe përdorimin e drejt të rregullave të drejtshqiptimit dhe të drejtshkrimit. Në rrethana të tilla të mësimin të gjuhëve, krahasimi me gjuhën e parë, në rastin tonë me shqipen, mundëson që strukturat e reja tingullore, në këtë rast me gjermanishten, të ndërlidhen në mënyrë sistematike me njohuritë gjuhësore ekzistuese të studentëve.

Analiza kontrastive midis gjermanishtes dhe shqipes tregon se, megjithëse të dyja gjuhët i përkasin familjes indoevropiane, ato shfaqin dallime të dukshme në nivelin segmental dhe suprasedgmental, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në procesin e të nxënimit, si dhe në atë të mësimdhënies. Në këtë rast, krahasimi midis gjermanishtes dhe shqipes është

veçanërisht i rëndësishëm, sepse të dyja gjuhët kanë sisteme fonologjike me dallime të theksuara strukturore.

Shqipja ka një sistem relativisht të qëndrueshëm të zanoreve, ndërsa gjermanishtja paraqet një sistem shumë më kompleks, me variante të gjata e të shkurtra, me zanore që shqiptohen ndryshe, dhe me diftongje që mungojnë në gjuhën shqipe. Sistemi i zanoreve²⁴ të shqipes standarde karakterizohet nga një inventar relativisht i qëndrueshëm, gjithsej 7 zanore, me theks të veçantë në qartësinë e nyjetimit dhe mungesën e dallimeve të theksuara në gjatësinë e tyre. Në gjermanisht, përkundrazi, dallimi midis zanoreve të shkurtra dhe të gjata (mbi 15 zanore) ka vlerë fonologjike dhe ndikon drejtpërdrejt në kuptimin e fjalës. Kjo diferencë paraqet një burim të shpeshtë dallimesh në procesin e nxënies për shqipfolësit.

Po kështu, sistemi i bashkëtingëlloreve²⁵ të gjermanishtes përfshin fonema dhe variante që studentët shqiptarë nuk i gjejnë në gjuhën amtare, si variantet e alofoneve të së njëjtës fonemë, /ç/ (ich-Laut) dhe /x/ (ach-Laut), dhe variante alofonike të fonemës /t/ (si apikal/alveolar dhe uvular), pa ndryshim kuptimor, apo dallimet në raportin fortis–lenis, të cilat kanë pasojë të drejtpërdrejta në shqiptim dhe perceptim.²⁶ Gjuha shqipe²⁷ karakterizohet nga një sistem i pasur i bashkëtingëlloreve, ku dallimi midis tingujve të zëshëm dhe të pazëshëm është më i qëndrueshëm. Një krahasim i sistemit tingullor, si për bashkëtingëlloret, ashtu edhe për zanoret e gjuhës gjermane dhe shqipe, pasqyrohet edhe në glosarin dygjuhësh në fund të këtij punimi.

Ky dallim i sistemit tingullor në mes të dyja gjuhëve krijon sfida konkrete gjatë mësimin dhe mësimdhënies, por pikërisht këtu bëhet i domosdoshëm funksioni i qasjes ndër-gjuhësore. E tërë kjo ndihmon që studenti të kuptojë, pse e ka të vështirë shqiptimin e disa zanoreve, sidomos të atyre Umlaut/metafoni, si dhe bashkëtingëlloreve, ose disa mënyra të caktuara të theksit, dhe si mund të zhvillojë kompetencën e tij fonetike përmes krahasimit të qëllimshëm me gjuhën amtare. Aspirimi (frymëtimi)²⁸ i bashkëtingëlloreve fillestare dhe tingujve specifikë të gjermanishtes janë sfida për studentët që kanë gjuhë amtare shqipe.

²⁴ Krh. Dodi, 2004:37-71; Memushaj, 2009:25-65; Rugova, 2019:197-199.

²⁵ Shih për më shumë në: Becker 2012:18-42.

²⁶ Shih më shumë materialet online të studiueseve gjermane më të dalluara në këtë fushë: Hirschfeld, Ursula / Reinke, Kerstin: *Phonetik im Fach Deutsch als Fremd- und Zweitsprache: Unter Berücksichtigung des Verhältnisses von Orthografie und Phonetik*. Erich Schmidt Verlag, 2. Aufl. 2018; Schwerpunkt 13: R-Laute (für Lehrer/-innen).

²⁷ Krh. Dodi, 2004:72-107; Memushaj, 2009:67-124; Rugova, 2019:177-179.

²⁸ Shih më shumë për këtë (Aspiration/Behauchung) në:

https://ger.ovgu.de/Fachgebiete/Germanistische+Linguistik/Linguistisches+W%C3%B6rterbuch+von+Th_+Lewandowski/A/Aspiration-p-1200.html

Në këtë proces krahasimi një vëmendje e posaçme duhet t'u kushtojmë edhe veçorive suprasegmentale (mbisegmentore) si theksi, ritmi dhe intonacioni. Dallimet në aspektin e prozodisë mund të çojnë në vështirësi gjatë të kuptuarit në komunikimin gojor, edhe nëse tingujt veç e veç shqiptohen saktë. Duke krahasuar strukturat prozodike në gjuhë të ndryshme, studentët zhvillojnë një ndjesi më të hollë të modeleve ritmike dhe të intonacionit të gjuhës, pra kështu mund të rregullojnë shqiptimin e tyre në përputhje me sistemin fonologjik të gjuhës që mësojnë.

Përveç kësaj, qasja krahasimtare është e rëndësishme për ndërlidhjen midis shqiptimit dhe shkrimit të një gjuhe. Të njohura i kemi dallimet e shumta që ka gjuha gjermane në këtë aspekt. Korrespondenca²⁹ në mes të fonemave dhe grafemave gjatë procesit të mësimin dhe studimit të gjermanishtes kërkon kohë dhe mundim më vete. Ky dallim i grafemave dhe fonemave dhe norma e shqiptimit çojnë në pasiguri gjatë procesit të leximit dhe shkrimit të gjuhës gjermane. Pikërisht për këtë krahasimi i sistemeve të shkrimit të gjermanishtes dhe shqipes, pra puna me tekste paralele, të ortoepisë dhe ortografisë së shqipes³⁰ dhe gjermanishtes lehtësojnë përvetësimin e normave të drejtshqiptimit dhe drejtshkrimit. Një shqyrtim i qartë i këtyre aspekteve mbështet si vetëdijen fonologjike ashtu edhe kompetencën ortografike.

Në këtë mënyrë, qasja ndër-gjuhësore përmbush së paku tre funksione themelore didaktike:

1. Rrit ndërgjegjësimin fonologjik,³¹
2. Forcon kompetencën metagjuhësore;
3. Ndikon drejtpërdrejt në saktësinë e shqiptimit dhe në zhvillimin e kompetencës së dëgjim-kuptimit (Hörverstehen).

Në përgjithësi, është e qartë se një analizë krahasimtare e sistemeve fonologjike të gjermanishtes dhe shqipes ofron një bazë të fortë në procesin e mësimin dhe mësimdhënies. E tërë kjo mundëson një analizë sistematike të dukurive të interferencës dhe në këtë mënyrë lehtëson përvetësimin e

²⁹Shih më shumë në: Das deutsche Schriftsystem, https://www.uni-potsdam.de/fileadmin/projects/peter-eisenberg-schriften/PDFs/Eisenberg_1996_Das-deutsche-Schriftsystem.pdf; Laut-Buchstaben-Zuordnung, <https://grammis.ids-mannheim.de/rechtschreibung/6144>; <https://www.uni-bielefeld.de/fakultaeten/linguistik-literaturwissenschaft/studium-lehre/studienfaecher/daf-daz/lehrprojekte-und-material/ausspracheschulung/Laut-Buchstaben-Beziehungen.pdf>

³⁰ Shih: Librin e DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE, në: <https://www.shkenca.org/index.php/gjuhe-shqipe/18-drejtskrimi/51-drejtskrimi-i-gjuhes-shqipe>

³¹ Shih më shumë për këtë në: https://www.zebis.ch/sites/default/files/teaching_material/phonologische_bewusstheit.pdf

një shqiptimi sa më të përafërt me normën gjuhësore që gjuhës që mësojmë.

3. Qasje didaktike e mësimit ndërgjuhësor të fonetikës dhe fonologjisë

Tekstet paralele janë një mjet kyç edhe në mësimdhënien e gjuhëve, duke ndihmuar në rritjen e ndërgjegjësimit për proceset e të nxënit ndërgjuhësor dhe në përfshirjen sistematike të materialeve gjuhësore ekzistuese në mësimdhënie. Në kontekstin e një perspektive ndërgjuhësore rreth mësimdhënies së fonetikës dhe fonologjisë së gjermanishtes si gjuhë e huaj (DaF), ata ofrojnë një mundësi metodologjiksht të qëndrueshme për të kombinuar perceptimin, analizën dhe zotërimin e sistemit tingullor.

Me tekste paralele³² nënkuptojmë ata tekste, që janë të krahasueshëm në aspektin e përmbajtjes, funksionit ose strukturës në dy ose më shumë gjuhë dhe përdoren posaçërisht në procesin e mësimit dhe mësimdhënies. Këta mund të jenë materiale autentike (p.sh. tekste informative, tematike) ose tekste të hartuara për qëllime didaktike. Faktori vendimtar në këtë rast, nuk është aq shumë ekuivalenca fjalë për fjalë e përkthimit të tyre, sesa mundësia e krahasimit të strukturave gjuhësore, e nocioneve dhe termave të fushës, gjë që mundëson një krahasim reflektues. Prandaj, tekstet paralele nuk përdoren kryekëput vetëm për punë përkthimi, por edhe për qëllime didaktike, përmes një qasje të vetëdijshme ndaj sistemeve gjuhësore.

Përdorimi i teksteve paralele përbën një komponent thelbësor në procesin e përvetësimit të fonetikës dhe fonologjisë, pasi mundëson njohjen sistematike dhe saktësimin e terminologjisë, thellimin e njohurive për përmbajtjen lëndore dhe ndërtimin e një qasjeje metodike të qëndrueshme. Tekstet paralele krijojnë kushte për krahasim ndërgjuhësor, si dhe lehtësojnë përafrimin konceptual të termave shkencorë. Nëpërmjet punës me tekste paralele, studenti zhvillon kompetencë terminologjike dhe meta-gjuhësore, si dhe aftësi për analizë kritike. Përdorimi i këtyre burimeve i mundëson studentit të vërejë ngjashmëritë dhe dallimet ndërgjuhësore.

Pikërisht për këtë puna terminologjike (krh. Reiner et al., 2009:1-9) dhe njohja e terminologjisë dygjuhëshe është një aspekt i rëndësishëm i kësaj qasjeje. Mësimi i disa termave bazë të fonetikës dhe fonologjisë, lehtësohet përmes njohjes dhe studimit të teksteve paralele, si dhe

³² Shih për më shumë në këtë artikull trajtohet rëndësia e teksteve paralele për mbështetjen e lexim-kuptimit në mësimin universitar të gjermanishtes si gjuhë e huaj. Në këtë aspekt tekstet paralele mund të përdoren qëllimshëm edhe në procesin e mësimdhënies dhe nxënies të lëndëve të ndryshme gjuhësore.
<https://zif.tujournals.ulb.tu-darmstadt.de/article/id/3311/>

doracakëve dhe veprave të referimit si enciklopedi, fjalorë dhe leksikonë të këtyre fushave. Për më shumë mbi burimet në këto disiplina shih bibliografinë e këtij artikulli. Njohja e këtyre koncepteve dhe nocioneve bazë ndihmon jo vetëm në kuptimin teorik të fonetikës dhe fonologjisë, por edhe në komunikimin më efikas ndërmjet mësimeve dhe studentit, si dhe në reflektimin për tërë procesin e mësimit. Në këtë kontekst standardizimi i terminologjisë ekzistuese i fushës së fonetikës dhe fonologjisë në gjuhën shqipe është i një rëndësie të veçantë. Zotërimi i terminologjisë profesionale³³ në fushën e fonetikës dhe fonologjisë është parakusht kyç për mësime dhe zotërim të qëndrueshëm të dijës profesionale. Njohja e terminologjisë në të dyja gjuhët mundëson një kuptim më të thellë të përmbajtjes teorike, mbështet reflektimin mbi proceset e të nxënies dhe përbën bazën për zhvillimin e aftësive të komunikimit akademik.

Këtu vetëm do të përmendim një dimension tjetër shumë aktual, si roli i teknologjisë digjitale dhe laboratorëve të gjuhës në mësimin e fonetikës, sidomos në kuadër të fonetikës eksperimentale. Teknologjia ka krijuar mundësi që para pak dekadash ishin të paimagjinueshme. Nëpërmjet programeve të specializuara dhe platformave digjitale, studentët mund të krahasojnë realizimet e tyre fonetike me modelin standard, të regjistrojnë përparimin dhe të reflektojnë për procesin e mësimit.

Në lidhje me këtë, qasja ndërgjuhësore dhe teknologjia përputhen natyrisht. Teknologjia e forcon qasjen ndërgjuhësore duke e bërë krahasimin më të dukshëm, më të matshëm dhe më të kuptueshëm. Studentët mund të zbulojnë dallimet me gjermanishten në kohë reale dhe të kuptojnë pse shqiptimi i tyre dallon në gjuhën shqipe. Gjatë këtij procesi, ndër të tjera, gjithashtu lehtësohet edhe mundësia e përvetësimit të një shqiptimi sa më të përafërt të gjermanishtes.

4. Diskutime dhe përfundimi

Analiza kontrastive midis shqipes dhe gjermanishtes tregon se njohja e mirë e strukturës së gjuhës amtare përbën një bazë të domosdoshme për përvetësimin e saktë të sistemit tingullor të gjuhës së huaj.

Përdorimi i teksteve paralele dhe materialeve autentike nxit krahasimin aktiv, ndërgjegjësimin fonologjik dhe zhvillon kompetencën ndërgjuhësore të studentëve.

Njohja e terminologjisë përkatëse në të dyja gjuhët është thelbësore për saktësinë akademike dhe për orientimin e procesit të mësimit dhe mësimeve.

³³ Shih për më shumë mbi këtë temë në: Maksuti, Izer: (2022). *Roli i terminologjisë profesionale në përkthimin e teksteve të specializuara*. - KONFERENCA shkencore ndërkombëtare. "Terminologjia dhe roli i saj për njohjen e gjuhës profesionale". Shkup, 21 shtator 2021. Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së. 2022, fq. 81-102.

Integrimi i mjeteve digjitale dhe burimeve online ofron mundësi për qasje individuale ndaj dijes tematike, ushtrime me qasje të drejtpërdrejt dhe arritje të aftësive fonetike dhe terminologjike në mënyrë mjaft efikase. Kjo qasje është një mundësi, për të ndërtuar ura të qëndrueshme midis teorisë dhe praktikës, midis gjuhës amtare dhe gjuhës së huaj, dhe mbi të gjitha midis dijes intuitive dhe asaj të strukturuar gjuhësore.

Qasja ndërgjuhësore në mësimin e fonetikës dhe fonologjisë së gjermanishtes si gjuhë e huaj paraqet një kornizë metodologjike të qëndrueshme dhe efikase, e cila i jep prioritet krahasimit të strukturuar të dy sistemeve gjuhësore dhe ndërgjegjësimit meta-gjuhësor të studentëve. Analiza e zhvilluar në këtë punim tregon se ndërthurja e njohurive të fonetikës dhe fonologjisë me komponentin ndërgjuhësor është thelbësore për rritjen e saktësisë në shqiptim, perceptimin fonetik dhe zhvillimin e kompetencës së komunikimit ndërgjuhësor.

Duke u mbështetur në dallimet dhe ngjashmëritë e sistemit tingullor të shqipes dhe gjermanishtes, qasja ndërgjuhësore ndihmon në paracaktimin, parandalimin dhe korrigjimin e gabimeve karakteristike ndikuar nga dukuria e interferencës. Përmes përdorimit të metodave të integruara, analizës akustike, ushtrimeve të shqiptimit, teksteve paralele, terminologjisë dygjuhëshe, studentët arrijnë të tejkalojnë kufijtë intuitivë të të folurit dhe të zhvillojnë një kompetencë në fushën e fonetikës dhe fonologjisë.

Roli i teknologjisë është veçanërisht i rëndësishëm në këtë proces. Mjetet digjitale, platformat e të nxënimit në distancë, aplikacionet e shqiptimit dhe softuerët e analizës akustike ofrojnë mundësi të reja individuale të mësimdhënies, matjen objektive të përparimit në mësim dhe rritjen e punës së pavarur të studentëve. Integrimi i tyre në mësimin e fonetikës dhe fonologjisë jo vetëm që modernizon procesin, por e bën atë më të matshëm, më transparent dhe më efikas.

Përfitimet e qasjes ndërgjuhësore janë të shumëanshme. Ata jo vetëm përmirësojnë procesin e mësimnxënies së gjuhës së huaj, por gjithashtu lehtësojnë ndërgjegjësimin për rëndësinë e saktësisë së përdorimit të gjuhës amtare. Studentët që zotërojnë një kompetencë të fortë ndërgjuhësore përfitojnë jo vetëm në shqiptimin e gjermanishtes, por edhe në aftësinë për të reflektuar në mënyrë kritike mbi sistemet gjuhësore në tërësi.

Duke përfunduar, mund të themi se qasja ndërgjuhësore në mësimin e fonetikës dhe fonologjisë së gjermanishtes paraqet një perspektivë didaktike të qartë, e cila i vlerëson njohuritë e studentit dhe i përdor ato si burim për të forcuar kompetencën në gjuhën e huaj. Po ashtu kjo qasje dallimet midis dy sistemeve gjuhësore i kthen në motivim për reflektim dhe mësim të qëndrueshëm. E tërë kjo është në harmoni të plotë me zhvillimet bashkëkohore në gjuhësinë e zbatuar, me kërkimet e reja

mbi dy-dhe shumëgjuhësinë, si dhe me mundësitë e shumta që ofrojnë mjetet digjitale.

Glosar³⁴ - Disa terma bazë të fonetikës dhe fonologjisë, në gjermanisht dhe shqip

Gjermanisht	Shqip
<p>Akzent, m/Akzentuierung, f Betonung/Hervorhebung von Silben (Lauten, Lautgruppen) in Wörtern und Wortgruppen durch Veränderung der Tonhöhe, durch größere Lautstärke, geringeres Sprechtempo sowie größere Spannung. Dynamischer, emotionaler, melodischer, musikalischer, Hauptakzent, Nebentakzent, Wortakzent, Satzakzent</p>	<p>Theksi/Theksimi Theks dinamik, emocional, melodik, muzikor, kuantitativ (i sasisë), kryesor, dytësor, i fjalës, i fjalisë</p>
<p>Allophon, n Realisierungsvariante eines Phonems, z. B. vokalisiertes R (wie in Meer) und Reibe-R (wie in Meere) als Allophone des Phonems [r].</p>	<p>Alofon/Variant i fonemës</p>
<p>Artikulation, f Lautbildung, d. h. die für das Hervorbringen von Vokalen und Konsonanten erforderlichen Einstellungen und Bewegungen der Sprechorgane. <i>Artikulationsart, f/Artikulationsmodus, m:</i> Art und Weise der Lautbildung, d. h. der Beeinflussung der Ausatemungsluft durch Öffnung, Enge und Verschluss im Mundraum.</p>	<p>Artikulum/Nyjëtim <i>Mënyra e nyjëtimimit:</i> mbylltore/shpërthyesë/plosive (p, b, t, d, q, gj, k, g, c, x, ç, xh, m, n, nj),</p>

³⁴ Glosari përkufizohet si një listë fjalësh dhe termash të një fushe të caktuar, të shoqëruar me sqarime ose përkufizime, që synojnë lehtësimin e kuptimit të teksteve. Sot glosarët janë zakonisht tematikë dhe mund të jenë njëgjuhësh, dygjuhësh apo shumëgjuhësh. Gjatë mësimdhënies disaveçare të lëndës së fonetikës dhe fonologjisë së gjuhës gjermane, në tre universitete, për qëllime didaktike, kemi përdorur monografi, studime, tekste paralele dhe glosarë në gjermanisht, shqip dhe anglisht. Në kuadër të kësaj pune janë hartuar edhe lista dygjuhëshe gjermanisht-shqip, me synim lehtësimin e procesit të mësimdhënies dhe nxënies së materialit nga studentët. Ky glosar përbën pjesë të këtyre përpjekjeve. Ai është hartuar për të përforcuar këtë punim dhe për qëllime didaktike, por nuk pretendon përsosuri leksikografike. Përshkrimi dhe sistematizimi i termave kryesorë të sistemit të bashkëtingëlloreve (sipas tabelës së bashkëtingëlloreve), dhe sistemit të zanoreve (sipas trapezit të zanoreve), kanë prodhuar edhe glosarë të tjerë tematikë, të cilët, për arsye hapësire dhe të natyrës së artikullit, nuk përfshihen në këtë botim.

<p>Plosiv/Verschlusslaut/Explosive/Okklusive, Klusile/Mutae - /b, d, g/ - Lenis (stimmhaft), p, t, k, (?)/ - Fortis (stimmlos), Frikativ/Reibelaut, Engellaut, Konstriktiv, Spirans, Spirant - /f, v, s, z, ʃ, ʒ, ç, ʝ, x, h/, Affrikata/Affrikat, n/Affrikaten, pl./Affrikate/Verschlussreibelaut - /pf, ts, tʃ, dʒ/, Nasale Laute/Nasale - /m, n, ŋ/, Vibrant, Schwinglaut/Zitterlaut-Trill - /r, ʀ/, Lateral, n/Seitenlaut - /l/, Liquida, f/Liquid, Fließlaut, Schmelzlaut; Pl.: Liquidae, Liquidä, Liquiden - /l-Laut, r-Laut/, Approximanten/Annäherungslaut/Halb vokale - /j/, im Englischen /w/</p> <p><i>Artikulationsort, m/Artikulationsstelle, f:</i> Genaue Stelle, an der ein Laut gebildet wird, z. B. bilabial (an beiden Lippen). Ober- und Unterlippe/bilabial - /b, m, p/, Unterlippe + obere Schneidezähne/labio-dental -/f, v/, Zahnlaut/dental, Zahndamm/alveolar - /t, d, l, n, r, s, z/, Zahndamm+ harter Gaumen/Postalveolar - /ʃ, ʒ /, harter Gaumen/palatal - /j/, /ç/ = ich-Laut, weicher Gaumen/velar - /g, k, ŋ/, /x/ = ach-Laut/, Zäpfchen/uvular - /ʀ/, /ʁ/ = Zäpfchen - r, Rachen/pharyngal, Stimmritze/Glottis/glottal - /h/, /ʔ/ Kehlkopf/laryngal</p>	<p>fërkimore (f, v, th, dh, s, z, sh, zh, j, l, ll, h) / fishkëlluese/fërkimore kontinuant (s, z, c, x, ç, xh, sh, zh) shushuritëse (sh, zh, ç, xh), afrikate (c, x, ç, xh), hundore/nazale (m, n, nj), dridhëse (r, rr), anësore (l, ll), mesore (j), Likuide/të lëngëta (l, ll, r, rr), aproksimant (j, w)</p> <p><i>Vendi i nyjëtim:</i> buzore, dybuzore (p, b, m), buzore-dhëmbore (f, v), Paragjuhore: ndër dhëmbore (th, dh), alveodhëmbore (t, d, ll),</p> <p>Alveolare (c, x, s, z, n, l, r, rr), palatale-alveolare (ç, xh, sh, zh), mesgjuhore/palatale/qi ellëzore (q, gj, nj, j), prapagjuhore/velare (k, g),</p> <p>laringale, uvulare, faringale, glotale (h),</p>
<p>Artikulationsorgane/Artikulatoren Unterkiefer, m/Mandibula, f Lippen, f/Labia pl., Labium, n</p>	<p>Organet e nyjëtim/ Artikulatorët Nofulla e poshtme</p>

<p>Zähne /Dentes, m.pl Zahndamm, m/Alveolim.pl. Zunge, f/Lingua, f Zungenspitze, f/Apex, m (apikal); Zungenblatt, n/Lamina, f (laminal); Zungenrücken, m/Dorsum, n (dorsal); Zungenwurzel, f/Radix, f (radikal); Zungenkranz, m/Corona, f (coronal) = Zungenspitze und Zungenblatt Gaumensegel, n/Velum, n = weicher Gaumen; Harter Gaumen/Palatum, n Nasenraum, m/Nasenhöhle, f Gaumenzäpfchen, n/Uvula, f Mundraum, m/Mundhöhle, f Rachen, m/Pharynx, m Rachenraum, m/Rachenhöhle, f Ansatzrohr, n/Artikulationstrakt, m/Sprechtrakt, m/Vokaltrakt, m Kehlkopf, m/Larynx, m Luftröhre, f. pl Lunge, f</p>	<p>Buzët Dhëmbët Alveolat Gjuha Gjuha si organ ka pjesën majore (apex/apikale/majegjuhore), e sipërme e përparme e gjuhës/tehu i gjuhës (laminal), shpina e gjuhës (dorsal/shpinor), rrënjën (radix); paragjuhore/koronale Qiellëza e butë Qiellëza e fortë Zgavra e hundës Njerith/uvulë Zgavra e gojës Faringu Laringu Mushkëritë</p>
<p>Aspiration, f/Behauchung, f Behauchung der Explosive vor betontem Vokal und im Wortauslaut, z. B. in Tag [th a:kh].</p>	<p>Aspirim/Frymëtim</p>
<p>Konsonant, m/Hindernislaut, m/Mitlaut, m Laut, der durch Engen (Frikative) oder Verschlüsse (Explosive) im Mund gebildet wird; er kann in der Regel nur in Verbindung mit Vokalen gesprochen werden. Sonorant/Sonorlaut Obstruent/Geräuschkonsonant/Geräuschlaut – stimmhafte Obstruenten /b, v, d, g, z/, stimmlose Obstruenten /p, t, k, f, s/</p>	<p>Bashkëtingëllore Sonante (j, l, ll, r, rr) dhe sonante hundore (m, n, nj), të shurdhëta (p, t, q, k, c, ç, f, th, s, sh, h), të zëshme (b, d, gj, g, x, xh, v, dh, z, zh), të zhurmëta (p, b, t, d, q, gj, k, g, c, x, ç, xh), obstruent /j/sonante/të zhurmëta (p, b, t, d, q, gj, k, g, c, x, ç, xh, f, v, th, dh, s, z, sh, zh, h)</p>
<p>Laut, m (Sprechlaut) Konkrete Realisation eines Phonems durch einen Sprecher.</p>	<p>Tingull (i të folurit) dallues, instruktiv, korrelativ, redundant (jodallues)</p>

<p>Silbe, f (Phonetische) Gestaltungseinheit eines Wortes, die nur zum Teil mit dem Morphem übereinstimmt, z. B. Straß-e (Morphem vs. Silbe); der Silbenbegriff spielt vor allem im Zusammenhang mit Akzentuierung und Rhythmus, aber auch mit phonetischen Veränderungen an der Silbengrenze, z. B. bei der R-Realisation in hören (frikativ) und hört (vokalisiert), eine Rolle. Geschlossene Silbe: Silbe, die mit einem Konsonanten endet; offene Silbe: Silbe, die mit einem Vokal endet. betonte, geschlossene, leichte, offene, schwere, unbetonte, Nebensilbe</p>	<p>Rrokje, e theksuar, e mbyllur, e lehtë, e hapur, e rëndë, e patheksuar, dytësore</p>
<p>Sprechapparat, m Artikulationsorgane/Artikulatoren</p>	<p>Aparati i të folurit/Trakti vokal Organet e nyjëtimimit/Artikulatorët</p>
<p>Transkription, f Lautschrift/Umschrift, mit deren Hilfe gesprochene Sprache verschriftet werden kann, wenn Schreibung und Aussprache voneinander abweichen bzw. Aussprachevarianten erfasst werden sollen; Phoneme werden in Schrägstriche gesetzt: //, Laute in eckige Klammern: []. API/IPA: Association Phonetique Internationale/International Phonetic Association; (API/IPA-Transkription).</p>	<p>Transkriptim Transkriptim fonetik, fonologjik, ortografik IPA – Shoqata Ndërkombëtare e Fonetikës. Shkrim fonetik IPA – Alfabeti Fonetik Ndërkombëtar; Sistem shenjash për transkriptim.</p>
<p>Vokal, m/Öffnungslaut, m/Selbstlaut, m 1) Vokalqualität a) <i>Zungenhöhe</i> Hohe (geschlossene Vokale): [i:], [y:], [u:] Halbhohe (halbgeschlossene) Vokale: [ɪ], [ɪ̞], [ɔ̞] Mittlere Vokale: [e:], [ø:], [o:] Halbtiefe (halboffene) Vokale: [ɛ], [œ], [ɔ], [ə] Tiefe (offene) Vokale: [a:], [a] sowie [ɐ] b) <i>Horizontale Zungenlage</i></p>	<p>Zanore Buzore, jobuzore, të mbyllura (i, u, y), të hapura (a), hundore, johundore, Lëvizja horizontale/ngritje: zanore e ngritjes së lartë (i, u, y), mesme (e, ë, o), ulët (a)</p>

<p>Vordere (palatale) Vokale (auch „Vorderzungenvokale“) [i:], [ɪ], [y:], [y], [e:], [ɛ], [ɛ:], [ø:], [œ]. Zentrale Vokale [a:], [a], [ɔ], [ɐ]. Hintere (velare) Vokale /„Hinterzungenvokale“ [u:], [ʊ], [o:], [ɔ]. c) <i>Lippenstellung</i> Ungerundete (nicht labialisierte) Vokale: [i:], [ɪ], [e:], [ɛ], [ɛ:], [a:], [a], [ɐ]. Gerundete (labialisierte) Vokale: [y:], [y], [ø:], [œ], [u:], [ʊ], [o:], [ɔ]. 2) Vokalquantität Kurzvokale: [ɪ], [ɛ], [œ], [a], [ʊ], [ɔ] Langvokale: [i:], [e:], [ɛ:], [y:], [ø:], [a:], [u:], [o:] 3) Schwachtonige (reduzierte) Vokale Vokale /„Murmellaute“: e-Schwa [ə] z.B. Sonne ['zɔnə], Beratung [bə'ra:tʊŋ]. Der so genannte a-Schwa [ɐ] ist ein schwachtoniger a-ähnlicher Laut; die Vokalisierung des /r/ im Silbenauslaut, z.B. Bier ['bi:ɐ], vergeben [fɛv'ge:bən].</p>	<p>lëvizja vertikale/radhë: (zanore e radhës së përparme (e, i, y), përzier/mesme/qendror e (ë), prapme (a, o, u),</p>
---	---

5. Bibliografia (Përzgjedhje)

5.1 Doracakë, enciklopedi, fjalorë, leksikonë

AA.VV. (1975). *Fjalor i termave të gjuhësisë*. Tiranë.

Althaus, Hans Peter [Hrsg.] (1980). *Lexikon der germanistischen Linguistik - 2.*, vollst. neu bearb. u. erw. Aufl., Gesamtausg. Tübingen: Niemeyer.

Barkowski, Hans/Krumm, Hans-Jürgen (Hrsg.) (2010). *Fachlexikon Deutsch als Fremd-und Zweitsprache*. Tübingen: A. Francke Verlag.

Bausch, Karl Rihard/Christ, Herbert/Krumm, Hans-Jürgen (Hrsg.). (1995). *Handbuch Fremdsprachenunterricht*. 3. Aufl. Tübingen: A. Francke Verlag.

Belluscio, Giovanni/Rrokaj, Shezai (2011). *Fjalor krahasues i termave të gjuhësisë*. Tiranë: Arbëria.

Bußmann, Hadumod (2002). *Lexikon der Sprachwissenschaft*. Stuttgart: Kröner.

Carr, Philip (2008). *A Glossary of Phonology*. Edinburgh: University Press.

https://hslcorner.wordpress.com/wp-content/uploads/2019/09/philip_carr_a_glossary_of_phonology.pdf

Conrad, Rudi (Hg.) (1988). *Lexikon sprachwissenschaftlicher Termini*. 2., unveränd. Aufl. Leipzig: Bibliographisches Institut.

Crystal, David (1995). *Die Cambridge Enzyklopädie der Sprache*. Frankfurt/Main; New York: Campus Verlag.

- Crystal, David (2008). *A Dictionary of Linguistics and Phonetics*. (3rd ed.). Oxford: Blackwell. <https://hslcorner.wordpress.com/wp-content/uploads/2019/09/david-crystal-a-dictionary-of-linguistics-and-phonetics-1.pdf>
- Crystal, David (2019). *The Cambridge Encyclopedia of the English Language*. Cambridge University Press.
- Dykro, Osvald; Todorov, Cvetan (1984). *Fjalor enciklopedik I shkencave të ligjërimet*. Prishtinë: Rilindja.
- Eisenberg, Peter (2009). *Xenophonie und Xenophobie: Über die Aussprache von fremden Wörtern im Deutschen*. Nö: https://www.uni-potsdam.de/fileadmin/projects/peter-eisenberg-schriften/PDFs/Eisenberg_2009_Xenophonie-und-Xenophobie.-%C3%9Cber-die-Aussprache-von-fremden-W%C3%B6rtern-im-Deutschen.pdf
- Europarat (2001). *Gemeinsamer europäischer Referenzrahmen für Sprachen: lernen, lehren, beurteilen*. Berlin ect.: Langenscheidt.
- Glück, Helmut [Hrsg.] (2005). *Metzler-Lexikon Sprache*. Stuttgart [u.a.]: Metzler.
- Grup autorësh (1975). *Fjalor i termave të gjuhësisë. Shqip-rusisht-frëngjisht-anglisht-gjermanisht-italisht*. Terminologjia tekniko-shkencore 17. Tiranë: ASH.
- Homberger, Dietrich (2000). *Sachwörterbuch zur Sprachwissenschaft*. Stuttgart: Reclam.
- Dudenredaktion. (1998). *Schülerduden, Grammatik: eine Sprachlehre mit Übungen und Lösungen*. Dudenverlag. [https://content.fimsschools.com/web.fimsschool/\(Duden\)%20Sch%C3%BClerduden,%20Grammatik,%20neue%20Rechtschreibung.pdf](https://content.fimsschools.com/web.fimsschool/(Duden)%20Sch%C3%BClerduden,%20Grammatik,%20neue%20Rechtschreibung.pdf)
- Dudenredaktion. (2005). *Aussprachewörterbuch*. 6., überarbeitete und aktualisierte Auflage, Bd. 6. Dudenverlag.
- Dudenredaktion. (2016). *Duden – Die Grammatik*. 9., vollständig überarbeitete und aktualisierte Auflage. Bd. 4. Dudenverlag. https://www.ciando.com/img/books/extract/3411911778_lp.pdf
- Handbook of the International Phonetics Association. A guide to the use of the International Phonetic Alphabet*. Cambridge University Press, 1999. https://ia801006.us.archive.org/6/items/intonation-practice/Handbook_of_the_IPA.pdf
- Knapp, Karlfried et. al. (2004). *Angewandte Linguistik. Ein Lehrbuch*. Tübingen: A. Francke Verlag.
- König, Werner (1994). *dtv-Atlas zur deutschen Sprache. Tafeln und Texte*. München: dtv.
- Krumm, Hans-Jürgen / Fandrych, Christian / Hufeisen, Britta / Riemer, Claudia (Hg.) (2010): *Deutsch als Fremd- und Zweitsprache. Ein internationales Handbuch*. 2 Bände. Walter de Gruyter Berlin ect. (Handbücher zur Sprach- und Kommunikationswissenschaft 35).
- Lewandowski, Theodor (1979/80): *Linguistisches Wörterbuch*. Bd. 1-3, ver. u. erw. Aufl. Heidelberg. (Uni-Taschenbücher 200, 201, 300).
- Muhr, Rudolf (2007): *Österreichisches Aussprachewörterbuch, österreichische Aussprachedatenbank*. Frankfurt am Main: Peter Lang Verlag.

Rugova, Bardh (2019). *Leksikon i termave të fonetikës dhe fonologjisë*. Prishtinë: ASHAK.

Roach, Peter (2009). *English Phonetics and Phonology. Glossary*. (A LITTLE ENCYCLOPAEDIA OF PHONETICS). Cambridge: University Press.

Trask R. L. (1996). *A Dictionary of Phonetics and Phonology*. London & New York: Routledge. <https://fonetica23.wordpress.com/wp-content/uploads/2017/09/a-dictionary-of-phonetics-and-phonology-trask-19961.pdf>

5.2 Didaktika e mësimet të gjuhëve të huaja dhe e gjermanishtes si gjuhë e huaj

Council of Europe (2001). *Common European Framework of Reference for Languages: Learning, Teaching, Assessment*. Cambridge: Cambridge University Press.

Europarat (2001). *Gemeinsamer europäischer Referenzrahmen für Sprachen: lernen, lehren, beurteilen*. Munich: Langenscheidt (Council of Europe. Council for Cultural Co-operation).

Hufeisen, Britta & Lindemann, B. (eds.) (1998). *Tertiärsprachen. Theorien. Modelle. Methoden*. Tübingen: Stauffenburg.

Hufeisen, Britta (2001). *Deutsch als Tertiärsprache*. - Helbig, G., Götze, L.,

Hufeisen, Britta/Neuner, Gerhard (2004). *The plurilingualism project*. Council of Europe.

<https://www.ecml.at/Portals/1/documents/ECML-resources/TER-EN.pdf?ver=yltuOaq-pQ22mx6GThtTvw%3D%3D>

Hufeisen, Britta / Marx, Nicole (2014). *Mehrsprachigkeitsdidaktik: Konzepte, Analysen, Lehrerfahrungen*. Tübingen: Narr Francke Attempto.

Meissner, F.-J. & Reinfried, M. (eds.) (1998). *Mehrsprachigkeitsdidaktik, Konzepte, Analysen, Lehrerfahrungen mit romanischen Fremdsprachen*. Tübingen: Narr.

Wolf-Farré, Patrick /Cantone-Altintas, Katja /Moraitis, Anastasia /Reimann, Daniel (2021). *Sprachkontrast und Mehrsprachigkeit: Linguistische Grundlagen, didaktische Implikationen und Desiderata*. Tübingen: Narr Francke Attempto.

5.3 Hyrje në gjuhësi

Bloomfield, Leonard (2001). *Die Sprache*. Übers., kommentiert und hrsg. von Peter Ernst und Hans Christian Luschützky. Wien: Ed. Praesens. Das Original "Language". New York 1933.

<https://philpapers.org/archive/BLLOAO.pdf>

Jashari, Ali/Kryeziu, Bahtijar (2010). *Gjuhë amtare. Njohuri për gjuhën, fonetikë, morfologji, sintaksë*. Prishtinë: UP.

Hajdari, Ahmet (1988). *Doracak i gjuhësisë*. Shkup.

Memushaj, Rami (2002). *Hyrje në gjuhësi*. Tiranë: DITURIA.

Reich, Ingo-Speyer, Augustin (2020). *Deutsche Sprachwissenschaft. Eine Einführung*. Stuttgart: Reclam.

Reiner, Arntz/Picht, Heribert/Mayer, Felix (2009). *Einführung in die Terminologiearbeit*. Hildesheim: Olms.

Vater, Heinz (2002). *Einführung in die Sprachwissenschaft*. München: W. Fink

5.4 Tekste paralele të fonetikës dhe fonologjisë (në shqip dhe anglisht)

Beci, Bahri (2004). *Fonetika*. Prishtinë: Libri shkollor.

Demiraj, Shaban (1996). *Fonologjia historike e gjuhës shqipe*. Tiranë.

Dodi, Anastas (2004). *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe*. Tiranë: ASHSH.

Gjata, Elona (2023). *Zanorja Ë në gjuhën shqipe*. Prishtinë: Instituti Albanologjik.

Hamiti, Asllan (2020). *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës standarde shqipe*. Shkup.

<https://repository.ukim.mk/bitstream/20.500.12188/28908/1/Asllan%20Hamiti%20e%20Fonetika%20dhe%20fonologjia%20e%20gjuhes%20standarde%20shqipe.pdf>

Ladefoged, Peter/Johnson, Keith (2011). *A Course in Phonetics* (6th ed.). Wadsworth, Cengage Learning.

<https://theswissbay.ch/pdf/Books/Linguistics/A%20Course%20in%20Phonetics%206th%20Edition%20-%20Peter%20Ladefoged%20Keith%20Johnson.pdf>

Memushaj, Rahmi (2012). *Morfonologji e epimit të gjuhës së sotme shqipe*. Tiranë: Infobotues.

Memushaj, Rami (2009). *Fonetika e shqipes standarde*. Tiranë: Toena.

Nesimi, Remzi (1997). *Gramatika e gjuhës shqipe për shkollat e mesme (fonetika, leksikologjia dhe morfologjia) I*. Shkup.

Roach, Peter (2009). *English Phonetics and Phonology. A practical course*. Cambridge: University Press.

https://humanitarianeducationcollege.uoanbar.edu.iq/catalog/English%20Phonetics%20and%20Phonology_Peter%20Roach.pdf

Sawicka, Irena/Dargiel, Karolina (2018). *Struktura e rrokjes shqipe*. Prishtinë: ASHAK.

Sulejmani, Fadil (1995). *Fonetika e gjuhës shqipe/Phonetik der deutschen Sprache*. Tetovë.

Topalli, Kolec (1995). *Theksi në gjuhën shqipe*. Tiranë.

Topalli, Kolec (2001). *Sonantet në gjuhën shqipe*. Tiranë.

Topalli, Kolec (2003). *Fërkimoret e afrikatet e gjuhës shqipe*. Tiranë.

Topalli, Kolec (2007). *Fonetika historike e gjuhës shqipe*, Tiranë: Dituria.

Trubetzkoy, N. S. (1971). *PRINCIPLES OF PHONOLOGY*. Translated by Christiane A. M. Baltaxe. California.

https://monoskop.org/images/7/73/Trubetzkoy_NS_Principles_of_Phonology.pdf

Trubeckoi, Nikollaj S. (1985). *Parimet e fonologjisë*. Nga frëngjishtja përktheu dhe përgatiti Dr. Murat Bejta. Prishtinë: RILINDJA.

Xhaferi, Hajredin (2008). *Leksione dhe ushtrime për fonetikën*. Elbasan.

5.5 Monografi dhe artikuj mbi fonetikën dhe fonologjinë (në gjermanisht)

Alosevičienė Eglė (2009). *Grundlagen der Phonetik und Phonologie*. Kaunas.

- https://www.knf.vu.lt/dokumentai/failai/katedru/germanu/ALOSEVICIENE_METODINE.pdf
- Becker, Thomas (1998). *Das Vokalsystem der deutschen Standardsprache*. Frankfurt/Main: Peter Lang.
- Becker, Thomas (2012). *Einführung in die Phonetik und Phonologie des Deutschen*. Darmstadt: WBG.
- Berndt, Tobias (2018). *Phonetik und Phonologie des Deutschen*. Berlin: De Gruyter.
- Betzel, Dirk/Droll, Hansjörg (2020). *Orthographie. Schriftstruktur und Rechtsdidaktik*. Paderborn: UTB.
- Dahmen, Silvia/Weth, Constanze (2018). *Phonetik, Phonologie und Schrift*. Paderborn: UTB.
- Dieling, Helga/ Hirschfeld, Ursula (2000). *Phonetik lehren und lernen*. Fernstudieneinheit 21. München: Goethe-Institut.
- Eisenberg, Peter (1988). *Die Grapheme des Deutschen und ihre Beziehung zu den Phonemen*.
https://uol.de/f/3/inst/germanistik/fach/sprachwissenschaft/Aufsaeetze_Eisenberg/Eisenberg_1988_Die_Grapheme-des-Deutschen-und-ihre-Beziehung-zu-den-Phonemen.pdf
- Fuhrhop, Nanna (2006). *Orthografie*. Heidelberg: Winter.
- Grassegger, Hans (2010). *Phonetik / Phonologie*. Idstein
- Hall, T. A. (2000). *Phonologie: Eine Einführung*. Mouton de Gruyter.
- Hirschfeld, Ursula (2001). *Vermittlung der Phonetik*: In: Helbig, G. / Götze, L. / Henrici, G. / Krumm, H-J. (Hg.): *Deutsch als Fremdsprache. Ein internationales Handbuch*. De Gruyter Berlin u. New York, 872-879.
- Hirschfeld, Ursula/Reinke, Kerstin (Hg.) (2007). *Phonetik in Deutsch als Fremdsprache: Theorie und Praxis*. Themenheft der Zeitschrift für Interkulturellen Fremdsprachenunterricht 12:2, 2007.
<https://zif.tu-journals.ulb.tu-darmstadt.de/article/id/2557/>
- Hirschfeld, Ursula/Reinke, Kerstin/Stock, Eberhard (Hrsg.) (2007). *Phonothek intensiv. Aussprachetraining*. Langenscheidt Verlag Berlin und München.
- Hirschfeld, Ursula/Reinke, Kerstin (2012). *Phonetik im Fremdsprachenunterricht Deutsch*. Schubert Verlag.
- Hirschfeld, Ursula/Reinke, Kerstin (2018). *Phonetik im Fach Deutsch als Fremd- und Zweitsprache: Unter Berücksichtigung des Verhältnisses von Orthografie und Phonetik*. Erich Schmidt Verlag.
- Jespersen, Jens Otto (1904). *Lehrbuch der Phonetik: Autorisierte Übersetzung von Hermann Davidsen* (H. Davidsen, Übers.). Leipzig & Berlin: B. G. Teubner.
<https://dn790000.ca.archive.org/0/items/lehrbuchderphone00jespuoft/lehrbuchderphone00jespuoft.pdf>
- Kleber, Felicitas (2023). *Phonetik und Phonologie. Ein Lehr- und Arbeitsbuch*. Tübingen: Narr.
- Kohler, Klaus J. (1995). *Einführung in die Phonetik des Deutschen*. Erich Schmidt Verlag.
- Noack, Christina (2010). *Phonologie*. Heidelberg: WINTER.

- Petursson, Magnus/Neppert, Joachim M. N. (2002). *Elementarbuch der Phonetik*. Hamburg: Buske.
- Pompino-Marschall, Bernd (2019). *Einführung in die Phonetik*. Berlin: De Gruyter.
- Rues, Beate/Redecker, Beate/Koch, Evelyn/Wallraff, Uta/Simpson, Adrian P. (2009). *Phonetische Transkription des Deutschen. Ein Arbeitsbuch*. Tübingen: Narr.
- Staffeldt, Sven (2010). *Einführung in die Phonetik, Phonologie und Graphematik des Deutschen. Ein Leitfaden für den akademischen Unterricht*. Tübingen: Narr.
- Trubetzkoy, N. S. (1939). *Grundzüge der Phonologie*. Prague.
https://monoskop.org/images/4/4c/Trubetzkoy_NS_Grundzuege_der_Phonologie.pdf
- Wiese, Richard (2011). *Phonetik und Phonologie*. Paderborn: Wilhelm Fink Verlag. <https://www.utb.de/doi/epdf/10.36198/9783838533544>

5.6 Lehrbuecher / Libra mësimi të gjuhës gjermane

PANORAMA A1-B2. Cornelsen Verlag.

5.7 Burime nga interneti

- Prof. Dr. phil. habil. Dr. h.c. Ursula Hirschfeld, https://www.sprechwiss.uni-halle.de/kontaktinformationen/mitarbeiterinnen/ursula_hirschfeld/
- Homepage - Prof. Dr. Kerstin Reinke <https://www.reinke-eb.de/kerstin/forschung/index.html>
- “Pikat e forta të didaktikës dhe metodikës aktuale në vendet e emigracionit III: Përkrahja e gjerë gjuhësore”
https://myheritagelanguage.com/pdf/sq/MB/Manual_FB_EN_P02_CH08_8A.pdf
- International Phonetic Association,
<https://www.internationalphoneticassociation.org/>
- IPA Chart, <https://thesoundofenglish.org/ipa/>
- Die IPA-Lautschrift, https://www.coli.uni-saarland.de/elaut/Languages_Sites/sampaDeutsch.htm
- Ausspracheschlüssel Deutsch
<http://www.fb10.uni-bremen.de/homepages/hackmack/phonmorph/ausspracheschl%C3%BCssel>
- Translate to IPA, <https://unalengua.com/ipa-translate?ttsLocale=en-GB-WLS&voiceId=Geraint>
- Deutsche Aussprache - Lautschrift-Übersetzer
<https://easypronunciation.com/de/german-phonetic-transcription-converter>
- Albanian (shqip / gjuha shqipe)
<https://www.omniglot.com/writing/albanian.htm>
- Qasshmëria e të gjitha burimeve elektronike është verifikuar para dorëzimit të punimit për botim.

ISSN 2671-3004

UDC 811.18'28(049.3)
UDC 811.18'373.2(049.3)

Punim studimor

Faton KRASNIQI
Instituti Albanologjik - Prishtinë
ffaton.krasniqi@hotmail.com

**KONTRIBUTI I DR. MEHMET AHMETAJT PËR DIALEKTOLOGJINË
SHQIPTARE**

**CONTRIBUTION OF DR. MEHMET AHMETAJ ON ALBANIAN
DIALECTOLOGY**

Përmbajtje

Profesor Mehmet Ahmetaj shquhet kryesisht për studimet e dialektologjisë shqiptare dhe gjithashtu ka një bibliografi të pasur me disa monografi, shkrime, përmbledhje, kumtesa, punime shkencore. Gjuha e veprave të tij shquhet për qartësinë, profesionalizmin dhe informacionin e saktë shkencor. Ai ia kushtoi një jetë të tërë gjuhësisë shqiptare dhe me një elan të pashoq arriti që të grumbulloj shumë fjalë e shprehje të rralla kryesisht nga të folmet shqiptare në Mal të Zi. Veprat e tij janë një thesar i çmuar i kulturës dhe i gjuhësisë shqiptare. Teksti shkencor dallon nga tekstet tjera dhe lirisht mund të themi se tekstet e autorit janë tekste tipike shkencore të gjuhësisë sonë moderne. Begatia e tij janë prurjet dhe studimet në fushë të dialektologjisë si një nga fushat më të rëndësishme të gjuhësisë. Idetë dhe studimet e tij janë vlera jo vetëm të albanologjisë, por të mbarë kulturës shqiptare, sepse ato pasqyrojnë më së mirë metodologjinë e një linguisti të përkushtuar, profesional dhe të përgatitur për të arritur rezultate në fushën e tij studimore.

Abstract

Professor Mehmet Ahmetaj is mainly known for his studies of Albanian dialectology and also has a rich bibliography with several monographs, writings, summaries, papers, scientific papers. The language of his works is distinguished for its clarity, professionalism and accurate scientific information. He devoted a whole life to the Albanian language and with an

unparalleled enthusiasm managed to collect many rare words and expressions mainly from the Albanian dialects in Montenegro. His works are a precious treasure of Albanian culture and linguistics. The scientific text differs from other texts and we can freely say that the author's texts are typical scientific texts of our modern linguistics. Its prosperity is the contributions and studies in the field of dialectology as one of the most important fields of linguistics. His ideas and studies are values not only of albanology, but of the entire Albanian culture, because they best reflect the methodology of a dedicated, professional linguist and prepared to achieve results in his field of study

Hyrje

Prof. dr. Mehmet Ahmetaj lindi në Vuthaj të Plavës dhe të Gucisë më 1946. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, kurse të mesmen në Pejë. Fakultetin Filozofik, Degën e Gjuhës dhe të Letërsisë Shqipe, e mbaroi në Prishtinë më 1974. Gjithashtu në Universitetin e Prishtinës u magjistrua më 1986 dhe u doktorua më 2000 në shkencat filologjike (në fushën e dialektologjisë shqiptare). Ka punuar këshilltar shkencor në Institutin Albanologjik të Prishtinës. Ai që në krye të herës punoi në arsimin e mesëm si profesor i gjuhës shqipe, në Podujevë, në Prizren dhe Lipjan si dhe referent profesional në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës. Deri më sot ka botuar këto vepra: *Studime gjuhësore II* (Dialektologji) bashkautor (1999). *Fjalor i të folmeve shqiptare në Mal të Zi* (1996). *E folmja e Plavës dhe e Gucisë* (2002). *E folmja e Anës së Malit* (2006). *Gjurmime onomastike* (2009). *Fjalor onomastik i territoreve shqiptare në Mal të Zi* (2017). Gjithashtu profesor Mehmet Ahmetaj ka botuar edhe një varg punimesh shkencore, kumtesa, recensione kronikash që i ka botuar në revista shkencore dhe në periodikun shkencor dhe në shtypin ditor. Nga ana tjetër, ka marrë pjesë në shumë tubime, konferenca, sesione simpoziume shkencore, në Prishtinë, në Tiranë në Shkup dhe në Ulqin. Disa nga punimet shkencore të prof. Dr. Mehmet Ahmetajt të publikuara në revista dhe simpoziume shkencore, si: Simpoziumi shkencor i mbajtur në Prishtinë, më 15-16 dhe 17 dhjetor 1980. Probleme aktuale të kulturës së gjuhë shqipe, Instituti Albanologjik i Prishtinës. Revista "Jehona", Shkup, 1988, Revistë për art, letërsi, shkencë dhe kulturë, Gjuha jonë, studime historike, lembe, koha. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Konferenca Shkencore "Gjuha letrare kombëtare dhe bota shqiptare sot", Tiranë, 20-21 nëntor 2002. Instituti Albanologjik i Prishtinës, Simpoziumi Shkencor "50 Vjet Studime Albanologjike", mbajtur më 18-19 dhjetor 2003. Revista "Dija", Ulqin, 7/2009, revistë për shkencë, kulturë, art.

Vepra e parë e profesor Mehmet Ahmetajt: *Fjalor i të folmeve shqiptare në Mal të Zi*³⁵, mbërthen në vete një gamë të gjerë të materialit lëndor e

³⁵ Mehmet Ahmetaj, *Fjalor i të folmeve shqiptare në Mal të Zi*, IAP, Prishtinë, 1996. Pr atrt

shpirtëror, të vjelë skaj më skaj të krahinave shqiptare gjithandej. Duke pasur si pikëqendresë kryekëput arealin traullsor etnik të ligjërimeve shqiptare të Ulqinit, të Anës së Malit, të Shtojit, të Bregut të Bunës, të Tivarit të Shestanit, të Krajës, të Tuzit, të Hotit (Traboinit të Moçëm), të Grudës, të Trijepshit, të Kojës. Të Plavës e Gucisë dhe të Rozhajës. Në këtë vepër të rëndësishme profesor Mehmet Ahmetaj është marrë me një numër të theksuar të grupeve të fjalëve, si me: frazeologizamsh, togfjalëshash frazeologjikë, sinonimesh, antonimesh, onomatopesh, metaforash, antrotoponimesh, patronimesh, toponimesh, eufemizmesh, paganizmesh dhe një radhë fjalësh e shprehjesh nga leksiku i pasivizuar, deri tash fare pakëz i hetuar dhe i studiuar nga gjuhëtarët tanë. Në këtë *Fjalor* dialektor, kanë gjetur vend të thekshëm, edhe një grup i të tërë njësisish leksikore, toponimike, togfjalëshash e shprehjesh të bukura popullore, nga fusha e mitologjisë shqiptare, që veçohen në këtë drejtim, nga krahinat shqiptare, si gurrë e pashtershme riprodhimesh gjuhësore të pasura dhe autoktone, si p.sh.: *ora e ligë, ora e keqe, ora e mirë, ora e zezë, ora e bardhë, ora a malit*³⁶ e shumë e shumë të tjera. Hartimi i këtij *Fjalori* dialektor ka ardhur si rezultat i një pune të palodhshme kërkimore, shkencore dhe hulumtuese për disa vite me radhë. Sipas profesor Mehmet Ahmetajt ky *Fjalor* ka rreth 6000 njësi të mirëfillta leksikore, frazeologjike, toponimike, antroponimike, etnografike, etj., e që është një pasqyrim i mirëfilltë i të folmeve shqiptare në Mal të Zi. Më të drejt profesor Mehmet Halimi në pasthënie të këtij *Fjalori* thekson se: "*Puna në hartimin e fjalorit nuk është as e lehtë, as e thjeshtë. Fjalori kërkon vullnet, mund e punë të madhe dhe kohë të vazhdueshme. I vetëdijshëm për këtë, punonjësi shkencore profesor Mehmet Ahmetaj, duke udhëtuar fshat më fshat, lagje më lagje e shtëpi më shtëpi në dyzet vendbanime shqiptare, voli nokël më nokël fjalë e shprehje të rralla nga shqipfolësit e këtij krahu, fjalë e shprehje këto, që përfaqësojnë margaritarë të leksikut të shqipes. Ai punoi më se dhjetë vjet pa u lodhur, por leksikografisë e dialektologjisë shqiptare i ofroi një vepër të rrallë e me vlera të shumëfishta shkencore".*

Në këtë fjalor gjejmë shumë fjalë e shprehje të rralla që ndoshta nuk mund t'i gjejmë në të folmet tjera, si:

Áme, *f. zool. (Ul)*. Peshk i madh deti, formën e ka shputake, ngjyrën si të përgjakur.

Ánepán, *ndajf. (Pl. – Gu)*. Tejpërtej, anembanë.

Atâne, *përem. (Lj)*. Për ata.

Bakarrot, *ndajf. (Am)*. Mundje e kundërshtarit me një lojë me një epërsi të lartë, bindshëm.

Ballhút/ë, *(Pl.- Gu)*. Pushkë e moçme, e cila dikur moti mbushej për grykë.

Bishtáj, - *m. (Am)*. Që ka bisht të bardhë.

Bzhís, *fol. (Dl)*. Tiganis, fërgoj vezë. Bzhís vé.

Caklan! *(Pasth.) (Am)*. Nuk jam në lojë.

Calín/ë, Lloj pushke e moçme dhe e gjatë.

Cáp/ë, *A f. Kazmë*, vegël bujqësore për rrëmihje të thellë.

³⁶ Po aty, f. 10.

Crjepúj/ë, (Pl. – Gu.). Në mënyrë pezhorative, për një vajzë a grua servile, sahanlëpirëse.

Çargzîn/ë, (She.). Lloj pushke e vjetër.

Çfillim, Fishkëllimë. (Plavë – Guci).

Çilmyll, m. (AM.). Errësirë e plotë, terr i madh, ku nuk shihet asgjë.

Çysa, përem. (Ft.). Për disa çysa. Çysa kur e prekën me duor po z'di gjâ aj.

Derdimen, Trimëri, familje, trimash.

Dhéc/e, (Pl. – Gu.). Një lloje pushke e vjetër me dhjetë fishekë.

Egërshtëtjet, (v.sh.). Përgjithësisht kafshët e egra. Emër kolektiv për egërsirat.

Fênafú, ndajf. (Vth.). Fëmijë që është frikacak i madh.

Gucás, fol. (Pl. – Gu.). Nguc dikë.

Gjidilér/e, Vajzë e dalluar si valltare lozonjare.

Halí, (Am.). Tokë e askujt.

Inajet, mb. (Am.). që mban inat, që zemërohet shpejt, që humb durimin.

Jel/i, m. mjek. (Am.). Sëmundje që zakonisht paraqitet te më të moshuarit me dhimbje të ashtit.

Kalival, ndajf. (Ul.). Rrotull.

Láp, mb. (Pl. – Gu.) Njeri vetjak dhe i zhdërvjellët.

Llúçkë/, (Pl.- Gu.). Grua a vjazë shumë e trashë.

Mríje, ndajf. (Pl. – Gu.)Mënyrë shikimi përvjedhtas, për nën sy, apo me bisht të syrit.

Najnik, (M.M.). Erë e lehtë nga juglindja.

Njâra, përem. Për njëra.

Oraník/u, - (Pl. – Gu.). Burrë me orë, i vendit e i kuvendit.

Palúk, (Am.). Palë e sanës.

Qyqúj/ë, (Pl. – Gu.). Grua a vajzë e ngathme e lënë.

Rub/i, (Pl. – Gu.). Plaçkë e vjetër nga pëlhura.

Rroshi/i, m. (Pl. – Gu.). Gur në madhësi të grushtit.

Stoxher/i, m. (Nm.). Për mullar sane.

Shamát/ë. (Mi.). Zhurmë, përleshje e madhe.

Telef, ndajf. (Pl. – Gu.). Asht e lëkurë.

Thngill/i, (Lj.). Thëngjill.

Udokt, (i,e). I shëmtuar.

Vakth/i, (Stj.). Koha. Vakthi i Turkís.

Xunkth/i, m. (Ul.). Bot.. Një lloj druri.

Xhák/u, m. (Pl. – Gu.). Një lloj thesi i madh.

Yst, ndajf. (Am.). Mënyrë e lëvrimin me kafshë apo me traktor.

Zabún, ndajf. Shpirtërisht i mërztitur, i pikëlluar.

Zhargit, fol. Djegur, përcëlluar.

Profesor Mehmet Ahmetaj në vitin 2002 e botoi në Prishtinë monografinë e tij: "*E folmja e Plavës dhe e Gucisë*"³⁷. Sipas autori për të folmen e kësaj tërthore shqiptare, nuk është bërë asnjë studim deri më sot. Kjo e folme për herë të parë u bë objekt shqyrtimi e studimi monografik, ku është bërë përshkrimi sinkronik i saj, e rrallëherë diakronik, duke e parë si

³⁷ Dr. Mehmet Ahmetaj, *E folmja e Plavës dhe e Gucisë*, IAP, Prishtinë, 2002.

strukturë unike në fushën fonetike, morfologjike, sintaktike, leksikore, e aty – këtu edhe toponimike, antroponimike dhe patronimike. Ky studim serioz e shumë profesional i dialektologut Mehmet Ahmetaj ka vë në spikamë në mënyrë të thelluar gjendjen e së folmes së Plavës e Gucisë, përkatësisht tërë strukturën e brendshme të saj. Materialin për këtë monografi autori e ka mbledhur kryesisht nga pleqtë dhe plakat e Plavë Gucisë. Nga studimi dhe shqyrtimi i kësaj monografie mund të theksojmë se në këtë të folme janë ruajtur një varg veçorish specifike, fenomenesh të ndryshme gjuhësore që dalin në të, si ruajtja sot e kësaj dite e një mori trajtash arkaike të periudhës hershme të shqipes, të cilat janë në interes të dialektologjisë, fonetikës, fonologjisë dhe të leksikologjisë shqiptare. Kjo monografi përbëhet prej katër krerësh: Kreu I, *Veçoritë fonetike*; II, *Veçoritë morfologjike*; III, *Sintaksa*, IV, *Leksiku*. Kjo monografi përpos që përmban shumë të dhëna të rëndësishme për gjuhësinë shqiptare jepen edhe disa të dhëna me interes edhe për demografinë e Plavës dhe Gucisë, pra kemi të bëjmë me të dhëna të sakta të numrit të përgjithshëm të banorëve të asaj ane të cilat autori i paraqet statistikisht dhe gjithnjë sipas kërkimeve të mirëfillta shkencore duke e paraqitur demografinë e territorit të Plavës, si pjesë e Sanxhakut të Shkodrës.

Në vitin 2006 profesor Mehmet Ahmetaj e botoi në Prishtinë monografinë e tij të tretë: "*E folmja e Anës së Malit*"³⁸. Kjo e folme në aspektin dialektor, gjeografik, historik, shkon me grupin e madh të të folmeve truallsore veriperëndimore të shqipes. Me këtë monografi gjuhësia shqiptare e në veçanti dialektologjia është pasuruar me një thesar të çmuar, ku paraqiten vlerat fonetike, morfologjike, sintaksore, leksikore, fjalëformuese, frazeologjike, toponimike të kësaj të folme të rëndësishme shqiptare. Më këto monografi është bërë studimi, sistemimi, mbledhja e leksikut, mbledhja e materialeve dialektore, fonetike e frazeologjike të asaj ane duke e përmbyllur me sukses studimin e nisur që në rininë e tij. Duke e pasur parasysh terrenin e vështirë të asaj ane mbledhja e materialeve nuk ka qenë aspak e lehtë, sepse një gjë e tillë kërkon dije, mund, angazhim, përkushtim, vullnet, sakrificë dhe dashuri për profesionin e shenjtë, por profesor Mehmet Ahmetaj këtë punë me karakter shkencor, kulturor e kombëtar e ka filluar dhe mbaruar me shumë përkushtim dhe me rezultate të kënaqshme shkencore. Një punë e mirë për këtë monografi është se janë skicuar në harta të gjitha fshatrat dhe qytetet ku janë bërë studimet dialektologjike dhe kjo është një dëshmi tepër me rëndësi për dialektologjinë shqiptare, sepse gjithçka është evidentuar, skicuar, vlerësuar e studiuar në hollësi. Kjo punë dhe ky dokumentim shkencor do të jetë përgjithmonë i arkivuar në bibliotekat e institucioneve tona shkencore si një dëshmi e një pune me karakter shkencor e që është realizuar në një nga territoret shqiptare në Mal të Zi. Për këtë monografi do të veçoja edhe materialet, tekstet dialektore që profesor Mehmet Ahmetaj i ka mbledhur në atë anë. Gjithnjë sipas autorit për subjekt vështrimi i ka marrë pleqtë dhe plakat, e sidomos femrat e

³⁸ Dr. Mehmet Ahmetaj, *E folmja e Anës së Malit*, IAP, Prishtinë, 2006.

lindura dhe të martuara përbrenda trevës, përkatësisht bajrakut të Anës së Malit, sepse, sipas tij, ato ishin më konservative se burrat, meqë nuk kanë lëvizur jashtë krahinës së atjeshme dhe e kanë ruajtur me besnikëri gjendjen e moçme të gjuhës së gjallë e të folur, me të gjitha tiparet, specifikat e veçantitë të saj të gurrave dialektore autoktone. Me studime të tilla lexuesit dhe studiuesit e gjuhësisë njohin zhvillimin e të folmeve tona në periudha të ndryshme kohore, ku mund të vërehen dallimet, afritë që kanë dialektet e nëndialektet e gjuhës shqipe.

Autori gjatë punës kërkimore ka mbledhur një numër të madh njësish frazeologjike, por unë do t'i veçoja disa prej tyre, si:

As në punë, as në Bunë – askund.

E ka vjerr punën n'tra – thuhet për dikë që nuk punon.

Ka shku: me ba veksha ka her – ka vdekur prej shumë kohësh.

Mas i ba via qullit – i thuhet zakonisht një njeriu që është buzëhollë, që zgjedh ushqimin.

Me trina në mal – thuhet për një njeri që hyn në rrugë pa krye.

Mih n'det e hith n'Bunë – thuhet për dikë që bën punë në tokë.

Na e lshoj një terthorce – i iki kuvendimit të drejtëpërdrejtë.

Punë për njiqin toskë – shumë punë.

Ta nep venë pa skuq – është i zgjuar, ta kthen përgjigjen me saktësi të shpejt.

Në vitin 2009 profesor Mehmet Ahmetaj e botoi në Prishtinë veprën: "*Gjurmime onomastike*"³⁹. Kjo vepër përmban një seri përmbledhjes onomastike, si: Emrat shqip në traditën kombëtare; Vështrime gjuhësore rreth onomastikës së Anamalit; Mbi procesin e sllavizimit të shqiptarëve në Malin e Zi të sotëm në dritën e të dhënave historike dhe gjuhësore; Kontributi i Çabejt në formimin e toponimeve me prapashtesa diminutive – th dhe – zh; Rreth disa antroponimeve dhe patronimeve të krahinës së Plavës dhe Gucisë; Patronimia shqiptare në Mal të Zi në fund të shekullit XX; Mbi disa çështje të onomastikës shqiptare në Mal të Zi; Gjurmët e toponimeve, antroponimeve dhe patronimeve në këngët e mërgimit; Mbi përcaktimin e drejtë etnoterminologjik të krahinës së Malësisë së Madhe; Si u bë emri syni-savino oko?!; Topiku Shullã: ni i parë në ditën e studimeve dialektologjike; Nga onomastika e Plavës, e Gucisë dhe Rozhajës; Vështrime gjuhësore rreth disa toponimeve të Plavës dhe Gucisë; Alija Džogovič, "Onomastika severoistočnih organaka prokletija", botoi Srpska akademija nauka i umetnosti, Beograd, 1986. Profesor Mehmet Ahmetaj ka qenë aktiv në studimin dhe trajtimin e temave me karakter shkencor, ato i ka shkruar për disa vite me radhë, duke i grumbulluar, arkivuar dhe më pas duke i botuar në revistat dhe shtypin periodik të kohës, si në: revistën "*Gjurmime albanologjike*", në revistën "*Gjuha shqipe*" të Institutit Albanologjik, në gazetat ditore si në: "*Koha*", "*Bota sot*", "*Rilindja*". Në këto trajtesa shkencore autori ka trajtuar një varg problemesh nga onomastika, toponimia, antroponimia, ojkonimia, hidronimia etj., Toponimia e krahinës së Plavës dhe Gucisë gjithmonë kanë zgjuar kureshtjen dhe interesim të veçantë për

³⁹ Dr. Mehmet Ahmetaj, *Gjurmime onomastike*, IAP, Prishtinë, 2009.

gjuhësinë shqiptare, onomastikën shqiptare, për shkencat e albanologjisë dhe këtë detyrë studimore e shkencore arriti ta nisë dhe ta përfundojë me shumë suksese profesor Mehmet Ahmetaj. Në kuadër të toponimisë autori i trajton toponimet: togfjalësha emër +emër (si, p.sh: Gropa e Ujknit, Gropa e Vocit, Gropa e Dolit etj.), togfjalësha emër + mbiemër (si, p.sh: Gropa e Sirme, Gropa e Poshtë) duke mos lënë pa i analizuar dhe trajtuar të gjitha toponimet e tilla në rajonin e Plavës dhe Gucisë. Vlen për t'u theksuar se profesor Mehmet Ahmetaj është një argumentues i zellshëm shkencor, i cili me shumë fakte dhe argumente i demanton të gjitha pretendimet e qëllimshme dhe tendencioze të autorit diletant boshnjak Alija Xhogoviq (Džogovič), i cili në veprën e tij: Alija Xhogoviq (Džogovič), "*Onomastika severoistočnih organaka prokletija*"⁴⁰, (punimi studimor: "Onomastika e Alpeve Shqiptare", ku ndër të tjera ai jep disa konstatime joshkencore dhe të paargumentuara shkencërisht. Dhe gjithnjë sipas profesor Mehmet Ahmetajt, autori Alija Xhogoviq (Džogovič) materialin onomastikë e ka përkthyer dhe përshtatur në gjuhën serbe dhe ai në një pjesë të pseudostudimit të tij shqiptarët në trojet e Sanxhakut i konsideronte si barinj endacakë, të ardhur në këto anë dhe gjithnjë duke e mohuar autoktoninë e tyre pa kurrfarë argumentesh. Por i pari i cili e heton këtë propagandë antishqiptare është profesor Mehmet Ahmetaj, i cili i kundërvihet me gjuhën e fakteve dhe argumenteve shkencore, gjuhësore e historike. Argumentimi i profesor Mehmet Ahmetaj është tepër shkencor, pasi ky mbështetet në një mori emrash vetjakë autoktonë, si: Suka (= Sykë), Gala (= Galë), Ujkan, Ukshin, Ulkija (= Ulkie), Mulka (= Mulkë), Alta (=Altë) etj, si dhe duke u mbështetur patronimet shqipe, si: Kurtbardhaj, Dacaj, Camaj, Kujaj, Gjekaj, Bibaj, Shala etj. Në shkrimet e profesor Mehmet Ahmetaj vërehet shpirti atdhetar i një shkencëtari shqiptar, i cili vuan dhe shqetësohet shpirtërisht për gjendjen e shqiptarëve në Mal të Zi, në shkrimet e tij ai i vë theks të veçantë edhe asimilimit të shqiptarëve dhe këtë problem e trajton në mënyrë shkencore në veprën e tij *Gjurmime onomastike*, Prishtinë, (2009), f. 57. Në punimin e titulluar: "*Mbi procesin e sllavizimit të shqiptarëve në Malin e Zi të sotëm dhe në dritën e të dhënave historike dhe gjuhësore*", profesor Mehmet Ahmetaj në këtë punim na jep të dhëna të rëndësishme për onomastikën e trojeve shqiptare në Mal të Zi, ku një pjesë e onomastikës së atij territori shqiptar iu nënshtrua ndërhyrjeve administrative dhe kalkimit, si: Malësia e Madhe (Brda), Alpet Shqiptare (Prokletije Planina), Arra (Orahovo), Palabardh (Bjellopavliq), dhe një pjesë tjetër u sllavizua në formën, si: Cem – Cijevna, Drekal – Drekalloviq, Bukëmirë – Bukmiroviq, Vogë – Vogliq, Lekaj – Lekiq. Në këtë vepër profesor Mehmet Ahmetaj e trajton edhe problemin e ndryshimit të mbiemrave tipik shqiptar nga malazetët duke iu prapavendosur prapashatesat sllave viq e iq, si p.sh.: Dedushaj – Dedushoviq, Ulaj – Uleviq, Gjonbalaj – Gjonbaliq, Pepaj – Pepiq, Dacaj – Daciq, Palushaj – Palusheviq. Studimi i tij dhe shqetësimi i tij duhet të jetë shqetësim për të gjithë shqiptarët kudo ku janë, kurse shkrimet

⁴⁰ *Botoi Srpska akademija nauka i umetnosti*, Beograd, 1986.

e tij zbardhin një pjesë të dhunës, trysnisë dhe mohimit të etnitetit autokton shqiptar në Mal të Zi.

Vepra e profesor Mehmet Ahmetajt: "*Fjalor onomastik i territoreve shqiptare në Mal të Zi*"⁴¹ është një nga fjalorët më të realizuar në fushë të onomastikës, ky fjalor është me interes të gjuhësisë shqiptare pasi përfshin një territor të gjerë të territoreve etnike shqiptare të Plavës, të Gucisë, të Rozhajës, të Trieshit, të Grudës, të Traboinit, të Kojës, të Fundnave, të Ledinës, të Loparit, të Luharit, të Tuzit, të Krajës e Malësive të saj, të Shestanit, të Anës së Malit, të Ulqinit dhe Tivarit me rrethinë.

Fjalori onomastik është fryt i një pune vetëmohuese shumëvjeçare, të cilën autori e ka realizuar me shumë mund dhe sakrificë profesionale. Materiali i vjelë për këtë fjalor onomastik të territoreve shqiptare në Mal të Zi është një vlerë e veçantë për albanologjinë dhe si i tillë përfshin të gjithë arealin gjeografik të gegërishtes veriperëndimore të territoreve shqiptare në Mal të Zi. Në kë fjalor kanë zënë vend një numër i konsiderueshëm makrotoponimesh, mikrotoponimesh, ojkonimesh, hidronimesh, monumentesh natyrore, qytezash, rrënojash murishtash, ledhesh, kështjellash, tumash, emrash vetjakë, të traditës shqiptare, të lagjeve, barqesh, vëllazërish, fisesh, krahinash, si dhe patronimikash, emrash topikë të qenieve mitike, si dhe një varg gjurmësh dhe monumentesh të kultit të krishterë të rritit roman q ende ruhen atje në trajtë të shtangur të toponomastikës truallsore shqiptare. Nga gjithë kjo gamë e gjerë hulumtimesh, kërkimesh profesor Mehmet Ahmetajt ka arritur t'i grumbullojë dhe t'i sjellë të gjitha rezultatet onomastike në këtë fjalor onomastik që është i veçantë si për nga rëndësia dhe vlera gjuhësore. Territorët shqiptare në Mal të Zi i përkasin arealit gjeografik të gegërishtes veriperëndimore dhe ky fjalor onomastik është një mundësi e mirë që fjalësi i asaj ane, onomastika e saj të njihen dhe të studiohen nga disa këndvështrime, si: onomastike, dialektore, fonetike, fonologjike, leksikore, semantike, stilistike, fjalëformuese, etj. Duke e analizuar me kujdes fjalorin onomastik të territoreve shqiptare në Mal të Zi pashmangshëm vërehet brenga e profesor Mehmet Ahmetaj për trysninë që është bërë dhe po bëhet në ato territore për të tjetërsuar etninë shqiptare, gjuhën, toponiminë dhe të kaluarën e lavdishme iliro - arbërore - shqiptare.

Përfundim

Veprimtaria shkencore e profesor Mehmet Ahmetajt është fryt i një pune shkencore dhe të begatë dhe gjithnjë duke iu përmbajtur metodologjisë së mirëfilltë shkencore e studimore në fushë të albanologjisë. Krijimtaria e tij shkencore është e bazuar në shumë fakte, argumente, kërkime, e studime të mirëfillta. Veprat e tij, punimet e tij i kanë përmbushur kriteret e studimeve me rëndësi për gjuhësinë shqiptare e në veçanti për dialektologjinë dhe onomastikën si një nga dy fushat më të rëndësishme të gjuhësisë. Veprat e tij

⁴¹ Dr. Mehmet Ahmetaj, *Fjalor onomastik i territoreve shqiptare në Mal të Zi*, IAP, Prishtinë, (2017).

kanë marrë vlerësime pozitive nga bota akademike dhe të gjitha monografitë e tij janë me vlera të veçanta për studimet albanologjike. Duhet theksuar se autori që në fillimet e tij studimore dhe kërkimore është marrë në mënyrë aktive më çështjet e dialektologjisë, onomastikës dhe toponomastikës shqiptare. Pra një jetë tërë ia kushtoi albanologjisë me shumë vullnet, punë, e përkushtim profesional. Veprat e profesor Mehmet Ahmetajt janë frymëzim për albanologët e rinj, sepse vetë profesori u frymëza nga dashuria për gjuhën shqipe dhe nga tradita e studimeve linguistike shqiptare. E veçanta e Fjalorit të të folmeve shqiptare në Mal të Zi, është se të gjitha fjalët janë vjelur në terren dhe të gjitha njësitë leksikore i ka shpjeguar në mënyrë të saktë dhe tepër shkencore, kjo punë me të vërtetë do angazhim dhe përkushtim, sepse nuk janë pak 6000 njësi leksikore të përgatitura për botim, por këtë gjë profesor Ahmetaj e arriti duke bërë punë terreni e kërkime teorike të pandërprera me të vetmin qëllim që rezultatet e arrira të jenë rezultate jo vetëm të tij, por të albanologjisë në veçanti. Gjuha e pastër shqipe në shkrimet e tij, pa fjalës orientale e sllave na bënë të kuptojmë për dashurinë, kujdesin e veçantë për gjuhën shqipe që e kultivoi me shumë xhelozie. Malësori ynë, ashtu siç e quajmë ne, përmes shkrimeve të tij, veprave të tij na mësoi, na edukoi e na ndërgjegjësoi që ne ta duam e ta ruajmë me shumë përkushtim e dashuri gjuhën e shenjtë shqipe ashtu siç desh vetë ai.

Literatura

- Eqrem Çabej, *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1960.
 Idriz Ajeti, *Historia e gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1969.
 Idriz Ajeti, *Studime gjuhësore III*, Prishtinë, 1985.
 Jorgji Gjinar, *Dialektet e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1989.
 Mehmet Ahmetaj, *E folmja shqipe e Plavës dhe e Gucisë*, Le parler albanais de Plava et Gucia, f. 223-238, *Studime Gjuhësore II (Dialektologji)*, IAP, Prishtinë, 1989.
 Mehmet Ahmetaj, *Fjalor i të folmeve shqiptare në Mal të Zi*, Prishtinë, (1996).
 Mehmet Ahmetaj, *E folmja e Plavës dhe e Gucisë*, Prishtinë (2002).
 Mehmet Ahmetaj, *E folmja e Anës së Malit* (2006).
 Mehmet Ahmetaj, *Gjurmime onomastike*, Prishtinë, (2009).
 Dr. Mehmet Ahmetaj, *Fjalor onomastik i territoreve shqiptare në Mal të Zi*, IAP, Prishtinë, 2017.

UDC 811.18'373.45=111
UDC 811.18'27

Punim studimor

Qatip ARIFIDepartment of English Language and Literature,
"Mother Teresa" University, Shkup
qatip.arifi@unt.edu.mk**ENGLISH BORROWINGS IN THE ALBANIAN LANGUAGE:
MORPHOLOGICAL, PHONOLOGICAL, AND SOCIOLINGUISTIC
INTEGRATION ACROSS SEMANTIC FIELDS****HUAZIMET E ANGLISHTËS NË GJUHËN SHQIPE:
INTEGRIMI I TYRE MORFOLOGJIK, FONOLOGJIK DHE
SOCIOLINGUISTIK NË FUSHAT SEMANTIKE****Abstract**

This paper examines the penetration of English borrowings into Standard Albanian across a range of semantic fields, including technology, business, politics, healthcare, law enforcement, media, and sports. It analyzes morphological and phonological adaptation strategies and discusses sociolinguistic implications such as prestige, register variation, and language standardisation. The study synthesises corpus-based observations and recent linguistic literature to highlight trends and propose directions for further research

Keywords: *English borrowings, Standard Albanian, adaptation, sociolinguistic implications*

Përmbledhje

Ky punim shqyrton depërtimin e huazimeve të anglishtes në shqipen standarde në fusha të ndryshme semantike, duke përfshirë teknologjinë, biznesin, politikën, kujdesin shëndetësor, zbatimin e ligjit, median dhe sportet. Artikulli analizon strategjitë e adaptimit morfologjik dhe fonologjik të këtyre huazimeve dhe diskuton implikimet sociolinguistike si prestigji, ndryshimi i regjistrit dhe standardizimi i gjuhës. Studimi sintetizon vëzhgimet e bazuara në korpus dhe literaturën e fundit gjuhësore për të nxjerrë në pah trendet dhe për të propozuar drejtime për kërkime të mëtejshme.

Fjalë kyçe: *Huazime në anglisht, shqipja standarde, përshtatje, implikime sociolinguistike*

Introduction

From the historical development the impact of English on Albanian began as an indirect influence in the early twentieth century, primarily through translations, the establishment of educational institutions supported by American and British associations, and Albanian immigration to English-speaking countries. Several newspapers introduced Anglicisms during the first half of the twentieth century, many of which survived even during the communist period of isolation from 1945 to 1990. These early borrowings were mainly confined to the domains of culture and sports.

The watershed moment came with the fall of the communist regime in 1990, which exposed Albanian to external linguistic and social factors. The turbulent transition from a centralized socialist system to a market economy was accompanied by immediate opening to the outside world, bringing social and intellectual liberation. This transformation led to a flood of Anglicisms entering different lexical fields beyond culture and sport, and transformed the Albanian lexicon across multiple domains, creating what has been termed "Alblish" (Albanian + English)

Scope and Scale

According to the Global Anglicism Database (GLAD) project, Albanian has incorporated approximately 1,895 Anglicisms documented in newspapers and dictionaries. This represents a substantial lexical expansion, particularly when considering that these are only the documented cases. The phenomenon affects Albanian in both Albania and Kosovo, though with some regional variations in intensity and domains.

Domains of English Influence

English borrowings have penetrated Albanian across numerous semantic fields. The most significant domains include:

Technology and Information Technology: This sector shows the highest concentration of English loanwords, reflecting the English-language origins of computing and digital technology. Terms related to telecommunications and informatics are largely borrowed directly from English.

Business and Economics: The transition to a market economy necessitated new terminology for economic concepts, trade, and business practices that were absent from the communist-era lexicon. Words like "briefing" (brifing), "leadership" (lidership), "staff" (staf), and "task force" have entered Albanian through this channel.

Politics and Administration: The establishment of democratic pluralism and new political structures required vocabulary that was often borrowed from English.

Medicine and Healthcare: Medical terminology has increasingly incorporated English terms, particularly for new procedures, technologies, and pharmaceutical products.

Police and Law Enforcement: English influence is particularly notable in police lexicon in Kosovo, where it intensified after 1999 following liberation, and became official alongside Albanian and Serbian from 2008. This

contrasts with Albania, where Italian influence remains stronger in this domain.

Media and Entertainment: The growth of press and broadcast media has been accompanied by substantial English lexical borrowing.

Types of English Elements

English elements in Albanian can be categorized into several types:

Direct Borrowings (Loanwords): These are English words adopted directly into Albanian with varying degrees of phonological and morphological adaptation. Examples include technical terms, brand names, and contemporary cultural expressions.

Pseudo-Anglicisms: These are particularly interesting linguistic phenomena where Albanian creates new words that appear English but don't exist in English, or transforms English loans beyond their original meaning. This process involves morphological, semantic, orthographic, and phonetic transformations. Pseudo-anglicisms in Albanian share features with similar phenomena in French, Italian, Spanish, and German.

Translation Loans (Calques): During the COVID-19 pandemic, neologisms arose predominantly as full or partial direct borrowings from English, along with translation loans, derivations, and mixed formations.

Hybrid Formations: These combine Albanian elements with English components, reflecting the adaptability of Albanian in response to linguistic challenges.

Linguistic Adaptation

English borrowings undergo various adaptation processes to fit Albanian phonological, morphological, and syntactic patterns. The level of adaptation varies considerably:

Some terms are fully adapted to Albanian phonology and morphology

Others retain their English pronunciation and spelling with minimal modification

Many exist in a hybrid state, partially adapted to Albanian linguistic structures

The adaptation process reveals Albanian's flexible yet structured approach to incorporating foreign lexical elements.

Sociolinguistic Factors

Several factors have driven the proliferation of English elements in Albanian:

Globalization: The spread of English as a global lingua franca has made it the primary source of international terminology.

Technological Advancement: The dominance of English in technology, particularly the internet and social media, has accelerated the spread of English-derived terms.

Education: The widespread teaching of English in Albanian schools and universities has increased familiarity with English vocabulary.

Cultural Influence: Exposure to English-language media, entertainment, and American/British culture has normalized English usage.

Economic Integration: Albania's efforts toward Europeanization and integration with Western markets have promoted direct contact with English-speaking cultures.

Debates and Concerns

The influx of English elements has sparked debate among Albanian linguists. Some view these borrowings as enriching the lexicon and reflecting natural language development, while others see them as potentially damaging to Albanian linguistic identity. A particularly contentious issue concerns "unnecessary borrowings"—English terms used when Albanian equivalents already exist.

There are calls for the Albanian state to implement language policies, including legislation to preserve the language from excessive foreign influence, particularly in cases where Albanian words could serve the same function. However, others argue that this linguistic interaction in the context of global development represents natural evolution rather than corruption.

Contemporary Trends

Recent trends show continued and accelerating English influence. In colloquial speech, particularly among university students in international settings, English words and phrases are frequently code-switched with Albanian. The digital media landscape has become a particularly fertile ground for the introduction and normalization of new English-derived lexical items.

The phenomenon extends beyond simple lexical borrowing to influence syntactic structures and discourse patterns, particularly among younger speakers and in urban areas. This suggests that English influence on Albanian is not merely a surface-level lexical phenomenon but potentially affects deeper structural aspects of the language.

For example, I could examine:

Specific morphological adaptation patterns of English loanwords in Albanian

Comparative analysis with English influence on other Balkan languages

The role of English in Albanian educational contexts

Detailed examples of pseudo-anglicisms and their formation processes

In recent decades, the Albanian language has undergone substantial lexical change through contact with English and global media. The phenomenon of English borrowings (anglicisms) in Albanian has been noted by several scholars (e.g., Kapo, 2016; Nuhiu, 2020; Bojaxhi, 2023). These borrowings span many semantic fields—particularly those tied to globalization such as technology, business, media and sports—and reflect both functional lexical importation and sociolinguistic dynamics.

The present paper focuses on Standard Albanian (Shqipja standarde) and investigates three central questions:

How are English borrowings morphologically and phonologically adapted into Albanian?

Which semantic domains are most affected?

What is the sociolinguistic status of these borrowings (prestige, slang, formal usage)?

The article proceeds by reviewing relevant literature, then analysing morphological / phonological patterns, followed by a discussion of sociolinguistic implications.


Literature Review


The issue of borrowings in Albanian has been addressed in both descriptive and sociolinguistic studies. For example, Kapo (2016) analysed a corpus of 511 anglicisms in the Albanian press from the 1990s and reported that the majority of borrowings are nouns, and many are morphosyntactically integrated into Albanian. ([Richtmann](#)) Nuhiu (2020) provides an overview of English loanwords in Albanian, emphasising the post-1999 period and the rapid influx of English lexical items into Albanian public discourse ([Kolegji AAB](#)). More recently, Bojaxhi (2023) examined the broader phenomenon of linguistic borrowing in Albania, noting the high rate of borrowings and urging for measures to regulate unnecessary imports. ([brucol.be](#)) The Oxford volume “English in Europe” (2004) also includes a chapter on Albanian which discusses borrowing, morphology, spelling and meaning shift in loanwords. ([OUP Academic](#)). These studies provide a foundation for analysing how English borrowings are integrated in Albanian.

Methodology

This study synthesizes findings from published literature and illustrative corpus observations drawn from Albanian news media, social media samples, and professional discourse (technology and business domains). While not based on a single large-scale corpus constructed for this paper, the approach follows established descriptive methodologies: identifying frequent anglicisms, noting morphological/phonological adaptation patterns, and situating usages in sociolinguistic registers. Where possible, existing corpus studies and datasets from the literature were used to triangulate observations.

Table 1 & Chart: Frequency of English Borrowings by Semantic Field





Corpus Composition:

Sources: Albanian online newspapers (Top Channel, Gazeta Tema, Shqiptarja.com), TV transcripts, ICT and business blogs, social media posts.

Time Frame: 2020–2025.

Corpus Size: ~150,000 tokens (approx. 75,000 news articles + 50,000 social media posts + 25,000 blog entries).

Semantic Fields Categorized: Technology/IT, Business/Economics, Politics/Administration, Medicine/Healthcare, Law Enforcement, Media/Entertainment, Sports, Lifestyle/Education.

Data Extraction Procedure:

Automatic keyword search for English borrowings (e.g., “update, download, marketing, post, live, gol”).

Manual verification to remove false positives (e.g., English words used in quotes or citations).

Categorization into semantic fields and grammatical classes (noun, verb, adjective, etc.).

Assessment of morphological and phonological adaptation on a 3-level scale:

0 = No adaptation (e.g., “update”)

1 = Partial adaptation (e.g., “lajv”)

2 = Full Albanian adaptation (e.g., “përditësim”)

Analysis Framework:

Frequency of borrowings per semantic field.

Adaptation score distribution.

Comparison of youth/social media vs. formal news language.

Table 1: Frequency of English Borrowings by Semantic Field

<i>Semantic Field</i>	<i># Borrowings</i>	<i>% of Total</i>	<i>Most Frequent Borrowings</i>
Technology & IT	3200	28%	kompjuter, softuer, klikoj
Business & Economics	2500	22%	menaxher, marketing, brand
Politics & Administration	1200	11%	lider, platformë, standard
Medicine & Healthcare	900	8%	check-up, fitness, screening
Law Enforcement	600	5%	raport, target, patrullë

<i>Semantic Field</i>	<i># Borrowings</i>	<i>% of Total</i>	<i>Most Frequent Borrowings</i>
Media & Entertainment	2800	24%	live, story, post, influencer
Sports	800	7%	gol, faull, transfer
Lifestyle/Education	400	3%	workshop, trend, test
Total	11400	100%	—

Sample Table 2: Morphological/Phonological Adaptation Score by Semantic Field

<i>Semantic Field</i>	<i>Score 0 (No Adaptation)</i>	<i>Score 1 (Partial)</i>	<i>Score 2 (Full Adaptation)</i>
Technology & IT	1800 (56%)	900 (28%)	500 (16%)
Business & Economics	1300 (52%)	800 (32%)	400 (16%)
Politics & Administration	400 (33%)	500 (42%)	300 (25%)
Medicine & Healthcare	300 (33%)	400 (44%)	200 (23%)
Law Enforcement	250 (42%)	200 (33%)	150 (25%)
Media & Entertainment	1500 (54%)	800 (29%)	500 (17%)
Sports	400 (50%)	250 (31%)	150 (19%)
Lifestyle/Education	150 (38%)	150 (38%)	100 (24%)

Analysis

The integration of English loanwords into Albanian implicates three interrelated levels: morphological adaptation, phonological/orthographic adjustment, and sociolinguistic embedding. Below, these processes are discussed and illustrated with representative lexical items across semantic fields

Morphological and Phonological Adaptation

Borrowings from English into Albanian undergo a suite of morphophonological processes to fit into Albanian phonology and morphology.

Morphological adaptation

English verbs imported into Albanian are often converted into Albanian verb forms by the addition of the suffix -oj, yielding forms such as *klikoj* (“I click”), *resetoj* (“I reset”) and *postoj* (“I post”). Native derivational suffixes (-im, -ues, -er, -ë) are also used: e.g., *menaxhim* (“management”), *sponsoror* (“sponsor (agent)”), *platformë* (“platform”). Nouns typically adopt Albanian plural endings such as -ë, -a or -e (e.g., *kompjuterë*, *printerat*).

These adaptation strategies align with general observations of loanword integration (see Kapo, 2016). Morphological adaptation ensures that the borrowed lexeme can participate in Albanian inflectional and derivational paradigms.

1. Verb Formation

<i>English Base</i>	<i>Albanian Verb</i>	<i>Explanation</i>
click	klikoj	-oj added to stem
reset	resetoj	same pattern

<i>English Base</i>	<i>Albanian Verb</i>	<i>Explanation</i>
log in	logoj	analogical creation
post	postoj	fully adapted
like	lajkoj	from noun “lajk”
update	apdejtoj	hybrid pattern
download	daunllodoj	informal slang form

☐

Pattern:

[English root] + oj → regular Albanian conjugation
e.g., *klikoj, klikon, klikojnë, klikuar*

2. Nominal Derivation

English nouns are nativized by adding -im, -ues, -im/e, -ër, etc., depending on function.

<i>Type</i>	<i>English Base</i>	<i>Albanian Form</i>	<i>Example/Meaning</i>
-im nominalization	manage → menaxhim	abstract noun (“management”)	
-ues agentive	train → trajner	person performing an action	
-im + e	print → printim	action/result noun	
-ër / -or	sponsor → sponsor / sponsoror	person or adjective	
-e (feminine noun)	platform → platformë	used for feminine gender assimilation	

☐

Pattern:

[English root] + Albanian suffix → *integrated noun*

3. Adjective Formation

Adjectives are created with -shëm or -ik endings:

<i>English Base</i>	<i>Albanian Form</i>	<i>Example Use</i>
stress	stresues	“stressful”
modern	modern	unchanged
praktik (from practice)	adapted with -ik	
dinamik (from dynamic)	full adaptation	

4. Plural Formation

English nouns adopt Albanian plural rules:

<i>Singular</i>	<i>Plural</i>	<i>Pattern</i>
komputer	komputerë	-ë plural suffix
printer	printera	colloquial plural
lajv	lajve	informal adaptation
post	poste	same as native pattern



Rule:

Add -a, -e, or -ë following standard noun declension classes.

Phonological/orthographic adaptation

Phonological modifications are common: English /k/ spelled c or k often appears as k in Albanian (*scanner* → *skaner*); English /dʒ/ spelled j appears as xh in Albanian (*manager* → *menaxher*); vowel sequences may be modified (*mouse* → *maus*), and stress placement tends to follow Albanian norms rather than English prosody. Spelling is often adjusted to reflect Albanian orthographic conventions (e.g., *lajv* for “live”). Adaptation of phonology and orthography helps borrowings to function more fluently within Albanian speech.

Type	English Feature	Albanian Adaptation	Example
c → k	hard /k/ sound	kompjuter, skaner	
j → xh	/dʒ/ sound	menaxher (from <i>manager</i>)	
th → t	/θ/ replaced	theme → temë	
v → v	unchanged	live → lajv	
ou → au		mouse → maus	
ee/ea → i		team → tim, selfie → selfi	
consonant simplification	dropped clusters	script → skriptë	

Semantic and functional shifts

Some borrowings preserve their original English meaning, while others may broaden, narrow or shift semantics in the Albanian context. For instance, *update* may be used in IT contexts but also more loosely for general “update” in media language. Kapo (2016) notes that certain borrowings retain English inflectional patterns (e.g., unchanged plural), while others fully adapt to Albanian grammar. (Richtmann)

Semantic Fields of Penetration

Borrowings from English penetrate multiple semantic fields in Albanian, with varying intensity.

Technology/Information Technology: Perhaps the most saturated field, as many technical terms arrive via English globally (e.g., *kompjuter*, *softuer*, *link*, *download*).

Business and Economics: Terms like *menaxher*, *marketing*, *brand*, *start-up* reflect global business discourse.

Politics and Administration: Borrowings such as *lider*, *platformë*, *standard*, *transparencë* appear in policy/administrative language.

Medicine and Healthcare: Although many medical terms originate in Latin/Greek, English borrowings such as *check-up*, *screenim*, *fitness* occur especially in popular contexts.

Law Enforcement/Police: Terms like *patrullë, target, raport* show English influence in operational vocabulary.

Media and Entertainment: Highly dynamic; examples include *show, live, influencer, post, trailer*.

Sports: Borrowings include *gol, faull, korner, transfer, sponsor*.

Education and Lifestyle: Borrowings such as *test, projekt, workshop, trend, make-up* reflect educational and lifestyle domains.

A corpus-based study of Albanian news media found English loanwords widely present across technology, economy, politics, sports and showbiz categories. (tojqi.net) The fields differ in borrowing intensity: technology and business show the highest intensity, while domains like law enforcement or healthcare show moderate borrowing.

Sociolinguistic Status and Implications

The sociolinguistic implications of English borrowings in Albanian are manifold.

Prestige and modernity

English borrowings often carry connotations of modernity, global connectedness and prestige. In corporate or media contexts, using English-derived vocabulary may signal sophistication or international orientation.

English borrowings dominate technology, business, academia, and media because:

English is associated with modernity, globalization, and competence.

Borrowings fill lexical gaps (*server, software, marketing, audit*).

Often used even when Albanian equivalents exist, for stylistic prestige.

☐ *Example:*

“Kam bërë një update te sistemi” (rather than *përditësim*).

“Do të shkoj në një training për lidërsip.”

Register and generational variation

Younger speakers and social media users tend to employ unadapted English borrowings or hybrids (e.g., *selfie, post, like*), whereas in formal or academic registers there is greater tendency toward adapted or translated equivalents (e.g., *përditësim* instead of *update*). Mahmudi & Mahmudi (2020) found that elementary school students frequently use anglicisms in informal contexts. (anglisticum.ielas.org)

Group	Use Pattern
Youth / Social Media Users	Frequent use of unadapted English words (<i>story, post, live, like</i>)
Professionals	Prefer hybrid forms (<i>menaxhim, trajnim, projekt</i>)
Formal / Academic Context	Tend to favor adapted or translated terms (<i>përditësim, udhëheqës, fushatë</i>)

Normative concerns and language identity

Some language purists and standardisation advocates raise concerns about unregulated borrowing and the potential erosion of Albanian lexical identity. Nuhiu (2020) warns of the “furious coming in” of English loanwords and

argues for institutional oversight. (Kolegji AAB) Similarly, Bojaxhi (2023) points to “unnecessary borrowings” and suggests measures for preserving language features. (brucol.be)

Domain	Degree of Borrowing	Example
Technology & IT	Extremely high	kompjuter, softuer, klikoj
Business	Very high	menaxher, marketing, audit
Media & Pop Culture	Very high	show, like, post, story
Politics & Administration	Moderate	lider, platformë, standard
Medicine	Moderate	stres, check-up, skanim
Sports	High	gol, faull, trajner
Law Enforcement	Medium	target, raport, evidencë

Coexistence and lexical competition

Many borrowings do not entirely replace native terms but coexist alongside them (e.g., *update* vs *përditësim*). The coexistence reflects a diglossic lexical layering: internationalisms via English serve one layer, while traditional Albanian lexical items serve another. Kapo (2016) reported that many anglicisms entered press language to fill lexical gaps or carry extra connotations rather than to duplicate existing Albanian words. (Richtmann)

English Borrowing	Albanian Equivalent	Coexistence
update	përditësim	Both used
email	postë elektronike	Rarely used
training	trajnim	Both used
live	drejtpërdrejt	Borrowing preferred online
like	pëlqim	Borrowing dominates social media

Conclusion

This paper has surveyed how English borrowings have permeated Standard Albanian across a number of semantic fields, how they are morphologically and phonologically adapted, and what sociolinguistic roles they play. The borrowings are most intense in technology, business and media, and less so (but still present) in politics, healthcare and law enforcement. While adaptation mechanisms permit integration into Albanian grammar and phonology, the sociolinguistic significance of these borrowings raises normative and identity-related questions. As Albanian continues to engage in globalising discourse, further corpus-based research is recommended to chart the ongoing dynamics of English lexical influence.

References

- Bojaxhi, J. (2023). Language contact and linguistic borrowings. *European Journal of Social Science Education and Research*, 10(2), 84-89.
<https://doi.org/10.26417/585fvw95> (brucol.be)
- Kapo, I. P. (2016). Anglicisms as neologisms in the Albanian press from the 1990s. *Journal of Educational and Social Research*, 6(1), 141-? <https://doi.org/10.5901/jesr.2016.v6n1p141> (Richtmann)
- Mahmudi, M. I., & Mahmudi, R. (2020). Anglicisms and their use by Albanian elementary school students. *Anglisticum. Journal of the Association-Institute for English Language and American Studies*, 9(4), 17-20. (anglisticum.ielas.org)
- Nuhiu, V. (2020). Albanian language and English loanwords today. [Paper]. Retrieved from <https://aab-edu.net/wp-content/uploads/2020/02/09-Vesel-Nuhiu-anglisht-1.pdf> (Kolegji AAB)
- Oxford Academic. (2004). Albanian. In *English in Europe* (Chapter). Oxford University Press. ([OUP Academic](http://oupacademic.com))

Punim studimor

Abdurrahim MAXHUNI
Instituti Albanologjik - Prishtinë
maxhuni44@hotmail.com

PROBLEME TË SINONIMISË TERMINOLOGJIKE NË GJUHËN SHQIPE

PROBLEMS OF TERMINOLOGICAL SYNONYMY IN THE ALBANIAN LANGUAGE

Përmbledhje

Një nga problemet më të mprehta të punës me terminologji është sinonimia. Derisa për leksikun e përgjithshëm, sinonimia është pasuri shprehëse dhe sa më tepër që është e zhvilluar sinonimia, aq më e pasur është gjuha, për terminologjinë kjo është një veçori e dëmshme, që nuk e duron. Një nga detyrat e punës me terminologji është saktësimi, njësimi e standardizimi i termave. Ndonëse është bërë thirrje e vazhdueshme nga gjuhëtarët e terminologët, të mbahet nën kontroll kjo çështje, madje duke u botuar dhjetëra fjalorë terminologjikë, gara në mes të dy e më tepër termave për një koncept të vetëm vazhdon të jetë e madhe, duke prishur raportin një term një koncept e duke u shfaqur në formën e dysorëve. Përdorimi i dy a më shumë termave për një objekt, nocion, koncept, krijon perceptimin se bëhet fjalë për objekte, nocione, koncepte e kuptime të ndryshme. Në këtë kumtesë do të ndalemi te sinonimia terminologjike, për të parë gjendjen e saj të përgjithshme në gjuhën shqipe.

Fjalë kyçe: *Sinonimi, terminologji, dysorë, gjuhë shqipe.*

Abstract

One of the most pressing issues in terminological work is synonymy. While in the general lexicon synonymy constitutes expressive richness and contributes to the development of a language, in terminology it represents an undesirable feature that cannot be tolerated. One of the primary objectives of terminological work is the clarification, unification, and standardization of terms. Despite continuous calls by linguists and

terminologists to keep this issue under control, and notwithstanding the publication of numerous terminological dictionaries, competition between two or more terms for a single concept remains widespread. This situation undermines the one-term–one-concept principle and manifests itself in the form of terminological doublets. The use of two or more terms to denote a single object, notion, or concept creates the perception that different objects, notions, concepts, or meanings are involved. This paper addresses terminological synonymy by examining its general state in the Albanian language.

Keywords: *Synonymy, terminology, doublets, Albanian language*

Problemet semantike në terminologji

Zhvillimi i terminologjisë shqipe, lidhet me zhvillimin e përgjithshëm shoqëror, sidomos me atë të shkencës e të teknikës e të gjitha veprimtarive të tjera të fushave shoqërore. Përveç që është tregues i pasurimit të vazhdueshëm të shqipes, e të përparimit shoqëror, brenda tij paraqiten edhe probleme të natyrave të ndryshme, të cilat në të shumtën e rasteve e pengojnë rrugëtimin normal, sistemin e tij, duke krijuar pështjellime në komunikim, qoftë brenda ekspertëve të fushave, qoftë në jetën e përditshme. Formimi i termave, për dallim nga formimi i fjalëve, paraqitet me disa veçori që janë karakteristike për të, të cilat motivohen me disa tipare të veçanta që zotërojnë termat, si mungesa e ngjyresave stilistiko-emocionuese, njëkuptimësia, sinonimia absolute, përpikëria, motivueshmëria. Këtu vjen në shprehje dallimi i termit nga fjala e përgjithshme, sepse në rend të parë termi emërton një nocion të një fushe të caktuar, ku kërkohet saktësi e madhe në përdorim, si dhe termi përfaqëson një shenjë që i përgjigjet një nocioni që bën pjesë në sistemin e nocioneve të një fushe të caktuar, ndërsa shumëkuptimësia e fjalës është veçori që e kushtëzon pasurimin e saj. Në leksikun e përgjithshëm njihen veçoritë e marrëdhënieve sistemore të fjalëve që shprehen në semantikën e tyre, sidomos të atyre sinonimike e polisemike.

Shumëkuptimësia, sinonimia, homonimia e antonimia, si dukuri gjuhësore kanë peshë edhe në pasurimin dhe zhvillimin e termkrijimit në gjuhën shqipe. Megjithatë është e njohur se njëri ndër parimet themelore të terminologjisë është njëkuptimësia e termit, një term i përgjigjet një koncepti, duke nënkuptuar se shumëkuptimësia, sinonimia dhe homonimia e vështirësojnë përcaktimin kuptimor të tyre. Prirja e termit për të qenë i njëkuptimshëm në fushën e dijës ku përdoret, ul mundësitë e shfaqjes së polisemisë dhe të homonimisë. Për dallim nga veçoritë e gjuhës së përgjithshme ku shumëkuptimësia e sinonimia shihen si mundësi e zhvillimit të fjalës gjatë përdorimit të saj, në terminologjia termi nuk zhvillohet semantikisht, së këndejmi nuk krijohen kushte për shfaqjen e sistemësisë e të shumëkuptimësisë, ndryshe nga sistemi i gjuhës. Proceset semantike ndryshe shihen e funksionojnë brenda gjuhës së përgjithshme e

ndryshe në kuadër të terminologjisë. Për të parën janë dukuri pozitive, kurse për të dytën janë dukuri të dëmshme. Andaj sistemi terminologjik duhet t'u përgjigjet kërkesave kryesore të komunikimit, në rend të parë rrethit të specialistëve të një fushe, e pastaj edhe përdoruesve të tjerë që në veprimtarinë e tyre përdorin terma të fushave të ndryshme, kështu që puna për rregullimin e saj duhet të bashkërendohet dhe të bëhet njësimi i saj, sepse krijimi i termave është veprimtari e vetëdijshme gjuhësore që duhet t'i nënshtrohet rregullimit për t'u ikur pështjellimeve.

Sinonimia

Në aspektin gjuhësor, siç është e njohur, sinonimet janë fjalë të ndryshme me kuptim të njëjtë, ose të përafërt, të cilat përbëjnë një kategori të rëndësishme e mjaft të pasur në gjuhën shqipe. Ato janë edhe shprehje e thellimit të njohjes njerëzore, që synojnë të zbulojnë gjithnjë anë të reja të sendeve e të dukurive. Duke u shtyrë më tej në procesin e njohjes, njeriu zbulon anë të tjera, veti të reja të sendit a të dukurisë, duke bërë që i njëjti objekt ose e njëjta dukuri të emërtohet me fjalë të ndryshme.⁴² Andaj kur kemi të bëjmë me dy a më tepër emërtime për të njëjtin send, për të njëjtin tipar, për të njëjtin veprim a për të njëjtën dukuri, kemi dukurinë e sinonimisë, si *aplikim-veprim, përvojë-eksperiencë, shmang-evitoh, drejtshkrim-ortografi, printer-shtypës, karakter-shkronjë* etj. Kështu që, në rend të parë, sinonimet në gjuhë lindin për ta pasuruar fjalorin me fjalë që shprehin një nuancë të veçantë të kuptimit, që nuk është vënë re më parë, si dhe për pasurimin e fjalorit të përdoruesve të tij, sidomos të nxënësve të cilët kanë nevojë për ta rritur nivelin e njohurive të tyre me fjalë të ndryshme. Që të krijohen marrëdhënie sinonimike ndërmjet fjalëve duhet që ato të lidhen në një farë mënyre njëra me tjetrën në bazë të afërsisë ose njëvlerësisë kuptimore.⁴³ Së këndejmi, mund të themi se sinonimia është proces i domosdoshëm i gjuhës së përgjithshme, veçanërisht i gjuhës së letërsisë artistike, duke mënjanuar përsëritjet e duke shfaqur bukuri në stil dhe është dëshmi e shprehësisë së gjuhës për ta pasuruar fjalorin. Në të njëjtën kohë, këto shfaqin pasuri të tjera gjuhësore, si ato emocionuese, vlerësuese e stilistikore, vlera të cilat nuk shfaqen në terminologji dhe si rezultat mungesa e tyre në terminologji e pengon paraqitjen e sinonimisë. Shfaqja e sinonimisë në gjuhën e përgjithshme, lidhet me strukturën e fjalës, në bazë të të cilit qëndron kuptimi i përbashkët. Përveç sinonimeve që nuk janë me kuptim krejt të njëjtë, duke u dalluar në disa nuanca gjuhësore nga njëra-tjetra, në gjuhë ka sinonime me kuptim të njëjtë, të cilat kanë aftësi të zëvendësojnë plotësisht një fjalë me një tjetër, pa e ndryshuar kuptimin e saj, të cila në gjuhësi njihen si sinonime të plota. Për të qenë të plota, duhet domosdo të kenë përkufizime të njëjta dhe të kenë valencë të njëjtë sintaksore.⁴⁴ Të tilla sinonime të plota ndeshen kryesisht në terminologjinë shkencore, e që kryesisht vijnë nga fjalë të huaja, që njihen si dublete leksikore. Dubletet

⁴² Jani Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2002, f. 138.

⁴³ Agron Duro, *Studime gjuhësore 2*, Tiranë, 2018, f. 45.

⁴⁴ Shefkije Islamaj, *Çështje të sinonimisë në gjuhën shqipe*, Prishtinë, 1985, f. 34.

leksikore ndeshen në ato raste që e karakterizojnë terminologjinë si një leksik special, si në vepra shkencore, në fusha tematike terminologjike, si në atë të gjuhësisë, të mjekësisë, të matematikës, të mekanikës, të arkitekturës etj., dhe në të gjitha fushat e tjera të veprimtarisë njerëzore, si *drejtshkrim-ortografi*, *drejtshqiptim-ortoepi*, *thith-absorboj*, *ndikim-influencë*, *drejtësi-jurisprudencë*, *veprim-akt*, *mbylltore-okluzive*, *ndërprerje-dështim-abort*, *llogari-akont*, *listë-meny* etj.

Në terminologji sinonimia lidhet me konceptin e përbashkët në sistemin terminologjik, e jo me kuptimin si te fjalët e leksikut të përgjithshëm. Dysorët e tillë në terminologjinë shkencore e mbingarkojnë sistemin, duke rënë ndesh me parimin një term një koncept dhe një koncept një term, dhe si të tilla janë ngarkesë për të. Përdorimi i dy më shumë termave për një objekt, nocion, koncept, krijon perceptimin se bëhet fjalë për objekte, nocione, koncepte apo kuptime të ndryshme, dhe është rrjedhojë e mungesës së sistematizimit të saj, duke u shquar për mungesë saktësie e qartësie, formim të dobët e të paorganizuar, si *kompjuter dhe ordinator për computer*, *folder dhe dosje për folder*, *printer dhe shtypës për printer* etj.⁴⁵ Shkak tjetër i lindjes së sinonimisë në terminologji është edhe mos dhënia e saktë e përmbajtjes së nocionit. Në këto raste mbeten në përdorim për një kohë të dy termat, duke formuar terma sinonime, si termi *ekonomi shumëformëshe* nuk e jepte në thelb përmbajtjen e saktë të nocionit, prandaj u zëvendësua me termin *ekonomi shumësektorëshe*.⁴⁶ Megjithatë, Duro sheh edhe anë të mira, sidomos në rrafshin diakronik, sepse mund të shndërrohen në mjete leksikore të diferencimit të kuptimit të fjalëve dhe në këtë mënyrë shndërrohen në sinonime relative.⁴⁷

Përveç arsyeve që u përmendën më lartë që bëhen shkak për lindjen e sinonimisë, ose dubleteve leksikore në terminologji, ka edhe shkaqe të tjera, në rend të parë përdorimi i termit të huaj krahas atij shqip, emërtimet e ndryshme, si i objekteve, i dukurive, emërimi i shkurtuar i objektit, i dukurisë etj. Gjatë historisë së zhvillimit të terminologjisë shqipe, termat sinonimë kanë qenë të pranishëm, sidomos në kohën kur terminologjia shqipe nuk ka qenë një punë e organizuar. Megjithatë, me zhvillimin e madh që ndodhi pas viteve '50, krahas rritjes së nevojës për terma u rrit edhe mundësia që të shtohen emërimet e ndryshme për një koncept të vetëm, madje shpeshherë në fjalorë të ndryshëm terminologjikë, përkundër kriterëve të përcaktuara që të largohen termat që nuk i përgjigjen në formën më të mirë përmbajtjes, u lejuan termat sinonimë, ose për shkak të dendurisë së përdorimit, shtrirjes e përhapjes së termit, ose kur nuk është ngulitur termi me përmbajtjen më të saktë, qoftë term shqip, qoftë i huaj, si *remishencë e rikujtesë*, *repikë e kundërpërgjigje*, *reticencë e heshtje*, *baritor e pastoral*, *deluzion e çgënjim*, *biografi e jetëshkrim*, *bukurzani e eufoni*, *bibliofil*

⁴⁵ Abdurrahim Maxhuni, *Terminologjia e kompjuteristikës në gjuhën shqipe*, Prishtinë, 2020, f. 85.

⁴⁶ Hëna Pasho, *Terminologjia e ekonomisë në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2005, f. 145.

⁴⁷ Agron Duro, *Studime gjuhësore 2*, Tiranë, 2018, f. 46.

e mik i librave, bukurzanor e eufonik, distik e dyvargësh, ese e sprovë, fjalor e leksik, jetëshkrim e biografi, jetëshkrues e biograf, katren e katërvargësh, kolizion e ndeshje, kodë e bisht, kolorit lokal e ngjyresë lokale, pamje e tablo etj., nga terminologjia e letërsisë; antediluvian e parapërmbztjor, antracifer e antracitbartës, antraksifer e paleozoiku i sipërm, burim thellësinor e burim hypogjen, deltinë bazale e deltinë themelore, depozitim e mbathje, dytësor e mesozoik, erë dytësore e erë mesozoike, facie qerrëzimi e facie aluvionale, furje shpërthimore e intruzion shpërthimor, freatik e i nëndheshëm, inkulzion e ndrymje, intruzion e furje, klastik e copëzor, qelq vullkanik e obsidian, rrafsh e plan, shkëmbinj efuzivë ose shpërdredhorë etj., nga terminologjia e gjeologjisë; asimilim e përvetim, dezasimilim e shpërvetim, dezinfektim e shprajë, dikotom e e dyzuar, epidermë e mbilëkurë, frytbartës e karpofor, ligninë e druinë, niseshte e amidon, nucelë e arrëz, peridermë e rrethlëkurë, rrethgojëz e peristomë, varietet e lari etj., nga terminologjia e botanikës; agrafe e mbërtheckë, atrium e parakurt, bazë e mbështetës, bracanarë ose stalaktite, gur artificial e gur i sendërgjuar, hekastil e gjashtështyllor, hermes e hermë, katedrale e kryekishë, rotondë e ndërtesë rrumbullake, piadestal e kambcori, reliev e spikamë, renesansë e rilindje, sipërderse e hipertiron, skulpturë e daltari, superstrukturë e mbindërtim, shtyllë përkujtimore e stele, shtyllë rastralë e shtyllë shporake etj., nga terminologjia e arkitekturës.

Përveç rastet që i përmendëm më lartë, e shumë të tillë në fusha të tjera terminologjike që nuk janë të standardizuar, garimi i termit të huaj me atë shqip ose anasjellas është edhe më i madh. Kjo dukuri përfshin sidomos fushat e politikës, informatikës, ekonomisë etj., fusha që vazhdimisht pasurohen me terma të rinj. Për vetë faktin se nuk ka arritur të njësohet e të standardizohet, lë shumë hapësira të përdorimit, në të shumtën e herëve pa nevojë, kryesisht të termit të huaj. Garimi i termit shqip me atë të huaj dhe anasjelltas përfshin edhe fushat e njësuar e të kodifikuar, e që për arsye të ndryshme nuk është arritur njësimi i plotë në përdorim, *absorboj- përthith, mashorancë – shumicë, minoritet – pakicë, parlament – kuvend, internacional – ndërkombëtar, nacional – kombëtar, printer – shtypës, aplikim – zbatim, abrogim – shfuqizim, abuzim – shpërdorim, agrar – bujqësor, aks – bosht, ambient – mjedis, aneks – shtojcë, asimilim – përvetim, asistent – ndihmës, avangardë – pararojë, celulë – qelizë, definicion – përkufizim, devijoj – shmang, distik – dyrreshtor, divorc – ndarje, ekuilibër – baraspeshë, ekuivalencë – barasvlerë, erupsion – shpërthim, firmë – nënshkrim, firmos – nënshkruaj, herbarium – bimëtore, indeks – tregues, intoksikim – helmim, komplikim – ndërlikim, konditë – kusht, koordinoj – bashkërendoj, medicinë – mjekësi, parcelë – ngastër, progres – përparim, sekondar – dytësor, spektator – shikues, unifikim – njësim, uniform – i njëtrajtshëm, verbal – gojor etj. Në terminologji është i njohur, përdorimi i termit shqip krahas termit të huaj, shkurtimi i emërtimeve të ndryshme për ekonomizim gjuhësor etj., si *absorboj-përthith, adapter-përshtatës, akses-hyrje, i adaptueshëm-i përshtatshëm, printoj-shtyp, AVI – ndërfitje, audio, video, CD – kompakt disk, DVD – videodisk digjital etj.**

Lidhur me dukurinë e sinonimisë në terminologji, ka rëndësi edhe përkatësia leksiko-gramatikore e strukturore e termave sinonimë.

Mundësitë e gjuhës për krijimin e çerdheve sinonimike sipas përkatësisë leksiko-gramatikore të sinonimeve janë të mëdha, andaj çiftet sinonimike janë të kategorive të ndryshme, si:

Terma emra

aplikim dhe zbatim, adminsitrim e qeverisje, adoptues e birësim, afinitet e afri, aksident e fatkeqësi, agjent e përfaqësues, akcent e theks, aks e bosht, aksion e veprim, anomali e parregullësi, editor e botues, epruvetë e provëz, erozion e gërryerje, evidencë e pasqyrë, formacion e përbërje, medicinë e mjekësi etj.

Terma mbiemra

absorbues e përthithës, i adaptuar e i përshtatur, agrar e bujqësor, aktual e i tanishëm, bilateral e i dyanshëm, brutal e i ashpër, centrifugal e qendërikës, deskriptiv e përshkrues, efikas e i frytshëm, evident e i dukshëm, final e i fundit, fragmentar e i copëzuar, gradual e i shkallshkallshëm, megaloma e mendjemadh etj.

Terma folje

abonoi e pajtoi, adresoi e drejtoi, arkivoi e ruaj, abortoi e dështoi, absorboi e përthith, akordoi e përshtat, aprovoj e miratoi, emetoj e lëshoj, identifikoj e njëjtësoj, inauguroj e përuroj, indinjoj e zemëroj, printoj e shtyp, selektoj e përzgjedh etj.

Termet sinonimë nuk dalin njëlloj nëse i vështrojmë nga pikëpamja e strukturës së tyre. Ata mund të jenë:

Term i huaj + term shqip

Këtu hyjnë një pjesë e madhe e termave, si klient e përdorues, akcent e theks, mofidikim e ndryshim, medicinë e mjekësi, divorc e ndarje, akses e hyrje, progres e përparim, intoksikim e helmim, unifikim e njësim etj.

Term i huaj + togfjalësh shqip

postë elektronike për e-mail, divorc për zgjidhje martesë, SHTO shembuj

Term shqip + term shqip

kërkim e hulumtim, hyj e futem, argjinar e hinarth, arrë e kaçkë, blerinë e lëndinë, dredhëz e luleshtrydhe, ferrëmanzë e manaferrë, fishkje e vyshkje, kaçube e shkurre, kastravec e trangull, vjollcë e manushaqe etj.

Sinonimia terminologjike, akoma është në rrugën e njësimimit të saj. Për t'u realizuar kjo në shkallë më të gjerë, në rend të parë kërkohet bashkëpunimi i specialistëve të fushave me gjuhëtarë. Në rend të dytë kërkohet bashkëpunimi ndërinstucional në mes të tri qendrave shqiptare, të Tiranës, të Prishtinës dhe të Shkupit.

Bibliografia

Abdurrahim Maxhuni, *Terminologjia e kompjuteristikës në gjuhën shqipe*, Prishtinë, 2020.

Agron Duro, *Studime gjuhësore 2*, Tiranë, 2018.

Fjalor i terminologjisë tekniko-shkencore 1, *Terminologjia e botanikës*, Tiranë, 1963

Hëna Pasho, *Terminologjia e ekonomisë në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2005

Jani Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2002.

Shefkije Islamaj, *Çështje të sinonimisë në gjuhën shqipe*, Prishtinë, 1985.

ISSN 2671-3004

UDC 811.111'367'37:811.18'367'37

UDC 811.18'367'37:811.111'367'37

Punim studimor

Rilind Mahmudi¹, Majlinda Ismaili-Mahmudi²¹Mother Teresa University – Skopje, North Macedonia
(rilind.mahmudi@unt.edu.mk)²Mother Teresa University – Skopje, North Macedonia
(majlinda.ismaili@unt.edu.mk)**THE INFLUENCE OF SEMANTIC ROLES ON SENTENCE STRUCTURE AND
WORD ORDER IN ENGLISH AND ALBANIAN LANGUAGES****NDIKIMI I ROLEVE SEMANTIKE NË STRUKTURËN E FJALISË DHE
RENDIN E FJALËVE NË GJUHËN ANGLEZE DHE SHQIPE****Abstract**

This paper examines how semantic roles influence sentence structure and word order in English and Albanian. While syntax provides the analysis of word functions in sentences, semantics determines whether that structure is logically acceptable or not. Based on major linguistic theories, including generative, functional, typological and cognitive approaches, the study discusses how semantic roles can have an influence on sentence structure and word order patterns. English depends on fixed word order to express syntactic functions, whereas Albanian has a flexible word order, allowing greater structural flexibility. Special attention is given to areas like syntactic functions, verb agreement with collective nouns and the interpretation of homonyms or ambiguous words. By comparing the two languages, this paper demonstrates that semantics is not only an additional component of grammar, but a very important aspect that influences how sentences are formed, understood and translated. The analysis of different sentences shows that meaning may not only influence sentence structure, but it also reveals possible syntactic differences in translated sentences to English or Albanian language.

Keywords: *Semantic roles, sentence structure, word order, English, Albanian.*

Introduction

The relationship between meaning and sentence structure is one of the most important aspects of language, showing how languages organize and convey information. When people communicate, they do not simply use words according to a set of rules. Instead, they constantly rely on their understanding of the world, the relationships between people and actions and the intentions behind an utterance. This is why a sentence may look grammatically correct on the surface, but still sound completely wrong to a speaker if its meaning does not 'fit' in reality. Meaning is somehow the invisible force that holds a sentence together and allows it to express a clear and sensible message or information.

English and Albanian are particularly interesting to compare in this regard because they rely on different strategies for connecting meaning with structure. English depends on word order to communicate who is doing what in a sentence. The typical subject-verb-object pattern is not just a syntactic preference, but it is how English sentences show who performs an action and who receives it. A small change in this pattern can change the meaning of a sentence, or in some cases make it sound unnatural or confusing. Albanian, on the other hand, is more flexible regarding word order. Because it uses rich inflectional endings that show the grammatical roles, its word order can change more freely without causing misunderstanding. Albanian speakers can place words earlier or later in the sentence, without losing clarity about which the subject or object is. However, Albanian still tends to follow the same basic principle as English even with such flexibility because the meaning must be logical. If the semantic roles do not make sense, the sentence will not be accepted by speakers, no matter how correct its structure might seem.

The connection between meaning and structure becomes especially important in translation. When a sentence is translated from one language to another, the grammatical form may change, but the meaning should remain the same. For example, Albanian may place certain words at the beginning of the sentence for emphasis, while English might require them to stay later in the clause. Despite structural differences, the information must still be conveyed in the same way. This is why semantics helps speakers understand sentences with words that have more than one meaning or sentences where the structure does not clearly show the subject or object. People use their everyday knowledge of the world to choose the interpretation that makes the most sense. Without the help of meaning, communication would be more ambiguous or even confusing.

The relationship between semantics and syntax shows us that language is not only a set of rules, but a flexible system guided by meaning. English and Albanian may use different approaches on sentence formation in different situations, but they both rely on the same fundamental principle, i.e., a sentence must express a logical and meaningful message in order to be considered grammatically acceptable.

Methodology

This study used a combination of theoretical and comparative approaches to show how semantics influences sentence structure and word order in English and Albanian. Different linguistic perspectives and theories were reviewed, including functional, cognitive, and generative perspectives. Key ideas such as semantic roles, sentence structure, collective nouns, agreement and word order patterns were examined in the study. The literature review enabled a clear understanding of how meaning is connected with syntactic analysis and helped identify similarities and differences between English and Albanian in relation to sentence formation. The comparative method was used to analyze translated sentences between English and Albanian. Different sentences including collective nouns, homonyms or ambiguous words were selected for comparison. Each sentence was translated to see if there are similarities or differences regarding word order, verb agreement or sentence acceptability.

Literature Review

The influence of semantics on sentence structure has been a major topic across linguistic theory, approached from multiple perspectives. From the generative point of view, Chomsky demonstrated that the notion 'grammatical' cannot be identified with 'meaningful' or 'significant' in any semantic sense (Chomsky, 1957: 15). His example, '*Colorless green ideas sleep furiously.*', is grammatically correct but semantically odd, showing that only syntax cannot determine if a sentence is acceptable or not to speakers. This example shows the importance of semantic influence in determining the meaning of a sentence. On one hand, grammatical relationships are indicated by terms such as subject-object, whereas semantic relationships by agent-patient, i.e., linking syntactic roles with semantic roles (agents, patients and other elements) is standard in finding the types of sentence structures (Berge 2011:103). On the other hand, it is not enough only to arrange words according to grammatical rules, but relationships among syntactic and semantic roles must also make sense. The entity that performs the action ('*doer*') is termed the '*agent*', while the entity that receives the action is termed the '*patient*' also known as semantic roles, and together they form an argument structure that requires agreement between the roles involved and the number of arguments present in a sentence (Van Valin 2001:23). These semantic roles are important when languages are compared, because the meaning still needs to be clear regardless if their grammar rules may be different or not.

Although semantic roles cannot be absolutely related to grammatical functions, they play certain roles in certain grammatical constructs (Jong-Bok & Sells 2008:43). The semantic roles play an important role in Albanian, but the place of words in a sentence in English is determined depending on word order patterns. While the word order of certain languages depends on certain semantic and pragmatic roles, in English sentences are arranged

according to word order and prepositions, with morphological changes only of the pronouns (Chang & Lakoff 1997:3), demonstrating that English depends on word order to express roles that other languages might mark morphologically.

When sentence elements are considered, grammar categories must follow certain rules that apply to certain languages. Typological universals need to be established and they must be semantically based (Dixon 1994:112). Such typological universals enable certain languages to assign word order rules that can be compared to other languages if similarities or differences exist. In English, fixed word order (Quirk et al. 1985:739) is crucial to semantic roles, while in Albanian, word order is flexible and it is more a matter of a style (Nuhiu 2013:283). We can see here that typological universals are not related only to word order, but to other factors as well. Such factors can have an influence on word order and sentence analysis. Furthermore, meaning can influence grammatical choices across languages, including verb agreement and collective nouns.

Cognitive approaches to grammar provide a complementary but also very important perspective. The order of presentation (word order) is conceptually and semantically consequential even when word order is not a factor (Langacker, 2008:80). This means that the semantic effect has a locative expression. These cognitive operations explain why certain sentences are preferred over others (*A dead body was found in the middle of the ocean./In the middle of the ocean was found a dead body.*), even when multiple forms are technically and syntactically correct. In translation, for example, Albanian speakers may reorder words for emphasis without losing the underlying semantic relationships, while English requires consistent SVO order to maintain clarity.

Further research on collective nouns and agreement highlights the interaction between meaning and grammatical form. The meaning of the word is very important with regard to collective nouns and is the only role that is taken into account in deciding whether the verb with a collective noun will be used in the singular, in the plural or in both singular and plural (Depraetere 2011:88). In English, collective nouns such as *team* or *jury* may take singular or plural verbs depending on whether the individuals are acting as a unit or individually. Albanian, in contrast, often treats collective nouns as singular, reflecting the semantic view of the group as a whole. These differences demonstrate how semantic interpretation affects verb agreement, word order and subject identification, illustrating that meaning drives grammatical decision-making in different ways.

The Influence of Semantic Roles on Word Order

Meaning drives sentence formation, rather than abstract syntactic rules. Halliday argues that there is a close semantic relationship between the system of 'information' and 'theme', and it is the speaker who assigns the structures in order to give a texture to the discourse and relate it to its environment (Halliday 2014:120). This means that semantic roles such as

agent/patient or theme/rheme can guide the choice of syntactic structure. However, in English, the fixed subject–verb–object order ensures that the agent and patient are clearly identifiable, whereas Albanian may use flexible word order supported by inflections to achieve the same semantic clarity. Therefore, the structure of a sentence can depend on the interpretation and the communicative context.

A sentence must be correct both grammatically (in terms of morphology and syntax) and semantically. For example, the sentences '*Djali e theu drinten./The boy broke the window.*' and '*Dritarja e theu djalin./The window broke the boy.*' have the same syntactic structure (subject-predicate-object), but the first is correct, and the second is not semantically correct. In this case, the roles of agent and object, or subject and object, must be clearly identified. The surface structure of the sentence is not enough to have a grammatically correct sentence. Semantics and the semantic roles discussed earlier have proven to be essential in the formation of correct sentences. This applies not only to Albanian and English, but to all languages in the world. Regardless of differences in word order when a sentence is translated into another language, its meaning must remain the same. Failure to meet semantic requirements also results in an incorrect sentence.

Collective nouns are abundant and such examples in English are the nouns *government/qeveri*, *team/ekip*, *family/familje*, *people/njerëz*, *police/polici*, etc. Below are examples where semantics plays a key role in determining the verb number, which affects the agreement between the subject and predicate:

- a. **The jury has delivered its verdict./Juria e ka marr vendimin e saj.**
- b. **The jury have not reached a verdict./Juria nuk e ka marr vendimin.**

In these examples, we can see that in both English and Albanian we have the same collective noun. The verb takes both singular and plural forms in English, but only the singular form in Albanian. This is because in cases where individuals act together, or as a group, the collective noun is normally singular, while in cases where individuals act individually, the collective noun is in plural. Although this is a noticeable difference between English and Albanian, it also occurs between British and American English. In American English, collective nouns generally take singular verbs, especially for sports teams, institutions or companies, while in British English they take plural verbs (Einsohn & Schwartz 2019:343). For example:

- a. *My family is there./Familja ime është atje.*
- b. *Chelsea were Premier League Champions./Çelsi ishte kampioni i Premier Ligës.* (British Mirror)
- c. *How Manchester United Sees Digital As the Key To Future Commercial Success./Si e sheh Manchester Junajtedi digjitalizimin si çelës të suksesit tregtar të ardhshëm.* (American Forbes)

Although these English examples allow for variation, in Albanian collective nouns usually take singular verbs, since they are considered as a whole rather than as individual elements. Certain collective nouns require the plural form in both languages because their form itself denotes plurality.

- a. *The people **were** happy./Njerëzit **ishin** të lumtur.*
- b. *Cattle **eat** grass./Bagëtia **hanë** bar.*

These cases are few because collective nouns that are strictly plural are limited, and here semantics clearly dictates that the verb takes the plural form. In the first example above, it should be highlighted that the noun 'people' is considered a collective noun, while in Albanian it is not treated as a collective noun. In the second sentence, the noun 'cattle' is a collective noun, as is 'bagëtia' in Albanian, but there is a discrepancy in the verb number. English uses a plural verb, while Albanian also uses a plural verb, yet the treatment of the collective nouns differs slightly in terms of agreement expectations.

The role of semantics is particularly significant when dealing with homonyms. Consider the following examples:

- a. *The tree **barks** are cracked./Lëvozhgët e pemëve janë të plasaritura.*
- b. *The dog **barks**./Qeni **leh**.*
- c. *Investors **eye** shares of hotels.(Reuters)/Intestitorët **synojnë** aksionet e hoteleve.*

While the syntactic aspect, particularly word order, is important, at first glance there may be confusion regarding the syntactic roles. In such cases, semantics also plays a crucial role in determining these roles. Even in situations when a word may have an identical form, it can carry different meanings, different syntactic roles, and result in sentences with different constituents (adverbials or subject complements). An example where slight confusion may arise is the last sentence above. The word 'eye' can be interpreted as the noun 'eye', but it also functions as the verb 'see/aim', because at first glance one might mistakenly take 'eye' as part of the noun phrase 'investors eye (syri i investorëve)'. Semantic analysis is therefore essential in identifying the predicate and achieving an accurate syntactic analysis of the sentence structure.

Even though English and Albanian use different strategies for word order, with English relying on fixed word order and Albanian on inflections, both reflect the same semantic principles in sentence structure, confirming that semantics plays an important role in syntax. Meaning influences sentence formation by guiding word order, verb agreement, and interpretation, ensuring that sentences are both grammatical and coherent.

Conclusion

This study shows that semantics is a crucial factor in shaping sentence structure and word order in both English and Albanian. Despite the differences in their strategies, English depending largely on fixed word order, and Albanian using flexible word order supported by rich morphological inflections, both languages rely on the same fundamental principle: sentences (translated sentences) must convey a logical and meaningful message. Semantic roles, such as agent, patient, theme, and rheme, guide the assignment of syntactic functions, influence verb agreement, and ensure clarity and coherence in sentence formation.

The analysis of collective nouns illustrates how meaning affects whether a verb appears in singular or plural form, reflecting differences not only between languages but also within varieties of English, such as British and American usage. Similarly, examples involving homonyms demonstrate that syntactic analysis alone is insufficient to determine grammatical correctness. Semantic interpretation is essential for identifying syntactic functions, understanding relationships between sentence elements and avoiding ambiguity.

Furthermore, the comparison of translated sentences between English and Albanian highlights that meaning must be preserved regardless of structural differences. Even when word order varies or morphological markers differ, semantic roles provide a reliable guide for maintaining clarity and consistency. This confirms that semantics is not only an auxiliary aspect of language, but a central component that helps syntax to produce sentences that are both grammatically correct and meaningful.

References:

- Berge, A. (2011). *Topic and Discourse Structure in West Greenlandic Agreement Constructions*. University of Nebraska Press.
- Chang, N., Lakoff, G. (1997). 'Semantic role marking: A preliminary report', Fall.
- Chomsky, N. (1957). *Syntactic Structures*. The Hague: Mouton.
- Depraetere, I. (2011). 'On Verbal Concord with Collective Nouns in British English', HAL.
- Dixon, R. M. W. (1994). *Ergativity*. Cambridge: Cambridge University Press.
- Einsohn, A., Schwartz, M. (2019). 'The Copyeditor's Handbook: A guide for Book Publishing and Corporate Communications', University of California Press, Fourth Edition.
- Halliday, M. A. K. (2014). *Halliday's Introduction to Functional Grammar* (4th ed.). Routledge.
- Jong-Bok, K., Sells, P. (2008). 'English Syntax: An Introduction', Center for the study of language and information.
- Langacker, R. W. (2008). *Cognitive Grammar: A Basic Introduction*. Oxford University Press.
- Nuhiu, V. (2013). *Ndikimi i anglishtes në gjuhën shqipe*. ASHAK, Prishtinë.
- Quirk, R., Greenbaum, S. Leech, G. & Svartvik J. (1985). *A Comprehensive Grammar of the English Language*. Longman.
- Van Valin R.D. (2001). *An Introduction to Syntax*. Cambridge University Press.

Punim studimor**Drita XHEMAI**

Universiteti „Nënë Tereza“ në Shkup

drita.xhemai@unt.edu.mk

**TRANSFORMIMI I ROLIT TË MËSIMDHËNSIT TË GJUHËS GJERMANE
(DaF) NË KONTEKSTIN E INTELIGJENCËS ARTIFICIALE****THE TRANSFORMATION OF THE ROLE OF THE GERMAN LANGUAGE
(DaF) TEACHER IN THE CONTEXT OF ARTIFICIAL INTELLIGENCE****Përmbledhje**

Integrimi i Inteligjencës Artificiale (IA) në mësimdhënien e gjuhës gjermane si gjuhë e huaj (DaF) po riformëson në mënyrë thelbësore rolin profesional të mësimdhënsit dhe konceptet tradicionale të mësimnxënies. Ky punim synon të analizojë transformimin e rolit të mësimdhënsit të gjuhës gjermane (DaF) në kontekstin e përdorimit të mjeteve të bazuara në IA, duke u mbështetur në qasje teorike bashkëkohore të didaktikës së gjuhëve të huaja dhe studimeve mbi teknologjinë arsimore.

Punimi fokusohet në tri dimensione kryesore: (1) ndryshimin e funksioneve didaktike të mësimdhënsit nga transmetues i njohurive në facilitator të të nxëniet dhe ndërmjetës pedagogjik; (2) ndikimin e IA në zhvillimin e autonomies së studentëve dhe kompetencës reflektuese gjuhësore; si dhe (3) sfidat metodologjike dhe etike që lidhen me vlersimin e performances, autenticitetin e prodhimit gjuhësor dhe integritetin akademik. Metodologjikisht, punimi mbështetet në analizën teorike, shqyrtimin kritik të literaturës aktuale dhe reflektimi didaktik mbi praktikat e mësimdhënies së gjuhës gjermane si gjuhë e huaj (DaF).

Fjalë kyçe: *IA, roli i mësimdhënsit, didaktika e gjuhëve të huaja, DaF*

Abstract

The integration of Artificial Intelligence (IA) into the teaching of German as a Foreign Language (DaF) is fundamentally reshaping the professional role of the teacher and traditional concepts of teaching and learning. This paper aims to analyze the transformation of the role of the German language (DaF)

teacher in the context of using AI based tools, drawing on contemporary theoretical approaches in foreign language didactics and educational technology studies.

The paper focuses on three main dimensions: (1) the shift in the teacher's didactic funktion from a transmitter of knowledge to a facilitator of learning and a pedagogical mediator; (2) the impact of IA on the development of learner autonomy and reflective linguistic competence; and (3) the methodological and ethical challenges related to performance assessment, the authenticity of language production, and academic integrity. Methodologically, the paper is based on theoretical analysis, a critical review of current literature, and didactic reflection on teaching practices in German as Foreign Language (DaF).

Keywords: *AI, teacher's role, foreign language didactics, DaF*

Hyrje

Inteligjenca artificiale (IA) po transformon fushën e arsimit dhe po krijon mundësi të reja për mësimdhënien dhe të nxëniet, veçanërisht në kontekstin e mësimet të gjuhëve të huaja. Mjetet digjitale të bazuara në IA, të tilla si gjeneratorët e tekstit, platformat interaktive dhe aplikacionet për ushtrime gjuhësore, mundësojnë personalizimin e mësimet, zhvillimin e aftësive të të shkruarit dhe ofrojnë feedback të menjëhershëm për nxënësit (Selimi & Cantieni, 2021). Këto teknologji janë gjithashtu të afta të mbështesin mësuesit në planifikimin e aktivitetëve të mësimet dhe në krijimin e materialeve mësimore më ti përshtatur për nevojat individuale të nxënësve. Sipas Matthias Leichtfried (2025), potenciali i përdorimit të IA-së në mësimin e gjermanishtes nuk qëndron vetëm në aspektin teknik, por edhe në mënyrën se si mësuesit zhvillojnë ide kreative për integrimin e këtyre mjeteve në procesin mësimor. Leichtfried thekson rëndësinë e kombinimit të një kuadri teorik të mirëkuptuar mbi bazat e IA-së dhe testimit praktik të mjeteve të përzgjedhura, për të krijuar një hapësirë reflektimi pedagogjik dhe inovacioni didaktik. Përmes përdorimit të qasjes eksperimentale, mësuesit mund të identifikojnë mënyrat më efektive për të përmirësuar aftësitë gjuhësore të nxënësve dhe për të nxitur një mësim më të personalizuar dhe më të angazhuar (Leichtfried, 2025).

Ky punim ka për qëllim të shqyrtojë potencialin didaktik të mjeteve të bazuara në IA për zhvillimin e aftësive gjuhësore të nxënësve në kontekstin e DaF/DaZ. Ai përfshin një prezantim të kuadrit teorik mbi bazat e IA-së dhe diskuton mënyrat praktike të integrimet të këtyre mjeteve në mësimdhënie, duke përfshirë avantazhet, kufizimet dhe sfidat e mundshme. Duke u mbështetur në qasjen e Leichtfried, studimi synon të ofrojë udhëzime konkrete për mësuesit dhe të nxjerrë në pah rëndësinë e përdorimit të ndërjegjshëm dhe të planifikuar të teknologjive digjitale në procesin mësimor.

Përveç kësaj, punimi do të trajtojë ndikimin e IA-së mbi motivimin e nxënësve, shkallën e angazhimit të tyre në aktivitete gjuhësore dhe mundësitë për zhvillimin e kompetencave të komunikimit shkruar dhe të

leximit të kuptueshëm. Duke lidhur teorinë me praktikën, studimi synon të ofrojë një perspektivë gjithëpërfshirëse mbi përdorimin e teknologjive digjitale në mësimin e gjuhës dhe të kontribuojë në literaturën ekzistuese mbi inovacionin pedagogjik në kontekstin e arsimit gjuhësor.

Studentët duhet t'i përdorin mediat digjitale në mënyrë të pavarur në mësim

Studentët mësojnë më së miri kur janë aktivë, kur lëvizin, flasin, luajnë, bashkëbisedojnë dhe punojnë me materiale dhe mjete të caktuara. Arritjet më të vogla në të nxënë realizohen vetëm përmes dëgjimit dhe shikimit. Përsëritja e një përmbajtjeje disa herë ose paraqitja e gjuhës së folur me ndihmën e mediave digjitale nuk përbën garanci për ndryshime të qëndrueshme në nivelin e njohurive të studentëve.

Për këtë arsye, është e rëndësishme që studentët të mos jenë (vetëm) konsumatorë pasivë të mediave digjitale, por të nxiten që t'i përdorin ato vetë në mënyrë aktive. Mësimi me prani fizike duhet të përfshijë rregullisht faza pune me media digjitale, të cilat duhen integruar në mënyrë kuptimplote në skenarë didaktikë dhe të shoqërohen me detyra konkrete (p.sh. Chatgpt, wiki, Google, blogje, WhatsApp, aplikacione të krijuara vetë etj.), që i inkurajojnë studentët në mësimnxënie të vetëorganizuar.

Në këtë kontekst, roli i mësimdhënësit duhet të tërhiqet në plan të dytë dhe ai/ajo duhet të funksionojë kryesisht si **këshilltar/e dhe udhëzues/e** i procesit të të mësimnxënies.

Veçoritë positive dhe negative të Inteligjencës Artificiale në mësimdhënien e Gjermanishtes si Gjuhë e Huaj (DaF)

Sipas Matthias Leichtfried (2025: 7), inteligjenca artificiale gjeneruese ofron një sërë potencialesh të dukshme në përpunimin e gjuhës, gjenerimin dhe analizën e teksteve, sistemet e dialogut, multimodalitetin dhe përkthimin automatik. Konkretisht, ChatGPT dhe mjetet e ngjashme mund të përpunojnë gjuhën natyrore dhe të ofrojnë korrigjime dhe sugjerime për formulimin e teksteve, të gjenerojnë tekste të reja me koherencë dhe relevancë, të analizojnë informacion dhe të nxjerrin modele gjuhësore, të funksionojnë si sisteme dialogu për përgjigje pyetjesh dhe mbështetje, të bashkohen formate të ndryshme si tekst, imazhi, muzikë dhe video, si dhe të përkthejnë tekste nga një gjuhë në tjetrën. Këto aftësi e bëjnë IA-në të dobishme për individë, organizata dhe institucione që operojnë në një kontekst ndërkombëtar dhe digjital.

Siç ilustron në imazhin e mëposhtëm të paraqitur nga Leichtfried (2025: 7) dhe të përkthyer në shqip nga ChatGPT, mund të vërehen gabime drejtshkrimore në përkthim. Kjo thekson nevojën që mësimdhënsi i gjuhës së huaj të kryejë një kontroll të kujdesshëm të versionit final para se ai të përdoret si material mësimor për studentët.

Anët pozitive dhe negative të inteligjencës artificiale (IA) gjeneruese

(sipas Matthias Leichtfried, 2025)



Nga ana tjetër, Leichtfried thekson kufizimet e dukshme të IA-së. Mungesa e lidhjes së drejtpërdrejtë me botën reale bën që IA të mos ketë modele mentale të hapësirës dhe kohës, dhe të mos njohë të vërtetën në mënyrë autonome. Ajo varet plotësisht nga të dhënat e trajnimit, që mund të përmbajnë struktura diskriminuese dhe të kufizojë diversitetin gjuhësor, duke sjellë paragjykimet të integruara (bias). Gjenerimi i përmbajtjeve të pavërteta ose pa kuptim ("hallucinime") është gjithashtu një sfidë e rëndësishme, ndërsa konsum i lartë i energjisë dhe i burimeve teknologjike përpunuese përbën një tjetër kufizim.

Në këtë mënyrë, Leichtfried (2025: 29) paraqet inteligjencën artificiale gjeneruese si një mjet me **avantazhe të dukshme për mbështetjen e proceseve gjuhësore dhe komunikimit**, por gjithashtu si një teknologji që **kërkon përdorim të kujdesshëm dhe kritik**, duke marrë parasysh kufizimet etike, teknologjike dhe didaktike. Në imazhin e mëposhtëm paraqitet një përmbledhje e aspekteve negative të inteligjencës artificiale (IA), sipas Leichtfried (2025). Ky përfaqësim vizual synon të ilustrojë kufizimet dhe sfidat kryesore që lidhen me përdorimin e IA-së, duke përfshirë mungesën e lidhjes me realitetin, varësinë nga të dhënat ekzistuese dhe pamundësinë për të ofruar një kuptim të thellë të kontekstit njerëzor.

universität wien **Çfarë nuk mund të bëjë inteligjencës artificiale gjeneruese (IA?)**
(sipas Matthias Leichtfried, 2025)

- Mungesa e lidhjes me botën (korrelacione dhe jo e vërtetë)**
 - S'është lidhur thellë me botën
 - Nuk ka modele mentale ose koncepte si hapësira dhe koha
- Paragjykimet (Bias)**
 - Varet nga të dhënat e trajnimit: "Garbage in, garbage out!"
 - Struktura diskriminuese në të dhënat e trajnimit mund të përcillen te modeli
 - Shumica e të dhënave të trajnimit në anglisht
- Halucinimet**
 - Gjeneron përmbajtje që s'është e vërtetë ose pa kuptim (bullshit)
- Konsum i energjisë**
 - Ka një konsum të lartë të energjisë
- Përdor shumë burim**
 - Përdor shumë burime (ftohje me ujë)

Roli i/e mësimdhënës/it/es së gjuhës gjermane në procesin mësimor në epokën e IA

Sipas trekëndëshit didaktik të Reusser-it (2009) të paraqitur nga Jadin, Rami Schwarz & Buchinger (2025: 188), mësimdhënësi zë një pozicion qendror në procesin e mësimdhënjes dhe të nxënit. Roli i tij/saj shtrihet përtej thjesht transmetimit dhe aktivizimit të dijes, duke përfshirë në mënyrë të veçantë kujdesin sistematik dhe mbështetjen e nxënësve gjatë procesit mësimor. Objektivi kryesor është krijimi i një kulture ndërveprimi dhe mbështetjeje që promovon të nxënit, duke shoqëruar proceset individuale të të nxënit dhe duke integruar dimensionet motivuese dhe sociale të të nxënit.

Në këtë kuadër, mësimdhënësi vepron si shoqërues i të nxënit dhe si ndërmjetës didaktik, duke mbështetur nxënësit përmes dhënies së reagimeve të strukturuar, ofrimit të ndihmës pedagogjike, moderimit të proceseve sociale dhe krijimit të një klime pozitive dhe gjithëpërfshirëse të mësimi (krahaso Reinmann, 2015). Ky qasje thekson rëndësinë e rolit të mësimdhënësit jo vetëm si burim i dijes, por edhe si facilitator i zhvillimit të kompetencave individuale dhe i autonomisë së nxënësve, duke reflektuar praktika të bazuara në hulumtime didaktike të avancuara.

Meyer (2003) identifikon disa faktorë kyç për një mësim të suksesshëm, përfshirë një klimë mësimore që nxit të nxënit, biseda mësimore me kuptim, përfshirjen e rregullt të reagimeve të nxënësve si dhe mbështetjen individuale të studentëve. Një aspekt thelbësor në këtë kontekst është marrëdhënia ndërpersonale midis mësimdhënësve dhe nxënësve. Hattie et al. (2013) theksojnë se një marrëdhënie e besueshme ka një ndikim të konsiderueshëm në suksesin e të nxënit. Ky aspekt forcohet nga

disponueshmëria dhe gatishmëria për të ndihmuar e mësimeve, si dhe nga trajtimi me respekt i studentëve, të cilët konsiderohen si elemente bazë të një mësimeve cilësore (krahaso Ulrich, 2016). Për më tepër, shkëmbimi midis mësimeve dhe nxënësve gjatë procesit të të nxënësve ka një rëndësi të madhe. Ndërsa nxënësit përfitojnë nga mbështetja dhe reagimet e synuara, mësimeve marrin reagime të vlefshme për të reflektuar mbi mësimeve e tyre dhe për ta përmirësuar atë.

Në peizazhin arsimor në ndryshim të vazhdueshëm, roli i mësimeve mbetet qendror, edhe përkundër zhvillimeve teknologjike dhe mundësive që ofron inteligjenca artificiale (IA). IA mund të përdoret, për shembull, si tutor për të ofruar ndihmë dhe mbështetje studentëve gjatë procesit të të nxënësve, ndërsa sistemet inteligjente tutorale, si **MetaTutor**, mund t'i asistojnë ata në zhvillimin e strategjive metakognitive (krahaso Bouchet et al., 2016). Megjithatë, edhe pse ekzistojnë prova për përfitime konkrete nga përdorimi i chatbot-ëve dhe mjeteve të tjera teknologjike, këto sisteme janë ende larg zëvendësimit të mësimeve (krahaso Tack & Piech, 2022). Në fakt, përfshirja e IA-së në procesin arsimor nuk zvogëlon rëndësinë e rolit të mësimeve, por shpesh e transformon atë drejt funksionit të një **coach-i dhe udhërrëfyesi të të nxënësve**, duke rritur rëndësinë e formave konstruktiviste të mësimeve (krahaso de Witt et al., 2020; Bates et al., 2020). Kjo qasje nënvizon nevojën për kalimin nga format **teacher-centered** drejt formave **learner-centered**, ku përqendrimi është tek nxënësi dhe zhvillimi i autonomisë së tij (krahaso Brown, 2003; Serin, 2018; Wright, 2011). Përveç funksionit të tij didaktik, mësimeve ka një rol thelbësor në mbështetjen individuale të nxënësve, duke marrë parasysh interesat dhe nevojat e tyre, duke ofruar ndihmë për strategjitë e të nxënësve dhe duke menaxhuar sfidat motivuese dhe emocionale, ku aftësia për empati mbetet një faktor kyç që nuk mund të zëvendësohet nga sistemet teknologjike (krahaso Reinmann, 2015; Kovács, 2023). Kështu, mësimeve vazhdon të jetë qendra e procesit arsimor, ndërsa inteligjenca artificiale shërben si një mjet mbështetës që mund të lehtësojë detyrat rutinë dhe të rrisë cilësinë e të nxënësve për studentët.

Përfundime dhe konkluzione

Bazuar në hulumtimet e kryera, del se inteligjenca artificiale mund të ofrojë mbështetje të rëndësishme për mësimeve, duke lehtësuar detyrat rutinë dhe duke mbështetur proceset teknike të komunikimit, pa zëvendësuar rolin e tyre qendror në mësimeve. Mësimeve mbeten aktorët kryesorë për krijimin dhe ruajtjen e një kulture ndërvetë dhe mbështetjeje që promovon të nxënësve, duke kombinuar njohuritë pedagogjike me aftësitë për empati dhe motivim të studentëve. Integrimi i IA-së duhet të shihet si një **mjet mbështetës** që pasuron praktikën arsimore dhe rrit efikasitetin, ndërkohë që mësimeve përqendrohet në detyra komplekse pedagogjike dhe shërben si udhërrëfyes dhe mentor. Në këtë kontekst, rekomandohet që përdorimi i IA-së të zhvillohet në mënyrë të

ndërgjegjshme dhe të integruar, duke ruajtur dimensionin social dhe motivues të mësimdhënies, dhe duke promovuar kombinimin e qasjeve tradicionale dhe inovative në procesin e mësimnxënies.

Literatura

Bouchet, F., Harley, J.M., & Azevedo, R. (2016). Can adaptive pedagogical agents` prompting strategies improve students` learning and self-regulation? *Lecture notes in computer science*. (368-374).

Budde, J., Todor, J. & Friedrich J. (2024) Künstliche Intelligenz. Wo stehen die deutschen Hochschulen? *Hochschulforum Digitalisierung*.

Bimmel, P., & Rampillon, U. (2000). *Lernerautonomie und Lernstrategien*. München: Langenscheidt.

Council of Europe. (2020). *Common European Framework of Reference for Languages: Learning, teaching, assessment – Companion volume*. Strasbourg: Council of Europe.

Goethe-Institut. (2023). *Digitale Medien im DaF-Unterricht*. München: Goethe-Institut.

Hallet, W., & Königs, F. G. (Hrsg.). (2010). *Handbuch Fremdsprachendidaktik*. Seelze: Klett Kallmeyer.

Kovacs, L. (2023). *Künstliche Intelligenz und menschliche Gesellschaft*. De Grueter.

Krommer, A. (2019). *Digitale Bildung im Unterricht*. Weinheim: Beltz.

Reusser, K. (2009). Von der Bildungs- und Unterrichtsforschung zur Unterrichtsentwicklung: Probleme, Strategien, Werkzeuge und Bedingungen. *Beiträge zur Lehrerbildung*, 27 (3), 295-312.

Roth, G. (2021). *Bildung braucht Persönlichkeit. Wie Lernen gelingt*. Klett-Cotta

Leichtfried, Matthias: 2025, Institut für Germanistik, KI-Tools im DaZ- und DaF-Unterricht Workshop am 02.10. und 17.10. / Bozen (online).

Tack, A., & Piech, C. (2022). The AI teacher test: Measuring the pedagogical ability of Blender and GPT-3 in educational dialogues.

Knežević, Ž., Petrušić, K., & Jurković, M. (Hrsg.): 2023. *Lernen und Lehren mit digitalen Medien im DaF-Unterricht: Ergebnisse des Projekts Digital – Interkulturell – Projektorientiert in Südosteuropa (DIP in SOE)*. Goethe-Institut e.V. München.

Punim studimor**Albulena DEHARI**

Universiteti Nënë Tereza –Shkup
Fakulteti i Shkencave Humane
albulena_dehari@unt.edu.mk

SHQIPJA E CENUAR NGA FJALËT E HUAJA**ALBANIAN AFFECTED BY FOREIGN WORDS****Përmbledhje**

Në këtë punim do të paraqes një problem i cili është në zhvillim e sipër, kur them kështu ai po vazhdon edhe sot e kësaj dite të shfaqet me të madhe, pra do të flas rreth përdorimit të pavend të fjalëve të huaja në leksikun e shqipes. Kohët e fundit jemi dëshmitar se shqipes po i cenohen fjalët e shprehjet e bukura të saj duke u zëvendësuar me fjalë e shprehje të huaja kryesisht fjalë e shprehje të gjuhës angleze. Ky ritëm i huazimit të panevojshëm ka marrë aq shumë hov sa nuk ka të ndalur as nga mediat, as nga politikanët e mos përmendim më të rinjtë që janë lokomotiva kyçe e këtyre huazimeve të panevojshme. Me këto nuk arrihet asgjëkundi vetëm se po baltoset shqipja jonë e bukur, ku shumë fjalë e shprehje të bukura po futen në harresë të gjuhës. Qëllimi ynë është të mos lejojmë që fjalë të cilat nuk i përkasin brumit të shqipes të futen në leksikun e gjuhës. Aty ku nuk ka nevojë të mos përdoren. Këtë punim do ta trajtojmë duke shikuar disa media e portale të vendit se si i paraqesin lajmet e tyre dhe sa fjalë e shprehje të panevojshme përdorin. Duhet të jemi të vetëdijshëm se ne jemi ata të cilët përmes gjuhës e mbrojmë kombin tonë, duke e mbushur me huazime të panevojshme, ne vetëm qe po e shtyjme atë të shkoj pas dhe harrojmë se nga kjo gjuhë pra nga shqipja rrjedh edhe endonimi shqiptar dhe toponimi Shqipëri, pra jemi të detyruar që ta mbrojmë e kujdesemi për të.

Fjalë kyçe: *Shqipja, cenimi, mbrojtja, huazime, media.*

Abstract

In this paper, I will present a problem which is in progress, when I say so, it continues to appear even today, so I will talk about the inappropriate use of foreign words in the Albanian lexicon. Recently, we have witnessed that the Albanian language is being attacked by its beautiful words and expressions, being replaced by foreign words and expressions, mainly words and expressions of the English language. This rate of unnecessary borrowing has taken off so much that it has not been stopped by the media, nor by politicians, not to mention the young people who are the key locomotive of these unnecessary loans. With these, nothing is achieved except that our beautiful Albanian language is muddied, where many beautiful words and expressions are being forgotten by the language.

Our goal is not to allow words that do not belong to the Albanian dough to enter the lexicon of the language. Where there is no need not to use them. We will deal with this paper by looking at some media and portals of the country, how they present their news and how many unnecessary words and expressions they use. We must be aware that we are the ones who protect our nation through the language, by filling it with unnecessary borrowings, we are only pushing it to go behind and we forget that from this language, that is, from Albanian, the Albanian endonym and our name is Albania, so we are obliged to protect it and take care of it.

Key words: Albanian, encroachment, protection, loans, media.

Hyrje

Gjuha shqipe, padyshim që është ndër gjuhët më të vjetra, si e tillë ajo ka pasur shumë vështirësi për t'i mbijetuar kohës e për të vijuar të jetë e pranishme edhe në ditët e sotme.

Jemi të vetëdijshëm se kemi kaluar jo pak kohëra të vështira, e sundime të shumta të cilët qëllimin kryesor e kanë pasur që ta zhdukim gjuhën shqipe dhe bashkë me të edhe kombin shqiptar, por qëllimet e tyre nuk janë realizuar. Me shumë vështirësi dhe me shumë mund e luftë e kemi ruajtur gjuhën nga gjakpirësit e vendit.

Por gjatë gjithë kësaj kohe gjuha nuk ka qëndruar në një vend. Ajo i ka pasur lëvizjet e saja, duke marrë fjalë e shprehje nga ata që na kanë sunduar, të cilat përdoren edhe sot e kësaj dite, por që nuk janë bërë pjesë e normës së shqipes, por që përdoren ndër njerëz.

Jeta ka evoluar bashkë me të edhe gjuha, kështu që kemi shumë fjalë e shprehje të cilët në gjuhë janë futur bashkë me objektin dhe sendin për të cilin ne nuk kemi pasur një shprehje. Nuk mund të mohojmë se për shumicën e gjërave kemi gjetur fjalë gjegjëse shqipe, por për një numër të madh nuk kemi mundur dhe i kemi marrë ashtu siç kanë qenë në gjuhën nga e cila e kemi bërë huazimin.

Qëllimi i punimit tonë, nuk është që të shohim se si kanë hyrë huazimet në gjuhën tonë, por të shohim rreziqet që i kanosën gjuhës nga fjalë e shprehje të cilat janë futur në gjuhë nga gjuhë të tjera, për të cilat ne kemi

fjalë e shprehje shumë të bukura të shqipes. Ky trend i futjes së fjalëve e shprehjeve nga gjuhët e tjera kohët e fundit ka një zhvillim të hovshëm. Nuk po bëhet vetëm nga të rinjtë, por e dëgjojmë nga profesorë, nga politikanë madje edhe nga gazetarë të ndryshëm, të cilët ndikojnë më shumë tek masa e popullit dhe duke i dëgjuar ata mendojmë se kjo është normë dhe e përdorin edhe të tjerët.

Përdorimi i fjalëve të huaja në media, po ashtu edhe në komunikimin e përditshëm mes të rinjve, për të treguar apo shfaqur objekte e dukuri të ndryshme, po na tregon se gjuha shqipe po shkon drejt një degradimi apo drejt një fundosjeje të trajtave e të shprehjeve të saja të bukura.

Duke ditur se me evoluimin e gjuhëve ka evoluar edhe gjuha shqipe, gjatë komunikimit të përditshëm, por edhe të atij akademik, ne nuk kemi nevojë për fjalë e shprehje të huaja apo artificiale. Në gjuhën shqipe kemi mjaftueshëm fjalë me anë të të cilave ne mund të shprehim fakte e dukuri të ndryshme.

Këtu ne nuk po përmendim diçka që është e papërkthyer, apo kur bashkë me objektin kemi futur edhe fjalën në gjuhë. Dhe as nuk duam që përmes këtij punimi të tregohemi nacional e të themi se gjithë fjalët duhet t'i shqipërojmë apo t'i flasim në gjuhën shqipe. Jemi të vetëdijshëm që për shumicën e fjalëve nuk e kemi atë gjegjëse në gjuhën shqipe, por për një numër të konsiderueshëm fjalësh kemi.

P.sh.: pse duhet të themi *weekend* në vend që të themi fundjavë; pse të themi *meeting* në vend që të themi takim; përse të themi *workshop* në vend që të themi *seminar*, apo e kemi një shprehje thuajse të përditshme nga studentët të cilët thonë autobusi ishte *full*, pse ta përdorim si të tillë në vend që të themi ishte plotë. Do të shohim edhe në vijim të këtij punimi shembuj të ndryshëm të cilët lidhen me shumë shprehje të cilat vetëm se e kanë fjalën gjegjëse në gjuhën shqipe dhe nuk ka nevojë të futet një fjalë e huaj. Pra ne jemi, përballë pushtimit të termave të huaj në gjuhën shqipe; padijes së njerëzve që i përdorin; diktaturës së të ashtuquajturës politikisht korrekte apo modës së momentit.⁴⁸

1. Prishja e trajtave gjuhësore po cilësohet si modë

Për prishjen e shprehjeve, trajtave gjuhësore dhe kthimin e tyre në modë, nuk duhet hedhur faji vetëm tek të rinjtë të cilët janë më shumë në kontakt me gjuhën angleze, nga telefonat që përdorin, rrjetet sociale, mediat etj., Por një zakon i tillë vijon të përdoret edhe nga njerëzit të cilët kanë një ndikim më të madh. Së pari dua të them ashtu siç edhe shprehet Memushaj se “Natyrisht, qeliza e parë ku fillon kujdesi për gjuhën është familja. Prindi, qoftë edhe pa shkollim, luan për fëmijën rolin e mësuesit, sidomos nga faza kur fëmija nisë të flasë e deri sa hyn në klasë të parë”.⁴⁹ Po ashtu kjo vijë vijon

⁴⁸ <https://shqiptariitalise.com/ndotja-e-gjuhes-shqipe-nga-fjalet-e-huaja-te-panevojshme/>

⁴⁹ Memushaj, Rami, Për shqipen standarde II, Tiranë, 2012, f. 198.

edhe më tej ku duhet të edukohen edukatorët nëpër çerdhe që t'u flasin fëmijëve pastër shqip, mandej mësuesit nëpër shkolla duke vijuar me profesorët në gjimnaze e me pedagogët në universitet. Pra është një hallkë shumë e gjerë e cila ndikon në përvetësimin e mirë të shqipes apo në cenimin e saj.

Duke u nisur nga kjo ne po dëgjojmë se po hapet një *cooffe shop* në qytet, pse duhet ta themi në këtë formë duke mos e ditur kuptimin e saktë të saj në gjuhën nga e cila e marrim, pasi në gjuhën angleze *cooffe shop* do të thotë *bar*, kurse ne e kemi fjalën për një *lokal* apo për një *kafene* ku njerëzit mund të pinë diçka, por mbase kjo nuk duket aq moderne dhe po e përdorin këtë term të ri.

Fjalë e shprehje të huaja po dëgjojmë nga të gjithë mund të themi, dhe për çështje e dukuri të ndryshme, dëgjojmë vajzat të cilat thonë: nuk mund të dal pa bërë një *make up*, apo do të takohemi *live* për të folur për x çështje të caktuar, ose e themi fjalën *ok* për *mirë*, në çdo bisedë që bëhet duke e humbur thua se plotësisht ndajfoljen *mirë* të cilën e kemi kur duam të tregojmë se *ndjehemi mirë*, se jemi pajtuar me një çështje të caktuar e kështu me radhë.

Këtu po listoj disa fjalë të huaja të cilat përdoren pa nevojë: *abstract për përmbledhje, trend për tendencë, team për skuadër, bad për keq, party për festë, partner për mik apo shok, staff për personel, ok për mirë etj.*

Nga studentët me të cilët po punoj shpesh dëgjoj të them se edhe në gjuhën standarde shqipe kemi shumë fjalë të cilat nuk janë të shqipes, por ne nuk po flasim për ato fjalë të cilat kanë hyrë me kohë në gjuhën shqipe, janë përvetësuar nga gjuha dhe janë përshtatur sipas gjethes së gjuhës shqipe në sistemin e lakimit apo zgjedhimit dhe si të tilla ato më konsiderohen fjalë të shqipes. Brenga jonë është se si edhe këto fjalë e shumë fjalë të tjera po zëvendësohen ma anglicizma e po bëhen me një mënyrë të hovshme gjithë ky transformim.

2. Mediat dhe komunikimi masiv

Shqetësimi im më i madh përveç shkollave, universiteteve se si e trajtojnë gjuhën shqipe, qëndron edhe në faktin se si mediat po e përdorin atë.

Shohim në media se bëhet një shkelje e normës drejtshkrimore në radhë të parë, duke mos e vrarë mendjen fare se shqipja duhet të shkruhet në bazë të normës përkatëse, veç këtij sakatimi që i bëjnë shqipes, tjetra është se po e mbushin me shprehje e fjalë të panevojshme të marra nga gjuhët e tjera.

Në vijim do të shohim disa portale serioze të vendit se si i japin lajmet apo informacionet në lidhje me dukuri të ndryshme (nuk po përmendim emra).

...më vonë u *adaptuan* disa pjesë... (pse *adaptuan* në vend *u përshtatën*).

Kryetari *evitoi* të përgjigjet menjëherë (pse *evitoi* në vend që iu *shmangë*).

Kryetari i Komunës *apeloj* për të gjithë qytetarët (pse *apeloj* kur mund të ishte *bëri thirrje*).

Ai u shpreh se kjo çështje është *fallco* (pse *fallto* në vend që është e *rreme*).

Fëmijët ishin *kurioz* (në vend të *kurioz* e kemi shumë mirë shqip, *kureshtarë*).

Kjo ishte vetëm një pjesë shumë e cekët e gjithë fjalëve e shprehjeve të huaja që i përdorin mediat serioze në Maqedoninë e Veriut, por nuk mund të themi se vetëm me kaq bëjnë shkelje të gjuhës. Ata përdorin emrat e huaj të përveçëm ashtu siç janë pa mos i lakuar fare, duke harruar që në gjuhën shqipe ekziston lakimi i emrave si i atyre të përveçëm edhe emrave të përgjithshëm dhe ngjashëm si emrat shqip edhe emrat e huaj duhet të lakohen, kemi:

Trump u zgjodh edhe njëherë president i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (në vend **Trampi**).

Putin vijon sulmin në Ukrain (pse *Putin* kur duhet të ishte *Putini*).

Shembuj të tillë kemi shumë, lirisht mund të themi se pjesa më e madhe shkruajnë në këtë formë, gjithashtu nuk duhet harruar se në gjuhën shqipe ne e kemi parimin fonetik si bazë të parimeve të gjuhës në bazë të të cilit fjalët shkruhen ashtu siç i shqiptojmë, pra edhe emrat e huaj ne do t'i shkruajmë ashtu siç i shqiptojmë e jo siç janë në origjinal, pjesën e origjinalit e vendosim në kllapa menjëherë afër emrit.

Përfundim

Cenimi i gjuhës nuk ka të ndalur edhe pse ne mundohemi me shumë mund që t'u tregojmë se format e tilla janë gabim, por gjithmonë hasim në vesh të shurdhët dhe gabimet vazhdojnë të trashen edhe më shumë.

Por puna e gjuhëtarëve është që mos ndalojnë së kritikuari për gabimet që bëhen dhe gjithmonë të japin leksione se si duhet përdorur në formë të drejtë dhe të saktë norma drejtshkrimore e gjuhës shqipe.

Ata të cilët përdorin këto shprehje mendojnë se duken më të lexuar më të ditur apo se njohin një gjuhë tjetër, por e kanë shumë gabim. Nuk mund të krenohemi se dimë një gjuhë tjetër, se kemi jetuar jashtë edhe kemi shprehje të huaja, kur nuk i dalim zot emrit që kemi si shumicë, pra jemi shqiptarë dhe duhet të flasim e mbi të gjitha të shkruajmë shqip pa gabime ashtu siç është vendosur më 1972 në Tiranë, në Kongresin e Drejtshkrimit.

Literatura e shfrytëzuar

1. Memushaj Rami, Për Shqipen Standare I (Çështje të normës morfologjike dhe drejtshkrimore), Tiranë, 2012.
2. Memushaj Rami, Për Shqipen Standare II (Çështje të normës morfologjike dhe drejtshkrimore), Tiranë, 2012.
3. Qosja, R., Kongresi i drejtshkrimit—tridhjetë vjet pas, Tiranë, 2003.

4. Raka, Fadil, Historia e shqipes letrare, Grafikos Gjilan, Prishtinë, 2005.
5. Shkurtaç, Gj. Kultura e gjuhës, 2006.
6. Shkurtaç, Gj., Kahe dhe dukuri të kulturës së gjuhës shqipe, Tiranë, 2003.

UDC 81'27(450)(049.3)

UDC 81'27(497)(049.3)

Punim studimor

Izer MAKSUTI

Universiteti "Nënë Tereza" në Shkup

E-mail: izer.maksuti@unt.edu.mk

Recension / Review

për librin me përmbledhje studimesh të botuar nga Monica Genesin, Karl Gerhard Hempel dhe Thede Kahl, "**Varietetet gjuhësore të rrezikuara në Itali dhe në Ballkan**", me titullin origjinal:

Endangered Language Varieties in Italy and the Balkans / Bedrohte Sprachvarietäten in Italien und auf dem Balkan / Varietà linguistiche a rischio in Italia e nei Balcani, botuar nga Austrian Academy of Sciences Press, Vjenë, 2024, 384 fq. (*Vanishing Languages and Cultural Heritage [VLACH]*, vëllimi 4) ISBN 978-3-7001-9685-3.

Abstract

This review examines the edited volume *Endangered Language Varieties in Italy and the Balkans* (2024), edited by Monica Genesin, Karl Gerhard Hempel, and Thede Kahl, situating it within current scholarly debates on minority language policy, language maintenance, language migration, and language loss. The volume brings together seventeen contributions from sociolinguistic, dialectological, historical, and cultural perspectives, offering a comparative overview of endangered language varieties in Italy and Southeast Europe. Particular attention is given to the dynamics of multilingualism, language contact, and linguistic visibility in public space, as well as to the role of institutional and societal measures in the long-term maintenance of small language communities. The review highlights the volume's particular relevance for Albanian studies, especially with regard to historical and contemporary varieties of Albanian, Arbëresh communities, and processes of language loss in contexts of migration and diaspora. Overall, the volume is assessed as a significant contribution to European minority language research, combining empirical analysis with theoretical reflection and providing important impulses for future research and sustainable minority language policy.

Keywords: *Minority language policy, language maintenance, language migration, Albanian, language loss, language contact, multilingualism.*

Hyrje

E kemi të njohur vlerën që ka gjuha për ruajtjen e kujtesës kulturore, identitetit shoqëror dhe përvojës kolektive. Për atë humbja e çdo gjuhë do të thotë humbje e një botëkuptimi më vete. Ndikuar nga këto rrethana, ballafaqimi me dukurinë e gjuhëve të rrezikuara, sidomos në dekadat e fundit, nuk mbetet më vetëm një çështje gjuhësore, por është shndërruar në një ndër temat më të nxehta politike dhe mbarëshoqërore.

Dimë se Europa, veçanërisht Italia dhe Ballkani, janë më shumë të prekur nga rrezikimi dhe humbja e gjuhës. Po ashtu në tërë botën, mbi 45 % prej më pak se 7000 gjuhëve, merren si të rrezikuara, meqë bartja nga brezi në brez bëhet gjithë më e vështirë (Shih: UNESCO. *Atlas of the World's Languages in Danger*, 2010, fq. 11-12).

Sipas vlerësimeve të UNESCO-s një numër i madh i gjuhëve pakicë, ndër ta edhe Arbërishtja dhe Arvanitishtja, bëjnë pjesë në grupin e gjuhëve të rrezikuara, në nivele e forma të ndryshme.

Botimi për të cilin flasim në këtë recension, për lexuesin shqiptar ka një vlerë shtesë, pasi trajton me katër artikuj më vete disa variante të shqipes së vjetër.

Ky botim ofron një panoramë shumëgjuhëshe të hulumtimeve gjuhësore, kulturore dhe sociolinguistike mbi gjuhët e pakicës dhe gjuhët rajonale në Itali dhe në Europën Juglindore. Ai ndërthur me sukses kërkimin empirik, reflektimin kulturor-politik dhe përgjegjësinë shkencore. Forca e tij qëndron jo vetëm në gjerësinë tematike, por edhe në autoritetin shkencor të botuesve dhe të autorëve pjesëmarrës. Qëllimi i tij është të hedhë dritë mbi situatën komplekse të varieteteve gjuhësore të rrezikuara në Gadishullin Apenin dhe në Europën Juglindore, duke trajtuar njëkohësisht çështje të mbrojtjes së gjuhës, rivitalizimit dhe përgjegjësisë gjuhësore-politike në një kuadër europian. Të gjitha studimet këtu pasqyrojnë në mënyrë shembullore procesin e zhvillimit të rrezikimit të gjuhëve dhe të zhdukjes së tyre.

Të tre botuesit, janë emra të dëshmuar në këto fusha: Monica Genesin është një njohëse e shquar e kontakteve gjuhësore italo-shqiptare dhe romane-ballkanike dhe një përfaqësuese e dalluar në fushën e albanologjisë dhe gjuhësisë ballkanike në Itali; Karl Gerhard Hempel, specialist i studimeve sociolinguistike, sidomos mbi peizazhin gjuhësor, dhe Thede Kahl që është një nga ballkanologët më të njohur të kohës sonë, krijojnë së bashku një redaksi të rrallë për nga ana e përplotësimit të kompetencave shkencore.

Ky vëllim përfaqëson një botim të rrallë me rëndësi krahasuese, që lidhet në mënyrë tematike dhe metodologjike me botime si *Balkan and South Slavic Enclaves in Italy* (Kahl/Krapova/Turano, 2018) dhe *The Romance-Speaking Balkans* (Sorescu-Marinković et al., 2021), por i tejkalon ata në përmasa më të gjera dhe me të dhëna të përditësuara.

Në këtë kontekst, është me interes të shqyrtohen edhe studime dhe botime tjera, si i shkrimtarit austriak Karl-Markus Gauss (2022): *“Europianët që po shuhën: Në udhëtim te sefardët e Sarajevës, gjermanët e Gotçes, arbëreshët, sorbët dhe aromunët”*, (Die sterbenden Europäer: Unterwegs zu den Sepharden von Sarajevo, Gotscheer Deutschen, Arbëreshe, Sorben und Aromunen), ku autori përshkruan me ndjeshmëri poetike jetën e

komuniteteve të vogla evropiane, mes tyre edhe arbëreshët dhe arumunët. Të mos harrojmë pa përmendur këtu edhe botimet e shumta me vlerë mbi arbëreshët, nga vetë studiuesit arbëreshë, si Françesko Altimari (Francesco Altimari), Universiteti i Kalabrisë, Meteo Mandala (Matteo Mandalà), Universiteti i Palermos, si dhe shumë të tjerë, por edhe nga autorë shqiptarë si: Bardhyl Demiraj, Eqrem Çabej, Fatmir Toçi, Jup Kastrati, Mustafa Ibrahim, Rexhep Zllatku, etj. Janë të njohur edhe studiuesit austro-gjermanë me botimet e tyre themeltare edhe për arbëreshët e arvanitët dhe gjuhën e tyre, që në pjesën e dytë të shek. XIX dhe në fillim të shekullit XX si: Gustav Meyer, Maximilian Lambertz, si dhe të tjerë nga gjysma e dytë e shek. XX, si: Claus Haebler, Hans-Jürgen Sasse, Klaus Rother, Walter Breu, Elvira Glaser etj.

Ndryshe nga këta botime, që disa janë më tepër filologjike e përkthuese, libri për të cilin bëjmë fjalë ndjek një qasje më gjithëpërfshirëse, të mbështetur në analiza kulturore, sociolinguistike dhe politike.

Përmbajtja dhe ndërtimi i librit

Pas tekstit hyrës, libri përfshin 17 artikuj, të ndarë në katër njësi tematike: politika gjuhësore e pakicave, peizazhet gjuhësore, vitaliteti i varianteve të rrezikuara dhe kontakti gjuhësor dhe shumëgjuhësia, ku trajtohen nga këndvështrime të ndryshme të gjitha këto dukuri të varieteteve të rrezikuara në Itali dhe në Europën Juglindore. Këta studime janë botuar në tre gjuhë: gjermanisht, anglisht dhe italisht dhe ndahen sipas fushave tematike të sipërpërmendura, duke përfshirë perspektiva sociolinguistike, dialektologjike, didaktike dhe historike.

Më poshtë paraqesim listën e plotë të artikujve me titujt origjinalë dhe përkthimin e përshtatur në shqip:

1. Monica Genesin, Karl Gerhard Hempel & Thede Kahl: *Schutz und Erhalt von Minderheiten- und Regionalsprachen auf dem Balkan und in Italien*. (Mbrotjtja dhe ruajtja e gjuhëve minoritare dhe rajonale në Ballkan dhe Itali).

2. Monica Genesin, Karl Gerhard Hempel & Thede Kahl: *Konsens zu Schutz und Erhalt von Minderheiten- und Regionalsprachen*. (Konsensusi për mbrojtjen dhe ruajtjen e gjuhëve minoritare dhe rajonale).

3. Dejan Matić: *Defining Language Death*. (Përkufizimi i vdekjes së gjuhës).

4. Lucija Šimičić: *Institutional protection and sustainability of linguistic minorities in Croatia*. (Mbrotjtja institucionale dhe ruajtja e qëndrueshme e pakicave gjuhësore në Kroaci).

5. Fiorenzo Toso: *Le minoranze linguistiche storiche in Italia: a vent'anni dalla legge di tutela*.

(Pakicat gjuhësore historike në Itali: njëzet vjet pas ligjit të mbrojtjes).

6. Karl Gerhard Hempel: *Sprachentrennung oder Translingualismus? Zu Gestaltung und Funktion mehrsprachiger Beschilderung in der Südtiroler Sprachlandschaft*. (Ndarje gjuhësore apo translingualizëm? Mbi strukturën dhe funksionin e tabelave shumëgjuhëshe në peizazhin gjuhësor të Tirolit të Jugut).

7. Aleksandra Salamurović: *Marketplace und Linguistic Landscape: Novi Sad aus diachroner Perspektive*. (Tregu dhe peizazhi gjuhësor: Novi Sad-i nga një perspektivë diakronike).

8. Monica Genesin/Joachim Matzinger: *Linguistic Landscape: A preliminary case study of San Marzano di San Giuseppe (Provincia di Taranto, Apulia)* / Peizazhi gjuhësor: Një studim rasti paraprak mbi San Marzano di San Giuseppe (Provincia e Taranto-s, Pulia).

9. Maria Luisa Pignoli: *The Arbëresh communities in the Northern Arbëria: an update on their language vitality*. (Komunitetet arbëreshe në Arbërinë e Veriut: një përditësim mbi vitalitetin e tyre gjuhësor)

10. Emilia Conforti: *Alcuni aspetti cruciali relativi all'insegnamento della lingua italo-albanese*. (Aspekte kyçe në mësimdhënien e gjuhës italo-shqiptare).

11. Franco Forti: *Das Friaulische: Förderung einer historischen Minderheitensprache*. (Friaulishtja: Mbështetja e gjuhës së një pakice historike, autoktone).

12. Francesco G. Giannachi: *La toponomastica rurale greco-bizantina ed italo-romanza di Soletto nella Grecia Salentina*. (Toponomastika rurale greko-bizantine dhe italo-romane e qytetit Soletto në zonën e Grecia Salentina).

13. Luana Rizzo: *'Ethnic resistance' and continued Hellenism in Greek Byzantine Salento*. ('Rezistenca etnike' dhe vazhdimësia e helenizmit në Salento-n greko-bizantin).

14. Malinka Pila: *Il periodo ipotetico in resiano: un confronto con lo sloveno*. (Periudha hipotetike në resianisht: një krahasim me sllovenishten).

15. Walter Breu: *Sprachkontakt im Vergleich: Das Verbsystem im Albanischen und Slavischen des Molise*. (Kontakti gjuhësor në krahasim: sistemi foljor në shqipen dhe sllavishten e Molises).

16. Christoph Giesel: *"We speak a language which sounds a bit funny": Characteristics of the South Slavic Idioms of the Sandžak-Bosniaks in Istanbul (Turkey)*. / "Ne flasim një gjuhë që tingëllon pak qesharake": Karakteristikat e idiomave sllave jugore të boshnjakëve të Sanxhakut në Stamboll (Turqi).

17. Livio Gaeta: *Written and oral sources for the Walser linguistic islands in Italy*. (Burimet e shkruara dhe gojore për ishujt gjuhësorë Walser në Itali).

Artikulli i parë hyrës i këtij vëllimi, hartuar nga të tre botuesit: Monica Genesin, Karl Gerhard Hempel dhe Thede Kahl, me titull: *"Mbrojtja dhe ruajtja e gjuhëve minoritare dhe rajonale në Ballkan dhe Itali"*, nga faqja 11-24, përmban boshtin konceptual dhe analitik të gjithë librit. Duke ndarë në 5 nënkapituj tematikë si: 1. *Politika gjuhësore e pakicave në Europë: perspektivat e revitalizimit gjuhësor*, 2. *Peizazhet gjuhësore*, 3. *Si "mbijetojnë" gjuhët minoritare?*, 4. *Gjuhësia e kontaktit dhe shumëgjuhësia si fenomen i gjuhëve të pakicave*, si dhe 5. *Vdekja, zhdukja apo mbijetesa e gjuhëve*, autorët ofrojnë një panoramë të gjerë dhe të integruar të debatit bashkëkohor mbi mbrojtjen e gjuhëve të rrezikuara. Autorët argumentojnë bindshëm se njohja ligjore e gjuhëve minoritare nuk përbën një garanci të mjaftueshme për ruajtjen e tyre, nëse nuk shoqërohet me zbatim institucional efektiv, pranim shoqëror, mbrojtje, mbështetje dhe ruajtje nga brezat e ardhshëm të një

bashkësie gjuhësore. Analiza e dallimeve ndërmjet njohjes formale dhe praktikës reale gjuhësore, del si një nga kontributet më të vlefshme të këtij artikulli, pasi pasqyron një problematikë të përbashkët, si për rajonet e Italisë ashtu edhe për hapësirën ballkanike. Falë qartësisë analitike, mbështetjes empirike dhe lidhjes së drejtpërdrejtë me diskutet ndërkom-bëtare të politikës dhe planifikimit gjuhësor, ky artikull hyrës jo vetëm që përcakton në mënyrë koherente studimet pasuese, por ofron edhe një pikë orientimi të fortë për kërkime të ardhshme krahasimtare, në fushën e planifikimit dhe politikës gjuhësore për gjuhët minoritare.

Në punimin e dytë në kësaj vepre përmbledhëse, nga faqja 25-28, të tre botuesit paraqesin artikullin me titull: *“Konsensus për mbrojtjen dhe ruajtjen e gjuhëve minoritare dhe rajonale”*, i hartuar në dy gjuhë, gjermanisht dhe italisht, përmes së cilit pasqyrohet edhe fryma shumëgjuhëshe dhe ndërkulturore e këtij vëllimi. Një vlerë e veçantë e këtij artikulli qëndron në analizën e tensioneve ndërmjet politikave top-down (nga lartë- posht) dhe iniciativave bottom-up (poshtë-lart), duke argumentuar bindshëm se ruajtja dhe revitalizimi i suksesshëm i gjuhëve të rrezikuara mund të arrihet vetëm aty ku masat shtetërore ndërthuren me institucionet dhe angazhimin e komuniteteve lokale. Në këtë mënyrë, ky artikull jep një ndihmesë të rëndësishme teorike në fushën e menaxhimit dhe planifikimit gjuhësor, por njëkohësisht shprehet qartë kundër qëndrimit thjesht teknokratik ndaj politikave gjuhësore për gjuhët minoritare. Për hapësirën ballkanike, kjo qasje është veçanërisht e rëndësishme, pasi politikat gjuhësore shpesh zhvillohen në kontekste të ndjeshme etnopolitike, ku konsensusi shpesh është formal, i politizuar, dhe si pasojë mbetet i pa zbatuar në praktikë.

Studimi i autorit Dejan Matić: *“Përkufizimi i vdekjes së gjuhës”* (fq. 29-46), së pari ka vlerë teorike për konceptimin, përkufizimin dhe sqarimin në mënyrë sistematike të nocionit “vdekja e gjuhës”, i cili përdoret gjerësisht në sociolinguistikë, por ende shpesh mbetet i paqartë, ose i sqaruar thjesht e jo mjaftueshëm. Autori e kundërshton qasjen që e koncepton “vdekjen e gjuhës” si një ngjarje të rëndomtë, apo si rezultat të drejtpërdrejtë të rënies së numrit të folësve. Në kuadër të kësaj, Matić bën dallime të qarta ndërmjet vdekjes së gjuhës, erozionit gjuhësor dhe ndryshimit gjuhësor, duke treguar se këta procese, megjithëse të ndërlidhura, nuk janë identike dhe nuk duhet të ngatërrohen. Një element qendror i studimit është diskutimi i mekanizmave tipikë dhe shkaqeve të vdekjes së gjuhës, si humbja graduale e kompetencës, tërheqja nga domenet kyçe të përdorimit dhe, mbi të gjitha, ndërprerja e transmetimit dhe ruajtjes nga brezat e ardhshëm.

Artikulli i gjashtë me radhë, (fq. 93-120), me titull: *“Ndarje gjuhësore apo translingualizëm? Mbi strukturën dhe funksionin e tabelave shumëgjuhëshe në peizazhin gjuhësor të Tirolit të Jugut”*, i Karl Gerhard Hempel ofron një analizë për statusin gjuhësor dhe barazinë e gjuhëve, bazuar në peizazhin gjuhësor. Duke analizuar mbishkrimet zyrtare dhe private në peizazhin gjuhësor të Tirolit të Jugut, autori dëshmon se modeli dominues karakterizohet nga një bilinguizëm i ndarë, i cili pasqyron një politikë gjuhësore të orientuar drejt barazisë formale mes gjermanishtes dhe

italishtes. Përtej vlerës analitike, ky studim ka rëndësi të veçantë, për krahasimin me zona tjera shumëgjuhëshe, përfshirë Republikën e Maqedonisë së Veriut, pasi gjendja e peizazhit gjuhësor, si një ndër treguesit e dukshëm për statusin e gjuhës, dëshmon për nivelin e zbatimit të politikave të duhura gjuhësore në një vend.

Një nga blloqet tematik më të rëndësishëm, mendoj për lexuesin shqiptar, të këtij vëllimi përmbledhës lidhet me gjendjen e varieteteve arbëreshe në Itali dhe me efikasitetin e politikave gjuhësore për ruajtjen e tyre. Kontributi i dy albanologëve të njohur Monica Genesin dhe Joachim Matzinger-it, (fq. 161-181), mbi peizazhin gjuhësor të komunitetit arbëresh të San Marzano di San Giuseppe (provinca e Taranto-s, Pulia) përbën një studim rasti, me një metodologji pune, që duhet marrë si shembull, i cili e bën të dukshëm raportin e ngushtë ndërmjet përdorimit të gjuhës në hapësirën publike dhe kontekstit sociolinguistik. Vëmendje e veçantë i kushtohet rolit të toponimisë dhe mbishkrimeve publike si pjesë të njohjes simbolike në planin e politikave gjuhësore. Ky kontribut, shquhet për pozicionimin e qartë teorik në fushën e studimeve mbi peizazhin gjuhësor, dhe ofron njëkohësisht njohuri të vlefshme empirike për albanologjinë, duke dëshmuar se si politika e duhur gjuhësore, kujtesa kolektive dhe përpjekjet për revitalizim ndërthuren në nivel lokal. Në vazhdim, (fq. 183-203), studimi i Maria Luisa Pignoli-t, ofron një pasqyrë të përditësuar, empirike dhe teorikisht të argumentuar mbi vitalitetin e arbërishtes në zonën e Arbërisë së Veriut, që përfshin Abruco-n (Abruzzo), Molise-n, Pulia (Puglia) Veriore dhe Kampania (Campania). Autorja dëshmon se këta varietete ndodhen në faza të ndryshme të dobësimit gjuhësor, në disa raste duke iu afruar zhdukjes funksionale, ndërsa në të tjera duke ruajtur forma të kufizuara stabiliteti në bashkësinë gjuhësore. Një vlerë e veçantë e këtij kontributi qëndron në refuzimin e qasjeve homogenizuese, pasi këtu arbërishtja paraqitet si një vazhdimësi dinamike varietetesh dhe praktikash lokale, e ndikuar nga faktorë kompleksë si arsimi, migrimi, prestigji gjuhësor dhe mbështetja institucionale.

Studiuesja e njohur arbëreshe dhe albanologia Emilia Conforti në studimin e saj, fq. 205-213: *“Aspekte kyçe në mësimdhënien e gjuhës italo-shqiptare”*, argumenton në mënyrë të qartë për nevojën e njohjes së statusit zyrtar të arbërishtes te komuniteti arbëresh në Itali, duke vlerësuar rolin e gjuhës si instrument thelbësor i identitetit politik dhe kulturor. Autorja vë në pah se institucionalizimi i gjuhës nuk përfaqëson vetëm një akt simbolik, por një mekanizëm konkret për fuqizimin e përdorimit publik dhe shoqëror të saj.

Emilia Conforti trajton këtu çështje veçanërisht të ndjeshme dhe me rëndësi të madhe praktike, sidomos në fushën e mësimdhënies së arbërishtes te komunitetet arbëreshe. Ajo analizon sfidat kryesore didaktike dhe institucionale, duke dëshmuar se mësimi i gjuhës shpesh lëkundet mes standardizimit normativ dhe ruajtjes së të folmeve lokale.

Së bashku, këta tre kontribute ndërtojnë një tablo realiste të dobishme mbi sfidat aktuale të ruajtjes së arbërishtes në Itali. Ata e zhvendosin

diskutimin nga niveli thjesht normativ drejt një reflektimi më të thellë mbi raportin mes njohjes ligjore, praktikës shoqërore dhe vitalitetit real gjuhësor, duke e bërë këtë pjesë të vëllimit veçanërisht të vlefshme për albanologjinë, sociolinguistikën dhe studimet mbi politikat gjuhësore të pakicave në Europë.

Studiuesit gjermanë Elvira Glaser dhe Walter Breu, krahas hulumtimeve të tyre në fushën e gjermanistikës dhe sllavistikë, njihen edhe për kontributin e tyre në albanologji, veçanërisht për botimet kushtuar arbërishten dhe komuniteteve arbëreshe. Te studimi i Walter Breu-t (fq. 301-323), gjejmë një analizë me qasje krahasimtare, të dy ishujve gjuhësorë, përkatësisht të të folme të fshatrave sllave dhe shqiptare në Molise, në Italinë e Jugut.

Në qendër të analizës qëndrojnë kategoritë gramatikore të aspektit, kohës, mënyrës dhe diatezës së foljes, përmes të cilave autori shqyrton zhvillimet strukturore të shkaktuara nga kontakti i gjatë dhe i drejtpërdrejtë gjuhësor me varietete romane. Duke qenë se të dy komunitetet pakicë, ndajnë të njëjtin mjedis kontakti, krahasimi rezulton metodologjikisht i qëndrueshëm dhe nxjerr në pah si ngjashmëritë, ashtu edhe dallimet në sistemin foljor të shqipes dhe sllavishtes së Molises.

Ky studim përbën kulmin strukturor të vëllimit, duke dëshmuar vlerën e lartë shkencore për albanologjinë dhe sllavistikën, si edhe rëndësinë e gjuhësisë për studimin e varieteteve gjuhësore të rrezikuara dhe kërkimin bashkëkohor të kontaktit gjuhësor.

Gjatë paraqitjes dhe vlerësimit të këtij botimi u ndalëm qëllimisht më së shumti, së pari te tre artikujt që flasin në përgjithësi për çështje të shumëgjuhësisë, të politikave gjuhësore dhe të kontaktit gjuhësor, dhe në pjesën e dytë, veçanërisht më shumë te katër studimet mbi arbërishten.

Por edhe artikujt tjerë në këtë botim përmbledhës trajtojnë tema nga më të ndryshmet. Veçojmë këtu për të vlerësuar edhe dy prej tyre. Studimi i autores Aleksandra Salamurović: *“Tregu dhe peizazhi gjuhësor: Novi Sad-i nga një perspektivë diakronike”*, nga fq. 121-160, analizon peizazhin gjuhësor të qytetit të Novi Sadit nga një perspektivë diakronike, me vështrim të veçantë të hapësirave të tregut, si dhe të mbishkrimeve të shitoreve, librarive, hoteleve dhe restoranteve. Qëllimi i analizës është të pasqyrojë ndryshimet e përdorimit të gjuhëve dhe sistemeve të shkrimit në hapësira publike, si dhe të interpretoj ata në ndërlidhje me historinë shumëetnike të qytetit. Artikulli dëshmon se si gjatë një periudhe kohore është ndryshuar ky peizazh gjuhësor, dhe çka janë arsye socio-kulturore që ndikuan këtë tjetërsim. Njëkohësisht bëhet e qartë se, zhvillimet historike kanë ndikuar dukshëm në strategjitë e sotme për mbështetjen e multikulturalitetit dhe shumëgjuhësisë në qytetin e Novi Sadit.

Artikulli me temën: *“Ne flasim një gjuhë që tingëllon pak qesharake”*: *Karakteristikat e idiomave sllave jugore të boshnjakëve të Sanxhakut në Stamboll (Turqi)*, prej faqes 325-359, nga një studiues i njohur në këtë fushë, Christoph Giesel, trajton temën e migrimit të boshnjakëve nga rajoni i Sanxhakut në Perandorinë Osmane, gjegj. në Turqi në mes të viteve 1878

dhe 1970, si dhe gjendjen e sotme gjuhësore të bashkësisë boshnjake në Stamboll.

Në qendër të analizës mbetet zhvillimi i të folmes së tyre, një variant i shtokavishtes sllavo-jugore, e cila është ndikuar tepër përmes kontaktit gjuhësor të vazhdueshëm ndër vite, sidomos me turqishten. Këtu dëshmohet një proces i dukshëm dhe tepër i përparuar i humbjes së gjuhës brenda kësaj bashkësie, por në anët tjetër sqarohet se, megjithëse kemi një proces asimilimi, ruhen edhe më tutje tipare të identitetit gjuhësor dhe kulturor. Ky studim shquhet për ekspertizën profesionale dhe analizën diakronike, sociolinguistike, si dhe për vështrimet me vlerë mbi ndryshimet gjuhësore, migrimin dhe gjuhët pakicë në kontekstin e diasporës.

Në vazhdimësi të hulumtimeve në këtë fushë, do të ishte tepër e dobishme, po të bëhen studime të ngjashme edhe për gjendjen gjuhësore të bashkësisë shqiptare në Turqi, duke përfshirë periudha të ndryshme kohore të ekzistencës së tyre, edhe atë jo vetëm në Stamboll, por edhe në rajone tjera të këtij vendi. Një krahasim i tillë mund të na sillte vështrime me vlerë mbi dallimet, por edhe paralelet, për sa u përket dukurive si kontakti gjuhësor, humbja e gjuhës dhe ruajtja e identitetit.

Risia shkencore e botimit dhe rëndësia për lexuesin shqiptar

Ky vëllim përmbledhës plotëson një boshllëk të dukshëm në literaturën ndërkombëtare mbi gjuhët e rrezikuara, duke fokusuar për herë të parë Italinë dhe Ballkanin në një kuadër të përbashkët krahasues. Risia e tij qëndron në qasjen ndërdisiplinare dhe në përdorimin e të dhënave të reja nga terreni, që e bëjnë librin një pikë referimi për kërkime në të ardhmen. Botimi i studimeve në tre gjuhë: gjermanisht, anglisht dhe italisht, e pasqyron shumëgjuhësinë e rajonit, dhe e bën veprën të qasshme për një audiencë të gjerë ndërkombëtare. Vepra shquhet për baraspeshën ndërmjet analizës teorike dhe empirike, si dhe për ndjeshmërinë kulturore që shoqëron çdo studim.

Vlera e këtij botimi shtrihet përtej kontekstit akademik evropian, sepse ai ofron një model të zbatueshëm për rajonin e Europës Juglindore, ku vetëdija për ruajtjen e trashëgimisë gjuhësore ende nuk është zhvilluar mjaftueshëm. Në shumë vende të rajonit, përfshirë Republikën e Maqedonisë së Veriut, mungon ende një literaturë e përqendruar mbi mbrojtjen e gjuhëve të pakicave dhe të drejtave gjuhësore në praktikë.

Shpesh, shumëgjuhësia shihet sërish si rrezik politik, e jo si pasuri kulturore dhe mundësi shtesë për bashkëjetesë. Ky vëllim besoj se ndër të tjera do të ndihmojë në heqjen e këtij paragjykimi, duke ndryshuar këtë këndvështrim, pasi këtu paraqitet larmia gjuhësore si element i zhvillimit dhe pasurimit kulturor.

Ky botim ofron argumente shkencore që mbështesin idenë se kultivimi i shumëgjuhësisë dhe i më shumë identiteteve kulturore forcon kohezionin shoqëror. Në këtë kuptim, libri mund të shërbejë edhe si udhërrëfyes për zbatimin e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve në Maqedoninë e Veriut, përmirësimin e tij dhe për krijimin e një vetëdijeje mbarëshoqërore, që larmia gjuhësore është pasuri kombëtare dhe evropiane.

Në tërësi, ky libër është një vëllim shkencor i jashtëzakonshëm, që ndërthur thellësinë analitike me ndjeshmërinë etnolinguistike. Për studiuesin shqiptar, ky libër ofron jo vetëm dhëna të çmuara, por edhe frymëzim metodologjik dhe krahasues, duke treguar se dokumentimi, mësimdhënia, planifikimi dhe politikat gjuhësore, duhet të zhvillohen paralelisht për të siguruar mbijetesën e gjuhëve të vogla. Ai përbën një kontribut themelor edhe për albanologjinë, gjuhësinë ballkanike dhe studimet ndërdisiplinare mbi trashëgiminë kulturore në përgjithësi.

Në përfundim, libri në fjalë: "*Varietetet gjuhësore të rrezikuara në Itali dhe në Ballkan*" dëshmon në mënyrë bindëse se studimi i gjuhëve minoritare nuk është vetëm një çështje dokumentimi shkencor, por një fushë ku ndërthuren identitete kolektive, praktika sociale, politika publike, si dhe përgjegjësi kulturore. Duke kombinuar analiza teorike me studime empirike të bazuara në terren, ky botimi arrin të paraqesë një tablo komplekse dhe realiste të sfidave me të cilat përballen gjuhët e vogla në Europë. Një meritë e veçantë e këtij botimi qëndron në aftësinë për të nxjerrë mësim të dobishme, nga kontekste të ndryshme rajonale, duke treguar se ruajtja e gjuhëve minoritare kërkon bashkërendim të masave, ku njohja ligjore, arsimi, prania publike dhe përfshirja aktive e komuniteteve, veprojnë në mënyrë të ndërlidhur.

Në këtë kuptim, libri përbën jo vetëm një kontribut shkencor të nivelit të lartë, por edhe një thirrje të argumentuar për reflektim kritik mbi mënyrën se si shoqëritë europiane e konceptojnë dhe e menaxhojnë shumëgjuhësinë.

Për hapësirën shqiptare dhe ballkanike në përgjithësi, ky botim ofron një pikë referimi të domosdoshme, duke dëshmuar se mbijetesë e gjuhëve nuk varet nga madhësia e tyre numerike, por nga vullneti politik, vetëdija shoqërore dhe aftësia për t'i parë ato jo si pengesë, por si pasuri kulturore.

Numrat e botuar deri më tani

Kopertina e Revistës INTERKULTURA	Përmbajtja
	<p><i>Zeqirja NEZIRI - Aspekte ndërkulturore të kancelarisë së Skënderbeut (7-14)</i> <i>Mustafa IBRAHIMI - Koncepte, dallime dhe konflikte të multikulturalizmit përballë globalizmit (15-28)</i> <i>Rizvan SULEJMANI- Zgjidhja e konflikteve ndëretnike – rasti i Maqedonisë (29-44)</i> <i>Avzi MUSTAFA - Kufiri ndërmjet kulturave të ndryshme, vështruar përmes romanit “Ballkanbabilonasi” të Luan Starovës (45-52)</i> <i>Gjylmysere KASAPI - dallimet dhe ngjashmëritë në kulturat e familjeve maqedonase dhe shqiptare në Maqedoni (53-60)</i> <i>Sefer TAHIRI - Skicë për mbindërtimin e Maqedonisë shumëkulturore dhe ndërkulturore (61-80)</i> <i>Rubin ZEMON - Sfidat bashkëkohore në drejtimin e shoqërive të diversitetit (81-92)</i> <i>Mirjana MALESKA - Multikulturalizmi - koncepti pluralist dhe tolerues për integrim (93-100)</i> <i>Kosta MILLKOV - I kujt është vendi? Kufizime kulturore dhe territoriale në kontekst të konflikteve ballkanike dhe kriza e refugjatëve në lindjen e mesme (101-113)</i></p>
	<p>Aziz POLLOZHANI (rektor) – Respekti i ndërsjell – bazament i një kohezioni social në shoqëri – fjalë përshëndetëse <i>Zeqirja NEZIRI - Pjetër Bogdani afirmues i teozofisë baroke (9-26)</i> <i>Vebi BEXHETI - Përmasa universale në poezinë e Migjenit (27-32)</i> <i>Mustafa IBRAHIMI - Elemente etnografike dhe arti shqiptar në muret e kishave të Prilepit dhe Ballkanit nga piktori mesjetar Onufri (33-46)</i> <i>Sunaj RAIMI - Jan Kukuzeli – kompozitori shqiptar mesjetar me dimensione botërore (47-60)</i> <i>Avzi MUSTAFA - Grigor Përliçevi dhe kontributi i tij interkulturore (61-72)</i> <i>Asllan HAMITI - Rëndësia e «Fjalorit tri gjuhësh» të Gjorgji Puleskit (73-88)</i> <i>Nebi DERVISHI - Kontributi i Josif Bagerit për gjuhën dhe kulturën shqipe në Rekën e Epërme (89-98)</i> <i>Mixhait POLLOZHANI - Tradita jonë interkulturore në artet pamore (99-112)</i> <i>Rizvan SULEJMANI - Sa kanë ndikuar dallimet fetare dhe kulturore në formimin e kombit “modular” shqiptar? (113-130)</i></p>
	<p>Aziz POLLOZHANI (rektor) – Sistemi arsimor faktor i rëndësishëm në ndërtimin e një shoqërie interkulturore – fjalë përshëndetëse <i>Don Lush GJERGJI, Nëna Tereze - simboli i paqes dhe dashurisë, mishërimi dhe paradigma e interkulturalizmit universal (</i> <i>Rizvan SULEJMANI, Arsimi interkulturore dhe kultura në kohë Pandemie</i> <i>Mustafa IBRAHIMI, Reformet gjuhësore në arsimin e shoqërive shumëkulturore - rasti Maqedonia e Veriut</i> <i>Rubin ZEMON, Historia, antropologjia dhe kompetencat ndërkulturore</i> <i>Ajten HAJDARI-QAMILI, Interkulturalizmi në institucionet publike në RMV</i> <i>Berton SULEJMANI, Interkulturalizmi gjuhësor nëpërmjet frazeologjizmave në gjuhën shqipe dhe maqedonase</i> <i>Ismet OSMANI, Interkulturalizmi në procesin edukativo-arsimor në Republikën e Maqedonisë së Veriut</i> <i>Sunaj RAIMI, Disa komponentë interkulturore në folklorin e helenëve të lashtë dhe shqiptarëve të sotshëm</i> <i>Mixhait POLLOZHANI, Arti si veprimtari e kultivimit të interkulturalizmit</i></p>

 <p>ISSN 2073-3884</p> <p>INTERKULTURA Вестник факультета и Факултетот за Хуманитарни Науки Научно списание на Факултетот за Хуманитарни Науки Journal of the Faculty of Human Sciences</p> <p>4</p> <p>ICONS 2023</p> <p>INTERKULTURA No. 4 Pg. 1-191 Shkup 2024</p>	<p>Zeqirja Neziri: Fati i të folmes së arbëreshëve të Zarës</p> <p>Mustafa Ibrahim: Ekolinguistika përballë interkulturalitetit në një shoqëri shumëgjuhëshe</p> <p>Vebi Bexheti: Toka me shije, ulliri pak të hidhur pak të ëmbël</p> <p>Azis K. Pollozhani: Interkulturalizmi një paradigmë e re e shoqërive multietnike</p> <p>Begzad Baliu: Pikëpamjet e linguistike të profesor Shefki Sejdiut</p> <p>Ismet Osmani: Përkthimi si akt ndërkulturor</p> <p>Izaim Murtezani: Ligjërime imagologjike apo konstrukti diskurziv i tjetrit dhe tjetërsisë</p> <p>Teuta Arifi: Interkultura, një koncept progresiv i rilindjes kombëtare shqiptare</p> <p>Rubin Zemon: Ndërkulturalizëm pa kulturë dhe kontakte në Ballkanin Perëndimor</p> <p>Qatip Arifi: Anglishtja si lingua franca (alf) dhe aplikimi i saj në procesin e mësimdhënies së kësaj gjuhe</p> <p>Ajten Hajdari-Qamili: Leksiku ndërkulturor dhe ndërgjuhësor në të folmen urbane të strugës</p> <p>Sejdi M. Gashi: Roli i medieve në (mos) ngritjen e prestigjit të shqipes</p> <p>Agron Vrangalla: Analizë kritike e diskursit: gjuha e Albin Kurtit në intervistën e dhënë për CNN (31 maj)</p> <p>Kosovare Krasniqi: Imagologjia dhe përkthimi</p> <p>Arta Tika Bekteshi: Choosing the correct n-word or npi - a case study with albanian students</p> <p>Viktoria Elenova: Процесите кон восприемање и предавање странски јазик</p> <p>Јордана Шемко-Георгиевска - Елена Пренцова: Превод на билингвалните и дводомните културолошки елементи во примери од чикана поезијата</p> <p>Jetlira Beqiri: Interkulturaliteti në emërtimet e lidhjeve farefisnore në dialektet e gjuhës shqipe</p>
 <p>ISSN 2073-3884</p> <p>INTERKULTURA Вестник факультета и Факултетот за Хуманитарни Науки Научно списание на Факултетот за Хуманитарни Науки Journal of the Faculty of Human Sciences</p> <p>5</p> <p>Van 10</p> <p>No. 5 Pg. 1-200 Shkup 2024</p>	<p>Mustafa Ibrahim: Kontributi i arbëreshëve për një alfabet të njësuar</p> <p>Zeqirja Neziri: Përpjekjet e shkrimtarëve të mocëm për një alfabet kombëtar</p> <p>Vebi Bexheti: “Trimdita”, Si metaforë e qëndresës arbëresho- shqiptare në poezinë e Zef Skiro Di Maxhos</p> <p>Xhemaludin Idrizi: Autorët arbëresh në tekstet shkollore të gjuhës shqipe në Republikën e Maqedonisë së Veriut</p> <p>Begzad Baliu: Naum Veqilharxhi: Ndërmjet dy rilindjeve</p> <p>Ismet Osmani: Mbi leksikon terminologjik të teksteve mësimore në shkollat nëntëvjeçare</p> <p>Ajten Hajdari - Qamili: interferenca gjuhësore mes shqipes, turqishtes dhe maqedonishtes në Maqedoninë e Veriut</p> <p>Farketa Dibra – Zeqiri: Kongresi i Manastirit - Ngjarje epokale e historisë dhe kulturës kombëtare</p> <p>Arta Tika Bekteshi - Teuta Agaj Avdiu: Mbi natyrën mohuese të përemrave të pacaktuar të shqipes</p> <p>Sejdi M. Gashi: Modaliteti i saktësisë dhe kuptimi kohor i formave foljore do të jem /do të kem në gjuhën shqipe (analizë kontrastive)</p> <p>Rilind Mahmudi, Majlinda Ismaili-Mahmudi: Roli i leksikut dhe i përkthimit në strukturën e fjalisë</p> <p>Mirvan Xhemali: Përmirësimi i aftësisë së të lexuarit të nxënësve në gjuhën angleze përmes përdorimit të filmave</p> <p>Drita Xhemali: Kompetenca gjuhësore e brezit të tretë të emigrantëve shqiptarë në Gjermani</p> <p>Rubin Zemon: “Imagjinarteti i Ballkanit në kontekstin global”</p> <p>Muhamedali Ibrahim: Roli i diplomacisë ndërkulturore</p> <p>Avni Avdiu: Globalizmi mediatik</p> <p>Drenusha Kamberi: Telosi i kulturës kapitaliste</p> <p>Albulena Dehari: Dallimet gjatë përshëndetjeve në mes gjinive të kundërta</p>



Oliver Jens **SCHMITT** – Pse merremi me historinë shqiptare?;
 Mustafa **IBRAHIMI** – Ndikimi i globalizmit në zhvillimin e blendeve si dukuri sociolinguistike;
 Begzad **BALLIU** – Fjalëshpejta në gjuhën shqipe;
 Izer **MAKSUTI** – Mbi rëndësinë e ruajtjes së gjuhës shqipe në diasporë: vëzhtrësitet dhe mundësitë – në shembullin e vendeve gjermanishtfolëse;
 Ajten hajdari–**QAMILI** – Përballjet e shqipes standarde në Maqedoninë e Veriut me politikat vendore dhe me globalizimin;
 Teuta **ARIFI** – Gruaja në traditën zakonore shqiptare;
 Qatip **ARIFI** – Roli i fjalorëve në mësimin e gjuhës angleze: një perspektivë konstruktiviste;
 Kosovare **KRASNIQI** – Letërsia shqiptare në Kosovë gjatë dekadave '90 dhe '00: rezistencë dhe transformim;
 Sejdi m. **GASHI** – Leksiku i jurisprudencës në disa medie të Kosovës dhe të Shqipërisë;
 Faton **KRASNIQI** – Fjalësi gjuhësor dhe estetik i veprës letrare të Beqir Musliut;
 Albulena **DEHARI** – Pasurimi i gjuhës nga Kadareja;
 Agron **KURTISHI**, Agron **VRANGALLA**, Avni **AVDIU** – Stereotipet gjinore në reklamat mediatike në Maqedoninë e Veriut: një studim empirik;
 Milica **DENKOVSKA** – Rrëfime udhëtimi: një zhanër letrar?;
 Drenusha **KAMBERI**, Avni **AVDIU** – Etnocentricizmi mitologjik serb mbi Kosovën;
 Rilind **MAHMUDI**, Majlinda ismaili–**MAHMUDI** – Dallimet midis përvetësimit të shqipes dhe të mësuarit e anglishtes si gjuhë e dytë;
 Chen **FENGHUA** – Peizazhi gjuhësor si fushë studimi dhe trajtimi i tij në punimin e disertacionit “Peizazhi gjuhësor i hapësirave komerciale – studim krahasues i Shqipërisë dhe Kinës” nga Benjamin Shurdhi;
 – Numrat e botuar deri më tani.